



AKADEMIA E SHKENCAVE E SHQIPËRISË

RAPORT

i Akademisë së Shkencave, 2017





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AKADEMIA E SHKENCAVE E SHQIPËRISË
A S A M B L E J A**

RAPORT
i Akademisë së Shkencave, 2017

Tiranë, 27 prill 2018

**RAPORT
I AKADEMISË SË SHKENCAVE, 2017**

**Përgatitur në përfundim të procesit të analizave vjetore
në seksionet shkencore dhe në sektorët e ASH-së,
referuar dokumenteve zyrtare të paraqitura prej tyre, pjesë e këtij raporti.**

**Redaktore: Brikena Liko
Paraqitja grafike: Enkelejda Misha**

**Aprovuar në mbledhjen e asamblesë së Akademisë së Shkencave,
datë 27 prill 2018**

Për raportet vjetore të ASH shih: <http://akad.gov.al/ash/asambleja/raporte>

PASQYRA E LËNDËS

Një vështrim i shkurtër panoramik për veprimtarinë vjetore të ASH	4
Kreu I.	
Raportimet zyrtare në analizat vjetore në seksione të zhvilluara në muajin mars 2018	7
I. Raportimi i paraqitur në analizën vjetore të SSHNT (Seksioni i Shkencave Natyrore e Teknike)	7
II. Raportimi i paraqitur në analizën vjetore të SSHSHA (Seksioni i Shkencave Shoqërore dhe Albanologjike)	79
Kreu II.	
Veprimtaria vetjake e anëtarëve të Asamblesë së ASH (Shtojcë I)	88
A. Veprimtaria individuale e anëtarëve të SSHNT	88
B. Veprimtaria individuale e anëtarëve të SSHSHA	112
Kreu III.	
Reforma në Akademinë e Shkencave hap pas hapi	121
Kreu IV.	
Veprimtaria e administratës dhe shërbimeve (shtojcë II)	133
• Botimet 2017	154
• Disa përparësi themelore për veprimtarinë e vitit 2018	159

NJË VËSHTRIM I SHKURTËR PANORAMIK PËR VEPRIMTARINË VJETORE TË AKADEMISË SË SHKENCAVE

Raporti vjetor i veprimtarisë së Akademisë së Shkencave për vitin 2017, është konceptuar si një shumatore e raporteve që secila njësi - në radhë të parë dy seksionet - si dhe ato të administratës dhe të shërbimeve, ka paraqitur në analizat vjetore tashmë të zhvilluara.

Jo vetëm burimet e këtij raporti, por dhe shqetësimet e parashtruara, vlerësimet për çfarë është arritur e çfarë përbën mosarritje, janë paraqitur në këtë dokument ashtu si kanë rezultuar në analizat vjetore të dy seksioneve dhe në njësitë e shërbimeve.

Viti 2017 ishte një vit nga më të vështirët për Akademinë e Shkencave, në mos më i vështiri që prej themelimit të saj.

Funksionimi, misioni, përbërja, kuadri ligjor, zgjedhjet në funksione drejtuese, rendi i brendshëm në Akademinë e Shkencave, u bënë çështje jo vetëm e opinioneve shkencore, por edhe e opinioneve publike në përgjithësi.

Debati që shoqëroi veprimtarinë e Akademisë së Shkencave gjatë vitit 2017, jo vetëm pjesa me karakter konstruktiv e tij, por edhe qortimet e rrepta, dyshimet e pafundme, mllefet dhe deri thirrjet për shuarjen institucionale të saj, patën anën e mirë, sepse shërbyen për një rikonceptim të përgjithshme të mënyrave tradicionale të administrimit.

U bë e qartë se Akademia e Shkencave nuk mund të ekzistonte më si më parë dhe se të gjitha krizat që ajo kishte kaluar, prej krizës statutore dhe mospërfshirjes në reformën institucionale të kërkimit shkencor, deri tek kriza e përfaqësimit, nuk do të mund të kapërceheshin pa ndryshimin e ligjit kuadër të rregullimit të veprimtarisë së saj.

Po ashtu, u bë e qartë se asnjë prej problemeve të akumuluar ndërmjet viteve, duke përfshirë përtëritjen e ngadaltë të Asamblesë, kufizimet në decentralizimin e përgjegjësi, krijimin e distancave mes brezave të studiuesve, kërkimin e pasuksesshëm të vendit të institucionit në kuadër të rregullimit të ri të sistemit të kërkimit shkencor në vend, nuk mund të pritej të zgjidheshin nga autoritetet qeverisëse.

Akademia e Shkencave përmes asamblesë vuri në lëvizje mundësitë e veta intelektuale për të shprehur me gjuhë juridike vullnetin e vet për mënyrën si e kupton të ardhmen e saj.

Duke qenë një vit reflektimi të përgjithshëm, Akademia e Shkencave pati gjatë vitit 2017 ndryshime cilësore në përfytyrimin e së ardhmes së saj, duke iu larguar disa koncepteve gati-gati të kthyer në tabu. Në mënyrë të veçantë mendimi reformues u çlirua prej një pengese shumë të fortë, që përmbledhet në pyetjen nëse institucioni do të ringrihej si një akademi me institute, siç kishte qenë deri në vitin 2008, apo do të përshtaste një model tjetër, që nënkuptonte edhe ndryshimin e misionit të saj në jetën shkencore të vendit. E gjendur nën një qortim të përgjithshëm prej institucioneve qeverisëse, atyre të arsimit universitar dhe kërkimit shkencor dhe deri prej taksapaguesve shqiptarë, Asambleja e Akademisë u bë protagoniste e ndryshimit, duke ndërmarrë iniciativë të njëpasnjëshme, me qëllim që vullneti i saj të shprehej besnikërisht dhe komunikimi me institucionet e tjera të ishte i drejtpërdrejtë me të.

Pothuajse të gjithë anëtarët e Asamblesë, duke përfshirë dhe shumë anëtarë nderi, u përfshinë në komisione, në grupe pune, në organizma të ngarkuar me detyra prej saj, me qëllim që propozimi për daljen prej krizës të shprehej me gjuhën e ligjit.

Duke qenë një prej viteve me vëmendjen më të madhe kritike publike, viti 2017 ishte njëherësh edhe viti që gjallëroi dhe vuri në lëvizje në tërësi Asamblesën, e cila është në të vërtetë Akademia e Shkencave, duke transferuar autoritet e kompetenca pikërisht tek ajo. Pikërisht këtu ne vërejmë burimin e një progresi të ndjeshëm që u dëshmuoi sidomos në tremujorin e katërt të vitit 2017.

1. U kalua prej retorikës dhe dialogut burokratik-formal, shpesh herë edhe të munguar; në nisma për ndryshimin e gjendjes;
2. U rivendos komunikimi midis Akademisë së Shkencave dhe Qeverisë dhe u arrit në përfundimin e përbashkët për rindërtimin juridik dhe funksional të saj;
3. Komunikimi dhe rivendosja e mirëbesimit dhe e dialogut konstruktiv u pasua me krijimin e komisioneve institucionale e ndër-institucionale, me qëllim që reforma të merrte karakterin e një nisme juridike me mbështetjen dhe ekspertizën e ALLEA dhe Akademisë Kombëtare Gjermane LEOPOLDINA; (shih: <http://akad.gov.al/ash/ecuria-e-reformes>)
4. Produkti i punës, një paketë e re juridike që përmban dy projekt-ligje: projektligjin për Akademinë e Shkencave (shih: <http://akad.gov.al/ash/pdf/Draftligji%20per%20ASH.pdf>) dhe projekt-kodin e deontologjisë në kërkimin shkencor (shih: <http://akad.gov.al/ash/pdf/KODI%20%20ETIK%20NE%20KERKIMIN%20SHKENCOR.pdf>); si dhe aktet nënligjore që i bëjnë këto ligje të zbatueshëm: Statuti, rregullore të brendshme, kritere të pranimeve të reja në Asamble, kritere të zgjedhjes në funksionet drejtuese në Akademi, kriteret për përzgjedhjen e titujve për botim dhe për themelimin e dhënien e çmimeve shkencore, është tashmë në pritje për t'u futur në procedurën e domosdoshme për t'u kthyer në akte për zbatim.

Viti 2017, qoftë për shkak të detyrave imperative për ndryshim e reformim, qoftë prej vullnetit të brendshëm të Akademisë së Shkencave, mund të cilësohet si vit i një

hapjeje të dukshme ndaj qendrave dhe njësive të tjera kërkimore dhe shkencore, ndaj individëve dhe institucioneve, ndaj kërkuesve të rinj dhe atyre në karrierë.

Rezultati më i rëndësishëm i këtij procesi është rikthimi i besimit tek vetëpërtëritja, dalja prej vetëmjaftueshmërisë, krijimi i bindjeve për domosdoshmërinë e të punuarit me të tjerë. Akademia e Shkencave është sot jo nën kërcënimin e mosqenies, por me një perspektivë të hapur, që do të konfirmohet gjatë vitit 2018. Asambleja e saj arriti të tregojë energji dhe fuqi reformuese.

Të gjitha këto janë të paraqitura në këtë raport në një kapitull të shkurtër, në të cilin gjendet kalendari i reformimit institucional dhe i nismave të ndërmarra, që mund të shërbejë dhe si një pasqyrë e kurbës së hapave të parë të daljes nga kriza. Kalendari dhe vendimet që janë marrë për reformimin paraqiten pa komente, sepse secili nga anëtarët e Asamblesë, në një mënyrë a një tjetër, është subjekt i tyre.

Sa u takon detyrave që Akademia e Shkencave ka kryer si në vitet të mëparshme, ato paraqiten në raportet e seksioneve herë në mënyrë tradicionale e herë në mënyrë tjetër.

Raportimi i veprimtarisë në seksione dhe pasqyrat e punës të shërbimeve dhe të administratës janë analitike. Kjo sigurisht nënkupton se në raport ka edhe informacion të tepërt për Asamblenë, por mungesat në Kryesi kufizojnë të drejtën për të bërë ndryshime në përmbajtjen e tyre.

KREU I

RAPORTIMET ZYRTARE NË ANALIZAT VJETORE NË SEKSIONE

I. Raportimi i paraqitur në analizën vjetore të SSHNT

Hyrje

Seksioni i Shkencave Natyrore dhe Teknike (SSHNT), si një nga dy seksionet ku zhvillohen veprimtaritë për kërkim e zhvillim të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë (ASHSH) në përmbushje të misionit të saj, gjatë vitit 2017 ka synuar realizimin e veprimtarive në disa drejtime kryesore, në:

- këshillimin dhe ekspertizën e nevojshme për institucionet politikëbërëse dhe vendimmarrëse në fushat e kërkim zhvillimit;
- paraqitjen e arritjeve dhe problematikave të kërkim zhvillimit, në fushat përparësore të zhvillimit të përgjithshëm të vendit nëpërmjet organizimit të kongreseve, konferencave e workshopeve/debateve shkencore në shkallë kombëtare e ndërkombëtare;
- bashkëpunimin me institucionet qeveritare në identifikimin e problematikave për angazhimin e ASHSH-së në realizimin e objektivave të Qeverisë, në grupe qeveritare, nderministrore, borde, këshille, grupe *ad hoc*, etj;
- bashkëpunimin me institucionet kërkimore e mësimore brenda dhe jashtë vendit për kryerjen e studimeve në fusha të ndryshme të shkencës e teknologjisë, për hartimin e programeve kombëtare e dypalëshe, ekspertizave e monitorimeve në shkallë vendi etj.;
- bashkëpunimin me biznesin dhe prodhuesit në të gjithë nivelet, në lidhje me zbatimet e produkteve të kërkimeve shkencore e inovative në veprimtaritë ekonomike;
- transferimin e teknologjive inovative nga rrjeti i akademive të shkencave të botës (InterAcademy Partnership), ai vendeve të Europës (All European Academies) si dhe nga institucionet kërkimore shkencore, me të cilat Akademia bashkëpunon brenda e jashtë vendit, në ato të veprimtarive prodhuese;
- botimin e organeve periodike dhe veprave të tjera me nivel të lartë shkencor;
- zbulimin, mbështetjen, nxitjen dhe promovimin e talentëve të reja të kërkuesve shqiptarë në shkencë brenda e jashtë vendit, për të realizuar nivele të larta kërkimi në Shqipëri, si dhe për të krijuar e mbështetur strukturat e saj të përfaqësimit në komunitetin shkencor e veprimtaritë prodhuese etj.

Me përparësi ka qenë edhe inkurajimi i bashkëpunimit ndërmjet shkencëtarëve të diasporës, shkencëtarëve të rinj nga institucionet brenda dhe jashtë vendit, me anë të përfshirjes nëpërmjet veprimtarive të ndryshme, si: workshop-e, forume shkencore, projekte etj. Gjithashtu, akademikët e SSHNT kanë drejtuar dhe marrë pjesë në realizimin e disa projekteve ndërkombëtare në fusha të ndryshme të teknologjisë së informacionit, energjisë në përgjithësi e asaj të rinovueshme në veçanti, transportit, edukimit, rasteve emergjente dhe problematikave që lidhen me to etj.

Gjatë vitit 2017, SSHNT ka realizuar organizimin e 13 veprimtarive shkencore (konferenca, simpoziume etj.) botimin e 3 librave dhe monografive si dhe dy revistave shkencore periodike ndërkombëtare: *Journal of Natural and Technical Sciences*, JNTS (ASHSH; 3 vëllime për vitin 2017) dhe *Journal of Agriculture of Animal Production Sciences for the Rural Development* - JAAPSR (botim i përbashkët i Fondacionit *Shkencë, Teknologji, Shërbim Këshillimor për Zhvillimin e Fermës* - BLELAL dhe ASHSH; 2 vëllime). Gjithashtu, SSHNT ka realizuar edhe veprimtari të tjera shkencore në kuadër të Programit “Edukimi në shkencë” të cilat synuan masivizimin e shkencës, si përrurime të veprave shkencore (kombëtare e ndërkombëtare), vlerësime të veprimtarive shkencore bazë e të aplikuara të figurave të shquara të shkencës shqiptare; promovimin dhe mbështetjen e shkencëtarëve të rinj në bashkëpunim me akademi të huaja dhe organizma të tjerë ndërkombëtarë. Vlen të theksohet rritja e vazhdueshme e progresive e pjesëmarrjes së të rinjëve në shkencë e studentëve në veprimtaritë e organizuara nga SSHNT.

SSHNT përbëhet nga 16 anëtarë që mbajnë titullin *akademik*, 3 anëtarë me titullin *akademik i asociuar* dhe 1 anëtar me titullin *akademik i përhershëm*. Gjatë vitit 2017, Seksioni humbi një nga anëtarët e tij, akad. asoc. **Afërdita Veveçka**.

Anëtarët e SSHNT kanë marrë pjesë në 69 konferenca shkencore (brenda dhe jashtë vendit); kanë botuar 110 artikuj shkencorë dhe kanë punuar në 13 projekte shkencore.

I. PROJEKTE

Përcaktimi i përparësive të zhvillimit shkencor në vend, vazhdon të jetë objektivi kryesor i veprimtarive të SSHNT të ASH. Përparësitë janë orientuar në përputhje me programet e zhvillimit shkencor, nevojat dhe mundësitë aktuale të vendit, bazuar në Strategjitë që kanë lidhje direkte dhe indirekte me kërkimin shkencor e që janë në harmoni me programet e bashkëpunimit rajonal e më gjerë europian; Strategjinë Rajonale për kërkimin dhe Inovacionin në vendet e Ballkanit Perëndimor; programet bilaterale të nënshkruara me vendet e rajonit (Itali, Greqi, Turqi, Slloveni dhe Maqedoni), si dhe programet e BE (p.sh. Horizon 2020 etj.), kur bëhet fjalë për të marrë pjesë në projekte shkencore konkurruese me cilësi të lartë.

A. Projekte në kuadër të protokollit të bashkëpunimit shkencor dhe artistik midis ASHSH dhe ASHAK

(shih: <http://akad.gov.al/ash/bashkepunime/bashkepunim-ashsh-ashak>)

1. Projekt pilot *Studimi i ndryshimeve mjedisore në një segment të zonës ndërkufitare Shqipëri-Kosovë*.

Koordinator i projektit për ASHSH - akad. **Gudar Beqiraj**; anëtarë akademikë **Salvatore Bushati**, **Neki Frashëri** dhe **Efigjeni Kongjika**; ekspertë të jashtëm prof. dr.

Alfred Mullaj (florist, përgjegjës i Qendrës Kërkimore të Florës dhe Faunës; si dhe prof. dr. Arsen Proko, ekspert i pyjeve dhe pasurive silvopastorale).

Koordinator i projektit për ASHAK - akad. Nexhat Daci (Kretar i ASHAK); anëtarë akademikët Isuf Krasniqi, Fejzullah Krasniqi, si përfaqësues nga ASHAK dhe si bashkëpunëtorë të jashtëm nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" (UP): prof. dr. Behxhet Mustafa dhe prof. asoc. Skënder Kabashi, (Fakulteti i Shkencave Matematiko-Natyrore), prof. asoc. Enver Hamiti (Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike); prof. asoc. Ahmet Shala (Fakulteti i Inxhinierisë mekanike).

Gjatë muajve të parë të vitit 2017 janë shkëmbyer informacione mes grupit të akademikëve të ASHSH dhe të ASHAK-ut për përzgjedhjen dhe saktësimin e zonës së studimit. Bazuar në argumente të shumta, si vlerat e gjeotrashëgimisë në shkallë botërore, llojshmërive gjeologjike dhe gjeobotanike, morfologjike, pedologjike, hidrologjike, biogeografike etj., në segmentin e zonës ndërkufitare Shqipëri-Kosovë u përzgjedh masivi i Sharrit dhe Koritnikut. Për shkak të vlerave të larta natyrore, në vitin 1986, një pjesë e Malit Sharr është shpallur Park Kombëtar nga Kuvendi i Kosovës, me sipërfaqe prej rreth 30.000 ha. Ndërsa në vitin 2012 u bë zgjerimi i kufijve të Parkut Kombëtar të Sharrit me një hapësirë prej rreth 23.469 ha., duke futur dhe masivin e Koritnikut. Aktualisht Parku Kombëtar i Sharrit ka një hapësirë prej 53.469 ha, duke përfshirë territore të pesë komunave: Kaçanik, Shtërpçë, Suharekë, Prizren dhe Dragash. Ndërsa, zona ndërkufitare Koritnik-Sharr-Korab është në programet për ruajtje të qeverive të ndryshme dhe organizatave ndërkombëtare për ruajtjen e natyrës si *MAVA Foundation, IUCN, UNEP, Global Environment Fund (GEF), WWF, European Centre for Nature Conservation, European outdoor conservation association, German Federal Foundation for the Environment (DBU), GIZ, Green Belt* etj., të cilat janë të fokusuara në rritjen e sipërfaqeve të zonave të mbrojtura dhe lidhjen e tyre përmes korridoreve ekologjike me qëllim krijimin e rrjetave të zonave të mbrojtura në vende të ndryshme të botës përfshirë këtu dhe Ballkanin.

Zona ndërkufitare Koritnik-Sharr-Korab është një ndër zonat më të pasura me biodiversitet, por edhe pse ajo zonë është nën mbrojtje në suazën e parkut kombëtar "Sharri" dhe gjithashtu në fokus të programeve të ndryshme për konservim, biodiversiteti dhe habitatet natyrore po shkatërrohen për shkak të menaxhimit jo të duhur.

Disa nga rreziqet që ndikojnë negativisht në ekosistemet natyrore të maleve të Sharrit dhe Koritnikut janë: prerja ilegale (me qëllim shfrytëzimin tregtar) dhe djegia e pyjeve, ndërtimi i hidrocentraleve dhe ndryshimi i rrjedhave të lumenjve, ndërtimet ilegale (rrugëve, shtëpive, objekteve të ndryshme rekreative etj.), mbishfrytëzimi i burimeve natyrore (mbledhja e bimëve mjekësore, gjuetia e pakontrolluar, ekstraktimi i mineraleve), ndotja e mjedisit, sëmundjet/dëmtuesit e ndryshme të bimëve dhe kafshëve etj. Prania e këtyre faktorëve kërcënues në zonë ka pasur pasoja negative si: fragmentim dhe zvogëlim të habitateve natyrore, zvogëlim drastik të kapacitetit natyror të mbajtjes së ujit në zonat e shpyllëzuara, zhdukje të specieve të bimëve dhe kafshëve të egra etj. Prandaj identifikimi i faktorëve kërcënues në zonë dhe përgatitja e një plani të mirëfilltë për menaxhimin e tyre do të kontribuojë në ruajtjen e biodiversitetit dhe ekosistemeve natyrore.

Përdorimi i imazheve satelitore mundëson analizën e ndryshimeve hapësinore dhe kohore të parametrave mjedisore, në radhë të parë të bimësisë, duke lehtësuar identifikimin e zonave të dëmtuara dhe atyre me interes ekonomik dhe duke zvogëluar koston e studimeve të stërzgjatura në terren. Identifikimi i zonave të nxehta apo me

interes del nga studimi i imazheve satelitore dhe krahasimi i të dhënave me studimet ekzistuese. Më pas, vlerësimi i gjendjes reale në terren do të bëhet vetëm në zonat e parazgjedhura dhe për parametra mjedisore specifike të identifikuar gjatë studimit.

Veprimtaritë e realizuara konsistuan në:

1. harmonizimin e metodologjisë hulumtuese me ekspertët nga Akademia e Shkencave të Shqipërisë;
2. studimin pjesorë të studimeve dhe të dhënave ekzistuese, grumbullimin dhe analizimin e materialeve relevante (raporteve, punimeve shkencore, dokumenteve nga bibliotekat, arkivat dhe universitetet);
3. hulumtimi dhe analizimi i imazheve digjitale paraprake (kombinimi i imazheve satelitore, fotografive ajrore, të dhënave të hollësishme kartografike, të marra nga burime të ndryshme si: Agjencia Kadastrale e Kosovës, Google Earth, Satelitet Landsat-8 dhe MODIS etj.);
4. krahasimin e disa të dhënave të gjetura nga literatura paraprake me ato të gjeneruara nga analizimi i imazheve satelitore, si dhe përcaktimin e lokaliteteve, ku janë të nevojshme vizitat në terren;
5. studimin në terren, me qëllim analizimin e ndikimit të faktorit antropogjen në ekosistemet natyrore, mbetet për tu realizuar në vitin 2018. Po ashtu këto ekspedita, përveç vrojtimit të ekosistemeve, do të përfshijnë edhe intervistimin e banorëve lokalë dhe autoriteteve të zonës;
6. analizimin e të dhënave dhe ato gjatë aktiviteteve paraprake të verifikimeve në terren dhe vlerësimi përfundimtar do të përpunohen për të vlerësuar efektivitetin e teknologjive. Studimi synon eksperimentimin pilot të kësaj metodologjie në vlerësimin e gjendjes mjedisore në një segment të zonave të mbrojtura në brezin ndërkufitar midis Shqipërisë dhe Kosovës. Rezultatet e studimit vlejné si për të kuptuarit e diagnostikimit të gjendjes e dukurive mjedisore dhe për përmirësimin e planifikimit të veprimtarive të qëndrueshme ekonomike e turistike në rajon.

Rezultatet e pritshme të projektit në përfundim të tij do të jenë:

1. rritja e bashkëpunimit dhe kapaciteteve shkencore në mes të institucioneve të ndryshme të përfshira në menaxhimin e ekosistemeve natyrore;
2. harmonizimi i metodologjive hulumtuese ndërmjet institucioneve partnere;
3. evidentimi i faktorëve kërcënues të identifikuar dhe lokalizuar në ekosistemet natyrorë të Koritnik-Sharrit;
4. punimet shkencore, prezantimet, raportimet dhe raporti përfundimtarë.

B. Projekte në kuadër të bashkëpunimit shkencor midis Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe institucioneve shkencore të huaja

Ngritja e Observatorit Magnetik në Shqipëri

Projekt i SSHNT (me koordinator akad. S. Bushati) në bashkëpunim me Institutin Kombëtar të Gjeofizikës dhe Vullkanologjisë, Romë, Itali dhe me mbështetje të bashkisë së Tiranës. Në sajë të një bashkëpunimi prej vitesh të Akademisë së Shkencave, institucioneve shkencore shqiptare në fushën e shkencave të tokës, si Shërbimit

Gjeologjik Shqiptar dhe institucioneve universitare me Institutin Kombëtar të Gjeofizikës dhe Vullkanologjisë, Romë, Itali (Istituto Nazionale di Geofisica e Vulcanologia - INGV), do të ngrihet një observator magnetik në Shqipëri, i pari i këtij lloji në vend. Vëzhgimet e fushës hapësinore gjeomagnetike të Tokës nëpërmjet monitorimit të të dhënave në mënyrë të vazhdueshme janë të një rëndësie të veçantë për vendin dhe rajonin. Të dhënat e përfuara nga observatori do të japin kontribut në kërkimet shkencore me vlera teorike e praktike, rreth fenomeneve të fushës magnetike, por gjithashtu për kontribute në monitorimin meteorologjik hapësinor, emergjencat e mjedisin. Të dhënat e përfuara do t'u vihen në dispozicion institucioneve qeveritare e atyre shkencore, të cilat merren me observimet e tokës, si Agjencisë së Sigurimit të Informacionit të Gjeoshkencave (ASIGJ) etj. Observatori do të ndërtohet sipas standardeve ndërkombëtare; pajisjet dhe ndërtimi i të cilit do të dhurohen nga Instituti Kombëtar Gjeofizikës dhe Vullkanologjisë e do të pasurohet hap pas hapi edhe me pajisje të tjera monitoruese. Me gjithë mbështetjen e kryebashkiakut z. Erion Velia, po punohet për përcaktimin e truallit ku do të ngrihet observatori i parë magnetik shqiptar, në hapësirat e parkut të madh të Tiranës.

C. Projekt-propozime

SSHNT i Akademisë së Shkencave e Shqipërisë ka bërë përpjekje të konsiderueshme dhe në vazhdimësi, në drejtim të pjesëmarrjes në programet e Bashkimit Europian (BE) ose në programe të tjera me karakter kërkimor, ku ajo përfaqësohet si ideatore, koordinatorë, partner ose që jep kontribut në nivel ekspertësh.

Projekt-propozimi *Albanian Young Academy is a key factor in sustainable development of Albania and West Balkan Countries* (sipas thirrjes së IAP-it për 2018)
(shih: <http://akad.gov.al/ash/akademia-e-te-rinjve/anetaret>)

Në kuadër të një prej përparësive të strategjisë së IAP që përputhet edhe me ato të vendit tonë, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, realizoi një projekt-propozim me qëllim identifikimin, vlerësimin dhe krijimin në një bashkësi, të të rinjëve në shkencë brenda e jashtë vendit - krijimin e një sinergjie në shkencë të të rinjëve. Projekt-propozimi u hartua nga Akademia e Shkencave e Shqipërisë (drejtues akad. S. Bushati), në bashkëpunim me akad. Isuf Krasniqi (sekretar shkencor i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës); akad. Vlado Matevski (nënkryetar i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Maqedonisë) dhe prof. Fatos Ylli (Instituti *Alb-Shkenca*, bashkëpartner i ASHSH).

Ekziston mungesa e bashkëpunimit të kërkuesve të rinj në vendet mes njëri-tjetrit dhe me kërkuesit në diasporë, e cila është shumë e rëndësishme. Projekti synon të krijojë një bashkësi të të rinjëve në shkencë, të cilëve në Shqipëri ende nuk i është kushtuar vëmendja e duhur e sidomos shqiptarëve që punojnë jashtë, në Kosovë, në Republikën e Maqedonisë dhe në diasporë. Synohet që kjo bashkësi e kërkuesve të rinj të marrë pjesë në zhvillimin e politikave ndërkombëtare të shkencës, në sajë të koordinimit bashkëpunimit dhe shkëmbimit me kolegët përtej kufijve; përmes Rrjetit të kërkuesve të rinj në Botë. Ata do të komunikojnë virtualisht, fitojnë njohuri të reja dhe fuqizojnë përvojat, të cilat kurrë nuk do t'i kishin në nivelin e tyre kombëtar ose brenda kufijve të disiplinës së tyre. Ata janë në pararojë të lëvizjes së shkencëtarëve të rinj ndërkombëtarë dhe krijojnë një zë të fuqishëm për të ndikuar në zhvillimin global

për një shkencë më efektive në mbarë botën, nëpërmjet lidhjes më të mirë, përmirësimit të masave të arritjeve dhe edukimit shkencor më të lartë dhe shtrirjes.

Nëpërmjet këtij projekti të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë do të vlerësohet informacioni aktual për kërkuesit e rinj duke organizuar seminare, ku do të ftohen të gjithë personat kyç në ministrinë tona, institucionet kërkimore (në Shqipëri, Kosovë, Maqedoni), si dhe për projekte të ndryshme që lidhen me këtë temë; ne synojmë të identifikohen kërkuesit në diasporë duke kontaktuar universitetet, institucionet shkencore në çdo vend, përmes anëtarëve akademikë të ASHSH, të krijojmë një bazë të dhënash në faqen e internetit si një burim i hapur për të pasur qasje në informacion në kohë reale. Procesi i kujdesjes të kërkuesve të rinj (KR) do të jetë në pajtim me standardet dhe rregullat e IAP-it; projekti është në përputhje me misionin e partneritetit dhe planin strategjik të IAP-it.

Projekt-propozimi *Diaspora shkencore si kapital i vyer njerëzor për zhvillimin socio-ekonomik e zhvillimin e qëndrueshëm të Shqipërisë - Scientific Diaspora as valuable human capital for the social-economic development and the sustainable development of Albania*

Ekziston një hendek i njohurive ndërmjet vendeve të Ballkanit Perëndimor (WBC) dhe shteteve anëtare të BE-së. Nevojiten perspektiva inovative në studimin e mobilitetit të shkencëtarëve dhe profesionistëve të kualifikuar. Duke njohur rëndësinë e shkencës dhe prodhimin e njohurive për zhvillim, nevojitet vlera e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe ndërhyrja e diasporës shkencore si aktorë të rëndësishëm. Ndërsa globalizimi dhe përparimet teknologjike kanë promovuar mënyra të reja për të kontribuar nga distanca, sfida tani është gjetja e mënyrës më të mirë për të përfshirë kapitalin njerëzor të emigruar në progresin shkencor dhe socio-ekonomik të vendeve të Ballkanit Perëndimor (VBP). Projekti synon të identifikojë diasporat shkencore, lëvizshmërinë shkencore, ngritjen e komuniteteve të dijes, nxitjen e bashkëpunimit ndërkombëtar, zhvillimin ekonomik, orientimin drejt integritit në BE etj., përmes institucioneve shtetërore dhe atyre shkencore në vendet përkatëse. Bashkëpunimi midis diasporës shkencore dhe shkencëtarëve nga vendi i origjinës mungon (tensioni i ikjes së trurit - fitimi i trurit - nocionet e qarkullimit të njohurive). Në anën tjetër, bashkëpunimi është kërkuar nga BE gjatë samiteve të Zagrebit dhe Selanikut (kapitulli 25 - "Shkencë" e "acquis communautaire"). Qëllimet kryesore të projektit janë identifikimi i diasporës shkencore, lëvizshmëria shkencore, krijimi i komuniteteve të dijes, nxitja e bashkëpunimit ndërkombëtar, zhvillimi ekonomik, mbështetur në politikat e zgjerimit etj. Identifikimi do të bëhet përmes universiteteve, institucioneve shtetërore dhe institucioneve shkencore në vendet përkatëse. Ka mungesë bashkëpunimi midis kërkuesve nga VBP) dhe diasporës shkencore.

Suksesi i praktikave ndërkombëtare të diasporave shkencore kërkon krijimin e veprimeve të organizuara që lehtësojnë ndikimin kolektiv. Për më tepër, si aktorë të rinj relevantë në ekonominë e dijes, diasporat shkencore kanë nevojë për struktura dhe mundësi që u lejojnë atyre të veprojnë si agjentë të ndryshimit. Ka mundësi të rritjes së kontribuimit të shkencëtarëve në vend dhe të atyre nga larg, kur ky i fundit duhet të konsiderohet si një alternativë premtuese për mbajtjen dhe kthimin e kapitalit njerëzor, duke u lejuar vendeve të përfitojnë nga bashkëpunimi me shkencëtarët e emigruar dhe profesionistët e kualifikuar. Diaspora shkencore mund të veprojë si një urë dhe që lidh njerëzit që jetojnë jashtë vendit me ato të vendeve përkatëse dhe t'i inkurajojë ata të kryejnë shkencë dhe të bëjnë kërkime, si dhe të ndihmojnë në transferimin e njohurive.

II. Konferenca, simpoziume, forume shkencore

Akademia e Shkencave e Shqipërisë, si institucioni shkencor më i rëndësishëm në vend, ka misionet përparësore në mbështetje të nevojave aktuale të vendit, në realizimin e strategjisë së kërkimit shkencor e teknologjik në fushat kryesore të saj, si dhe në iniciativat e reja në fushën e kërkimit dhe arsimit. ASHSH bashkëpunon me institucionet kërkimore e të arsimit, të ekselencës shkencore etj., për gjetjen e zgjidhjeve të çështjeve me rëndësi jetike për vendin, duke i ofruar institucioneve të qeverisjes këshillim dhe ekspertizën e duhur në realizimin e detyrave të kërkimit e zhvillimit në të gjitha fushat. Zhvillimi i konferencave dhe veprimtarive të tjera shkencore si simpoziume dhe forume nga të cilat dalin përfundime të rëndësishme është një nga misionet e saj.

Kështu, në fushën e prioriteteve të shëndetit, ASHSH në përputhje dhe me rekomandimet e tre konferencave të mëparshme të saj: *“Menaxhimi - sfidë madhore e sistemit shëndetësor”*; *“Parandalimi dhe diagnoza e hershme e kancerit - sfidat dhe mundësitë për një impakt pozitiv në Shqipëri”* dhe të konferencës *“Faktorët e të ushqyerit dhe ndikimi në sëmundshmëri: shëndeti përmes të ushqyerit”*, organizoi këtë vit dy konferenca të tjera në fushën e shëndetit. Më poshtë paraqiten veprimtaritë e organizuara nga SSHNT, sipas kronologjisë së zhvillimit të tyre.

A. Konferenca shkencore ndërkombëtare *Kanceri i qafës së mitrës: parandalimi, diagnostikimi dhe trajtimi i tij*

(shih: <http://akad.gov.al/ash/konferenca?id=214>)

Në mbështetje të trajtimeve shkencore multidisiplinore në fushën e shëndetit, si një nga problematikat përparësore të vendit, ASHSH në bashkëpunim me Cytomol - Frankfurt mbi Main, Republika Federale e Gjermanisë, Ministrinë e Shëndetësisë, Universitetin e Mjekësisë, Institutin e Shëndetit Publik, spitalet universitare obstetrike gjinekologjike “Mbretëresha Geraldinë” dhe “Koço Gliozheni” dhe Shoqatën e Patologëve Shqiptarë, dhe me mbështetjen e Organizatës Botërore të Shëndetësisë dhe të UNFPA-së, organizoi konferencën shkencore ndërkombëtare *Kanceri i qafës së mitrës: parandalimi, diagnostikimi dhe trajtimi i tij*, e cila u zhvillua në Ditën Ndërkombëtare të parandalimit të kancerit të qafës së mitrës më 4 shkurt 2017.

Qëllimi i konferencës ishte evidentimi i gjendjes në Shqipëri dhe krahasimi i saj me vendet e tjera të Europës Perëndimore dhe sensibilizimi me problemin që ekziston sot në botë mbi kancerin e qafës së mitrës, që aktualisht është një nga format e kancerit që mund të parandalohet pothuajse totalisht e në mënyrë shumë të suksesshme. Gjithashtu, konferenca synonte të vërë në dukje nevojën e vendit për krijimin e shërbimeve mjekësore të shpejta dhe të një sistemi kujdesi shëndetësor cilësisht të lartë, duke ruajtur e përmirësuar performancën kundrejt standardeve bazë, teksa sigurohet balancë financiare, përmirësim i dobishmërisë dhe produktivitetit të sistemit shëndetësor dhe sistemit të kujdesit shëndetësor, duke parandaluar shëndetin e keq, si dhe duke mbështetur njerëzit në një jetë më të shëndetshme. Arritjet realizohen falë kërkimit shkencor, inovacionit dhe rritjes, duke u mundësuar njerëzve dhe komuniteteve të marrin vendime rreth shëndetit të tyre dhe kujdesit të tyre shëndetësor dhe duke ndërtuar e zhvilluar krahun e punës dhe përmirësuar shërbimet përmes teknologjisë bashkëkohore, informacionit dhe transparencës.

Në konferencë u paraqitën 13 referime kryesore nga specialistë shqiptarë e të vendit dhe morën pjesë mbi 142 specialistë: anatomo-patologë, obstetër-gjinekologë, biologë molekularë, mjekë të kujdesit parësor, studentë etj. Gjithashtu nëpërmjet një workshop-i të zhvilluar në kuadër të konferencës nga specialistë gjermanë dhe shqiptarë, u shpalsën teknikat bashkëkohore të diagnostikimit të kancerit të qafës së mitrës.



Çaste nga zhvillimi i konferencës shkencore ndërkombëtare “Kanceri i qafës së mitrës: parandalimi, diagnostikimi dhe trajtimi i tij”

Nga referimet e diskutimet e problematikave rezulton se kjo konferencë kishte prurje programore në arritjet e qëllimeve të zhvillimit të konferencës, mbi diagnostikimin e hershëm të kancerit të qafës së mitrës, për teknikat më efektive bashkëkohore të diagnostikimit etj. në përputhje edhe me kushtet e vendit tone. Gjithashtu u parashtruan nga specialistët dhe rekomandime për institucionet politikë-bërëse, vendimmarrëse, për komunitetin shkencor dhe për të gjithë palët e interesuara, të përfshira në fushën e shërbimeve shëndetësore në arritjen e qëllimit të konferencës. Në muajin kushtuar luftës kundër kancerit në përgjithësi, dhe atë të Ditës për Luftën kundër KQM-së, janë zhvilluar mjaft veprimtari sensibilizuese edhe nëpërmjet medias audio-vizive dhe shtypit. Pas realizimit të konferencës, sipas të dhënave të anketimit nga 84.5 për qind të pjesëmarrësve dolën në pah disa tregues të rëndësishëm statistikorë për vlerësime shkencore. Nga pjesëmarrësit, 62 për qind ishin të seksit femër. Moshë mesatare e pjesëmarrësve ishte 33,2 vjet; 63 për qind e pjesëmarrësve ishin mjekë të përgjithshëm, prej të cilëve 87 për qind meshkuj; 82 për qind e pjesëmarrësve punonin në institucione publike, ndërsa pjesa tjetër e ushtronin profesionin e tyre si në ato publike dhe në ato private. Po ashtu, 84 për qind e pjesëmarrësve mendojnë se njohuritë e marra nga veprimtaria ishin shumë të reja dhe në përgjithësi 95,5 për qind e pjesëmarrësve e vlerëson organizimin e përgjithshëm të veprimtarisë si “shumë të mirë”.

Në komentet e tyre, të anketuarit sugjeruan, se është e nevojshme të organizohen të tjera veprimtari me temë mbi kancerin kolono-rektal, të mitrës si dhe me tema mbi pediatriinë, apo mbi urgjencat dhe menaxhimin e tyre.

Në përfundim, konferenca aprovoi “Kartën e konferencës”, e cila do të shërbejë si një platformë për institucionet politikë-bërëse, vendimmarrëse dhe palët e interesit jo vetëm të komunitetit shëndetësor në Shqipëri por dhe më gjerë në vendet e rajonit.



Çaste nga emisioni LindOn në televizionin shqiptar ChannelOne, ku u informua publiku i gjerë për konferencën shkencore ndërkombëtare mbi kancerin e qafës së mitrës që do të zhvillohej më datë 4 Shkurt 2017.

Karta e konferencës

Shkencëtarët, ekspertët dhe profesionistët e institucioneve e fushave të ndryshme të shëndetësisë, nga Shqipëria dhe vende të rajonit, të mbledhur në konferencën “Cervical-cancer: prevention, diagnosis and treatment”, organizuar në ASHSH, nënvizuan se:

- *Kanceri i qafës së mitrës është kanceri i dytë pas kancerit të gjirit për gratë e moshës 15-49 në Shqipëri. Çdo vit, rreth 40 gra vdesin në moshë relativisht të re nga ky kancer.*
- *Vdekjet nga kanceri i qafës së mitrës konsiderohen të parandalueshme. Me njohuritë shkencore dhe teknologjinë ekzistuese nuk duhet të kishim vdekje nga ky kancer. Programet e depistimit për këtë kancer konsiderohen gjithashtu si shumë kosto-efektive dhe do të kishin përfitime të matshme për të gjithë shoqërinë.*
- *Prirjet në kohë të këtij kanceri në Shqipëri nuk tregojnë shenja rënie, përkundrazi. Organizimi dhe mbështetja e shërbimeve ekzistuese janë të pamjaftueshme, të papërshtatshme dhe jo efektive për parandalimin e kancerit të qafës së mitrës në popullatë. Në Shqipëri ofrohen vetëm shërbime të depistimit sporadik me një mbulesë shumë të ulët në popullatë, pa garantim të elementeve të etikës dhe me kontroll të mangët të cilësisë.*
- *Institucionet kërkimore/akademike/shëndetësore në Shqipëri, vitet e fundit kanë prodhuar mjaftueshëm informacion që lejon një analizë të përshtatshme të kapaciteteve dhe nevojave në nivele të ndryshme të sistemit shëndetësor, lidhur me fillimin e një programi të depistimit kombëtar.*

Bazuar në këto informacione, konferenca rekomandoi me forcë:

- *Duhet fillimi i një depistimi të organizuar për kancerin e qafës së mitrës në Shqipëri. Edhe në kushtet e ekzistencës së një vaksine për imunizimin kundër HPV, programi i depistimit mbetet i domosdoshëm. Sikur një program vaksinimi kundër HPV të fillonte tani, efektet e tij në shëndetin e grave do të përfitoreshin vetëm pas 30 apo 40 vitesh.*
- *Që një program i tillë të jetë efektiv dhe të ketë pak risqe, ai duhet të jetë i organizuar dhe të sigurojë një mbulesë të lartë depistimi, ndërkohë që siguron një kontroll të cilësisë në të gjitha nivelet e sistemit. Një program depistimi për kancerin e qafës së mitrës i përfshin të gjithë nivelet e sistemit shëndetësor dhe kërkon një organizim të*

përshtatshëm për bashkëpunimin mes tyre në funksion të shërbimeve për gruan dhe shëndetin e saj.

- *Që programi i depistimit në Shqipëri të ketë një mbulesë të lartë duhet të sigurojë ftesën apo informimin e organizuar dhe personal për gratë që do të përfshihen në program. Për një mbulesë të lartë do të shërbenin masat për uljen e barrierave financiare (pa kosto për gratë e përfshira) dhe gjeografike (testet depistuese dhe ekzaminimet gjinekologjike sa më pranë grave, ndërkohë që leximi i testeve të bëhet në mënyrë të centralizuar).*
- *Programi i depistimit të organizuar duhet të aplikohet në mënyrë graduale dhe të sigurohet qëndrueshmëri në kohë përmes masave ligjore dhe mbështetjes së Ministrisë së Shëndetësisë.*

Bazuar në informacionin më të mirë shkencor që ekziston sot në botë në fushën e kontrollit të kancerit të qafës së mitrës, si dhe në udhëzuesit më të fundit europianë për sigurimin e cilësisë në depistimin për kancerin e qafës së mitrës dhe udhëzuesit e Praktikës Bazë për kontrollin gjithëpërfshirës të kancerit të qafës së mitrës i Organizatës Botërore të Shëndetësisë, konferenca orienton masat për t'u ndërmarrë në këtë fushë në Shqipëri sipas principeve të mëposhtme:

- *Për nivelin e zhvillimit të vendit tonë dhe për të shmangur në maksimum ndërhyrjet invazive të padobishme, në Shqipëri është më e përshtatshme strategjia 'depistim-diagnostikim-trajtim i parakancerit' kundrejt strategjisë 'depistim-trajtim';*
- *Qendrat e kujdesit shëndetësor parësor janë vendi më i përshtatshëm për kontaktin e grave të përfshira në program me personelin shëndetësor dhe ofrimin e shërbimeve të këshillimit dhe marrjes së mostrës biologjike për testin e depistimit. Mjekët, mamitë dhe infermierët që punojnë në këto qendra, për të përballuar një program depistimi në shkallë të gjerë, duhet të mbështeten me trajnim, bazuar në udhërrëfyes/protokolle kombëtare;*
- *Nuk duhet lejuar që mangësitë në diagnozë dhe trajtim në institucionet shëndetësore publike të kërcënojnë besimin e publikut tek programi. Duhet bërë përpjekje për minimizimin sistematik të tyre dhe sigurimin e të gjithë shërbimeve bazë të diagnozës dhe trajtimit në Shqipëri;*
- *Për të rritur kosto-efektivitetin dhe për të kontrolluar cilësinë, leximi i testeve të depistimit primar duhet centralizuar në Tiranë;*
- *Përveç Pap-testit, duhet të merret në konsideratë seriozisht përdorimi i testit të HPV me risk të lartë si test i depistimit primar për arsye të efektivitetit dhe praktikitetit gjatë aplikimit të tij në shkallë të gjerë;*
- *Nuk është kosto-efektive përdorimi paralel i dy testeve të depistimit primar, por është e rekomandueshme që njëri prej testeve të përdoret si triazh, për gjithë rastet që rezultojnë pozitive në testimin primar.*

Në përfundim, pjesëmarrësit në konferencë, pas shkëmbimit të përvojave më të mira deritanishme në Shqipëri dhe në vende të tjera, bien dakord mbi nevojën për organizim dhe koordinim ndërinstitutional në këtë fushë:

- *Ministria e Shëndetësisë duhet të udhëheqë procesin e ngritjes së programit kombëtar për depistimin e kancerit të qafës së mitrës përmes mekanizmave ligjore dhe mbështetjes financiare.*
- *Spitalet Universitare në bashkëpunim me Institutin e Shëndetit Publik dhe Qendrën Kombëtare të Cilësisë dhe Sigurisë duhet të përgatisin standardet, mekanizmat e përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë dhe treguesit e vlerësimit e të monitorimit të programit. Bashkëpunimi me ekspertë ndërkombëtarë në këtë fushë do të ishte i*

dobishëm. Një bord me përfaqësues nga këto institucione dhe i miratuar nga Ministri i Shëndetësisë do të ndihmonte ndjekjen në vijimësi të tyre.

“Karta e konferencës” u hartua në Tiranë, më 4 shkurt 2017 nga grupi i moderatorëve me prurjet e zhvillimit të konferencës dhe me kontributin e specialistëve të fushës nga Shqipëria, Gjermania, Sllovenia, Çekia, Mali i Zi, Maqedonia dhe Kosova në Akademinë e Shkencave të Shqipërisë.

B. Kongresi V Ndërkombëtar i Shoqatës Shqiptare të Obstetër-Gjinekologëve

Më 12-14 maj 2017, në Akademinë e Shkencave, u organizua në Tiranë Kongresi V-të Ndërkombëtar i Shoqatës Shqiptare të Obstetër-Gjinekologëve (SHSHOGJ) në partneritet me Shoqatën e Obstetërve dhe Gjinekologëve të Kosovës (SHOGJK) dhe në bashkëpunim me Akademinë e Shkencave. Kongresi u zhvillua në përputhje me problematika përparësore të shëndetësisë, që janë pjesë edhe të programit kombëtar të kërkimit shkencor, teknologjik dhe inovativ, me Programin e Qeverisë për shëndetësinë dhe strategjitë kombëtare që lidhen me të, me pikësynime:

- promovimin e bashkëpunimit ndërmjet shoqatave profesionale nga Shqipëria, Kosova dhe vende të tjera të rajonit;
- shkëmbimin e njohurive të reja me profesorë të njohur në Obstetrikë dhe Gjinekologji;
- gjetjen e mënyrave për përmirësimin e kujdesit shëndetësor në fushën e shëndetit të nënës dhe të foshnjës për të ndikuar kështu pozitivisht në zvogëlimin e sëmundshmërisë dhe vdekshmërisë maternale dhe perinatale në Shqipëri e Kosovë;
- evidentimin dhe rritjen e kapaciteteve për punë profesionale, shkencore-kërkimore të profesionistëve shqiptarë dhe ardhjen në ndihmë elitës profesionale duke e promovuar atë;
- përmirësimin e skringut për kancerin e gjirit dhe të qafës mitrës, duke e kthyer atë nga pasiv në aktiv; diskutimin e protokolleve moderne dhe aplikimin e udhërrefyesëve bashkëkohore në obstetrikë- gjinekologji;
- bashkëpunimin më të zgjeruar dhe më aktiv me specialistët e sistemit parësor dhe dytësor për të standartizuar kujdesin shëndetësor në fushën e shëndetit të nënave dhe të foshnjave, për të përmirësuar sëmundshmërinë dhe vdekshmërinë maternale dhe perinatale në Shqipëri e Kosovë dhe me mjekët e familjes si një ndihmëse e madhe në parandalimin dhe vlerësimin e patologjive obstetrikale dhe gjinekologjike.

Kongresi ishte ngjarja më e madhe profesionale - shkencore e vitit për shëndetin e gruas, nënës dhe të porsalindurit. Mjekët obstetër-gjinekologë që morën pjesë nëpërmjet ligjëratave, ofruan një profesionalizëm të lartë klinik në fushën e shëndetit të gruas, në të tre ditët e zhvillimit të Kongresit. Veprimtaria kërkimore dhe studimet klinike-statistikore të paraqitura në rreth 40 referime të përgatitura nga 107 autorë e bashkautorë studiuesish dhe organizimi i një workshopi me dy sesione ishin të një niveli bashkëkohor. Diagnoza prenatale, kujdesi perinatal, standardet e parandalimit, zbulimit të hershëm dhe trajtimit të patologjive kancerogjene të organeve gjentile femërore, të patologjive uro-gjinekologjike, të infeksioneve seksualisht të transmetueshme dhe riprodhimit të asistuar, ulja e përqindjes së trajtimit me medikamente në periudhën e paralindjes dhe ndërhyrjeve në lindje, thellimi në

gjinekologjinë pediatrike dhe të adoleshencës, përmirësimi i cilësisë së jetës së gruas në menopauzë ishin disa nga temat interesante të paraqitura në kongres. Niveli bashkëkohor i trajtimit të problemeve ndikoi që konferenca të ketë prurje programore në arritjet e qëllimeve të zhvillimit të saj, të teknikave etj., si dhe të paraqiten rekomandime për institucionet politikëbërëse, vendimmarrëse, për komunitetin shkencor dhe të gjithë palët e interesuara, të përfshira në fushën e shërbimeve shëndetësore në fushat e obstetrikë-gjinekologjisë.



Çaste nga zhvillimi i punimeve të Kongresit V-të Ndërkombëtar të Shoqatës Shqiptare të Obstetër-Gjinekologëve.

C. Konferenca *BalkanCom* 2017

(shih: <http://akad.gov.al/ash/konferenca?id=324>)

U mbajt për herë të parë në Tiranë nga data 30 maj deri më 2 qershor 2017, konferenca shkencore ndërkombëtare “BalkanCom 2017” me temë: “*Angazhimi i rajonit të Ballkanit përmes komunikimit dhe rrjetëzimit*”. Qëllimi i konferencës ishte mbledhja dhe gjetja e rrugëve të bashkëpunimit ndërmjet kërkuesve të universiteteve, qendrave të kërkimit dhe të industrisë nga e gjithë bota, me synim rritjen dhe forcimin e potencialit të talenteve të reja të rajonit të Ballkanit në fushën e kërkim-zhvillimit.

Konferenca “BalkanCom” u mbështet nga Akademia e Shkencave e Shqipërisë. Akad. Arjan Durrësi, anëtar i Asamblesë së Akademisë, i cili ishte dhe bashkëdrejtues i konferencës. Ajo që ra në sy ishte pjesëmarrja e kërkuesve jo vetëm nga rajoni i Ballkanit por dhe nga Europa dhe më gjerë. Kjo konferencë është një hap në drejtim të angazhimit të komunitetit hulumtues në vendet e Ballkanit në këto zhvillime të reja teknologjike. Në këtë konferencë të parë, pas një procesi të plotë shqyrtimi, u pranuan 29 punime për prezantime dhe 8 për postera. Programi mbulon një sërë temash të pasura, duke përfshirë rrjetin 5G, rrjetin e definuar nga softueri, komunikimin me valë milimetër, rrjetëzimin e automjeteve, pajisjet për komunikim të pajisjes, si dhe kontributet nga teoria e informacionit, përpunimi i sinjalit dhe aspektet e shtresës fizike. Autorët e këtyre punimeve përfaqësojnë 28 vende me 52 për qind të autorëve nga Gadishulli Ballkanik. BalkanCom 2017 ishte edicioni i parë i një sërë konferencash që do të mbahen në vendet e Ballkanit në vitet e ardhshme. Qëllimi i serive të konferencës BalkanCom është të bashkojë hulumtuesit nga bota dhe Ballkani në një forum për ndarjen e ideve dhe punës kërkimore në fushat e reja të komunikimit dhe rrjetëzimit. Komunikimi dhe rrjetëzimi po përjetojnë një revolucion që po transformon

mënyrën se si njerëzit jetojnë, punojnë dhe bashkëveprojnë me njëri-tjetrin dhe po ndikojnë në mënyrën se si funksionojnë biznesi, arsimi, argëtimi dhe kujdesi shëndetësor. Për më tepër shih <http://www.balkancom.info/2017/index.html>



Fotografi e faqes online të konferencës BalkanCom 2017

D. Simpozium shkencor Hortikultura shqiptare: gjendja dhe ardhmëria në këndvështrimin e studimit enciklopedik më të fundit të Akademisë së Shkencave

(Shih: <http://akad.gov.al/ash/simpoziume>)

SSHNT në bashkëpunim me Universitetin Bujqësor të Tiranës organizoi në sallën “Aleks Buda” të Akademisë së Shkencave, më 2 qershor 2017, simpoziumin shkencor “Hortikultura shqiptare: gjendja dhe ardhmëria në këndvështrimin e studimit enciklopedik më të fundit të Akademisë së Shkencave” duke bërë edhe përrurimin e botimit të ri të Akademisë së Shkencave “Hortikultura: një vështrim enciklopedik”, me autorë akad. Nazim Gruda dhe prof. dr. Andrea Shundi. Simpoziumi u organizua edhe në kuadër të programit “Edukimi në shkencë”, program i ndërmarrë nga SSHNT për masivizimin e shkencës, për tërheqjen e kërkuesve të rinj në diskutimin e problemeve të kërkimit shkencor, në sinergji me zhvillimin e politikave ekonomike të vendit. Në mbështetje të këtij argumenti, auditori përbëhej nga specialistë të njohur të drejtimeve të ndryshme të hortikulturës, mbrojtjes së bimëve, bujqësisë organike etj., si dhe me studentë pasuniversitarë të departamentit të hortikulturës dhe arkitekturës së peizazhit në Fakultetin e Bujqësisë dhe Mjedisit të Universitetit Bujqësor të Tiranës. Fjalën e hapjes e mbajti akad. Salvatore Bushati, i cili theksoi qëllimin e organizimit të këtij simpoziumi, *ku duhet të debatohet për gjendjen e drejtimeve të ndryshme të hortikulturës në vendin tonë, dhe të nxirren në pah problemet e ndryshme të zhvillimit të kësaj dege të rëndësishme të ekonomisë sonë në periudhën e tranzicionit, të programohen kërkime shkencore në këtë fushë e të zbatohen produkte shkencore e inovative.*

Veprimtarinë e simpoziut e përshëndetën prof. dr. Bahri Musabelliu, rektor i Universitetit Bujqësor të Tiranës, i cili theksoi nevojën e mbështetjes së zhvillimit të shkencës duke përfshirë subvencionimin e institucioneve akademike në funksion të punës kërkimore për të siguruar sinergjinë midis zhvillimit shkencor dhe programeve të zhvillimit kombëtar. Z. Flamur Laze, drejtor i politikave bujqësore në Ministrinë e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave vuri në dukje modelin ekonomik të Qeverisë në fushën e bujqësisë në përgjithësi dhe të hortikulturës në veçanti, nevojën e ndryshimit të raportit eksport/import në dobi të eksporteve të produkteve hortikulturore, ndryshimin e strukturës varietore në dobi të specieve autoktone etj.

Në prezantimin “Gjendja, sfidat dhe perspektiva e perimtarisë në Shqipëri”, prof. Astrit Balliu paraqiti faktin se sipërfaqja e mbjellë me perime ka mbetur konstante 10 vitet e fundit, por ka rritje graduale të prodhimit të tyre. Prodhimi i perimeve në serat diellore përbën sektorin më dinamik të prodhimit bujqësor edhe si pasojë e pozicionit të përshtatshëm gjeografik dhe klimatik në raport me vendet fqinje. Në këtë kuadër, në politikën bujqësore, orientimi paraqitet i qartë drejt eksporteve dhe trendi kryesor përbëhet nga eksporti i perimeve të freskëta në vend të prodhimit për industrinë përpunuese. Pozitive duket dominanca e eksporteve ndaj importeve, por jo mjaftueshëm në vlerë monetare. Për sa i përket kultivimit të perimeve vërehet progres, por ekzistojnë shumë probleme si ende njohuri të pamjaftueshme dhe zgjidhje empirike midis fermerëve lidhur me praktikën e kultivimit të bimëve (përdorime të dozave të larta të pesticideve, disbalancim në plehërimet etj.). Auditorit iu paraqiten dilema dhe sfida në këtë drejtim shumë të rëndësishëm të hortikulturës si prodhimi në fushë të hapur përkundrajt prodhimit në mjedis të mbrojtura; prodhimi për konsum të freskët përkundrajt prodhimit për përpunim industrial; prodhimi sezonal përkundrajt prodhimit gjithëvjetor etj. Në të ardhmen, specialistët parashikojnë se prodhimi për konsum të freskët dhe orientimi i qartë drejt eksporteve do të vazhdojnë të mbeten karakteristikat dalluese kryesore të industrisë së perimeve në Shqipëri.

Prof. dr. Fadil Thomai, specialist i njohur në fushën e pemëtarisë, në prezantimin e tij “Pemëtaria shqiptare në zhvillim; arritje dhe probleme” paraqiti disa arritje në këtë fushë si rritjen e numrit të pemëve vitet e fundit me rreth 40 për qind, ndërsa të prodhimit me 25 për qind në krahasim me vitin 2000. Me gjithë arritjet, jemi ende larg plotësisht të nevojave me fruta dhe nënproduktet e tyre. Pemëtorja është investim afatgjatë (25-35 vjet) dhe si e tillë është investim i konsiderueshëm për nga vlerat monetare, aq më tepër në kushtet e ekonomisë shqiptare. Nga viti 2007, pemëtaria përmes skemave mbështetëse mori një impuls të ri në mbjelljet e reja (kryesisht, vreshtaria, pemëtaria dhe ullishtaria). Në vitet që pasuan u shtuan dhe arrorët, ujitja me pika etj., por defekti i kësaj politike ishte se një mbështetje që shkoi në drejtim të zvogëlimit të sipërfaqes, në vend që të ndodhte e kundërta. Përmirësimi për të ardhmen kërkon: mbështetje financiare për sipërfaqe mbi 5 ha, të mbështetura në projekte të mirëfillta shkencore.

Detyra imediate për zhvillimin e pemëtarisë lidhen me realizimin e një rajonizimi sa më të përshtatshëm të specieve dhe kultivarëve, specializimin e zonave, duke zhvilluar në secilën zonë kulturën më të përshtatshme. Baza e suksesit lidhet dhe me materialin mbjellës, me përdorimin e fidanëve të certifikuar për vërtetësinë gjenetike dhe pastërtinë fitosanitare, krijimin e një inspektorati të përhershëm për kontrollin dhe garantimin e cilësisë. Autori propozon hartimin e një strategjie rajonale dhe kombëtare, që përfshin edhe krijimin e një grupi të gjerë ekspertësh të fushave të ndryshme pranë

çdo bashkie, studimin e çdo rajoni nga afër dhe përcaktimin e prioriteteve, hartimin dhe miratimin e projekteve nga institucionet kompetente ose specialiste të certifikuar.



Çaste nga zhvillimi i punimeve të simpoziumit shkencor "Hortikultura shqiptare: gjendja dhe ardhmëria në këndvështrimin e studimit enciklopedik më të fundit të ASH"

Prof. Lush Susaj, specialist i vreshtarisë dhe verëtarisë, në prezantimin e tij "Vreshtaria shqiptare, problemet dhe përparësitë e zhvillimit" konstaton se përqindja e tokës bujqësore e mbjellë me vreshta në Shqipëri, tregon se edhe për shumë vite të tjera, sipërfaqja e vreshtave do të jetë një tregues në rritje. Aspekt negativ është se në 10 vitet e fundit, Shqipëria nuk ka eksportuar rrush, ndërsa ka importuar sasi të konsiderueshme për konsum të freskët dhe për përpunim. Shqipëria ka vuajtur dhe po vuan përsëri nga izolimi dhe nga mungesa e theksuar e reformave, kohezionit dhe integritimit bashkëkohor të ekonomisë me tregjet dhe me zhvillimet rajonale e botërore në vreshtari. Në këtë mënyrë, zhvillimi i parë me interes për prodhuesit dhe specialistët shqiptarë dhe të vendeve të tjera të rajonit lidhet me trendin aktual të rritjes së kërkesës së tregut dhe të rritjes së prodhimit botëror të verës në përgjithësi, dhe verës rozë në veçanti. Ndërsa zhvillimi i dytë me mjaft interes për vendin dhe për rajonin ka të bëjë me rritjen e madhe të konsumit botëror të rrushit të tavolinës. Të dy këto zhvillime bashkëkohore janë më interes për Shqipërinë dhe për vendet e tjera të rajonit që tashmë kanë filluar që të përshtatin programet, investimet dhe strukturat e tyre varietore.

Autori ngre disa probleme, që pengojnë zhvillimin bashkëkohor të vreshtarisë shqiptare: mungon ligji profesional i vreshtave, sepse në ligjin aktual nuk flitet mbi vreshtarinë e qëndrueshme, përfshirë atë organike, biodinamike, as për vreshtarinë e integruar, apo për atë tradicionale; mungon totalisht studimi i territorit në drejtim të rajonizimit të nënshartesave dhe kultivarëve; mungon kadastra funksionale e vreshtave; prej më shumë 30 vitesh, nuk funksionon drejtimi i përmirësimit gjenetik të popullatave dhe ekotipeve lokale dhe rajonale të hardhisë dhe si pasojë mungojnë klonet lokale dhe rajonale që janë baza për markat bashkëkohore të verës me identitet historik dhe gjeografik të përcaktuar. Mungesa e këtyre markave identitare të verës dhe të nënprodukteve të tjera të vreshtarisë dhe bujqësisë shqiptare është goditja më e rëndë ndaj tregut, eksportit dhe sidomos ndaj agroturizmit shqiptar; në Shqipëri mungojnë trajnimet gjithëvjetrore të fermerëve dhe specialistëve të bujqësisë; në vreshtat aktuale ka një strukturë varietore kaotike e me shumë kultivarë në dallim nga vendet e rajonit që kanë mbi 30 vite, që punojnë me 3-5 kultivarë të mirërajonizuar, të mirëseleksionuar e ku

u është dhënë përparësi ekotipeve dhe kultivarëve të tyre tradicionalë të përmirësuar; më negative është mungesa e një sistemi certifikimi për materialin mbjellës.

Autori duke u mbështetur në punën e stafit të UBT thekson se problemet do të zgjidhen me mirë në të ardhmen, kur kualifikimi shkencor i vazhdueshëm do të bëhet përsëri funksion dhe detyrim ligjor dhe moral për departamentet e Universitetit Bujqësor, duke u kthyer në rolin dhe në funksionin e tij historik, atij të përmbushjes me korrektesë dhe profesionalizëm të përgjegjësive morale dhe ligjore ndaj bujqësisë dhe ndaj degëve të tjera të ekonomisë së vendit.

Prof. asoc. dr. Gjok Vuksani në kumtesën e tij “Lulëtaria në Shqipëri” thekson se ka një tendencë në rritje të kërkesës së shqiptarëve për lule nga viti në vit, por kërkesat e tyre fatkeqësisht plotësohen me produkte të importit. Shqipëria ka një eksport modest në fushën e lulëtarisë. Italia është shteti i rëndësishëm në të cilin eksportojmë më shumë në sasi. Në Shqipëri ekzistojnë 18 kompani importuese, veçanërisht për lulet e prera për buqetë. Për bimët zbukuruese që importohen nuk ka një studim paraprak mbi përshtatshmërinë e tyre me kushtet e mjedisit të vendit tonë. Në shumicën e rasteve është një përzgjedhje e tregtarëve bazuar në leverdishmërinë ekonomike dhe në normën e fitimit, gjë e cila shpesh herë ka çuar në dështimin e bimëve të konsumatorët familjarë apo në biznese. Vendosja e bimëve zbukuruese në projektet publike është shumë amatoreske, pa një konsultim paraprak me profesionistët e fushës, “arkitektët e peizazhit” dhe si pasojë janë shkaktuar miliona lekë dëm financiar, pikërisht nga zgjedhjet e gabuara të specieve, p.sh. mbjellja e palmave në autostradë apo gjelbërimi në bashkinë e Durrësit apo mbjellja pa kriter e rrapit në të gjitha qytetet e vendit. Nga organet qeveritare duhet të merren të gjitha masat organizative dhe profesionale për rritjen e kultivimit të luleve në vendin tonë.

“Arkitektura e peizazhit - dimension i munguar i hortikulturës shqiptare” konsiderohet një problem interesant i paraqitur nga prof. dr. Zydi Teqja. Kërkesat e kohës në këtë drejtim lidhen me objektivat e Konventës Europiane të Peizazheve si nxitjen, mbrojtjen, menaxhimin dhe planifikimin e peizazheve, organizimin e bashkëpunimit në nivel rajonal dhe europian si një element i rëndësishëm për cilësinë e jetës së popullsisë në mjediset urbane e rurale. Prof. Teqja theksoi se Shqipëria është një nga fare pak vendet europiane që akoma nuk ka një program të plotë diplomimi në arkitekturë peizazhi. Universiteti Bujqësor i Tiranës po përgatitet që t’ia ofrojë këtë mundësi të munguar deri tani studentëve shqiptarë. Programi i propozuar nga UBT bazohet në përvojën e vendeve anëtare të BE dhe atë të SHBA dhe parashikon që së shpejti të ketë një proces të plotë diplomimi në arkitekturë peizazhi. Diplomati e studentëve në këtë drejtim do të krijojnë mundësi punësimi për të rinjtë në drejtoritë e planifikimit të qyteteve, organizatat e planifikimit urban, zyrat e projekteve, kompanitë e ndërtimit, zyrat e shërbimeve publike për mirëmbajtjen e gjelbërimit, varrezave, fidanishteve të bimëve zbukuruese, kompanitë private të projektimit dhe ndërtimit të kopshteve, qendra kopshtarie, institute dhe shërbime për mbrojtjen e natyrës dhe të mjedisit, parqet kombëtare, organizata turistike, institucione shkencore e arsimore, shërbime inspektimi etj.

“Potenciali i specieve autoktone në hortikulturë” përfaqëson objektivin e referimit të prof. dr. Alban Ibraliu, i cili numëron rreth 320 specie spontane në Shqipëri, një pjesë prej të cilave të njohura mirë nga popullatat lokale me traditë në grumbullimin e tyre për përdorim individual dhe në familje ose për tregun. Ndër to, 151 specie në “Librin e Kuq” kanë potencial përdorimi si bimë zbukuruese, që konsiderohet një nga rrugët kryesore të ruajtjes së tyre nga kërcënimi për zhdukje.

Prof. asoc. dr. Rexhep Uka në kumtesën “Mbrojtja e bimëve në hortikulturën shqiptare” paraqiti një historik të ngritjes së departamentit të mbrojtjes së bimëve në UBT, duke theksuar se pa hortikulturën, diploma në këtë drejtim nuk do të bëhej kurrë profesion, mjeshtri. Me shtimin e prodhimit bujqësor u bë e domosdoshme që mbrojtja e bimëve të institucionalizohej dhe në vitin 1987 u miratua Ligji 7188 “Për shërbimin e mbrojtjes së bimëve”. Por mbas viteve 90-të, një nga ligjet e para që është miratuar ishte dhe Ligji 7662 “Për shërbimin e mbrojtjes së bimëve”, i cili ishte një konceptim bashkëkohor për t’iu përgjigjur kushteve të reja të ekonomisë së tregut dhe integritit me komunitetin ndërkombëtar, i shoqëruar me ngritjen e strukturave shkencore. Autori mbështet mesazhin “Drejt një prodhimi bujqësor të integruar, me menaxhim të integruar”, ku aspektet e mbrojtjes së bimëve i përshtaten kësaj filozofie të re.

“Hortikultura organike, sistem harmonizues i interesave të konsumatorit dhe mjedisit” me argumente interesante ishte prezantimi i fundit në simpozium i mbajtur nga prof. dr. Enver Isufi, nga Instituti i Bujqësisë Biologjike, Durrës. Autori krahason llojet e ndryshme të bujqësisë së sotme me avantazhet dhe disavantazhet e tyre dhe nxjerr në pah përfitimet e rëndësishme nga përfshirja e hortikulturës organike në zhvillimin e këtij drejtimi të rëndësishëm të bujqësisë së sotme. Bujqësia biologjike/organike/ ekologjike përdor inpute të padëmshme për shëndetin e njerëzve dhe për mjedisin. Interesimi për mjedisin është po me aq rëndësi se sa vetë përkushtimi për prodhimin dhe fitimin. Për këto arsye quhet “bujqësi e së ardhmes”. Autori rendit disa arsye për të përfshirë hortikulturën organike dhe në Shqipëri, si: nuk prek shëndetin e konsumatorëve dhe për pasojë ul koston e mjekësisë; larmia biologjike është shumë më e mbrojtur dhe pasurohet vazhdimisht në fermat biologjike; ruan dhe pasuron tokën me lëndë ushqyese dhe me organizma të dobishme; çmimet e produkteve bio janë më të larta se prodhimet e bujqësisë konvencionale, gjë që ndihmon prodhuesit; përdor më pak energji dhe inpute; ka aftësi për të përthithur më shumë forca pune se sa bujqësia e supermekanizuar e zakonshme; ka më shumë alternativa në treg; e zbatueshme edhe në fermat e vogla, të cilat zënë mbi 80 për qind të fermave në shkallë botërore; nxit turizmin dhe agroturizmin.

Në fund të referimeve nga specialistët e lartpërmendur u zhvillua një debat i gjallë në auditor si pasojë e problemeve të mprehta që ngriti komuniteti shkencor mjaft i specializuar. Përfundimi kryesor theksonte nevojën e zhvillimit të hortikulturës së sotme me ligje integruese, me dije, me kontroll dhe me teknologji bashkëkohore, duke arritur në nivele konkurruese me hortikulturën dhe me tregjet rajonale e globale të prodhimit bujqësor. Kjo kërkon edhe rritjen e impaktit të kërkimit shkencor në këto fusha dhe mbështetjen e organeve politikëbërëse dhe ekzekutive në pjesën më të kualifikuar të komunitetit shkencor në Shqipëri.



Prezantimi i botimit “Hortikultura: vështrim enciklopedik” nga autorët akad. Nazim Gruda (në të majtë) dhe prof. dr Andrea Shundi (në të djathtë)



Çaste nga emisioni LindOn në televizionin ChannelOne, ku u trajtuan çështje të Hortikulturës në Shqipëri si dhe botimi i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë “Hortikultura: vështrim enciklopedik”, me autorë akad. Nazim Gruda dhe prof. dr Andrea Shundi.

Në një seancë të veçantë u përrua dhe botimi i ASH “Hortikultura: një vështrim enciklopedik”, me autorë akad. Nazim Gruda dhe prof. dr. Andrea Shundi. Të dy autorët e botimit “Hortikultura: vështrim enciklopedik”, akad. Nazim Gruda dhe prof. dr Andrea Shundi në prezantimet e tyre vunë në dukje se botimi mbush një boshllëk në një fushë ku bota akademike ka shumë nevojë. Traktati përbëhet nga 850 faqe, 4600 terma me qindra sinonime dhe një fjalorth me rreth 500 fjalë shqipe ose të shqipëruara. Gjithë materiali përshkohet nga një hulumtim i kujdesshëm shkencor me saktësi e thellësi të mendimit, prurje të informacionit, si atij bashkëkohor botëror ashtu edhe atij specifik shqiptar, shumëllojshmëri të përdorimit të gjuhës së saktë shkencore dhe të pastër shqipe. Të gjitha termat dhe fjalët janë të shoqëruara me barasvlerësit e tyre në anglisht dhe në rastin e emrave të bimëve apo të sëmundjeve edhe në latinisht. Për çdo lloj bime janë paraqitur vlerat ushqyese dhe zbukuruese, veçoritë biologjike, si dhe të dhënat e ekologjisë dhe agronomisë, por dhe ato historike apo të traditës shqiptare. Për të veçuar janë përshkrimet e jo vetëm të bimëve të rëndësishme në Shqipëri, por edhe të bimëve të rralla, që ende nuk e kanë gjetur rrugën e tyre në fushë, serë, kopsht apo ballkon. Me të drejtë, autorët theksojnë që “zhvillimi dhe

arritjet e një shoqërie, kultura e jetesës së tyre maten edhe me qëndrimin dhe përkujdesjen e tyre ndaj bimëve dhe mjedisit në tërësi”.

E. FORUME SHKENCORE PUBLIKE

Siç u theksua në raportin e vitit 2016, në Akademinë e Shkencave u themeluan çmimet për kërkim shkencor akademik: **çmimi i karrierës, çmimi Çabej, çmimi Radovicka** dhe **çmimi i kërkuesit të ri**. Numri i veprave të paraqitura për konkurrim në edicionin I të çmimeve për të dy seksionet ishte rreth 60 tituj. Themelimi i këtyre çmimeve i jep mundësi ASH të identifikojë cilësinë shkencore dhe të inkurajojë më të suksesshmit. Kjo nismë konsiderohet e rëndësishme për shtimin e urave të bashkëpunimit dhe krijimin e një bashkësie studiuesish të afërt me të, me mundësi afatgjatë projektesh dhe botimesh të përbashkëta. Pjesëmarrja e disa anëtarëve të SSHNT në jurinë e konkursit, si dhe ekspertizat e specialistëve të brendshëm e të ftuar kanë kontribuar në nominimin e 4 veprave shkencore për **çmimin shkencor kombëtar vjetor “Radovicka”** për studimin më të mirë në fushën e shkencave natyrore dhe teknike (“*Ujërat termale dhe minerale të Shqipërisë*”, me autorë A. Frashëri dhe R. Eftimi; “*Bazat dhe metoda klinike e trajtimit të dhimbjes fantome*” me autor A. Vaso; “*Polimorfizmi gjenetik i sistemit HLA në popullatën shqiptare dhe roli i markuesve imunologjikë dhe imunogjenetikë në realizimin e transplanteve dhe diagnozën e sëmundjeve autoimune*” me autor G. Sulçebe dhe “*Pasuritë ujore të Shqipërisë*” me autor N. Pano) dhe 2 nominime për Çmimin shkencor kombëtar vjetor “*të kërkuesit të ri*” më të suksesshëm në fushën e shkencave natyrore dhe teknike (“*Integrating antimicrobial therapy with host immunity to fight drug-resistant Infections: Classical vs Adaptive treatment*” me autore E. Gjini dhe “*Molecular Evolution of Pyroglutamylated RFamide peptide and Orphan G Protein Coupled Receptor*” me autor R. Bakiu).

Më 21 prill 2017 në sallën “Aleks Buda” të Akademisë së Shkencave në prani të një auditori të gjerë të studiuesve dhe kërkuesve shkencorë dhe të medias, u organizua ceremonia e dhënies së çmimeve për studimet dhe botimet më të arrira, të përcaktuara nga juria përkatëse. **Çmimin Radovicka** e meritoi prof. dr. Niko Pano për botimin e vitit 2015 “**Pasuritë ujore të Shqipërisë**” me motivacionin “Vepra shkencore **Pasuritë ujore të Shqipërisë**, një studim i gjerë dhe kompleks, është rezultat i kërkimeve gjysmëshekullore për resurset hidrike të Shqipërisë, të realizuar me metoda bashkëkohore, me kontribut të shquar për shërbimin hidrometeorologjik në fushën e pasurive ujore të Shqipërisë me ndikim teorik e praktik në kërkim - zhvillim, si dhe në fushën e arsimit e të edukimit të kërkuesve të rinj”. (shih: http://akad.gov.al/ash/images/cmime_2016/radovicka-niko%20pano_fitues.jpg)

Çmimin “Kërkuesi i ri më i suksesshëm” e fitoi prof. asoc. dr. Rigers Bakiu për studimin shkencor “Molecular Evolution of Pyroglutamylated RFamide peptide and Orphan G Protein Coupled Receptor” me motivacionin “Monografia **Evolucioni molekular i peptidit RFamide i piroglutamilizuar dhe receptorit jetim të proteinës G të çiftëzuar**, si studim shkencor i bazuar në metoda bioinformatike dhe molekulare për të evidentuar aspektin evolutiv në strukturën dhe funksionin e dy bashkëvepruesve (peptidi 26RFa dhe receptori GPR103) është një kontribut i dobishëm në kuptimin e mekanizmave të rregullimit të aktivitetit të lëvizjes, gjumit dhe të efektit mbrojtës në sëmundjen Alzheimer”. (shih: http://akad.gov.al/ash/images/cmime_2016/rigers%20bakiu_fitues.jpg)

Akademia e Shkencave në vijim të projektit të saj për të nxitur cilësinë shkencore në procesin kërkimor dhe për të përruar arritjet më të rëndësishme të këtij procesi, certifikuar përmes organizimit të dhënies së çmimeve shkencore kombëtare organizoi forume shkencore publike me kërkuesit e nominuar dhe fituesit e çmimeve. Forumet u organizuan në formën e ligjëratave për veprat me të cilat autorët konkuruan për çmimet shkencore. Qëllimi i kësaj veprimtarie ishte që gjithsecilit prej të nominuarve t'i jepej mundësia për të paraqitur publikisht, tezat, problemet dhe arritjet themelore të punimeve shkencore të tyre, në një mjedis akademik, me praninë e studiuesve të fushave. Gjithashtu këto veprimtari i japin mundësinë komunitetit shkencor, kërkuesve të rinj e universitarëve, e më gjerë shoqërisë civile dhe biznesit të njihen me arritjet më të mira shkencore të vitit, siç u cilësuan në kuadër të çmimeve shkencore kombëtare që Akademia e Shkencave themeloi. Këto forume u mbajtën në sallën “Akademikët”.

- Në forumin **“Pasuritë ujore të Shqipërisë”** me autor prof. dr. Niko Pano, fitues i *Çmimit Radovicka*, paraqit studimi i tërësisë së resurseve ujore të rrjetit hidrografik të Shqipërisë: lumenjtë, liqenet, ujërat nëntokësore dhe burimet e tyre, si dhe hapësirat bregdetare shqiptare të deteve Adriatik dhe Jon dhe mbi këtë bazë edhe tipizimi dhe rajonizimi i pasurive ujore të këtij rrjeti. Pasuritë ujore të Shqipërisë është një studim i gjerë dhe kompleks, rezultat i kërkimeve gjysmëshekullore për resurset hidrike të Shqipërisë, për hartimin e të cilit janë shfrytëzuar të dhëna arkivale që prej viti 1948 e deri më sot. Krahas veçorive fiziko-gjeografike të pellgut ujëmbledhës të rrjetit hidrografik të Shqipërisë, studimi cek edhe resurset hidrike të vendit, kompleksitetin dhe rëndësinë shkencore dhe ekonomike që ato kanë. Në këtë botim paraqiten veçoritë e objekteve të shumta ujore që formojnë rrjetin hidrografik të Shqipërisë, dukuritë dhe proceset kryesore hidrojike që përcaktojnë natyrën e veçantë të regjimit ujqor të këtij rrjeti. Më ujërat e këtij rrjeti janë të lidhura ngushtë dhe organikisht aspekte të rëndësishme si sigurimi i ujqit të pijshëm të popullsisë, ndërtimi i veprave hidroenergjitike, ujqitja e tokave bujqësore, lundrimi detar, furnizimi me ujë i industrisë, peshkimi, turizmi etj., elemente të rëndësishme të zhvillimit ekonomik të vendit.

Spektri i gjerë i studimit dhe vlerësimi tërësor i potencialit ujqor të Shqipërisë e bën këtë monografi një punim madhor shkencor për një nga pasuritë natyrore më jetësore të vendit siç është uji. Botimi përfaqëson një studim të munguar, i përditësuar dhe i paraqitur në një formë të plotë e gjithëpërfshirës për gjithë pasuritë ujore të Shqipërisë.

Në botim analizohen të gjitha të dhënat faktike shumëvjeçare mbi rrjetin hidrografik të Shqipërisë, që dispononte Instituti i Hidrometeorologjisë në vite. Autori i ka përpunuar rezultatet me metoda bashkëkohore, i ka analizuar, interpretuar dhe i ka përgjithësuar me vërtetësi shkencore, bazuar në metodologjitë bashkëkohore. Botimi përfaqëson një manual të veçantë e të rëndësishëm në duart e përdoruesve të shumtë: kërkues shkencorë, projektues e zbatues, subjekte private e studentë etj., me vlerë shkencore dhe praktike. Auditori me specialistë të ujërave, kërkues shkencorë të ish Institutit të Hidrometeorologjisë dhe më gjerë diskutoi gjerësisht për problemet e shtruara në studim dhe me urimet për autorin e librit.

- **Forumi “Evolucioni molekular i peptidit RFamide i piroglutamizuar dhe receptorit jetim të proteinës G të çiftëzuar.”** me autor prof. asoc. Rigers Bakiu, fituesi i çmimit *Kërkuesi i ri më i suksesshëm* për vitin 2016, i cili në prezantimin e tij vuri në dukje rolin e jashtëzakonshëm të këtyre strukturave tek eukariotët, përfshirë njerëzit

në funksionet neuro-endokrine, sjellje, ndijim, në sistemin nervor autonom, si dhe në sistemet e riprodhimit, kardiovaskulare, imune dhe tretës. Ai fillimisht paraqiti një histori të evolucionit molekular dhe të dikotomisë në ditët tona midis qasjeve morfologjike dhe molekulare për studimin e evolucionit të organizmave të gjalla.

Në monografi, aspekti evolutiv fokusohet në vertebrorët, në veçanti tek gjitarët dhe peshqit është kryesor jo vetëm për njohjen e procesit të seleksionit natyral, por edhe për përdorime praktike në fushën e biomjekësisë. Po ashtu, ai theksoi se kërkimet shkencore që e kanë zanafillën jo më shumë se 15 vite më parë po evidentojnë se bashkëveprimi i tyre është i rëndësishëm për aktivitetin e lëvizjes, gjumin dhe është vënë re një efekt mbrojtës ndaj neuroneve karakteristike të sëmundjes së Alzheimerit. Në monografi trajtohet evolucionin molekular i receptorit jetim GPR103 dhe ligandit. Të gjithë njohuritë e përftuara, nga analiza eksperimentale, bazuar në metoda bioinformatike dhe molekulare janë të dobishme për shërimin e sindromave neurologjike apo sëmundjeve të tjera si p.sh. sëmundja e Alzheimerit.

Shtirja në fusha të ndryshme shkencore e kërkimore si në biologjinë molekulare, evolucionin molekular, biomjekësinë dhe neurobiologjinë e bën studimin e paraqitur në monografi interesant për studiues në fusha të ndryshme. Puna origjinale e prof. asoc. dr. Baku në grupin e autorëve të huaj mjaft të specializuar qëndron në studimin e veprimit të nukleotideve dhe aminoacideve duke përdorur metoda bioinformatike. Këto janë punime të vetme lidhur me të dy elementet bashkëveprues, ku trajtohet analiza artificiale e moderne e pranisë së përzgjedhjes natyrore dhe ndikimi i saj në veçoritë e këtyre elementeve. Auditori me pedagogë dhe specialistë të fushës së gjenetikës dhe biologjisë molekulare diskutoi gjerësisht për vlerën e monografisë dhe mundësinë e përdorimit të metodave të kërkimit edhe në vendin tonë.



Çaste nga forumi shkencor publik me prof. asoc. Rigers Baku, fituesi i çmimit Kërkuesi i ri më i suksesshëm për vitin 2016

- **Forumi “Ujërat termomineralë dhe mineralë të Shqipërisë”** me autorë prof. dr. Romeo Eftimi dhe prof. dr. Alfred Frashëri që u nominuan për *çmimin Radovicka* u organizua nga Akademia e Shkencave e Shqipërisë edhe në kuadër të programit “Edukimi në shkencë” dhe në bashkëpunim me Shoqatën e Gjeofizikantëve të Shqipërisë, ku të ftuar ishin studiues e specialistë të gjeoshkencave nga institucionet shkencore të vendit. Prof. dr. Romeo Eftimi theksoi se kjo vepër shkencore konsiderohet si botimi i parë i plotë mbi ujërat minerale të Shqipërisë dhe përfaqëson një monografi të plotë në sfondin e studimeve të thelluara mbi gjeoterminë e kores së tokës në

territorin e Shqipërisë, si dhe të ndërtimit gjeologjik dhe strukturor të saj. Në të përshkruhen të gjithë burimet e njohura natyrore termalë dhe mineralë, si dhe ato të zbuluara nga shpimet e thella të kërkimit të naftës dhe gazit. Gjithashtu përshkruhen burimet e industrializuara (të pijshëm). Sintetizohen të gjithë faktorët formues të ujërave termalë dhe nxirren përfundime për shpërndarjen krahinore të tyre. Lexuesi mund të gjejë analiza të veçorive sasiore dhe cilësore të grupeve kryesore të ujërave termale dhe minerale, sistemet ujëmbajtëse, që i ushqejnë ato, faktorët që kontrollojnë formimin e cilësive fiziko-kimike, si dhe grumbullimin dhe riprodhimin e rezervave të tyre. Karakterizimi i ligjësive të formimit dhe përhapjes së ujërave termale dhe minerale jepet në lidhje të ngushtë me ndërtimin gjeologjik dhe karakteristikat hidrogjeologjike të përgjithshme të Shqipërisë. Gjithashtu përshkruhet përdorimi i tyre në fushën e shëndetit, në jetën sociale dhe ekonomike të vendit.

Ndërmjet ujërave termo-minerale të Shqipërisë, autorët veçojnë përdorimin më të gjerë të burimeve të mirënjohura të llixhave të Peshkopisë dhe të Elbasanit, si dhe uji i shpimit të thellë Ishmi-2, në Bilaj të Fushë-Krujës. Përvoja e vendit tonë dhe e shumë vendeve ka treguar se përdorimi i këtyre ujërave është i shumëfishtë, për kurimin e mjaft sëmundjeve nëpërmjet banjave, inhalacionit dhe pirjes, për zhvillimin e turizmit gjithë sezonal dhe të shumanshëm (kurues, rekreativ, ekologjik, njohës etj.), për shfrytëzimin e energjisë termike për ngrohje (mjedisesh publike, serash, pellgje për rritje industriale të peshkut) dhe për prodhimin industrial të kripës, sqfurit, bromit, jodit dhe elementëve të tjerë të vyer.

Vepra është mbështetur edhe në botimin shkencor “Atlasi gjeotermal i Shqipërisë dhe platforma e shfrytëzimit të nxehtësisë së Tokës” (Akademia e Shkencave e Shqipërisë dhe Fakulteti i Gjeologjisë dhe Minierave, 2016), si dhe në projektin e përbashkët të Fakultetit Gjeologji-Miniera (UPT), dhe Institutin e Gjeofizikës së Akademisë së Shkencave të Republikës Çeke, 1995. Auditori vlerësoi studimin për ndihmesën e madhe për studiuesit shqiptarë, për shfrytëzuesit e këtyre ujërave, si dhe për intensifikimin e shfrytëzimit të tyre në sfondin e kushteve mjedisore dhe humane shumë stimuluese, që ato kanë për zhvillimin jo vetëm për qëllime balneologjike, por edhe për zhvillimin si qendra të ardhshme turistike të klasit të parë. Monografia do t’iu shërbejë specialistëve të fushës, projektuesve dhe ekonomistëve, mjekëve dhe agronomëve. Meqenëse monografia shtjellohet në kornizën e gjeologjisë e tektonikës rajonale Ballkanike dhe më gjerë, ajo përfaqëson gjithashtu një interes të madh ndërkombëtar, veçanërisht për studiuesit e vendeve fqinje.

- Forumi “Polimorfizmi gjenetik i sistemit HLA në popullatën shqiptare dhe roli i markuesve imunologjikë dhe imunegjenetikë në realizimin e transplantëve dhe diagnozën e sëmundjeve autoimune” me autor prof. dr. Genc Sulçebe, i nominuar për çmimin Radovicka

Studimi është projekt kombëtar i miratuar nga AKTI për periudhën 2010 - 2014 me qëllim kryesor vënien në jetë të metodave bashkëkohore në realizimin e provave të pajtueshmërisë indore në transplantet e indeve dhe organeve në Shqipëri dhe aplikimin e këtyre metodave në studimin e lidhjes gjenetike të popullit shqiptar me popullatat e tjera europiane, si dhe studimin e sëmundjeve autoimune në këtë popullatë. Grupi i punës është gjithëpërfshirës me kërkues nga Shërbimi i Imunologjisë dhe Pajtueshmërisë indore në bashkëpunim me Shërbimin e Nefrologjisë dhe Hematologjisë të QSUT “Nënë Tereza”, si dhe qendrat e dhurimit të gjakut në Tiranë dhe Prishtinë.

Në forumin e organizuar nga SSHNT morën pjesë kërkues nga fusha e mjekësisë, specialistë të fushës, gjeneticienë, studentë të mjekësisë dhe biologjisë dhe një publik i interesuar për problemet lidhjeve të popullatës shqiptare me popullatat e tjera, Në ligjeratën e tij prof. dr. Sulçebe u ndal në vlerat shkencore të studimit, ku u arrit të realizohet për herë të parë në Shqipëri studimi i polimorfizmit alelik të gjeneve të sistemit HLA në popullatën shqiptare dhe të aplikohen në vend provat e pajtueshmërisë indore dhurues/marrës në transplantet e organeve dhe qelizave; qëllimet kryesore kanë qenë krijimi i kushteve për kryerjen e transplanteve edhe në Shqipëri; krahasimi i distancave gjenetike midis popullatave shqiptare në Shqipëri dhe Kosovë me popullatat e tjera europiane, si dhe studimi i lidhjeve midis aleleve HLA dhe disa sëmundjeve autoimmune në Shqipëri. Grupi studimor është i vetmi që aplikon provat e përshtatshmërisë indore jo vetëm në Shqipëri, por edhe në Kosovë, si dhe viset shqiptare të Maqedonisë, në të cilat për herë të parë u arrit një studim i plotë i profilit të aleleve të gjeneve të sistemit HLA në popullatën shqiptare, për të zenë vend në studimet e shumta të kryera për popullatat botërore, kryesisht ato europiane; distancat gjenetike midis dy popullsive shqiptare për këto popullata në Shqipëri dhe Kosovë rezultuan të papërfillshme, gjë që provon me metoda të biologjisë molekulare unitetin e popullsisë shqiptare. Përfundime të rëndësishme dhe interesante për diferencimin e dy grupe popullatash kryesore dallohen gjenetikisht: i) grupi i përbërë nga popullatat greke, shqiptare, bullgare dhe maqedonase, dhe ii) grupi i popullatave serbe, boshnjake dhe kroate. Ky përfundim hedh poshtë hipotezat e disa studiuesve të huaj se popullsia shqiptare ka migruar vonë nga mesjeta e hershme nga larg. Por në se merret parasysh autoktonia e popullatës greke, fakti që popullata shqiptare është pothuaj identike gjenetikisht me atë greke tregon se të dy popujt janë të lashtë në viset e tyre. Studimet e gjenetikës së popullatave tregojnë se në përgjithësi distancat gjenetike janë në përpjesëtim të drejtë me distancat gjeografike, por përfundimi interesant i ndryshimeve statistikisht sinjifikative të popullsisë shqiptare kosovare me popullsinë serbe, pavarësisht fqinjësisë gjeografike flasin për autoktoninë e hershme të popullit shqiptar në këto vise. Pjesa kryesore e studimit kërkimor shkencor ka rëndësi të veçantë, sepse bën të mundur realizimin e transplantove në Shqipëri duke patur impakt direkt në përmirësimin e shëndetit dhe në rritjen e jetëgjatësisë dhe cilësisë së jetës së pacientëve shqiptarë. Auditori me specialistë të profileve të ndryshme diskutoi për studimin interesant duke vënë në dukje jo vetëm vlerat e studimit mjekësor, por veçanërisht ato mbi origjinën e popullatave të ndryshme sidomos në rajon.



Çaste nga forumi shkencor publik me prof. dr. Genc Sulçebe, finalist i çmimit Radovicka vitin 2016

- Forumi “Bazat teorike dhe praktika klinike e trajtimit të Dhimbjes Fantomë” me autor dr. Apostol Vaso, i nominuar për çmimin shkencor Radovicka

Kjo vepër është realizuar në autorësi të dr. Vaso, kurse artikulli shkencor që e shoqëron “Peripheral Nervous System Origin of Phantom Pain” është në bashkautorësi me studiues nga Spitali Universitar i Traumës, Fakulteti i Shkencave Sociale, UT, si dhe autorë nga qendra shkencore të Izraelit. Ky i fundit është botuar në revistën shkencore “Pain” më 2014, revista më e lexuar në botë për sa i përket aspekteve neuro-fiziologjike të dhimbjes. Dr. Vaso, si mjek anestezist-reanimator dhe kërkues shkencor në fushën e trajtimit të dhimbjes kronike dhe të kancerit parashtrori thelbin e studimit të tij shkencor në një auditor të përbërë nga mjekë, specialistë të fushës, por edhe më gjerë.

Vepra e dr. Vaso konsiderohet si një ndër botimet e rralla shqiptare për dhimbjen kushtuar bazave dhe metodave klinike të trajtimit të dhimbjes *Fantomë*. Në vepër shqyrtohet një problematikë pak e studiuar, që lidhet me sëmundjen e dhimbjes kronike, si ndjeshmëri dhe dhimbje e gjymtyrës së munguar, një perceptim i veçantë dhe i komplikuar që shfaqet në rastet e intervenimeve kirurgjikale të amputimit të gjymtyrëve dhe rezeksionit të organeve të brendshme, si dhe në mungesat kongjenitale të tyre. Ndër të tjera u vlerësua dhe komenti i studiuesve të huaj, që kanë analizuar impaktin e vëzhgimeve të dr. Vasos të dhëna në artikullin shkencor në të ardhmen e kërkimit shkencor mjekësor dhe veçanërisht në trajtimin e dhimbjes në nivel global. Në auditorin me specialistë, mjekë e studentë u diskutua gjerësisht për këtë fushë të re kërkimi dhe trajtimi, si dhe u mbështet mendimi për stimulim të kërkimeve të tilla edhe nga institucione publike.



Çaste nga forumi shkencor publik me dr. Apostol Vaso, finalist i çmimit “Radovicka” vitin 2016

- Forumi “Integrimi i terapisë mikrobiale me imunitetin e strehuesit, për të luftuar infeksionet rezistente ndaj barnave: Trajtimi klasik kundrejt trajtimit adaptiv” me autorë dr. Erida Gjinin, e nominuar për çmimin Kërkuesi i ri më i suksesshëm për vitin 2016.

Me një profil kërkuesi shkencor interesant në fushën e biologjisë matematike, si kërkuese kryesore në Institutin Gulbenkian të Ciencias në Portugali, dr. Gjini paraqiti ligjëratën në një auditor me pedagogë dhe studentë të departamenteve të biologjisë, bioteknologjisë dhe matematikës të Fakultetit të Shkencave Natyrore dhe Teknike të Universitetit të Tiranës. Dr. Gjini theksoi rëndësinë e studimit të rezistencës mikrobiale të agjentëve infektivë për të parandaluar seleksionin e vazhdueshëm dhe përhapjen e rezistencës ndaj antibiotikëve. Sot debatohet fort për të krahasuar terapitë agresive

kundrejt atyre më të moderuara duke marrë parasysh edhe imunitetin e organizmit si një faktor i rëndësishëm në trajtimin e infeksioneve rezistente. Veçoria e studimit qëndron në përdorimin e modelimit matematik të dinamikës së infeksionit për studimin e ndërveprimit mes patogjenëve bakterialë, përgjigjes imunitare të organizmit dhe trajtimit me antibiotikë. Krahasohen terapitë me regjim klasik (dozë dhe kohëzgjatje fikse) me ato me regjim të përshtatur (që administrohen në varësi të ngarkesës bakteriale), duke eksploruar sistematikisht rezultate e infeksionit si: koha për eliminimin e baktereve, imunopatologjia, imunizimi i bartësit dhe seleksioni i baktereve rezistente gjatë trajtimit. Analizat dhe simulacionet kompjuterike zbulojnë strategji efektive të trajtimit, që promovojnë sinergji midis sistemit imunitar dhe medikamenteve antibiotike në pastrimin e infeksionit. Në të dy llojet e trajtimeve del në pah se si koha e trajtimit dhe fuqia e përgjigjes imunitare përcaktojnë suksesin e terapive të moderuara. Me rëndësi të veçantë është shpjegimi i parametrave kryesorë dhe dimensioneve, ku një regjim adaptim ndryshon nga trajtimi klasik, duke sjellë njohuri të reja në fushën e studimit të menaxhimit të rezistencës.

Autorja vuri në dukje se novacioni në këtë studim është edhe përdorimi i modelit të ri matematik, që çojnë në suksesin e terapive. Optimizimi i trajtimeve në epokën e mjekësisë së personalizuar kërkon tregues të gatshëm të përgjigjes imunitare, patologjisë, si dhe të proceseve të rimëkëmbjes gjatë infeksionit. Qasjet matematikore e kompjuterike janë çelës për të integruar informacione të tilla me praktikën klinike.

Në një auditor të afërt me studimet e saj, dr. Erida Gjini në mënyrë të pashmangshme ngjalli diskutime si për vlerën e punimit, por edhe për mesazhin e saj për të tërhequr vëmendjen drejt matematikës në biologji si një fushë shumë e rëndësishme e shkencës sot në botë, me potencial aplikimesh të shumëllojshme, veçanërisht në epidemiologji, biomjekësi, ekologji dhe imunologji. Një mesazh tjetër i autores është nxitja e vëmendjes institucionale për ngritjen e strukturave të reja akademike dhe kurrikulare për matematikën e aplikuar në biologji në Shqipëri.

Së fundi, dr. Gjini shprehu dëshirën e saj të sinqertë për bashkëpunim me anë të projekteve shkencore me botën akademike shqiptare. SSHNT i ASH i propozoi dr. Gjinit të organizojë një seminar në vitin 2018 me studentë universitarë dhe pasuniversitarë të të shkencave të jetës dhe të matematikës e informatikës.



Çaste nga forumi shkencor publik me dr. Erida Gjini, finaliste e çmimit Kërkuesi i ri më i suksesshëm për vitin 2016

Forumi shkencor “Kultivarët e vendit të pemëve frutore, hardhisë, ullirit dhe agrumeve në Shqipëri dhe në Kosovë dhe ndërtimi i sistemit shkencor të certifikimit për prodhimin e fidanëve” (në këndvështrimin e botimit të ri shkencor *Pemëtaria dhe vreshtaria në Shqipëri dhe në Kosovë*, në kuadër të Protokollit të Bashkëpunimit Shkencor dhe Artistik midis ASHSh dhe ASHAK).

(Shih: <http://akad.gov.al/ash/simpoziume?id=326>)

Forumi shkencor “Kultivarët e vendit të pemëve frutore, hardhisë, ullirit dhe agrumeve në Shqipëri dhe në Kosovë dhe ndërtimi i sistemit shkencor të certifikimit për prodhimin e fidanëve” u organizua nga SSHNT (ASHSH) në bashkëpunim me Akademinë e Shkencave dhe të Arteve, Kosovë; Fakultetin e Bujqësisë dhe Veterinarisë të Universitetit të Prishtinës; Universitetin Bujqësor të Tiranës dhe Universitetin e Tiranës; Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Qendrën e Transferimit të Teknologjive Bujqësore, Vlorë; dhe me Institutin Agronomik Mesdhetar të Barit, Itali.

Veprimtaria u zhvillua më datë 22 nëntor 2017 në Sallën Aleks Buka të Akademisë së Shkencave. Kjo veprimtari mori shkas nga diskutimet e zhvilluara në SSHNT mbi rëndësinë e botimit të ri shkencor “Pemëtaria dhe vreshtaria në Shqipëri dhe Kosovë” (Kultivarët e vendit dhe prodhimi i fidanëve të pemëve frutore, hardhisë, ullirit dhe agrumeve) me autorë kryesore dhe redaktorë shkencorë akad. Efigjeni Kongjika, akad. Latif Susuri, prof. Agim Zajmi, prof. Arben Myrta në përputhje me mbështetjen e fuqishme që Programi i Qeverisë i jep zhvillimit të frutikulturës.

Kryetari i SSHNT të ASH, akad. Salvatore Bushati hapi forumin duke theksuar rëndësinë e botimit, jo vetëm si vepër e përbashkët e të dy akademive, por edhe për zgjedhjen e duhur të bashkësisë së autorëve të të dy vendeve dhe për zgjidhjet optimale për ngritjen e sistemit të certifikimit për prodhimin e fidanëve të drufrutoreve.

Gjithashtu përshëndeti forumin shkencor përfaqësuesi i Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, dr. Grigor Gjeçi, i cili theksoi mbështetjen e Ministrisë për impaktin e kërkimit shkencor në ekonominë bujqësore në përgjithësi dhe në drejtimin e zhvillimit të frutikulturës në veçanti, si degë kryesore në kushtet e sotme të Shqipërisë. Dekani i Fakultetit të Bujqësisë dhe Mjedisit në Universitetin Bujqësor të Tiranës, prof. Fatbardh Sallaku dhe dekanı i Fakultetit të Shkencave Natyrore të Universitetit të Tiranës, prof. Spiro Drushku vlerësuan bashkëpunimin shkencor të institucioneve të tyre me Akademinë e Shkencave në realizimin e projekteve, botimeve dhe konferencave të përbashkëta me synim përfitimin e një produkti shkencor që i vlen ekonomisë dhe shoqërisë. Specialistë të mirënjohur të fushës nga të dy anët e kufirit, debatuan dhe paraqitën opsionet shkencore për përbashkëtimin e problemeve që ka frutikultura në përgjithësi. Një nga temat më të ndjeshme që u diskutua ishte ngritja e një sistemi të besueshëm certifikimi që duhet realizuar në të dy vendet.

Akad. Efigjeni Kongjika dha një vështrim panoramik të problemeve që trajtohen në botimin e ri duke ia lënë vendin autorëve të kapitujve të veçantë, që diskutuan për problemet që duhen zgjidhur urgjentisht për mbarëvajtjen e kultivimit të specieve drufrutore autoktone dhe për funksionimin e sistemit të certifikimit të prodhimit të fidanëve të këtyre specieve, që duhet të realizohet në institucione shkencore të specializuara dhe të akredituara për prodhim të materialit mbjellës fidanor sipas standardeve të njohura dhe të mirëpërcaktuara.

Megjithëse sistemi i certifikimit është objektivi kryesor i forumit, shumë probleme të tjera për sa i përket stimulimit të kultivimit të kultivarëve autoktone të drufrutoreve u debatuan duke i shtruar dhe duke dhënë zgjidhje shkencore. Rëndësi ka që këto zgjidhje

të gjenden në këtë panoramë të zhvillimit të vendeve tona të vogla, që duhet të mbijetojnë në situatat e globalizimit.

Prof. Agim Zajmi pasqyroi pamje të gjermoplazmës së pasur të pemëve në Kosovë, ndërsa prof. Resmi Osmani në bashkëpunim me prof. asoc. Ilir Çiçi evidentoi fondin vendës të pemëve në Shqipëri të pasur me forma, ekotipe dhe kultivarë me origjinë të lashtë. Specialistët e mirënjohur në të dy vendet theksuan domosdoshmërinë e hartimit të një Programi Kombëtar me orientimet strategjike të politikave për ruajtjen e burimeve gjenetike si në Shqipëri ashtu edhe në Kosovë. U shtrua detyra e grumbullimit, koleksionimit, shëndetësimit fitosanitar, ruajtjes e studimit të gjermoplazmës së pemëve frutore vendëse, si detyrë imediate për ruajtjen dhe shfrytëzimin, si pjesë e kulturës bujqësore tradicionale kombëtare, por edhe e zhvillimit perspektiv mbi bazën e kërkesës së konsumatorëve, industrisë përpunuese, por edhe të eksportit. Prof. Lush Susaj, specialist në UBT, bashkautor me prof. Bashkim Koronica nga Kosova për vreshtarinë dhe verëtarinë, pasi paraqiti kultivarët e hardhisë vendase me karakteristikat e tyre të vlefshme për treg, përshkroi perspektivën e zhvillimit të vreshtarisë si në rritjen e sipërfaqes totale të kultivimit, ashtu dhe për përmirësimin e strukturës varietore të mbjelljeve duke pakësuar numrin e kultivarëve më të mirë ndërkombëtarë dhe duke rritur sipërfaqen e mbjellë me kultivarët e seleksionuar e të përmirësuar të vendit. Prof. asoc. Hajri Ismaili me bashkëpunëtorët e tij paraqitën të dhëna mbi fondin gjenetik vendas të ullirit, si dhe të agrumeve, për rëndësinë e agroturizmit si element multifunksional në korrelacion me biodiversitetin, komercializimin e produkteve shumë tradicionale të vajit të ullirit, si dhe zhvillimin në harmoni me territorin për ferma të vogla multifunksionale.

Përvoja e prof. Arben Myrta, ekspert i fushës së virusologjisë bimore në Kompaninë Certis Europe në Bruksel ka qenë në qendër të vëmendjes së auditorit për problemet e gjendjes fitosanitare të fidanishteve në Shqipëri dhe në Kosovë. Kjo përvojë e gjatë për identifikimin e fitopatogjenëve është rezultat i projekteve të përbashkëta edhe midis ASH dhe ASHAK-ut, që fatkeqësisht ka evidentuar praninë e patogjenëve karantinorë jo vetëm në fushë, por edhe në fidanishte. Gjithashtu është konstatuar prania e viruseve të reja si në Shqipëri edhe në Kosovë me rrezik jo vetëm në vend, por edhe në rajon e më gjerë. U shtrua me forcë përafrimi i legjislacionit për certifikimin e fidanëve të bimëve drufrutore dhe hardhisë me legjislacionin përkatës të BE-së në Shqipëri dhe në Kosovë. Me gjithë përpjekjet e vazhdueshme të dy vendeve për përditësimin e tij, mbetet akoma për të bërë në mënyrë që ky legjislacion të jetë i njëjtë me atë të vendeve të BE-së. Specialistët e kësaj fushe shtruan nevojën emergjente të ndërtimit të një sistemi certifikimi të besueshëm me institucione, detyra dhe përgjegjësi të përcaktuara për prodhimin e materialit shumues në dy drejtime: të sigurt gjenetiki dhe të pastër ndaj problemeve fitosanitare. U theksua fuqimisht edhe roli i fidanrritësve, që duhen konsideruar komponent kryesor në sistemin e certifikimit, sepse produkti fidanor mirret prej tyre dhe ju kthehet si "burim bazë" i certifikuar.

Duket se zgjidhjet dalin nga institucione shkencore, në laboratorë të mirëpajisur, por veçanërisht nga kërkues të specializuar, me vizion, që njohin të kaluarën, por jetojnë të tashmen e vështirë me shumë probleme dhe që konsiderojnë mundësitë e ndryshimit të fuqishëm të bujqësisë me frutikulturën si drejtim kryesor. Është pikërisht kjo bazë që duhet të mbështetet nga politika stimuluese të Qeverisë dhe të Ministrisë së Bujqësisë e Zhvillimit Rural, që tashmë janë shpалosur në programe të Qeverisë me modelin e ekonomisë mbështetur në diversifikimin e produkteve dhe shërbimeve, adoptimin masiv të teknologjive të reja.

Komuniteti shkencor që e ndjen veten përgjegjës për zhvillimin e sotëm të bujqësisë dhe agroturizmit po aq sa politika, ndofta më shumë, sepse ai komunitet mbetet, ndërsa qeveritë ndryshojnë, ndjehet po ashtu i respektuar, kur i dëgjohe mendimi i specializuar, ekspertiza, kur vihet në detyrën e kryesimit të trajnimit dhe të transferimit të njohurive bashkëkohore tek studentët, tek nxënësit në shkollat bujqësore rajonale që po shtohen dhe deri tek fermerët, që janë pjesëmarrësit më aktivë të interesuar për certifikimin e fidanëve të prodhuar. Në radhë të parë, departamenteve të Universitetit Bujqësor me specialistët duket se po ju kthehet roli dhe funksioni i tyre kryesor në zhvillimet e sotme në bujqësi e në ekonomi në përgjithësi. Natyrisht, edhe ky komunitet ka nevojë për bashkëpunim me specialistë në universitete të tjera të vendit. Të mos harrojmë se sot japin rezultate pozitive dhe të qëndrueshme projektet multidisiplinore si në nivel kombëtar, në trevat shqipfolëse, në nivel rajonal dhe europian.

Në forum u shfaq mendimi pozitiv se drejtuesit e sotëm të Ministrisë së Bujqësisë shohin me sy kritik papërgjegjshmërinë 25-vjeçare që çoi drejt mbylljes institucionet e kërkimit, që siç përmend ministri Niko Peleshi *duhen ringjallur për t'i kthyer ato në modele inteligjente për ta bërë prodhimin vendas më konkurrues në tregun ndërkombëtar.*

Pjesëmarrësit e forumit diskutuan aktivisht për problemet e kultivimit të kultivarëve autoktonë dhe certifikimin e fidanëve të prodhuar, për nevojën e mbështetjes jo vetëm shkencore për studiuesit dhe specialistët e prodhimit të pemëve, vreshtit, atyre të fidanishteve dhe sidomos për forcimin e lidhjeve midis institucioneve kërkimore dhe mësimore, por edhe për një bashkëpunim më aktiv në fushën e prodhimit të fidanëve të drufrutorëve midis Shqipërisë dhe Kosovës.

Së fundi, pjesëmarrësit në forumin shkencor miratuan *Kartën e forumit* me rekomandime të komunitetit shkencor drejtuar institucioneve politikëbërëse e vendimmarrëse, komisioneve parlamentare, Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministrisë së Arsimit, Sporteve dhe Rinisë, universiteteve dhe institucioneve shkencore.

KARTA E FORUMIT TË KONFERENCËS

Kultivarët e vendit të pemëve frutore, hardhisë, ullirit dhe agrumeve në Shqipëri dhe në Kosovë dhe ndërtimi i sistemit shkencor të certifikimit për prodhimin e fidanëve, në këndvështrimin e botimit të ri shkencor Pemëtaria dhe vreshtaria në Shqipëri dhe në Kosovë, në kuadër të Protokollit të Bashkëpunimit Shkencor dhe Artistik midis ASHSH dhe ASHAK)

SSHNT i Akademisë së Shkencave në bashkëpunim me Akademinë e Shkencave dhe të Arteve, Kosovë; Fakultetin e Bujqësisë dhe Veterinarisë të Universitetit të Prishtinës; Universitetin Bujqësor të Tiranës dhe Universitetin e Tiranës; Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Qendrën e Transferimit të Teknologjive Bujqësore, Vlorë; Institutin Agronomik Mesdhetar, Bari, Itali organizuan forumin shkencor *“Kultivarët e vendit të pemëve frutore, hardhisë, ullirit dhe agrumeve në Shqipëri dhe në Kosovë dhe ndërtimi i sistemit shkencor të certifikimit për prodhimin e fidanëve”* me qëllim: (i) stimulimin e kultivarëve të vendit të pemëve frutore, hardhisë, ullirit dhe agrumeve në Shqipëri dhe në Kosovë dhe (ii) sensibilizimin për domosdoshmërinë e ndërtimit të një sistemi certifikimi për prodhimin e fidanëve të tyre. Në përfundim të referimeve, analizave dhe diskutimeve kërkuesit shkencorë arritën në hartimin e disa rekomandimeve kryesore duke aprovuar rekomandimet e paraqitura si më poshtë:

Për përmirësimin e legjislacionit dhe të rregullave për kultivimin e kultivarëve të drufrutorëve

- **Ngritjen e një grupi ekspertësh** nga Ministria e Bujqësisë, institucionet shkencore dhe Instituti Agronomik Mesdhetar i Barit (Itali) për të analizuar situatën e prodhimit të fidanëve në vend dhe problemet e vështirësitë, që hasen për të filluar zbatimin e një

programi certifikimi në vend të ngjashëm me vendet e BE-së. Grupi të vejë theksin në përpilimin e programeve për përparimin e pemëtarisë dhe vreshtarisë si dhe ruajtjen e kultivarëve vendorë dhe atyre në rrezik zhdukjeje.

- **Hartimin e një programi kombëtar** me orientimet strategjike të politikave për ruajtjen e burimeve bimore gjenetike si në Shqipëri, ashtu edhe në Kosovë.
- **Vlerësimi i gjendjes aktuale fitosanitare të fidanishteve dhe blloqeve të pemëve apo të vreshtave pranë tyre**, për të siguruar që nuk janë të infektuara nga patogjenë karantinorë ose të rëndësisë ekonomike të veçantë.
- **Hartimin e ligjit profesional të vreshtave**, ku të përfshihet vreshtaria e qëndrueshme, si ajo organike, biodinamike, vreshtaria e integruar, tradicionale (pjergullat dhe erekët), që të pasqyrojë realitetin lokal, rajonal dhe atë europian e botëror të zhvillimit të vreshtarisë dhe enologjisë.
- **Organizimin e një kadastre funksionale të pemëtarisë, vreshtave, agrumeve apo ullirit**, duke përcaktuar vendndodhjen gjeografike të tyre, llojet, duke përfshirë parcelat “mëma”, koleksionet, gjermoplazmën autoktone etj.
- **Realizimin e një studimi të mirëfilltë të territorit për rajonizimin** e kultivarëve e nënshartësive drejt specializimit të zonave për kulturën më të përshtatshme.
- Shpalljen çdo vit nga drejtoritë teknike të MBZHR dhe UBT të **strukturave të mbjelljeve dhe kultivarët e rinj, që futen në prodhimin komercial.**
- **Ullikultura duhet të mbrohet nga shteti për të ndaluar erozionin numerik**, veçanërisht për pemët e vjetra, për rajonin ekonomik të zhvillimit të ullirit; të **krijohet një fond financimi mbi bazën e projekteve për rikonstruksionin e ullishtave të vjetra e të subvencionohet krijimi i ullishtave të reja deri 3 vjet.**
- **Ngritjen e infrastrukturës me teknologjinë e ruajtjes, standardizimit, përzgjedhjes, përpunimit të nënprodukteve në zonat e kultivimit industrial të drufrutorëve.**
- Krijimin e zinxhirit të vlerave të produktit frutikulturor duke **mbështetur kooperativizimin e prodhimit, unifikimin e agroteknologjive dhe mbështetjen e qendrave të grumbullimit dhe marketingut.**

Në veçanti, *për zhvillimin e vreshtarisë dhe verëtarisë në Shqipëri dhe në Kosovë*, për integrimin bashkëkohor me trendin aktual të rritjes së kërkesës së tregut dhe me zhvillimet rajonale e botërore në vreshtari dhe të prodhimit të verës kërkohet:

- **Rritjen e sipërfaqes së vreshtave dhe të prodhimit të tyre** si në Shqipëri në mbi 20000 ha dhe në Kosovë në 9500 ha; **rritje të sipërfaqes së vreshtave për rrush tavoline** në 20 për qind të totalit të sipërfaqes me vreshta; **rritje të sipërfaqes së serrave për rrushin e hershëm e të vonë nga fusha e mbrojtur** me të ardhura vjetore 4-5 herë më të larta se ato prej vreshtave të rrushit të verës së kuqe.
- **Përqendrimin e strukturës varietore në më pak kultivarë**, më të mirë, dhe më të kërkuar nga tregu dhe nga konsumatori.
- **Rritjen e prodhimit të verës rozë në vreshtarinë shqiptare**, lidhur me trendin aktual të rritjes së kërkesës së tregut.
- **Rishikimin e planit perspektiv afatgjatë të zhvillimit të vreshtarisë për kalimin në prodhimin e verërave të emërtimit të origjinës EOM**, në kuadër të zhvillimit të turizmit,

Për kërkimin shkencor - në mbrojtjen dhe kultivimin e kultivarëve autoktonë

Në funksion të rolit që do të luajnë në një sistem certifikimi kombëtar në të ardhmen, institucioneve, qendrave këshillimore dhe strukturave private për problemet e mëposhtme t'i jepet mbështetje:

- **me projekte e institucioneve shkencore për përzgjedhjen, grumbullimin dhe ruajtjen e gjermoplazmës autoktone shqiptare**, si detyrë kryesore për gjenetistët dhe seleksionerët, veçanërisht në kushtet e erozionit të theksuar gjenetik.
- **për laboratorët *in vitro* të Institutit të Resurseve Gjenetike, të UBT për ruajtjen *in vitro* të koleksioneve të resurseve gjenetike drufrutore, si dhe të QTTB Vlorë për shëndetësimin e kloneve të infektuara dhe shtimin e nënshartesave të pastra të resurseve gjenetike drufrutore.**
- **për përmirësimin gjenetik të popullatave dhe ekotipave lokalë dhe rajonalë të hardhisë**, baza për markat bashkëkohore të verës me tipicitet të shquar dhe me identitet historik e gjeografik në kushtet e zhvillimit të agroturizmit.
- **kultivimit të specieve me “përdorim të pakët”** (manaferra, boronica, nespola, arra me lulëzim anësor, bajamja, arra e pistakut, luleshtrydhja, shega, fiku).

Për kërkimin shkencor në mbështetje të sistemit të certifikimit të prodhimit të fidanëve

- **Ngritjen e programit të certifikimit për kontrollin fitosanitar e gjenetik të materialit të shumimit dhe harmonizimi i ligjit shqiptar të certifikimit me direktivat e BE-së**, implementimi nga MBZHR në bashkëpunim me UBT.
- **Riaktivizimin me investime minimale i strukturave dhe laboratorëve që janë ndërtuar nga projekti i Institutit Agronomik Mesdhetar të Barit pranë QTTB, Vlorë dhe UBT/Institutit të Mbrojtjes së Bimëve në Durrës.**
- **Akreditimin e laboratorëve të referencës për kontrollin molekular të fitopatologjive dhe shëndetësimin i laboratorëve të biologjisë molekulare dhe atij të kulturave *in vitro* të Fakultetit të Shkencave Natyrore, UT dhe bashkëpunimi i tyre me laboratorët e QTTB Vlorë dhe të UBT për rritjen e eficiencës së strukturave të tyre brenda një kohe të shkurtër.**
- **Kthimin e QTTB Vlorë në institucion kërkimor shkencor pranë MBZHR** për të luajtur rol maksimal në prodhimin vendas dhe me produkt më konkurrues në treg.
- **Bashkëpunimin me projektin aktual të ullirit që Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe UBT po realizojnë sot me partnerë italianë, ku tema e certifikimit është pjesë e projektit.**
- **Fuqizimin e sistemit të karantinës në kontrollin e fidanëve frutorë të importuar.**
- **Mbështetjen e fidanishteve private e shoqatave të tyre për të garantuar partneritetin e interesin e tyre për sistemin e certifikimit dhe kultivarët e vendit.**

Për edukimin e specialistëve të rinj, të biznesit për prodhimin e fidanëve dhe të fermerëve t'i kushtohet vëmëndje më e madhe:

- **mbështetjes për institucionet akademike e shkencore në funksion të punës kërkimore për sigurimin e sinergjisë mes kërkimit shkencor dhe programeve të zhvillimit kombëtar dhe pjesëmarrje të përbashkët në programet e fushës së frutikulturës.**
- **arsimimit të të rinjve dhe mbështetje doktoraturave e masterave në drejtim të frutikulturës dhe përdorimit të teknologjive inovative në të.**
- **rritjes së dijeve dhe nivelit të kulturës bujqësore për fermerët dhe specialistët e ekstensionit me hapjen e më shumë shkollave bujqësore rajonale dhe me anë të kualifikimit të vazhdueshëm të fermerëve dhe specialistëve të mesëm e të lartë.**

- zgjidhje e problemeve, kur **kualifikimi shkencor i vazhdueshëm do të bëhet përsëri funksion dhe detyrim ligjor dhe moral për departamentet e Universitetit Bujqësor, duke e kthyer në rolin dhe në funksionin e tij historik.**

III. BOTIME

A. Botimet periodike

Journal of Natural and Technical Sciences (JNTS)

(shih: http://akad.gov.al/ash/pdf/periodike/07_jnts_1_2017.pdf)

Revistë shkencore shumëdisiplinore në gjuhën angleze ISSN-je: 2489-0484 dhe me Global Impact Factor >0.6. Në këtë revistë janë publikuar artikuj që kanë të bëjnë me çdo aspekt të shkencave të natyrës, teknike mjekësore dhe atyre inxhinjerie, teknologjike e bujqësore. Një vend të veçantë zënë artikujt, që me përmbajtjen e tyre unifikojnë konceptet e shkencës me të dhënat, qofshin këto të dhëna vëzhgimore apo thjesht teorike, si për ato të produkteve shkencore bazë dhe të aplikuara.

Për vitin 2017, u botuan tre numra të revistës JNTS. Numri i parë (numër special) i dedikohet njëres nga fushat prioritare të shkencës së nanoteknologjisë sot dhe aplikimeve të saj. Punimet në këtë numër bazohen në workshop-in triditor “Nanotechnology and biosensors, impact in health, environment, safety and security of Albania” (Nanoteknologjia dhe biosensorët, ndikimi në shëndetësi dhe mjedis, mbrojtja dhe siguria në Shqipëri), organizuar nga SSHNT i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë në bashkëpunim me Fakultetin e Shkencave të Natyrës i Universitetit të Tiranës, Universitetin Politeknik të Tiranës, Universitetin e Mjeksisë, Universitetin Bujqësor të Tiranës, Catalan Institute of Nanoscience and Nanotechnology, Spanjë (ICN2) dhe me mbështetjen e Ambasadës së Spanjës në Tiranë. Në këtë numër special kontribuan redaktorët e ftuar, akad. Arben Merkoçi, ICREA, Spanjë dhe prof. dr. Majlinda Vasjari, Fakulteti i Shkencave të Natyrës, Universiteti i Tiranës.

Në numrin e dytë të revistës, lexuesi mund të gjejë materiale nga fusha e matematikës, shkencave të tokës, informatika, biologjia dhe mjekësia si fusha bazë, por dhe materiale nga nënfushat e tyre si gjenetika humane, energjia e rinovueshme si alternativë për furnizimin me energji për popullatën, përfitimet në mjedis, ekonomi e shëndetësi etj. Për sistemin e taksimit, informacion të rëndësishëm paraqet artikulli “The implementation of progressive tax in Albania” (Implementimi i taksës progressive në Shqipëri). Artikulli paraqet alternativat për një sistem më të drejt taksimi që nuk rëndon mbi popullatën. Artikulli “Impact of managerial skills on the efficiency and effectiveness of organisations-a case of Albanian business organisations” (Ndikimi i aftësive menaxhuese mbi efikasitetin dhe suksesin e organizimit në *punë-rasti* të një biznesi shqiptar) raporton nevojën e biznesit për studime rreth marrëdhënieve aftësi menaxhuese - efikasitet menaxherial - prodhimtari. Rezultatet e studimit tregojnë rëndësinë e programeve të trajnimit për të përmirësuar aftësitë ndërpersonale ose “aftësitë e buta”, veçanërisht për menaxhimin e ulët dhe të mesëm dhe nga ku tërhiqet vëmendja në drejtim kujdesit që duhet t’i kushtohet strukturës organizative me synimin që alokimi i detyrave të bëhet më konsistent dhe sistematik dhe përshkrimet e punës të jenë koherente dhe konçize. Po edhe në rubrikën e informacioneve shkencore mjaft të

dobishëm për sistemin e transportit paraqet dhe artikulli “Electric vehicles, chances of an expanding market: the case of Albania” (Makinat elektrike, mundësitë e hapjes së tregut) si alternativë për një system transporti më ekonomik, më komod dhe më miqsor me mjedisin. Numri i tretë i revistës i kushtohet studimeve të paraqitura për herë të parë në konferencën ndërkombëtare “Kanceri i qafës së mitrës: parandalimi, diagnostikimi dhe trajtimi i tij”, në të cilin publikohen edhe punime të paraqitura nga një workshop i zhvilluar në vazhdim të konferencës. Në këtë numër publikohet edhe Karta e rekomandimeve të konferencës, e cila do të orientojë planet e zhvillimit për realizimin e rekomandimeve të konferencës.

No	Author	Research Papers	Page
1	Aida SHASVARI	Ordered semigroups with commuting bi-ideals	3
2	Orges BEQIRI Faton PETRO	Generalized weakly F -division rings	17
3	Alfons HAREZAJ Fatmir HOXHA	Measurement of abilities of candidates in test assessments	29
4	Roland SAHATÇIA Emira QOSJA Ambrozi FERHATAJ	Impact of managerial skills on the efficiency and effectiveness of organizations (a case albanian business organisations)	39
5	Ormen RRAPQ Ornik SERKAN Gjergj GRUZI	A statistical assessment of the earthquake activity in the Vlera-Lushnja-Elbasan-Dibra transversal fault zone, Albania	59
6	Alfred FRASHERI Salvatore BUSHATI	Geothermal energy use for space heating & cooling in Albania and the directives of european union	77
7	Pandeli FASHIKO Dardan MLLISHI Veset HOXHA	The mesoscale evaporites on the se part of Adriatic foredeep basin (Albania)	93
8	Elona ABAZI	Analysis of the influence of Drita river flow in the water regime of Drita river using subel software	105
9	Vilma GURAZI Luljeta KHAGALLI Romana IRDIA Tetkide VASQI	A comparative study of alternative immobilization techniques and their impact in fermentation characteristics of yeast cells	121
10	Juliana GJERAZI Erjan TASHI Ervin RAPAJ Irma TASHI Rajina HANA Tetina FLEQI Juliana DAKA Loreta KARALLI Perlat KAPSYZI Jul BESHQI	Seriv markers cell profile in blood and quantum in Chronic obstructive pulmonary disease exacerbations (AECOPD)	131
11	Ida KOLA Blerina KOLGJINI Sjira RAMBOUR Genti GUXHO Paul KEKELIS	Influence of linear density and cross section shape of the monofilaments on their bending behaviour	147
12	Kristina HAKRAMA Genti GUXHO	Structure analysis of recycled rubber by using vibration infra red spectroscopy method, equipped with ATR system.	159
13	Ile KEKA Boris CICO Naki FRASHERI	Effect of parallelism in calculating the execution time during forecasting electrical load	169
14	Dardan BELA	Reasoning about implementation of progressive tax on personal income from employment, reduction of vat threshold and implementation of a flat tax on business profits in Albania	181
15	Stajton DUME	Electric vehicles, chances of an expanding market: the case of Albania	197
		Obituary: Dr. Arqile Bërsholli	211

Revista shkencore “Journal of Natural and Technical Sciences”


Revista është një botim i përbashkët me Fondacioni BLEKALB. Buletini “Kërkimi Shkencor në Bujqësi dhe Prodhimin e Kafshëve dhe Zhvillimin Rural” boton punime origjinale shkencore, përmbledhje të rezultateve paraprake të kërkimit shkencor, artikuj bibliografikë, referime e kumtesa të paraqitura në simposiume, konferenca e kongrese shkencore, rezultate të përvojës në zbatimin e teknologjive të ndryshme në prodhimin bujqësor e blegtoral, shkrime problemore dhe/ose përgjithësuese të zhvillimit të ekonomisë bujqësore e blegtorale, trajtime shkecore dhe/ose përgjithësuese të proceseve të zhvillimit ekonomik të qëndrueshëm rural, të përgatitur nga autorë shqiptarë dhe të huaj, në gjuhën shqip dhe anglisht. Bordi botues i revistës me kryeredaktor prof. dr. Kristaq Kume, përbëhet nga 36 specialistë të fushave ndërmjet të cilëve dhe tre anëtarë të SSHNT, akademikët J. Vangjeli dhe S. Bushati dhe E. Kongjika. Në këtë revistë që botohet në dy numra vjetorë në vit, edhe në vitin e saj të shtatë të botimit. në vëll. 7, nr. 1 u publikuarn punime të autorëve vendas (4 artikuj) dhe të huaj (3 artikuj), ku në vartësi të problematikës në këtë numër, punimet grupohen në:

- studime që trajtojnë çështje të **biodiversitetit në bimë e kafshë që përdoren për bujqësi e ushqim**. Në to jepen rezultatet e kërkimeve që kanë në fokus vlerësimin e cilësive dhe tipareve të prodhimit të specieve/racave që studiohen, kushtet për kultivimin/ mbarëshkrimin e tyre dhe vlerësimin e rëndësisë ekonomike që ato kanë;


- punime në të cilat jepen rezultatet e **kërkimit në studimin e florës dhe faunës së egër**, ku vlera e këtyre punimeve është jo vetëm për informacionin njohës që ato sjellin për këtë pasuri biologjike por edhe pse në to diskutohen rrugë dhe mundësitë për ruajtjen e biodiversitetit, si faktorë me efekt të rëndësishëm në jetën e njeriut;

- studime që fokusohen në **identifikimin dhe vlerësimin e rolit të bujqësisë në zhvillimin ekonomik të vendit** dhe në gjetjen e rrugëve dhe instrumentave alternativë për të zvogëluar efektin e krizave në ekonominë e vendit;

- studime që trajtojnë **çështje të miradministrimit të hapsirave publike** në qytet me theks përdorimin e infrastrukturës së gjelbër, të cilat jepen në mënyrë të detajuar e shkencore, problemet që duhet të zgjidhen për të mundësuar rritjen e hapësirave të gjelbra në zonat urbane dhe demostrohen teknika që mund të përdoren për këtë qëllim. Prurjet shërbejnë si udhërrëfyes për vendimarrësit që administrojnë këto hapësira.



Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë
Academy of Science Republic of Albania
Shkencë Teknologji Shërbim Këshillimor për Zhvillimin e Fëmës
Science Technology Extension Service for Farm's Development



ISSN 2224-7718

BULETIN

Kërkimi shkencor në bujqësi dhe prodhimin shtazorë për zhvillimin rural

Journal of Agriculture and Animal Production Science for Rural Development

VII (1)

Viti VII

Tiranë - 2017

Content
Përmbajtja

<p>B. Kadriaj, E. Sherifi, N. Shaban</p> <p>M. Blazhevska Toshevi, P. Stajkovski</p> <p>Z. Myrollari, K. Teneqzhi, E. Janari</p> <p>E. Lekaj, Z. Topaj</p> <p>M. Luma, H. Mehmeti, H. Detyca, I. Zenebi</p> <p>B. Dervishi</p> <p>K. Kama, E. Zyta, N. Barshali</p> <p>J. Gjerman, B. Kola</p> <p>Zh. Haxhi, V. Ibrahimli</p> <p>S. Gati</p>	<p>Analysis of several quantity variables of <i>crucis lasiocornis</i> and <i>crucis heuffeliana</i> <i>Alveta e disa variablales ciluar në crucis lasiocornis</i> and <i>crucis heuffeliana</i></p> <p>Economic importance of agriculture for the Republic of Macedonia <i>Rëndësia ekonomike e bujqësisë në Republikën e Maqedonisë</i></p> <p>Study of new onion cultivars in Devoll ecogeographic <i>Studim i disa kultivarëve të ri të qepës në eko-rafionin e Devollit</i></p> <p>Evaluation of urban green spaces and air quality in Tirana city <i>Hartimi i hapësirave të gjelbra urbane dhe i cilësisë së ajrit në qytetin e Tiranës</i></p> <p>Cattle breeding structure and mortality from tubercular skin disease (LSD) in Kaçanik region <i>Struktura racore dhe riprodhueshmëria e gjelbrave në kumësirin e Kaçanikut nga sëmundja gjyqerore e lëkurës (LSD)</i></p> <p>Study on the possibility of cultivating the cherry plant in Albania <i>Studim mbi mundësinë e kultivimit të berrës së sheqerit në Shqipëri</i></p> <p>First establishment of an Albanian network for wildlife health surveillance as a key element for the protection of human health and biodiversity <i>Udhëzimi i parashfaqur për mbledhjen e informacioneve të kufijëve të qytetit si një element kyq për mbledhjen e shënjestër të shtetit dhe biodiversitetit</i></p> <p>Assessment of macro-prudential in a novelty after financial crisis <i>Fluturimi i makroprudencës si një risi pas krizës financiare</i></p> <p>Use of industrial organic fertilizer of the group "NANO AG" in the corn plant <i>Përdorimi i plehurit biologjik industrial të grupit "NANO AG" në bimën e misrit</i></p> <p>Techniques of Urban Greenery Infrastructure <i>Teknikat e infrastrukturës së gjelbrimit urban</i></p>
--	---

Vëllimi	7	Numri	1	Viti	2017	Periudha	Janar-Qershor	Tiranë
Volum	7	Number	1	Year	2017	Period	January-June	Tirana

Revista shkencore "Journal of Agriculture of Animal Production Sciences for Rural Development" (JAAPSR) 2017/1

B. MONOGRAFI

Monografia *“Hapësira bregdetare Divjakë - Karavasta në Adriatik”* me autorë **Niko Pano, Alfred Frashëri, Salvatore Bushati, Efigjeni Kongjika, Bardhyl Abdyli, Hajri Haska, Evis Taska, Gentian Muça**, që vjen si rezultat i studimeve komplekse dhjetëravjeçare, hidrografia e hapësirës bregdetare të Karavastasë trajtohet si pjesë e rëndësishme e litoralit shqiptar dhe vetë hapësira e Karavastasë analizohet në mënyrë të detajuar. Vlerësohen aspekte të tilla të rëndësishme, si: regjimi limnologjik i sistemit lagunor të Karavastasë, hidrologjia e lumenjve Seman e Shkumbin në pjesën e poshtme të rrjedhjes së tyre, si dhe talasografia e hapësirës përkatëse bregdetare të Adriatikut. Pjesë përbërëse dhe të rëndësishme të kësaj monografie janë edhe klasifikimi morfologjik dhe vlerësimi i dinamikës së zhvillimeve hidromorfologjike të zonës bregdetare. Elementet e mësipërme janë shqyrtuar në bashkëveprim të ndërsjellë dhe në unitet të plotë me njëri-tjetrin. Gjatë këtij shqyrtimi janë mbajtur parasysh veçoritë e përgjithshme fiziko-gjeografike të territorit, si: gjeologjia, pedologjia, klima, veshja bimore etj. Përveç kësaj, zhvillimet hidrogjeomorfologjike të kësaj hapësire janë trajtuar edhe në kuadrin e vlerësimit të ndikimeve që kanë ndryshimet klimatike në këto zhvillime.

Monografia mbështetet në përpunimin dhe përgjithësimin e një informacioni të gjerë shumëvjeçar faktik arkivor si dhe në rezultatet e ekspeditave hidrometrike në terren, veçanërisht ato të realizuara gjatë periudhës 2000-2010. Të dhënat ekspeditore të grumbulluara gjatë periudhës së mëparshme 1972-1992, në këtë botim janë përdorur kryesisht për të shqyrtuar shkallën e ndryshimeve limnologjike në kohë në sistemin lagunor të Karavastasë. Në tërësinë e saj, monografia ka realizuar përgjithësimin e të dhënave faktike ekzistuese për sistemin Divjakë - Karavasta duke paraqitur një tablo integrale dhe të plotë, e cila do të kontribuojë për zgjidhjen e detyrave të ndryshme për rikuperimin mjedisor, si edhe mbrojtjen e zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik-social të kësaj hapësire me rëndësi të madhe dhe me një bukuri të rrallë natyrore.

Kjo monografi është realizuar nga specialistë të institucioneve dhe shoqatave shqiptare në bashkëpunim edhe me Universitetet e Ferrarës dhe Barit, Itali. Sjellja e një botimi të tillë, me të dhëna shumëvjeçare dhe të përditësuar për nga njohja e monitorimit të terrenit, si dhe me analiza shumëdisiplinore të realizuara nga specialistët e shumtë të angazhuar për këtë botim do t'i shërbejë komunitetit të specializuar shkencor, studentëve pasuniversitarë dhe universitarë, si dhe shoqatave ambientaliste, komuniteteve prodhuese e menaxhuese të këtyre pasurive natyrore të paçmuara.

Monografia *“Bazat e gjeofizikës së zbatuar në shkencat e tokës me metodat sizmike, gravimetrike dhe studimit të puseve”* me autorë **Vilson Silo dhe Salvatore Bushati**, është përgatitur si përgjigje e kërkesave praktike dhe teorike bashkëkohore ndaj metodave gjeofizike që përdoren në shkencat gjeologjike, gjeoteknike, gjeologo-inxhinerike, mjedisore etj. Në botim përfshihen konceptet bazë të përpunimit shifror në ordinator të sinjalit në përgjithësi dhe atij sizmik e sizmologjik në veçanti, trajtohen parimet themelore teorike e praktike të përhapjes dhe të regjistrimit të valëve sizmike e sizmologjike në Tokë, zbatimi i tyre në fushat e gjeoshkencave, në inxhinierinë civile, në gjeoteknikë, në interpretimet e ndryshme të karakterit gjeologjik të kërkimit të hidrokarbureve dhe mineraleve të ngurta etj. Jepen gjithashtu edhe bazat e metodës gravimetrike, si dhe i disa metodave të tjera të gjeofizikës, që përdoren për zgjidhjen e

detyrave të ndryshme në fushat e gjeoshkencave. Në parathënie dhe në hyrje autorët theksojnë rëndësinë e metodave gjeofizike në ndihmë të studimeve të problemeve gjeologjike, të kërkimit të mineraleve të dobishme, të hidrokarbureve etj., si dhe historikun e shkurtër të zhvillimit dhe përdorimit të tyre.

Trajtimi i metodave të trajtuara në aspektin teorik e, mandej në fushat e tyre të aplikimit në praktikë për zgjidhjen e shumë problemeve konkrete dhe të ilustruara me shëmbuj të zbatimeve në Shqipëri. Kështu, botimi ofron njohuri shkencore teorike e praktike për stafin akademik, por edhe për specialistët përkatës të institucioneve shkencore e e universitare si dhe kompanive private, të cilët zgjidhin probleme të shumta me interesa konkrete prodhimi në kërkimin dhe nxjerrjen e burimeve natyrore mbi e nëntokësore si uji, gazi natyror, nafta, bitumi, qymyret, mineralet xeherorë metalorë e joxeherorë, si dhe shumë probleme të inxhinierisë civile në drejtim të ndërtimit e monitorimit të ndërtesave të banimit, rrugëve, ura, diga, ruajtje mjedisi nga gjeorreziket deri tek gruposja e mbetjeve urbane.

Botimi është fryt i një pune disavjeçare bazuar në të dhënat më të fundit të konsultuara me literaturë të gjerë bashkëkohore të fushave përkatëse të gjeofizikës. Në punimet dhe artikujt shkencorë të vetë autorëve të këtij libri, si dhe të specialistëve shqiptarë e ndërkombëtarë, në përvojën e gjatë të tyre në kryerjen, drejtimin, përpunimin shifror në kompjuter dhe në interpretimin e integruar të punimeve të metodave gjeofizike.

Në recensionet e tyre, ekspertë të fushës, prof. dr. Vilson Bare e prof. dr. Rrapo Ormeni vlerësuan botimin "...si një punim me vlera të larta shkencore i shkruar me kompetencë shkencore, profesionale dhe didaktike."

Monografia "Studime tekniko-shkencore mbi mundësinë dhe problemet e shfrytëzimit të lumenjve Drini i Zi dhe Vjosa" me autorë doc. inxh. Marko Kamenica dhe akad. Edmond Pinguli, paraqet studimet e kryera për shfrytëzimin hidroenergjitik dhe jo vetëm të lumit Drini i Zi dhe Vjosa, duke e konsideruar ujin si një nga pasuritë më të rëndësishme të një vendi. Historia e zhvillimit tregon se vendet dhe popujt, që kanë pasur zhvillim më të madh ekonomik shoqëror, kanë bërë kujdes për shfrytëzimin e gjithanshëm të pasurive ujore.

Lumi i Drin i Zi ka një pellg ujëmbledhës prej 5585 km² dhe vetëm 41,8 për qind e tij shtrihet brenda kufijve të Shqipërisë, ndërsa pjesa tjetër më e madhe në shtetin e Maqedonisë dhe një pjesë e vogël në shtetin grek. Për shfrytëzimin energjitik të lumit Drin, degë kryesore e të cilit është Drini i Zi, janë kryer bisedime me ish-shtetin jugosllav dhe ndërtimet në Shqipëri, janë kryer sipas vendimeve të përbashkëta të Komisionit shqiptaro-jugosllav për ujërat kufitare. Për ndërtimet e studiuara nga pala shqiptare, në shtratin e lumit Drini i Zi, në bazë të vendimeve të komisionit të përbashkët për ujërat kufitare, nuk bëhet asnjë shkelje nga pala shqiptare, ndërsa pë punimet që janë parashikuar nga pala maqedonase në lumin Radika, degë e lumit Drini i Zi, ka të dhëna të pasaktësuar, se pala maqedonase kërkon të transferojë jashtë pellgut më tepër ujë se sa parashikon marrëveshja për ujërat kufitare, e pranuar nga palët nderkufitare. Në këtë vështrim, është e nevojshme që ky problem të diskutohet nga një komision dypallësh siç parashikohet në procedurat e njohura ndërkombëtare. Studimi i paraqitur në këtë libër mund të jetë në ndihmë të palës shqiptare, që do të diskutojë e do të zgjidhë këtë problem.

Lumi Vjosa e ka burimin në malet e Pindit, në shtetin fqinj grek, ku ndodhet dhe 1/3 e pellgut ujëmbledhës me gjatësi të shtratit të lumit rreth 70 km. Studimi ka për qëllim

të bëjë të njohur aftësitë hidroenergjitike të lumit, të bashkërenduara me nevojat në rritje për energji që kërkohen për zhvillimin e vendit në të ardhmen. Në studimin dhe projekt-idenë e kaskadës së Vjosës, të hartuar nga shoqëria “Tekno Projekt” të bie në sy se niveli i lartësisë së digave të studiuara nuk kalon lartësinë e brigjeve të shtratit të tij. Pra nuk kemi përmbajtje të tokave dhe mjediseve të tjera sociale dhe banimi. Kshtu gjatë projektimit është pasur parasysh që të ruhet mjedisi natyror dhe të mësohet asnjë dëmtrim në të. Por Vjosa është përmendur në studimin e organizatave River Watch dhe Euronatur, si një nga tre zonat e rëndësishme të Gadishullit Ballkanik, ku duhet të ndalohet urgjentisht ndërtimi i digave të reja për hidrocentrale. Në studim jepen dhe disa konsiderata të autorëve në lidje me këtë çështje.

Monografia “Trashëgimia natyrore e Shqipërisë - vlerat, rreziqet dhe menazhimi” me autor prof. dr. Perikli Qirjazi trajton problemet e trashëgimisë natyrore të Shqipërisë dhe mbështetet në një bazë të pasur të dhënash, të siguruara nga vërtetimet dhe rilevimet e përsëritura në terren. Trashëgimia përfshin në vetvete vlera natyrore e kulturore që përcillen brez pas brezi. Kur pjesë e saj janë vlera të mjedisit natyror, kemi trashëgimi natyrore; ndërsa kur bëhet fjalë për vlera materiale e shpirtërore të shoqërisë, kemi trashëgimi kulturore. Në përbërje të trashëgimisë natyrore përfshihen objekte, peizazhe, ekosisteme, habitate më të veçanta, të rralla apo unike, relikte, endemike apo të rrezikuara për t’u zhdukur. Si të tilla, ato kanë rëndësi të madhe shkencore, ekologjike, kulturore, didaktike, por edhe turistike. Prandaj ruhen e mbrohen edhe me forma e mënyra shumë më të rrepta, të përcaktuara saktë dhe prerë në ligje të veçanta.

Botimi jep ndihmesë të veçantë në njohjen, trajtimin, mbrojtjen dhe menazhimin shkencor të vlerave të siteve të trashëgimisë sonë natyrore për qëllime studimore, ekologjike, kulturore, turistike etj. Për herë të parë tregohet kujdes i veçantë për evidentimin dhe analizën e vlerave shpirtërore të zonave të mbrojtura, duke hedhur bazat dhe drejtimitet e hulumtimit dhe trajtimit të këtyre vlerave. Në botë dhe në Shqipëri, trashëgimia natyrore, por edhe kulturore, përbën një nga problemet e mëdha mjedisore të kohës së sotme dhe të perspektivës. Kjo i jep veprës vlera të mëdha teorike dhe praktike, duke synuar të ndihmojë në zgjidhjen e problemeve praktike të mbrojtjes dhe menazhimit të trashëgimisë së pasur dhe të larmishme natyrore të vendit tonë.

IV. VEPRIMTARI TË TJERA

A. Takimi shkencor “Një jetë me përkushtim në gjeologji” për specialisten mineraloge prof. dr. Marije Koçi

Shërbimi Gjeologjik Shqiptarë në bashkëpunim me Akademinë e Shkencave në kuadër të veprimtarive për programin “Edukimi në Shkencë” organizuan takimin shkencor “Një jetë me përkushtim në gjeologji” në kënd vështrimin e vlerësimit të veprimtarisë kërkimore -shkencore e zbatuese të një prej specialisteve mineraloge prof. dr. Marije Koçi, cila gjithë jetën e saj ia ka kushtuar shkencave të tokës. Takimi u organizua në sallën “Aleks Buda” më 9 shkurt 2017.

Fjalën e hapjes e mbajti akad. Salvatore Bushati, i cili theksoi zhvillimin e këtyre veprimtarive në njohjen dhe ruajtjen e trashëgimisë shkencore në përgjithësi e veçanërisht të shkencave të tokës në Shqipëri, të dhëna të rëndësishme për edukimin shkencor të kërkuesve të rinj. Drejtori i Shërbimit Gjeologjik Shqiptar, dr. Viktor Doda vlerësoi veprimtarinë shkencore të prof. dr. Koçit duke e trajtuar atë lidhur ngushtë me arritjet e gjeologëve shqiptarë në përgjithësi.

Në takim diskutuan mjaft kolegë të prof. dr. Koçit, pedagogë të saj që në edukimin e mesëm e deri në atë universitar duke theksuar përgatitjen e saj, por dhe aspekte të karakterit bashkëpunues në marrëdhëniet profesionale me kolegë e miq.

Prof. dr. Koçi është një ndër gjeologët e para në Shqipëri dhe ka shënuar një veprimtari shkencore në fushën e gjeologjisë shqiptare me kontribute në studimet gjeologjike të albanideve, studimet prognozë për perspektivat e zbulimit të mineraleve të dobishme, të cilat kanë lënë gjurmë për kontribute të spikatura në arritjet e saj në specialitetin e mineralogjisë. Ajo ka punuar pranë gjeologëve të shquar si Minella Shallo, Injac Ndoja, Zef Boriçi, Agim Dobi, Alaudin Kodra, Agim Tërshana, Polikron Theodhori, Ismail Turku, Petro Kati etj., të cilët i përkasin plejadës së gjeologëve që me shumë përgjegjësi dhe përkushtim vunë themelet e Shërbimit Gjeologjik Shqiptar, i cili mori zhvillim që nga vitet 60-të shekullit të kaluar. Ajo është autore e bashkautore në shumë studime gjeologjike, botime e referate shkencore brenda e jashtë vendit, pjesëmarrëse në shumë aktiviteteve të gjeologjisë, duke u vlerësuar kështu si një model i shkencëtares, por edhe i femrës shqiptare në fushën e gjeologjisë.

B. Ceremoni për dhënien e mirënjohjes “Nderi i Akademisë” prof. dr. Agim Ballvorës

Në kuadër të vlerësimit të kërkuesve shqiptar në botë dhe misionit që ASHSH ka për aktivizimin e diasporës, si një *pasuri* që duhet të kontribuojë për Shqipërinë, u zhvillua ceremonia për vlerësimin e veprimtarisë shkencore të dr. Agim Ballvorës dhe dhënien e medaljes “Nderi i Akademisë” me motivacionin “Për arritje të shquara inovative ndërkombëtare në kërkimin shkencor në fushën e bioteknologjisë bimore moderne dhe edukimin shkencor e transferimin e teknologjive edhe në Shqipëri”, e cila u organizua më 10 mars 2017 në mjediset e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë.

Në fjalën e tij përshëndetëse, kryetari i SSHNT, akad. Salvatore Bushati vuri në dukje disa aspekte të punës së prof. Ballvorës në institucione shkencore në Shqipëri, Gjermani etj. Akad. Efigjeni Kongjika, pedagoge e tij dhe kolege në Institutin e Kërkimeve Biologjike paraqiti përshtypjet e saj më mbresëlënëse për aftësitë dhe punën e Ballvorës. Si student në biologji në FShN të Universitetit të Tiranës dallohej ndër të tjerët për rezultate maksimale dhe për këmbënguljen e tij për tu përfshirë në studime që edhe sot konsiderohen bashkëkohore. Si kërkues shkencor në Institutin e Kërkimeve Biologjike ai ka punuar deri më 1989 nën udhëheqjen e drejtorit të Institutit, akad. Teki Tartari në një projekt për analizën biokimike dhe gjenetike të gliadinave të grurit. Edhe në këtë mjedis shkencor, dr. Ballvora respektohej për seriozitetin në punë dhe thjeshtësinë e tij.

Dr. Ballvora është lektor i ftuar i disa universiteteve si Universiteti i Napolit Federico II. Gjithashtu është dhe anëtar i bordit këshillues të revistës shkencore “Agronomia Colombiana”. Është autor dhe bashkautor i më shumë se 30 artikujve shkencorë, mbi 30 referime në konferenca të ndryshme, të cilat janë produkt i punës së tij kërkimore. Me një kurrikulum të pasur dhe me arritje konkrete gjatë kualifikimit dhe veprimtarisë shkencore në institucione të ndryshme kërkimore brenda dhe jashtë vendit, dr. Ballvora ka mundur të fitojë përvoja të shumëllojshme dhe të thelluara si dhe të japë kontribut në fusha të ndryshme të biologjisë, veçanërisht për sa i përket fushës së gjenetikës molekulare të bimëve. Ai ka dhënë ndihmesën e tij si lektor i ftuar në zhvillimin e dy konferencave ndërkombëtare të organizuara në Tiranë (simpoziumi shkencor ndër-institucional: “Zhvillimet shkencore, institucionale dhe ligjore për përdorimin e sigurt të produkteve bioteknologjike - nga biosiguria në përdorimin e produkteve

bioteknologjike”, organizuar nga Instituti i Kërkimeve Biologjike pranë Akademisë së Shkencave më 2005 dhe konferenca ndërkombëtare “Zhvillime bioteknologjike”, organizuar nga Akademia e Shkencave në bashkëpunim me Fakultetin e Shkencave Natyrore të Universitetit të Tiranës, më 2011). Në këtë të fundit, dr. Ballvora paraqiti disa rezultate të punës së tij shkencore me një grup të gjerë kërkuesish nga institucione të njohura në Bon dhe Këln të Gjermanisë në disa fusha shkencore si bioteknologji, gjeodezi dhe gjeoinformacion, të analizës inteligjente dhe sistemit të informacionit, fitosferës dhe dinamikës së ekosistemeve.



Çaste nga ceremonia e dhënies së medaljes “Nderi i Akademisë” dr. Agim Ballvorës.

Së fundi, pjesëmarrësit në këtë ceremoni shprehën konsideratën për veprimtarinë shkencore në nivel bashkëkohor të dr. Ballvorës, që e meriton të jetë mes mjedisit akademik shqiptar me një titull të tillë të lartë “Nderi i Akademisë”. Nuk ka dyshim se dhënia e këtij titulli do t’i shërbejë dr. Ballvorës për të qenë gjithmonë pranë studiuesve shqiptarë të kësaj fushe me bashkëpunime në projekte të përbashkëta, si dhe pranë studentëve për të përmirësuar kurrikulat në disiplina të tilla bashkëkohore me vlerë të gjithanshme. Për të materializuar këtë bashkëpunim, fillimisht dr. Ballvora pranoi ftesën nga SSHNT për të organizuar gjatë vitit 2018 një seminar në fushën e gjenetikës, biologjisë molekulare dhe bioteknologjisë bimore me studentë të profilit biologji në Universitetin e Tiranës, në Universitetin Bujqësor të Tiranës etj.

C. Forumi “Mobilizimi i shkencëtarëve në shërbim të zhvillimit: Njohuritë për të pajtuar evolucionin e lehtësirave infrastrukture portuale me zhvillimet e qëndrueshme në Mesdhe”, i mbledhur në Gjenova të Italisë i Grupit Ndër-akademik për zhvillim (*Permanides VIII*), më 21 deri 23 mars 2017.

Në një takim fillimit të konferencës *Presidenti i GID-EMAN (Grupi Ndër-akademik për Zhvillim - Rrjetit Ndër-akademik Mesdhetar)*, akademik prof. dr Pavao Rudan, zhvilloi takimin e Asamblesë së Përgjithshme të GID-EMAN, ku mori pjesë edhe Kryetari i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë akad. prof. dr. Muzafer Korkuti si dhe kryetari i SSHNT akad. Salvatore Bushati. Në takimin e zhvilluar u raportua në lidhje me zhvillimet e akademive në zbatim të objektivave të dala nga Konferenca e mëparshme (*Permanides VII*) në lidhje me propozimet e akademive për anëtarësim në GID-EMAN, si dhe me projekt - propozimet për tu paraqitur në këtë takim, ku akad. Salvatore Bushati paraqiti tre projekt-propozime dhe dy propozime për forume shkencore:

1. “Përcaktimi i statusit trofik në kohë reale i kufirit detar Adriatik dhe Jonian të Slloveni - Kroaci - Mali i Zi dhe Shqipëri”;
2. “Mbrojtja e bregdetit dhe infrastrukturës portuale nga erozioni”;
3. “Zhvillimi i turizmit kulturor malor në rajonin Malësi e Madhe”;
4. “Forum shkencor në lidhje me zbatimin e ndjekjes së rezultateve të projektit dypalësh IPA-I të kryera nga të dyja akademitë”
5. “Forum shkencor në lidhje me përdorimin e teknologjisë së imazheve satelitore (remote sensing) në fushat e shkencave të tokës.

Konferencën e përshëndetën: drejtori i portit antik të Gjenovës, Alberto Capato; kryetari i bashkisë Marko Doria; anëtar i Asamblesë Parlamentare të Mesdheut, François Commeeinhes; nënsekretari i përgjithshëm i Bashkimit për Mesdheun (UFM), Ihab Famhy; presidenti i GID dhe president honorifik i Akademisë së Teknologjive, François Guinot. Në konferencë u trajtuan problematika, të cilat ishin me interes për t’u trajtuar edhe në hapësirat portuale shqiptare, indikatorë të cilat i prezantoi edhe Akademia e Shqipërisë me qëllim të propozimeve për tu zhvilluar në bashkëpunim me akademitë e vendeve që lag Deti Adriatik: Slloveni, Mali i Zi dhe Itali.

D. Konferenca vjetore e shkencës “Java e Shkencës” 2017 në Prishtinë

Më 16 - 19 maj 2017 në Prishtinë u organizua konferenca vjetore “Java e Shkencës - 2017”, e organizuar nga Ministria e Arsimit e Shkencës dhe e Teknologjisë së Kosovës, ku morën pjesë me prezantimet e tyre edhe nga ASHSH.

Në seancën plenare u diskutuan përfitimet dhe mundësitë e reja të Kosovës nga anëtarësimi i saj në UNESCO, si dhe aplikimi i politikave Europiane për qasjen e hapur (OPEN ACCESS) dhe shkenca e hapur (OPEN SCIENCE).

Në referimin e tij akad. prof. dr. Floran Vila, *“Vlerësimi i disa karakteristikave standarde të atmosferës për qëllime referimi duke përdorur dhomën klimatike” Përgatitur në bashkëpunim me akad. asoc. Ilirjan Malollari, Dhurata Premti, Iska Spahiu, paraqiti rezultatet mbi përcaktimin e përmbajtjes standarde etalonuese të lagështisë së mjedisit për qëllime kalibrimi dhe karakterizimi referues duke përdorur dhomën klimatike të modelit DY110 - 62672. Gjatë këtij studimi janë realizuar matjet eksperimentale, gjithashtu për qëllime krahasuese edhe llogaritjet përkatëse në përputhje me karakteristikat e mëposhtme: kufijtë e matjeve të lagështisë: 10 për qind deri në 98 për qind; kufijtë e matjeve të temperaturës: -40°C deri në 180°C. Në këtë kumtesë theksohet rëndësia e kalibrimit të dhomës klimatike për të përcaktuar devijimin e karakteristikave klimatologjike të temperaturës së ajrit dhe lagështisë relative, në ato pjesë të vëllimit hapësinore, të cilat janë të parashikuara për përdorim ose në pika specifike. Përveç këtyre devijimeve, aspekte të tilla, si mungesa e homogjenitetit, qëndrueshmëria etj. janë shpesh të domosdoshme edhe për karakterizimin e mjedisit në dhomën klimatike dhe efektet e mundshme të materialit provë të vendosur në të.*

Rezultate nga njëra anë janë me interes të madh për përdoruesit e dhomës, pasi përshkruajnë vetitë e saj gjatë përdorimit dhe në anën tjetër janë të nevojshme edhe për përcaktimin e pasigurisë në matjet e rezultateve.

Po kështu akad. Efigjeni Kongjika, me bashkëautorët prof. dr. Agim Zajmi, prof. dr. Arben Myrta, akad. prof. dr. Latif Susuri (1941-2016), akad. prof. dr. Feriz Krasniqi, paraqiti referatin *Prodhimi dhe certifikimi i fidanëve të pemëve frutore, hardhisë, ullirit*

*dhe agrumeve në Shqipëri dhe Kosovë, duke paraqitur të dhënat e sotme, veçanërisht për gjendjen e kultivarëve autoktonë të pemëve frutore, hardhisë, ullirit, agrumeve në të dy trojet shqiptare. Rezultatet kapin një diapazon të gjerë problemesh, që çojnë deri në zgjidhjen e shqetësimeve në pemëtari, kur me hapjen e kufijve të tregut europian dhe me qarkullimin e lirë të produkteve bimore lind si domosdoshmëri, rregullimi në nivel komunitar dhe kombëtar përmes një programi shkencor dhe legjislativ të lidhur me prodhimin, certifikimin dhe tregtimin e materialit të shumimit të pemëve frutorë, që lëviz dhe tregtohet në të gjithë botën. Sëmundjet virusale janë identifikuar me anë të metodës ELISA dhe me transmetim me anë të shartimit me indikatorë drunorë; viroidet me metodën *tissue-printing hybridisation* (TPH) dhe fitoplazmat me PCR, ndjekur me RFLP. Testimet e pemëve *Prunus* spp. në Shqipëri zbulojnë se 42 për qind e 2632 pemëve të testuar janë të infektuar me të paktën një virus. Ndërsa në Kosovë ka rezultuar prania e virusit të rrezikshëm të sharkës (PPV) në të gjitha pemëtoret, duke përfshirë dhe disa fidanishte. Është konstatuar për herë të parë prania e viruseve të rinj në të dy vendet. Gjithashtu për herë të parë paraqiten të dhëna për shëndetësimin e materialeve mbjellëse të drurëve frutorë me përdorimin e metodave *in vitro* të meristemës për eliminimin e viruseve për speciet me rëndësi të gjinisë *Prunus*, *Malus* dhe *Pyrus* të rritura në Shqipëri dhe Kosovë. Rezultatet e paraqitura do të jenë një kontribut konkret në duart e specialistëve në Shqipëri dhe Kosovë për ngritjen e një sistemi të përbashkët të certifikimit në prodhimin e materialit bimor të kategorisë “bazë”; do të ndihmojnë në krijimin e bashkëpunimeve midis dy vendeve për sa i përket mbrojtjes së specieve bimore me rëndësi ekonomike nëpërmjet detektimit të hershëm të sëmundjeve virusale; do të përmirësojnë ekspertizën e kërkuesve të rinj në përdorimin e metodave serologjike e molekulare të detektimit të fitopatologjive kryesore virusale, në prodhimin e fidanëve të shëndetësuar dhe në njohjen dhe zbatimin e legjislacionit për certifikimin e materialit bimor fidanor të specieve frutore.*

E. Konferenca shkencore mbi mikroshumimin “VITROSOI” 2017 në Itali

Grupi “Mikroshumimi dhe teknologjitë *in vitro*” i Shoqatës së Horti-flori-frutikulturës Italiane organizoi në Pescia të Italisë konferencën kombëtare mbi mikroshumimin, nga 29 deri 31 maj 2017, ku tematikat kryesore të konferencës lidheshin me probleme të ndryshme të kulturave *in vitro*, që nga cilësia e mikroshumimit deri në prodhimin e metabolitëve sekondarë, nga vlerësimi deri në konservimin e biodiversitetit, nga teknologjitë inovative deri në embriogjenezën somatike dhe në teknikat e tjera të rigjenerimit, nga bioriparimi dhe rezistenca ndaj streseve deri në kulturat *in vitro* në mbështetje të përmirësimit gjenetik.



Pjesëmarrësit italianë dhe të huaj në Konferencën Kombëtare Italiane mbi Mikroshumimin

Konferenca ku morën pjesë kërkues shkencorë, prodhues, teknikë, studentë dhe tregtarë të sektorit të fidanishteve të horti-flori-frutikulturës dhe të bimëve mjekësore-aromatike pati si qëllim të forcojë komunikimin midis botës shkencore të kërkimit me atë tekniko-operativ të prodhimit dhe tregtimit të bimëve të mikroshumuara. Në konferencë ishin të pranishëm shumë relatorë të huaj të ardhur nga Portugalia, nga USA/Koreja, Spanja, Vendet e Ultë, nga Shqipëria, Brazili dhe Irani, të cilët paraqitën skenarë teknologjik të inovacionit shkencor ndërkombëtar.

Akad. Efigjeni Kongjika, specialiste në fushën e mikroshumimit në Shqipëri, paraqiti dy prezantime me bashkautorësi (prof. asoc. Valbona Sota dhe dr. Carmine Damiano): “*Collezioni in vitro di alcune specie autoctone di genere Prunus in Albania*” dhe “*Costituzione di collezioni in vitro di alcune importanti specie arboree “minori” da frutto.*”



Çaste nga prezantimet e punimeve të grupit shqiptar

Prania e punimeve të kërkuesve shqiptarë ishte një rast i mirë për të paraqitur jo vetëm përvojën në fushën e mikroshumimit, por edhe për të vënë në dukje bashkëpunimin e ngushtë me kërkues italianë, në veçanti me një shkencëtar të nivelit të lartë si dr. Carmine Damiano, që ne e konsiderojmë si themeluesin e fushës së re të kulturave *in vitro* në Shqipëri. Prezantimet e paraqitura janë fryt i bashkëpunimit të

grupit kërkimor të Laboratorit të Kulturave Indore dhe Qelizore të ish Institutit të Kërkimeve Biologjike, sot në Departamentin e Bioteknologjisë në Fakultetin e Shkencave Natyrore të Universitetin e Tiranës me grupin në Institutin Eksperimental të Frutikulturës në Romë, drejtuar nga dr. Carmine Damiano, pionier i kulturave *in vitro* edhe në Itali. Auditori vlerësoi si figurën e shquar të dr. Damianos edhe punën e kryer nga kërkuesit shqiptarë. Konferenca demonstroi rezultate interesante të fituara në fushën e kërkimit shkencor për mikroshumimin, si dhe përparimet e realizuara vitet e fundit në përdorimin praktik në kompanitë e mëdha të prodhimit të fidanëve me anë të metodave bioteknologjike të kulturës *in vitro*. Konferenca ishte dhe një rast i përshtatshëm për bashkëpunim të mëtejshëm jo vetëm me grupe shkencore, por edhe me kompani të mëdha shkencore dhe tregtare për ngritjen e infrastrukturave shkencore dhe prodhuese edhe në Shqipëri për prodhimin dhe certifikimin e fidanëve të drurëve frutorë.


F. Workshopi i 10-të i Agjencisë Hapësinore Europiane (Fringe 2017) “Përparimet në Shkencën dhe Aplikimet e Interferometrisë SAR and Sentinel-1 InSAR”

Agjencia Europiane e Hapësirës (European Space Agency, ESA) organizoi Fringe - 2017, Workshopin e 10-të Ndërkombëtar mbi “Përparimet në Shkencën dhe Aplikimet e SAR Interferometry dhe Sentinel-1 InSAR”, në mjediset e Universitetit Aalto në Helsinki, Finlandë, nga 5 deri më 9 qershor 2017.

Fringe-2017 ishte një seminar i hapur për kërkuesit kryesorë të ESA-s, bashkëpunëtorët, përdoruesit e Sentinel-1, shkencëtarët, studentët, përfaqësuesit e agjencive hapësinore kombëtare, europiane e ndërkombëtare dhe industrisë. Objektivat kryesore të workshopit qenë: (i) të organizojnë së bashku komunitetin e përdoruesve global InSAR; (ii) paraqetja e rezultateve më të fundit të InSAR të dhënave Sentinel-1 data and S-1A/B interferometry; (iii) përgatitja e një forumi për të prezantuar në ESA rezultatet e projekteve InSAR; (iv) vlerësimi i arritjeve të aplikimeve InSAR dhe *state of the art* në këtë fushë; (v) krijimi i lehtësive të komunikimit të shkëmbimit ndërkombëtar të dijeve në kërkimet InSAR Research, zhvillimet dhe aplikimet; (vi) prezantimi i statusit të misionit Sentinel-1 algoritmet dhe produktet; (vii) prurjet dhe vlerësimi i progresit të tyre në përpunime me rekomandimet e FRINGE - 2015 dhe (viii) propozimet e shkencëtarëve për përgatitjen ESA për fillimin e mbështetjes së aktiviteteve shkencore për Sentinel-1.

Akademia e Shkencave e Shqipërisë përfaqësohej në këtë workshop me punimin “Sar Interferometry for Identification of Environmental phenomena - Case of Albania” (Interferometria SAR për identifikimin e dukurive mjedisore - Raste në Shqipëri), autorë të së cilës janë akademikët Neki Frashëri, Gudar Beqiraj dhe Salvatore Bushati, ku u prezantuan rezultatet e studimit të kryera në Shqipëri mbi dukuri të rëndësishme mjedisore problematike të zonë bregdetare të realizuara me anë të përdorimit të teknologjive inovative *remote Sensing*. U aplikua metoda e interreferometrisë SAR, sipas të cilve u identifikuan zonalitete anomale (sipas *fringeve*) në pjesën veriore të ultësirës PreAdriatike; përqendrimet e *fringeve* në zonat malore udhëheqin hipotezën e faktorëve mjedisorë; përsëritja e interferogramave me dy imazhe ENVISAT dhanë rezultate të ngjashme - *fringe* në lartësitë e Torovicës dhe të Vaut të Dejës.

Po kështu, analizat kohore (me përdorimin e imazheve *Landsat Tempora*), duke kombinuar bandat pankromatike të vitit 2000: blu - jeshil; 2016: e kuqe tregojnë mungesë të vazhdueshme ose reduktim të mbulimit të vegjetacionit në zonat e lidhura



Posteri i prezantuar në Konferencën e Fringe 2017

U përdorën edhe analizat e detajuara interferometrike, duke përdorur imazhet SENTINEL-1, sipas të cilave u identifikuan mbulesa të territorit me *fringe*, sipas ndryshimeve të çifteve të imazheve, që supozohen të jenë krijuar nga variacionet vegetative me rreth 12 ditë në prill dhe tetor.

Qytetet e Tiranës, Durrësit dhe Shkodrës janë të dukshme, gjithashtu në *fringet* e vazhdueshme në kodrat e Torovicës, Vaut të Dejës dhe Puka në zonën malore, dhe në veçanti maja e Malit me Gropa në lindje të Tiranës. Pamjet satelitore nga hartat Google tregojnë mungesën e mbulimit të vegjetacionit: bar dhe shkurre të ulëta në zona të caktuara në fotot e mëposhtme; gjithashtu arrihet në përfundimin se ka dhe prani erozioni gradual të mbuluar me bar dhe shkurre të ulëta malore.

G. Takim shkencor për botimin më të fundit “Pemëtaria dhe vreshtaria në Shqipëri dhe në Kosovë” (Kultivarët e vendit dhe prodhimi i fidanëve të pemëve frutore, hardhisë, ullirit dhe agrumeve)

Në kuadër të panairit të librit organizuar në Prishtinë më 6-12 qershor 2017 u organizua takimi shkencor për përrurimin dhe diskutimin mbi botimin e ri shkencor *“Pemëtaria dhe vreshtaria në Shqipërisë dhe në Kosovë” (Kultivarët e vendit dhe prodhimi i fidanëve të pemëve frutorë, hardhisë, ullirit dhe agrumeve)*.

Botimi i ri shkencor *“Pemëtaria dhe vreshtaria në Shqipëri dhe Kosovë” (Kultivarët e vendit dhe prodhimi i fidanëve të pemëve frutorë, hardhisë, ullirit dhe agrumeve)* ka si autorë kryesorë dhe redaktorë shkencorë akad. Efigjeni Kongjika, akad. Latif Susuri, prof. Agim Zajmi, prof. Arben Myrta. Vepra e përbashkët e realizuar në kuadër të Protokollit të Bashkëpunimit Shkencor dhe Artistik midis Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës mbledhi kërkues shkencorë, specialistë, fidanrritës dhe studentë nga Shqipëria dhe Kosova më 22 nëntor 2017 në sallën “Aleks Buda” të Akademisë së Shkencave në Tiranë. Kjo ngjarje vjen pas përrurimit me sukses të librit në Prishtinë me rastin e Panairit të Librit në maj 2017.

Hartimi i botimit vjen pas një pune të gjatë për realizimin e projektit *“Inventarizimi i virozave dhe shëndetësimi i materialit mbjellës të specieve frutore dhe vreshtave në Kosovë dhe Shqipëri”*, përsëri në kuadër të Protokollit të Bashkëpunimit mes dy akademive me koordinatorë akad. Latif Susuri (ASHAK) dhe akad. Efigjeni Kongjika (ASHSH). Botimi i ri është fryt i punës së 27 autorëve nga Shqipëria dhe Kosova, specialistë të njohur në fusha të ndryshme të frutikulturës, të fitopatologjisë, biologjisë molekulare, bioteknologjisë, njohës të legjislacionit europian dhe shqiptar për certifikimin e fidanëve të drurëve frutorë. Takimi shkencor u organizua në formë debati për probleme të rëndësishme të pemëtarisë dhe vreshtarisë në të dy rajonet shqiptare si mundësi për përdorimin e specieve frutore autoktone duke u bazuar në një sistem certifikimi bashkëkohor në prodhimin e materialit fillestar. Në këtë takim u mbledhën një numër i madh specialistësh nga SSHNT të Akademisë, nga disa institucione shkencore dhe mësimore si të Universitetit Bujqësor të Tiranës, të Universitetit të Tiranës, ekspertë italianë dhe shqiptarë nga Instituti Agronomik Mesdhetar në Valenzano të Barit në Itali, nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe qendra e transferimit të teknologjive bujqësore në Vlorë, kompania e mirënjohur Certis Europe, gjithashtu në Kosovë nga SSHN të ASHAK-ut, Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural etj. Nderonte me pjesëmarrjen e tij akad. Isuf Krasniqi, sekretar shkencor i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, si përfaqësues i kësaj akademie në këtë veprimtari të përbashkët.

Fjalën e hapjes e mbajti sekretarja shkencore e SSHNT akad. Efigjeni Kongjika, si përfaqësuese e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe si autore kryesore e botimit të ri. Ajo vuri në dukje bashkëpunimin e ngushtë dhe frytëdhënës midis të dy akademive në realizimin e disa botimeve dhe projekteve të përbashkëta. Auditori nderoi kujtimin e dy autorëve të rëndësishëm, që gjatë periudhës së gjatë të përgatitjes së këtij botimi, u ndanë nga jeta, në kohën që po kontribuonin në mënyrë aktive në përgatitjen e tij, akad. Latif Susurin, bashkautor i disa kapitujve në mbrojtjen e bimëve dhe njëkohësisht botues shkencor i librit, dhe prof. Bashkim Koronica, bashkautor për pjesën e vreshtarisë, verëtarisë dhe fidanishteve.

Në emër të Kryesisë së ASHSH akad. E. Kongjika uroi që puna e përbashkët e kolegëve nga Shqipëria dhe Kosova të shërbejë me anë të këtij botimi si mbështetje

shkencore për studiuesit dhe specialistët e prodhimit të pemëve, vreshtit, atyre të fidanishteve dhe sidomos për forcimin e lidhjeve midis institucioneve kërkimore dhe mësimore, por edhe për një bashkëpunim më aktiv në fushën e prodhimit të fidanëve të drufrutorëve midis Shqipërisë dhe Kosovës.

Në emër të ASHAK-ut përshëndeti veprimtarinë akad. Feriz Krasniqi, një ndër autorët e botimit të ri, por edhe bashkëpunëtor i përhershëm dhe koordinator në të gjitha projektet e përbashkëta të të dy akademive, që nga viti 2001, kur filloi zbatimi i Protokollit të Bashkëpunimit Shkencor dhe Artistik midis të dy akademive. Ai vuri në dukje rëndësinë e produkteve shkencore të këtij bashkëpunimi, tre fjalorët në fushën e botanikës, si dhe botimin e fundit, vepra, që janë në vitrinat e të dy akademive dhe në duart e lexuesve të specializuar dhe amatorë në Shqipëri dhe në Kosovë. ASHAK vlerëson punën e të gjithë autorëve të botimit të ri për informacionin bashkëkohor, që lexuesi mund të gjejë jo vetëm për praninë e specieve autoktone frutore dhe të hardhisë, por edhe për rëndësinë e tyre në ekonominë shqiptare, traditën, aktualitetin dhe perspektivën e prodhimit të fidanëve. Akad. Feriz Krasniqi uroi që edhe në të ardhmen lexuesi të ketë në duar botime të tilla të vlefshme në të gjithë hapësirën shqiptare.



Prezantimi i botimit shkencor “Pemëtaria dhe vreshtaria në Shqipëri dhe në Kosovë” në mjediset e Panairit të Librit në Prishtinë

Akad. E. Kongjika paraqiti një informacion të detajuar për auditorin rreth përmbajtjes së botimit duke u përqendruar në qëllimin kryesor të tij, në prodhimin e fidanëve të specieve frutore të vendit me vlerë për shumë veçori, si përshtatja dhe aklimatizimi në rajone të caktuara, prodhimtari të lartë dhe prodhim me vlera të larta ushqimore dhe teknologjike, për konsum të freskët apo përpunim industrial, rezistencë relative natyrore ndaj disa sëmundjeve dhe dëmtuesve, për forma me afate pjekjeje të shtrirë në kohë, që sigurojnë vargëzimin e prodhimit etj. Por vlera e botimit lidhet edhe me arritjen e synimit kryesor të ngritjes së një sistemi të përbashkët të certifikimit në prodhimin e materialit bimor të kategorisë “bazë”. Sistemi i përket mbrojtjes së specieve bimore me rëndësi ekonomike nëpërmjet detektimit të hershëm të sëmundjeve virusale me anë të përdorimit të metodave serologjike e molekulare; shëndetësimin të bimëve të infektuara, që nuk luftohen me asnjë metodë tjetër, përveç kulturës *in vitro* të meristemës, kombinuar me termoterapinë në prodhimin e fidanëve, dhe njohjes dhe zbatimit të legjislacionit për certifikimin e materialit bimor fidanor të

specieve frutore. Shtrohet detyrë imediate e strukturave shkencore grumbullimi, koleksionimi, ruajtja, studimi dhe shfrytëzimi i gjermoplazmës së pemëve vendëse, si pjesë e kulturës bujqësore tradicionale kombëtare, por edhe e zhvillimit perspektiv mbi bazën e kërkesës së konsumatorëve, industrisë përpunuese, por edhe të eksportit. Në botim propozohet hartimi i një programi kombëtar me orientime strategjike të politikave për ruajtjen e burimeve gjenetike si në Shqipëri ashtu edhe në Kosovë, që mund të realizohet nga institucionet shtetërore, prodhuesit privatë të fidanëve si dhe pëmishtet prodhuese. U theksua edhe një herë nevoja emergjente për ndërtimin e një sistemi certifikimi të besueshëm me institucione, detyra dhe përgjegjësi të përcaktuara për prodhimin e materialit shumues të sigurt gjenetikisht dhe të pastër ndaj problemeve fitosanitare. U shtrua si detyrë edhe bashkëpunimi shkencor i ekspertëve të pemëtarisë dhe vreshtarisë me ata fitopatologë, së pari për të hartuar skemat e seleksionimit klonal dhe sanitar, dhe për të bashkëpunuar aktivisht përgjatë gjithë procesit. Akad. E. Kongjika thekson se suksesi i certifikimit kërkon pjesëmarrjen e shtetit në mbështetje të institucioneve përgjegjëse me mjete financiare, përmirësimin e kuadrit ligjor të nevojshëm duke e përfruar me direktivat e BE-së, si dhe zbatimin rigoroz të këtij kuadri ligjor.

Në fjalën e saj prof. dr. Edlira Kukali si recensente e botimit vuri në dukje vlerat e botimit dhe veçanërisht ndihmën që do të japë botimi për autoritetet shkencore dhe zyrtare në Shqipëri dhe në Kosovë në vlerësimin e gjendjes shëndetësore të specieve frutore, hardhive, ullirit dhe agrumeve;



Çaste nga zhvillimi i takimit shkencor për botimin më të fundit “Pemëtaria dhe vreshtaria në Shqipëri dhe në Kosovë” (Kultivarët e vendit dhe prodhimi i fidanëve të pemëve frutore, hardhisë, ullirit dhe agrumeve)

Një ndër autorët e rëndësishëm të librit, prof. dr. Lush Susaj ngriti disa probleme akute të mbështetjes së zhvillimit të kërkimit shkencor nga shteti për subvencionimin e institucioneve akademike e shkencore në funksion të punës kërkimore për të siguruar sinergjinë midis zhvillimit shkencor dhe programeve të zhvillimit kombëtar. Gjithashtu kërkohet vëmendje për arsimimin e të rinjve në shkencat natyrore, bujqësore etj. përmes aplikimit të burimeve dhe incentivave të nevojshme. Autori thekson domosdoshmërinë e ekspertizës shkencore nga departamentet e Universitetit Bujqësor të Tiranës me staf të kualifikuar në shumë degë të bujqësisë.

Auditori vlerësoi dhe përshëndeti punën e grupit të autorëve nga Shqipëria dhe nga Kosova për këtë botim të ri, që mund të konsiderohet si vazhdim i monografisë “Sëmudnjat e pemëve frutore dhe të hardhisë” me autorë akad. Latif Susuri dhe prof. dr.

Arben Myrta, botim i vitit 2012. Por ndërsa në këtë monografi konstatohet prania e sëmundjeve të pemëve frutore në Shqipëri dhe Kosovë, vepra e re kap një diapazon më të gjerë çështjesh, që do çojnë deri në zgjidhjen e problemeve shqetësuese të pemëtarisë, veçanërisht në dekadat e fundit, kur me rritjen e shkëmbimeve tregtare në Europë dhe sidomos të tregtimit të fidanëve, lindi edhe domosdoshmëria e rregullimit në nivel komunitar dhe kombëtar përmes një programi shkencor dhe legjislativ të prodhimit, certifikimit dhe tregtimit të materialit të shumimit të pemëve frutore.

H. Simpoziium shkencor: “Prof. Arqile Bërxfholi, një jetë në kërkimin shkencor e pedagogjik në fushat multidisiplinore të gjeografisë”

Simpoziiumi shkencor për të përkujtuar figurën e shquar të prof. Arqile Bërxfholi u organizua më 29 Qershor 2017 në sallën “Aleks Buda” të Akademisë së Shkencave. Akad. prof. dr. Salvatore Bushati, kryetar i SSHNT hapi simpoziiumin për nder të prof. Arqile Bërxfholi, i cili u nda nga jeta para pak kohësh, pas një sëmundje të rëndë. Ai do të kujtohet si një ndër përfaqësuesit e denjë të plejadës së gjeografëve, që hodhën bazat e arsimit dhe të shkencës gjeografike, për të cilat brezat do t’u jenë përjetë mirënjohës.

Në simpoziium, akad. Gudar Beqiraj paraqiti një jetëshkrim të shkurtër të prof. Bërxfholit. duke theksuar kontributin e tij shumë të rëndësishëm, në mësimdhënie, por mbi të gjitha në studimet shkencore, të konkretizuara në referime dhe botime të shumta në fushën e gjeografisë, demografisë etj. Kontribut i veçantë i prof. Bërxfholit është veprimtaria shkencore, të cilën ai e zhvilloi në Akademinë e Shkencave në periudhën 1991-2008, në institucionin e Qendrës së Studimeve Gjeografike. Pas disertacionit të suksesshëm mbi probleme të popullsisë së Shqipërisë së Jugut, veprimtaria shkencore e tij do të pasurohej me monografi, harta e atlase, si dhe shumë botime të tjera divulgative për një publik më të gjerë. Midis tyre, veçohen botime me rëndësi kombëtare, si: *Popullsia e Shqipërisë* (bashkautor); *Demografia e Shqipërisë*; *Atlasi i Popullsisë së Shqipërisë* etj, duke dhënë së bashku me kolegë, studime e vepra me rëndësi kombëtare e me prurje shkencore të nivelit të lartë shkencor. Monografitë, artikujt, referatet dhe librat e tij të shumta shkencore mbi problemet gjeografike të Shqipërisë dallohen për mendime origjinale, për mënyrën e shtrimit dhe të trajtimit të koncepteve dhe të ideve të reja gjeografike, për rrugët e propozuara prej tij për zgjidhjen e shqetësimeve të ndryshme sociale, ekonomike e mjedisore, që kanë lindur vazhdimisht në vendin tonë. Këto studime do të mbeten model për kërkime shkencore në fushën e gjeografisë, kësaj trashëgimie shkencore që i shtohet edhe botimi i tij më i fundit: “Trevë e Gjirokastrës - Enciklopedi”, me të cilin bëri mbylljen më të bukur, që ai mund t’i bënte punës së tij shumëvjeçare, Lunxhërisë, krahinës së tij të lindjes e Gjirokastrës që e deshi aq shumë.

Në referimin “Kontributi i prof. dr. Arqile Bërxfholit në fushat shkencore multidisiplinore të gjeografisë” të përgatitur nga profesorët Perikli Qirjazi, Vasil Kristo dhe Skënder Sala referuan mbi kontributet e veçanta që profesor Bërxfholi pati në drejtimin shkencor e menaxhimin e Qendrës së Studimeve Gjeografike, duke e ngritur atë në një nivel infrastrukturor me teknologjitë e përparuara të kohës e një staf të kualifikuar, duke i u përgjigjur nevojave të kërkimit e zhvillimit të vendit, me një kontribut të çmuar, vendosjen e emërtimeve të sakta shkencore në hartat fizike të vendit, në konceptimin e përgatitjen e hartave administrative, në studimet e gjeografisë fizike, studimet demografike, ato gjeomjedisore, multidisiplinore etj. Në përputhje me objektivat e Akademisë, Qendra e Studimeve Gjeografike njohu rritje teknologjike profesionale, e cila u realizua nga stafi i saj dhe i drejtimit shkencor të prof. Bërxfholit, i cili kontribuoi fort në

përgatitjen e kualifikimin e të rinjve gjeografë, për të cilët ai nuk ka qenë vetëm një drejtues i talentuar shkencor, por edhe një koleg i afërt, duke u dhënë atyre gjithçka nga shpirti i tij i gjerë. Ai realizoi lidhjet dhe zhvilloi me kolegë bashkëpunime me institucione prestigjioze shkencore e universitare jashtë vendit në fushën e shkencave gjeografike etj.



Momente nga simpoziumi shkencor: “Prof. Arqile Bërxfholi, një jetë në kërkimin shkencor e pedagogjik në fushat multidisiplinore të gjeografisë”

Prof. Roland Gjini nga Universitetin e Elbasanit mbajti kumtesën “Prof. Bërxfholi dhe veprimtaria e tij në formimin universitar e pasuniversitar të shkollës shqiptare dhe transferimin e dijeve shkencore”. Me njohuritë e thella nga shkenca e gjeografisë, prof. Bërxfholi zhvilloi leksione dhe seminare në disa lëndë gjeografike, të cilat gjithmonë u ndoqën me interes të veçantë nga studentët për nivelin shkencor, për informacionin e pasur, për argumentet bindëse të ideve dhe tezave gjeografike.

Eksperiencat e tij në fushën e gjeografisë ishin një kontribut i tij në përgatitjen e teksteve të gjeografisë për arsimin parauniversitar dhe universitar, të cilat dallohen për informacionin gjeografik shumë të pasur, për thellësinë e argumentimit të tyre shkencore, për analizën e detajuar dhe bindëse të koncepteve gjeografike, për nivelin e mirë metodik. Këto tekste përbëjnë një bazë, jo vetëm për arsimin gjeografik, por edhe për shkencën e re të gjeografisë ekonomike shqiptare.

Lidhjet dhe bashkëpunimet me institucione prestigjioze shkencore e universitare jashtë vendit në fushën e shkencave gjeografike etj. i paraqiti kolegu i prof. Bërxfholit, prof. dr. Dhimitër Doka nga Universiteti i Tiranës në kumtesën “Prof. Bërxfholi dhe roli i tij në bashkëpunimin shkencor dhe pedagogjik me gjeografë të huaj”. Prof. dr. Bilal Draçi, Universiteti i Tiranës vuri në dukje “Vlerat dhe prurjet shkencore në botimin enciklopedik të fundit të prof. Bërxfholit: *“Treva e Gjirokastrës. Mjediti, popullsia, vendbanimet, ekonomia”*, Tiranë 2016.

Drejtuesi i shtëpisë botuese UEGEN, Z. Xhevahir Lleshi, paraqiti konsideratat e tij për lidhjen me prof. Bërxfholin në kumtesën “Mbresa të një bashkëpunimi me studiuesin pasionant e të urtë, Arqile Bërxfholi”.

Në fund të simpoziумit, në emër të shoqatës “Lunxhëria” përshëndeti një përfaqësues i saj, z. Kleanthi Dede.

I. Leksion i hapur *The innovative technology on the environment quality using the moss survey*

Akademia e Shkencave, SSHNT në bashkëpunim me Fakultetin e Shkencave Natyrore të Universitetit të Tiranës organizoi në kuadër të programit “Edukimi në Shkencë” më 4 korrik 2017 në mjediset e Akademisë së Shkencave leksionin e hapur “The innovative technology on the environment quality using the moss survey”. Leksioni u mbajt nga i ftuari i nderit i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, Emeritus prof. dr. Eiliv Steinnes, anëtar i Akademisë së Shkencave Teknike të Norvegjisë, i cili është një ndër themeluesit e teknikës së monitorimit të ajrit me anë të myshqeve, si bioindikator, dhe që prej vitit 2015 bashkëpunon me grupin e kërkuesve shqiptarë nga Universiteti i Tiranës dhe ai i Vlorës në monitorimin e cilësisë së ajrit me anë të kësaj metode. Gjithashtu, në vazhdim, nga grupi i bashkëpunëtorëve të tij në Shqipëri, prof. Pranvera Lazo, nga departamenti i kimisë në FSHN, referoi mbi rezultatet e këtij projekti në Shqipëri. Qëllimi i kësaj veprimtarie ishte njohja e pjesëmarrësve të interesuar me teknikën e monitorimit të ndotësve të ajrit me anë të myshqeve si bioindikatorë, si dhe me rezultatet e deritanishme të grupit të studiuesve shqiptarë. Pikërisht nivelet e larta të disa prej metaleve të rënda në mostrat e myshqeve të vendit tonë u bënë bazë e punës së vizitës së prof. Eiliv Steinnes në Shqipëri, i cili gjatë vizitës së tij 5-ditore në Shqipëri u njoh me laboratorët e departamentit të kimisë, ku kryhen një pjesë e analizave të mostrave të myshqeve, si dhe me disa pika monitorimi në jug të vendit.



Prezantimi i referimit kryesor nga prof. emeritus Eiliv Steinnes dhe nga bashkëpunëtorja e tij, prof. dr. Pranvera Lazo

Prof. Steinnes referoi për punën e kryer në kuadër të Programit Ndërkombëtar të Bashkëpunimit mbi efektet e ndotjes atmosferike të bimëve natyrore dhe drithërat (The International Cooperative Programme on Effects of Air Pollution on Natural Vegetation and Crops, ICP Vegetation), që i ka fillimet në vitet 1980. Programi “ICP Vegetation” u krijua më 1987 si një program ndërkombëtar kërkimi shkencor, i cili vëzhgon ndikimin e ndotësve të ajrit në vegetacion. Aktualisht në këtë program janë të përfshira rreth 35 vende dhe mbi 200 shkencëtarë nga Europa, Azia, Amerika Qendrore, Kanadaja dhe Afrika e Jugut. Që prej vitit 2014 e në vijim Programi drejtohet nga prof. asoc. dr. Marina Frontasyeva, (Joint Institute of Nuclear Physics - JINR, Dubna, Rusi). Programi ka si objektiv studimin e efektit të ndotësve të ndryshëm të ajrit në mjedis (vegetacioni bimor, pyjet, ujërat), si dhe ndikimet në shëndet. Studimi i monitorimit të efektit të metaleve të rënda me anë të myshqeve si bioindikatorë zhvillohet çdo pesë vjet.

Gjithashtu në vitin 2010 me anë të një projekti-pilot filloi dhe studimi i ndikimit të disa ndotësve organikë të qëndrueshëm (POPs) me anë të myshqeve. Kjo metodë bën të mundur studimin e shpërndarjes në hapësirë dhe në kohë të ndotësve atmosferikë. Me anë të të dhënave të secilit parametër të raportuar nga çdo vend pjesëmarrës, ndërtohet për secilin parametër harta e shpërndarjes së tyre në Europë, përcaktohen zonat më problematike, dhe me anë të përpunimit statistikor të rezultateve realizohet vlerësimi mjedisor i ndotjes, si dhe origjina e emetimit të tyre në ajër.

Aplikimi i kësaj metode në Shqipëri ka filluar në vitin 2010, kur me iniciativën e prof. Pranvera Lazos u krijua grupi shqiptar i monitorimit të ajrit me anë të myshqeve si bioindikatore pranë Universitetit të Tiranës, Fakulteti i Shkencave të Natyrës, departamenti i kimisë. Ky grup i ri iu bashkëngjiti programit “ICP Vegetation” për studimin e metaleve të rënda si ndotës të ajrit. Në këtë kuadër janë ndërmarrë disa studime doktrature pranë Universitetit të Tiranës, të udhëhequra prej prof. dr. Pranvera Lazo. Falë kontakteve dhe bashkëpunimit me Universitetin e Shkupit, Maqedoni dhe Institutin e Fizikës Bërthamore, Dubna, Rusi, është bërë e mundur të analizohen 64 mostra të marra nga i gjithë territori i Shqipërisë dhe të grumbullohen të dhëna mjaft të plota mbi praninë e 46 elementeve gjurmë në myshqe. Grupi shqiptar në bashkëpunim me biologun dr. Jani Marka, specialist në fushën e briofiteve, ku bëjnë pjesë dhe myshqet, ka bërë të mundur kampionimin e mostrave të myshqeve në të gjithë territorin e Shqipërisë. Me studimin e kryer është arritur që grupi i studiuesve shqiptarë t'i bashkohet me dinjtet grupit të madh të studiuesve Europeanë apo “Familjes së Myshqeve”. Aktualisht, si drejtues të grupit të studiuesve shqiptarë janë prof. dr. Pranvera Lazo dhe prof. asoc. dr. Flora Qarri, Universiteti i Vlorës, Fakulteti i Shkencave Teknike, departamenti i kimisë.



Çaste nga zhvillimi i leksionit të hapur “The innovative technology on the environment quality using the moss survey”.

Nga rezultatet e deritanishme nëpërmjet studimit në shkallë europiane të ndotësve të metaleve gjurmë në ajër, është demonstruar se vlerat e medianes së përqendrimit të metaleve të rënda në myshqe për periudhën 1990-2010 janë zvogëluar në masën 21 për qind deri 77 për qind për elemente Pb, V, Cd, Cr, Zn, Ni, Fe dhe As. Për periudhën e monitorimeve 2005 dhe 2010, ulja e nivelit të Cu dhe Pb është përkatësisht 6 për qind dhe 36 për qind, ndërkohë që në Europën Juglindore dhe vendet e Ballkanit Perëndimor vërehen nivele të larta në trajtën e “hot-spotëve”. Nivelet e metaleve të rënda pësojnë një rritje të ndjeshme duke kaluar nga Europa Veriperëndimore në atë Juglindore. Nivele mjaft të larta të Al, Fe, V; Ni dhe Cr janë evidentuar në Rumani, Maqedoni, Shqipëri,

Ukrainë dhe Bullgari. Për sa i përket nivelit të merkurit, Hg, nivele mjaft të larta janë gjetur në Shqipëri dhe Maqedoni, dhe më pas në Itali (rajoni i Bolzanos), Poloni dhe Francë. Në veçanti, për Shqipërinë, nivele të larta të metaleve të rënda hasen në myshqet në pjesën lindore të vendit, që është nën ndikimin e emetimeve të këtyre metaleve nga *metalurgjia, industria minerare dhe vendburimet metalifere të kësaj hapësire. Përmbajtja e metaleve të rënda te myshqet ulet dukshëm duke shkuar drejt perëndimit duke arritur vlerat më të ulëta në pjesën jugperëndimore të Shqipërisë. Ky gradient zbritës nga lindja në perëndim konsiderohet në përputhje me vendburimet gjeokimike në Shqipëri.*



Çaste nga emisioni LindOn në televizionin ChannelOne, ku u promovua leksioni i hapur “The innovative technology on the environment quality using the moss survey”.

Pjesëmarrja e gjerë në auditor e specialistëve të interesuar të fushës, pedagogë dhe studentë pasuniversitarë të nivelit “master” dhe “doktoraturë” nga Fakulteti i Shkencave Natyrore (departamenti i kimisë dhe biologjisë), nga Universiteti i Vlorës, Universiteti Politeknik i Tiranës (Fakulteti i Gjeologjisë dhe Fakulteti i Mjedisit), nga Universiteti Bujqësor i Tiranës dhe Universiteti Mesdhetar e gjallëroi këtë veprimtari me pyetje dhe debate interesante shkencore.

J. Forum i hapur shkencor *Universi në epokën e valëve gravitacionale*

Akademia e Shkencave e Shqipërisë në mbështetje të grupit THESEUS-Shqipëri, organizoi në kuadër të Programit “Edukimi në Shkencë” forumin e hapur shkencor “Universi në epokën e valëve gravitacionale”. Veprimtaria u organizua më 29 shtator 2017, vetëm një ditë pasi ekipet e eksperimenteve shkencore VIRGO dhe LIGO njoftuan kapjen e një vale të re gravitacionale. Vala gravitacionale është kapur prej tyre me 14 gusht 2017. Ajo është krijuar nga përplasja gjigande e dy vrimave të zeza hapësinore rreth një miliard vjet më parë. Valët gravitacionale janë parashikuar nga Albert Einstein 100 vjet më parë. Detektimi i tyre në shekullin 21 përbën një hap madhështor për progresin e shkencës dhe të njerëzimit.

Prof. dr. Halil Sykja, në referimin e tij foli mbi këtë ngjarje duke dhënë në mënyrë shumë të kuptueshme esencën e teorisë së përgjithshme të relativitetit, krahasimin ndërmjet valëve gravitacionale dhe atyre elektromagnetike, si dhe informacione të përgjithshme mbi bazën teorike të regjistrimit të valës.

Prof. dr. Mimoza Hafizi, anëtare e Grupit THESEUS-Shqipërinë referoi mbi valët gravitacionale, burimet dhe kapjen e tyre, për lidhjen me valët elektromagnetike dhe perspektivat e kësaj fushe shkencore duke dhënë në mënyrë të detajuar bazën teorike mbi të cilën mbështetet vrozimi dhe regjistrimi i këtyre valëve. Ajo foli mbi detektorët e deritanishëm dhe veçanërisht për VIRGO-n që ndodhet në Piza të Italisë, por dhe mbi të ardhmen e detektorëve, projektet e të cilëve janë në studim e sipër si detektor i hapësinor LISA, apo ai nëntokësor EINSTEIN. Gjithashtu në referimin e saj prof. dr.M. Hafizi foli dhe mbi të dhëna specifike të katër valëve gravitacionale të kapura deritashmë.

Dr. Sonila Boçi, anëtare e grupit THESEUS-Shqipëri, paraqiti para auditorit projektin THESEUS, një projekt mision i propozuar në ESA (European Space Agency) në kuadër të programit Cosmic Vision. që synon të zbulojë Universin e fazave shumë të hershme. Objektivat e këtij projekti janë: 1) Eksplorimi i kushteve fizike në Universin e hershëm nëpërmjet dedektimit të shpërthimeve gama (Gamma-Ray Burst (GRB)) me origjinë në një miliard vitet e para të jetës së Universit. 2) Monitorimi i Universit në diapazonin e rrezatimit X, duke mbështetur vrozimin e dedektorëve të valëve gravitacionale dhe neutrinove, për të lokalizuar dhe identifikuar nëpërmjet rrezatimit elektromagnetik burimet e valëve gravitacionale dhe neutrinove, të cilat do të dedektohen nëpërmjet LIGO/VIRGO, ET (Einstein Telescope, rreth 2030).



Pamje e observatorit VIRGO në Piza të Italisë.

K. Konferenca shkencore ndërkombëtare *Globalism vs Nationalism*

ASHSH i ka kushtuar një vëmendje të veçantë problematikave që lidhen me burimet njerëzore të kërkimit shkencor, edukimit në shkencë duke vlerësuar atë si një process që duhet filluar nga moshat parashkollore, e për të cilën janë investuar shumë pak në politikat e zhvilluara të edukimit. Nëse duam të punojmë për të patur kërkues në shkencë, duhet të investojmë për to, të nxitim kreativitetin, të identifikojmë talente dhe ti ndjekim ato që nga fëmijëria e herëshme.

Në konferencën shkencore ndërkombëtare *Globalism vs Nationalism* të organizuar nga *World Academy of Art and Science, European Academy of Sciences and Arts* dhe *The Global Round Table*, në Akademinë e Shkencave dhe Arteve të Malit të Zi (MASA), Podgoricë (2-3 November 2017), Akademia e Shkencave e Shqipërisë u prezantua me studimin me titull: “*Tracing the Global Child: Global politics shaping local childhoods*”, me autorë Angela S. Bushati (Freie Universität, Berlin) dhe Salvatore L. Bushati (Akademia e Shkencave e Shqipërisë).

Koncepti i fëmijërisë, dhe veçanërisht duke marrë parasysh ndërtimin social dhe kulturor të fëmijërisë, nuk ka marrë mjaft fokus në debatet e vazhdueshme mbi globalizimin dhe pasojat e saj. Megjithatë, elementët thelbësorë të globalizimit janë të gjithëpranishëm në maskën e diskurseve të reja rreth fëmijërisë, të cilat janë bërë në mënyrë transnacionalisht veçanërisht rezonante. Shumë traktate ose konventa ndërkombëtare, siç është Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve (1989), formojnë realitetin kombëtar dhe vendor të fëmijëve në mbarë botën, bazuar në konceptualizimet globale të fëmijërisë, të cilat bazohen kryesisht në idealet perëndimore të asaj që nënkupton të jesh fëmijë. Zbatimi i nocioneve të tilla globale të fëmijërisë në kontekste të ndryshme në mbarë botën shpesh nuk i konsideron realitetet lokale dhe ideologjitë kulturore të fëmijërisë dhe në mënyrë indirekte bën më shumë dëm sesa dobi. Fëmijëria përbën një lidhje thelbësore dhe shumë delikate në realitetet në ndryshim të vazhdueshëm; që nga fëmijëria e herëshme ajo zë një hapësirë simbolike ku pasqyrat e globalizimit mund të reflektohen, e cila nuk mund të lihet pa u konsideruar. Jo vetëm që fëmijëria e kupton bazën e lidhjes kulturore, por është mekanizmi kryesor i rekreacionit social. Duke u bazuar në studimet postcoloniale dhe kritike, prezantimi përpiqet të analizojë disa aspekte që lidhen me perëndimizimin dhe ndërtimin e idealit të fëmijës global dhe paraqet një pasqyrë të ndikimeve të fëmijëve në politikat globale ndaj formimit të fëmijërisë vendore.

L. Promovimi i botimit *Atlasi i Florës i Shqipërisë* me autor akad. Jani Vangjeli

Pas daljes në dritë të vëllimit të parë të veprës “*Atlasi i florës së Shqipërisë*” me autor akad. Jani Vangjelin, botuar në gjuhën shqipe nga Akademia e Shkencave e Shqipërisë dhe në gjuhën angleze nga shtëpia botuese “*Koeltz Botanical Books*” në Gjermani, SSHNT organizoi më 6 nëntor promovimin e tij në një auditor të mbushur me kërkues shkencorë, pedagogë, specialistë në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit etj.

Në fjalën e tij të hapjes, akad. Gudar Beqiraj, vlerësoi aktivitetin dhe më pas i dha fjalën akad. Efigjeni Kongjika, sekretare shkencore e SSHNT-së, e cila theksoi rolin e madh të Akademisë së Shkencave në botimin e veprave themelore në fushën e florës, duke përmbushur një nga misionet e saj kryesore për kalimin të lexuesit të specializuar të veprave me vlera të veçanta shkencore, si ky botim, të cilit i erdhi koha për t'u ardhur në ndihmë specialistëve dhe entuziastëve të florës. Merita e autorit akademik Jani Vangjeli, konsiston në punën pasionante për grumbullimin, përfshirjen dhe përpunimin e një informacioni të madh shumëvjeçar të vetë autorit dhe botanistëve të tjerë shqiptarë dhe të huaj.

Recensentët e veprës, profesorët e mirënjohur Liri Dinga dhe Arsen Proko vlerësuan karakterin akademik të veprës, krahasuar dhe me botimin themelor të “*Florës së Shqipërisë*”, që vjen si rezultat i punës voluminoze shumëvjeçare, përvojës profesionale dhe këmbënguljes së autorit për ndërmarrjen e nismave të tilla të mëdha në studime të thelluara. Ata vlerësuan domosdoshmërinë e veprës në kohën kur ka lëvizje të shtuar ndjeshëm të studiuesve dhe amatorëve si shqiptarë dhe të huaj, të interesuar për florën tonë. Nga fjala e akad. Salvatore Bushati, kryetar i SSHNT, u vu në dukje rëndësia e kësaj

vepre me vlerë që i shtohet trashëgimisë shkencore në fushën e studimeve të botanikës. Botimi është një studim i realizuar në vazhdimësi prej vitesh dhe pjesë e serisë së veprave të këtij lloji, që hap rrugën për hulumtime të tjera në këtë fushë. Ai vjen në vazhdimësi, pak kohë pas promovimit të studimit monografik mbi hortikulturën shqiptare. Shtëpia e madhe botuese “Koeltz Botanical Books” në Gjermani, që e ka vlerësuar këtë vepër dhe e ka botuar në gjuhën angleze para pak kohësh, i ka dërguar falënderimet e saj redaksisë së revistës *Journal of Natural and Technical Sciences*. Nga ana tjetër, në fjalën e akad. Bushatit u theksua se botime të tilla kanë jo vetëm prurje për shkencat natyrore e teknike, por kanë dhe ndikim në studimet e shkencave gjuhësore, antropologjike e më gjerë.

Prof. dr. Aleko Miho nga Fakulteti i Shkencave të Natyrës të Universitetit të Tiranës dhe prof. dr. Peçi Naqellari nga Universiteti “Aleksandër Xhuvani” i Elbasanit përshëndetën takimin në emër të grupeve të pedagogëve dhe kërkuesve të biologjisë, vlerësuan botimin e ri dhe uruan autorin për vepra të tjera të këtij niveli. Akademik asoc. prof. dr. Gjovalin Shkurtaç vlerësoi botimin e ri për saktësinë në përdorimin e drejtshkrimit të shqipes dhe rëndësinë e veprës në studimet leksikografike.

Në paraqitjen e veprës, akad. Jani Vangjeli parashtroi historinë e botimeve themelore në fushën e florës dhe rolin e madh të akademikut Kolë Paparisto për suksesin e këtyre botimeve në rrethin e studiuesve dhe kërkuesve, jo vetëm shqiptarë, por edhe të huaj, të interesuar për florën shqiptare. Autori e vlerëson botimin për rreth 1700 specie bimësh spontane dhe të kultivuara në Shqipëri si domosdoshmëri për studimet e thelluara në florën tonë me kontribute në studime të tjera në fushën e pyjeve, kullotave, bimëve aromatike e mjekësore, farmaceutikës etj. Vetë autori theksoi se në këtë vepër është shpalosur edhe kontributi i studiuesve të tjerë, prandaj me këtë rast për njohjen e auditorit me rrugën 67-vjeçare të botimeve themelore në fushën e florës dhe të vegjetacionit iu bë një homazh gjithë plejadës së njohur të kërkuesve botanistë, autorë të veprave madhore, si: prof. Ilia Mitrushit me veprat “Drurët dhe shkurret e Shqipërisë” (1955); “Dendroflora e Shqipërisë” (1966); prof. Paparistos dhe bashkautorëve të botimit “Flora e Tiranës” (1961), vepër e mirëfilltë shkencore, origjinale, shumë serioze e me vlera praktike, që u nderua me Çmimin e Republikës; veprave “Flora ekskursioniste e Shqipërisë (1983); “Flora e Korçës” (1985). Në takim u theksua veçanërisht puna kolosale për botimin e “Florës së Shqipërisë” në 4 vëllime (1988-2000) me redaktor të përgjithshëm akademik prof. Kolë Paparisto dhe bashkautorët, profesorët Ilia Mitrushi, Xhafer Qosja, Mustafa Demiri, bashkëpunëtori i vjetër shkencor Emin Balza, si dhe brezi më i ri i studiuesve, profesorët Jani Vangjeli, Babi Ruci, Alfred Mullaj. Ndërkaq profesorët Leonard Topuzi, Lefter Kashta, Liri Dinga, Kozma Buzi, Petrit Hoda, Murat Xhulaj, Mersin Mersinllari dhe shumë studiues të tjerë më të rinj të profilit të biologjisë në Fakultetin e Shkencave të Natyrës të Universitetit të Tiranës, në Universitetin Bujqësor të Tiranës si dhe në universitetet e tjera të Shqipërisë, kanë dhënë kontribut me studime në fushën e florës dhe vegjetacionit.

Gjithashtu u theksua vlera e veçantë e botimit për shfrytëzimin e bimësisë autoktone në shumë drejtime të bujqësisë. Shumë projekte të realizuara nga institucionet tona shkencore e mësimore të profilit biologjik, në kuadër të programeve kombëtare për kërkim dhe zhvillim, të monitorimit të mjedisit, të programeve të Komisionit Europian etj. bazohen në njohuritë themelore mbi florën e vegjetacionit shqiptar. Aq më shumë, nismat edhe në të shkuarën, edhe sot për një mjedis ekologjik me biodiversitet të pasur dhe të magjishëm me bukuritë edhe floristike, që ndikojnë në zhvillimin e ekoturizmit, realizohen mbi këto njohuri bazë. Ndërsa këto burime bimë shfrytëzohen në ekonominë bujqësore, pylltari apo të mjekësisë alternative, kohët e fundit në sheshin e

madh në qendër të Tiranës është shfrytëzuar bimësia jonë spontane në dekorimin e tij. Por, ndërsa entuziazmohemi për këtë gjetje interesante, mendojmë se specialistët tanë duhet të përfshihen aktivisht në projekte të tilla. Edhe promovimi i veprës “Atlasi i florës së Shqipërisë” shërben për të ndërgjegjësuar publikun dhe veçanërisht pjesën vendimmarrëse dhe ekzekutive në çdo nivel për të vlerësuar shkencëtarët tanë ashtu si e meritojnë. Gjithashtu u theksua se botime të tilla themelore kanë vulën e studimeve albanologjike për pasurinë e veçantë floristike të vendit tonë, por që duhet të thellohen nga grupe studiuesish të drejtmeve të ndryshme biologjike, si: të biologjisë molekulare, të citogjenetikës për karakteristikat e kromozomeve etj., që japin sot informacion të saktë, veçanërisht për specie që zbulohen rishtas, për specie endemike etj.

V. Kontributi i SSHNT të ASH në politikat e kërkimit shkencor në Rrjetin Ndër-Akademik (Inter Academic Partnership, IAP)

A- Mbështetja që Akademia e Shkencave e Shqipërisë i jep qytetit të Triestes, për emërimin e saj “Qyteti Europian i Shkencës” *Letter of Support: ESOF 2020 Trieste*

Europa, që nga viti 2010 organizon Forumin e hapur të Euroshkencës (ESOF), i cili zhvillohet çdo dy vjet në një nga qytetet e përzgjedhur përsa i përket kapaciteteve e veprimtarive shkencore. Takimet e mëparshme të ESOF janë mbajtur në Torino (2010), Dublin (2012), Kopenhagen (2014) dhe Manchester (2016), dhe një tjetër është planifikuar në Toulouse (2018), që siç konstatohet, këto janë të gjitha të vendosura në Europën Perëndimore. Për vitin 2020, qyteti i Triestes propozohet si një nga dy qytetet për tu quajtur zhvilluar ESOF-2020, e cila sjell me vete titullin e “Qyteti Europian i Shkencës”.

Fushat tematike që zhvillohen për ngjarjen përfshijnë ‘Shkencë në Shkencë’, ‘Shkencë në Biznes’, ‘Shkencë në Politikë’, dhe ‘Shkenca për qytetarët’; tematika këto të cilat lidhen ngushtë me qëllimet strategjike të Rrjetit të Akademive të Botës (InterAcademy Partnership), akademive anëtare, gjithashtu dhe me tematikat e ASH.

Cilat janë arsytet pse ASH duhet të mbështesim që Trieste meriton të emërohet për “Qytetin Europian të Shkencës” për vitin 2020?

Qyteti i Triestes njihet prej kohësh si qyteti i shkencës, sepse atje zhvillojnë aktivitetin e tyre një numër i madh institucionesh shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare, si Akademia Botërore e Shkencave (TWAS), Partneriteti InterAcademy etj.

Trieste është përmendur për kapacitetet e saj infrastrukturore shkencore dhe arsimore. Këtu ndodhet Qendra Ndërkombëtare për Fizikë Teorike (ICTP), një nga institucionet më të rëndësishme shkencore, e cila luan një rol të rëndësishëm në krijimin e marrëdhënieve midis pjesëve të ndryshme të botës. ICTP tregon rëndësinë e një qasjeje globale për të trajtuar problemet e kohës sonë duke përdorur gjuhën universale të shkencës. Funkzioni i saj i parë dhe më i rëndësishëm është të mbledhë së bashku shkencëtarë nga e gjithë bota për të shpërndarë më mirë njohuritë shkencore në pjesët më të varfra të botës. Që nga dita e themelimit, ICTP ka përfituar më shumë 130.000 shkencëtarë, megjithëse ndikimi i vërtetë shkon përtej çdo sasi të matshme dhe sot përballet me sfida të reja emocionuese pasi që misioni është të nxisë ndjekjet intelektuale në të gjitha anët e botës për të arritur pasurinë kulturore për të mbështetur zhvillimin dhe mbijetesën e njerëzimit. Në ditët e sotme, ICTP ndihmon hartuesit e

politikave shkencore dhe shkencëtarët e këtyre vendeve në krijimin e qendrave lokale të ekselencës dhe rrjeteve aktive shkencore, ndërsa në të njëjtën kohë forcimin dhe zgjerimin e aktiviteteve kërkimore në të njëjtën kohë.

ICTP ishte institucioni që kontribuoi si institucion pritës në organizimin e Akademisë së Shkencave të Vendeve të Botës në Zhvillim (TWAS) si një akademi globale shkencore e angazhuar për avancimin e shkencës dhe inxhinierisë për prosperitet të qëndrueshëm në botë; aktiviteti i TWAS krijoi nismën për Rrjetin e Akademive të Shkencave të Botës, për kërkimin Shkencën dhe mjekësinë - InterAcademy Partnership (IAP) me vendndodhje po në Trieste. Partneriteti i TWAS dhe IAP bashkon rrjetet e themeluara të akademive të shkencës, mjekësisë dhe inxhinierisë që zhvillojnë ngjarjet përfshijnë Shkencën për: Shkencën, Biznesin, Politikën dhe Qytetarët.

OGS, Instituti Kombëtar i Oceanografisë dhe Gjeofizikës Eksperimentale (Instituti Kombëtar i Oqeanografisë dhe Gjeofizikës Eksperimentale) është një institucion publik kërkimor i orientuar ndërkombëtarisht i vendosur në Trieste, që ushtron funksionet e tij aplikative në shkencat e tokës e më gjerë, si kualifikimet universitare, doktoraturës në fusha specifike shkencore bazë dhe aplikative. Bashkëpunon me CNR, UNIDO etj, për të qenë plotësisht në pajtim me misionin e saj. Qëllimi është të lehtësojë transferimin e rezultateve të hulumtimit nga bota shkencore në atë të prodhimit dhe në këtë mënyrë të kontribuojë në zhvillimin teknologjik dhe socio-ekonomik të vendit.

Në Trieste gjendet edhe Universiteti i Studimeve të Triestes, që është i angazhuar në studimin e shkencës, inovacionit dhe teknologjisë. Gjithashtu, në bashkëpunim të plotë me qytetin e Triestes dhe rajonin e Friuli-Venezia-Giulia, përfshihen edhe institutet lokale të arsimit të lartë si Universiteti i Udines, SISSA, qendra të tjera ndërkombëtare si ICGEB, qendrat kombëtare kërkimore të tjera në zonë, ato shkencore rajonale dhe parqe të teknologjisë e inovacionit. Trieste gjithashtu ka një histori të pasur të trashëgimisë në fushën e zhvillimit të biznesit, duke u bazuar në aplikimet shkencore si një nga zonat me infrastrukturë dhe zhvillime të rëndësishme portuale në vend; e për pasojë falë edhe veprimtarive të TWAS dhe IAP, si dhe numërit të institucioneve të tjera shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare, Trieste është mirënjohur në Europë dhe në mbarë botën si një 'qytet i shkencës' e me vlera në trashëgiminë shkencore.

Përzgjedhja e Triestes për ESOF 2020 është të kuptuarit 'Liria për Shkencën, Shkenca për Lirinë' (gjithnjë duke mbajtur në mendje përgjegjësitë morale dhe etike për lirinë e shkencës) dhe është një pasqyrim i kohës sonë; kjo jo vetëm vlen për epokën moderne, por gjithashtu jep udhëzime përballë shoqërive që ndryshojnë me shpejtësi avancimet teknologjike dhe inovacionet. Këto janë pritjet e organizatorëve, që ngjarja 2020 të ketë një fokus të fortë në Europën Qendrore dhe Lindore (CEE).

Ofrimi i ESOF-2020 në Trieste do të ishte një mundësi unike për t'i dhënë më shumë rëndësi komunitetit shkencor në vendet e Europës Qendrore dhe Lindore; do të ishte një moment historik, nëpërmjet dialogut shkencor, social dhe politik, në integrimin, thyerje të barrierave dhe forcimi i parimeve të paqes dhe lirisë. Nga ana tjetër edhe IAP me anëtarësinë e saj të shumtë të akademive, shpreson të luajë një rol kyç në angazhimin e komunitetit shkencor në Europën Qendrore e Lindore.

Akademia e Shkencave e Shqipërisë hulumtoi të gjitha argumentet për të qenë plotësisht dakord për të mbështetur emërimin e qytetit të Triestës "Qyteti European i Shkencës-2020". Ajo është e bindur se Trieste mund t'i përgjigjet kësaj kërkese, si një rrugë ndërlidhëse për shkencë midis Lindjes dhe Perëndimit, si dhe midis Veriut dhe

Jugut, si rasti më i mirë në dy nga kandidatët, pasi qyteti tjetër konkurues është në një vend që ndodhet më larg Perëndimit se Italia.

B- Pjesëmarrja ASH në grupet e punës të IAP
(shih: <http://www.interacademies.org/>)

Akademia e Shkencave e Shqipërisë ka një bashkëpunim të vazhdueshëm e aktiv me IAP-in, nëpërmjet veprimtarive të cilat zhvillohen në kuadër të strategjisë së saj, por dhe në harmoni me misionin e ASHSH dhe në kuadër të Strategjisë kombëtare të kërkimit shkencor, teknologjik e inovativ. Kështu gjatë vitit 2017, ASHSH ka bashkëpunuar në dy grupe pune të IAP-it, të cilat kanë përgatitur rezoluta mbi çështjet kritike globale në të cilat shkenca luan një rol vendimtar. Gjithashtu vazhdon puna në 3 grupe pune të tjera në të cilat bëjnë pjesë dhe ekspertë nga ASHSH. InterAcademy Partnership (IAP), është një organizatë e re ombrellë e formuar nga bashkimi i tri rrjeteve ndër-akademike të themeluara: Këshillit NdërAkademik (Inter-academic Council, IAC), IAP - Rrjetit Global të Akademive Shkencore dhe Panelit Ndërakademik Mjekësor në IAPartnership (Shkencë, Kërkim, Shëndetësi). Aktualisht IAP ka 136 akademi anëtare në botë, që së bashku komunikojnë me qeveritë, duke përfaqësuar 95 për qind të popullsisë së botës.

Çështjet kritike të analizuar nga këto grupe pune paraqiten respektivisht më poshtë.

I. Grupi i punës *Roli i shkencës dhe teknologjisë në reduktimin e rrezikut nga fatkeqësitë*

Korniza “Sendai” për reduktimin e rrezikut të katastrofave 2015-2030, të cilën vendet e botës nënshkruan në mars 2015, bën thirrje për rritjen e kontributit të shkencës, teknologjisë dhe kërkimit në përballjen me rreziqet e fatkeqësive natyrore dhe menaxhimin e ndikimeve të tyre. Për këtë, duhet të zhvillohen strategji për të zvogëluar rreziqet e fatkeqësive para një ngjarjeje, për të menaxhuar emergjencën gjatë ngjarjes, për të siguruar mëkëmbje efektive më pas dhe për të rritur aftësinë ripërtëritëse. Rezoluta mbi rolin e shkencës dhe teknologjisë në reduktimin e rrezikut nga fatkeqësitë u hartua nga një grup ekspertësh të përzgjedhur nga akademitë anëtare të IAP dhe të udhëhequr nga Këshilli i Shkencës i Japonisë i kryesuar nga prof. Shigeo Haruyama. Grupi i punës vë në dukje se: “...edhe në një vend të pasur dhe të përgatitur si Japonia, ne jemi gjithmonë të mësuar dhe gjithmonë përpiqemi të përmirësojmë gatishmërinë dhe përgjigjet për katastrofat tona. Për shembull, tërmeti Tōhoku si dhe cunami dhe fatkeqësia e centralit bërthamor në Japoni lindore 2011, na dhanë shumë mësim të vlefshme, të cilat ne jemi përpjekur t'i integrojmë këto në rekomandimet e paraqitura në rezolutën e IAP-it”.

Grupi i punës përbëhet nga:

1. Anderson-Berry Linda, Australian Bureau of Meteorology
2. Ashtiani, Mohsen Ghafory, International Institute of Earthquake Engineering and Seismology, Tehran, Iran
3. BUSHATI, Salvator, Academy of Sciences of Albania
4. CUTTER Susan L., Hazards & Vulnerability Research Institute, Department of Geography University of South Carolina, USA.

5. DURRHEIM Raymond, South African Research Chair in Exploration, Earthquake & Mining Seismology, School of Geosciences, University of the Witwatersrand Johannesburg.
6. FANG Chen, Institute of Remote Sensing and Digital Earth, CAS, Beijing China.
7. GABRICHIDZE Guram, Georgian National Academy of Sciences.
8. LIZARRALDE Gonzalo, IF Research Group (grif) and the Canadian Disaster Resilience and Sustainable Reconstruction Research Alliance, School of Architecture, Faculty of the Built Environment, Université de Montréal, Canada.
9. MARENGO Jose Antonio. Centro Nacional de Monitoramento e Alerta a Desastres Naturais, Brazil.
10. SEMINARA Giovanni, University of Genoa, Italy.
11. SINGH R.B. Department of Geography, Delhi School of Economics, University of Delhi, India
12. SPARKS Steve. Department of Geography, Delhi School of Economics, University of Delhi, India
13. URRUTIA-FUCUGAUCHI Jaime. Mexican Academy of Sciences

ASHSH në kontributin e saj ka pasur parasysh Draft Strategjinë Kombëtare për Reduktimin e Riskut të Rrezikut dhe Mbrojtjes Civile të RSh (National Strategy for Disaster Risk Reduction and Civil Protection), 2014-2018, e cila është konsideruar nga GP gjatë draft propozimit të parë dhe të dytë. Në attach jepet rezoluta.

1. Grupi i Punës “Ndryshimet Klimatike dhe Arsimimi”

Njerëzimi përballet me një krizë serioze klimatike, e cila do të ndikojë në të gjithë botën gjatë shekullit 21 dhe më gjërë. Ballafaqimi me këtë krizë do të varet shumë nga të rinjtë që janë sot në shkolla dhe mund të bëhen “agjentë të ndryshimit”. Korniza ligjore ndërkombëtare për të trajtuar ndryshimet klimatike, dmth Konventa Kuadër e Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike (UNFCCC, 1992) dhe Marrëveshja e Parisit (OKB, 2015), e njohin këtë pikë duke deklaruar se “zhvillimi dhe zbatimi i programeve të arsimit dhe trajnimit ... në veçanti për vendet në zhvillim “(UNFCCC, neni 6.b.ii) dhe “palët duhet të marrin masa ... për të rritur edukimin për ndryshimin e klimës” (Marrëveshja e Parisit, neni 12). Njohuritë dhe të menduarit kritik mbi të kuptuarit e dukurive të klimës së Tokës, ndikimi i emetimeve të gazrave serrë në sistem, si dhe perceptimi i strategjive për zbutjen (“lufta kundër shkaqeve”) dhe adaptimi (“përballimi me efektet”), nga nivelet globale në ato lokale është një problem i prekshëm aktual. Shkenca klimatike bashkon çështje specifike, të cilat aktualisht nuk janë të njohura gjerësisht nga kurrikulat shkencore në shkolla dhe universitete.

Praktikuesit e disiplinave tradicionale, siç janë shkencat e tokës, fizika, kimia, shkencat e jetës, matematika, shkenca shoqërore dhe ekonomia etj., duhet të bashkëpunojnë në mënyrë ndërdisiplinore për t'i trajtuar këto çështje në të gjithë programet mësimore, madje edhe në nivelin e arësimit elementar. Përveç kësaj, ekziston nevoja për të kuptuar se si këto ndërveprime komplekse midis sistemeve natyrore dhe shoqërore (p.sh. menaxhimi i riskut) lidhin veprime lokale me pasoja globale - për të cilat kërkohet përfshirja e shkencave sociale, si dhe të shkencave

shëndetësore e të ekonomisë. Një arsimim i tillë duhet të njohë gjithashtu edhe rolin e solidaritetit, altruizmit dhe vlerave etike, të cilat nuk rrjedhin nga njohuritë shkencore. Nevojitet një përpjekje e rëndësishme për të integruar të gjitha këto aspekte.

Grupi i punës përgatiti një Deklaratë duke studjuar edukimi shkencor si pararojë dhe arësimimin si një problem përparësor duke vlerësuar mësuesit (në shkolla fillore dhe të mesme) si dhe profesorët (në universitete) si hallkat më të rëndësishme të edukimit. Po kështu edhe nxjerr si domosdoshmëri para shkencëtarëve dhe inxhinierëve në arsim, detyra në bërjen e njohurive të reja prej hulumtimeve si dhe nga ata që e përdorin atë, të luajnë një rol thelbësor në frymëzimin dhe vazhdimisht përmirësimin e përditësimit të përmbajtjes së currikulave të arsimit, në shkolla dhe në universitete. Risia e çështjeve klimatike, sfidat ndërdisiplinore për t'i adresuar ato, së bashku me dyshimet që shpesh mbartin konkluzione shkencore, i japin bashkësisë shkencore një rol të veçantë në kontributin për transformimin e arsimit. Mësimdhënësit e shkollave, të cilët në shumë rajone nuk marrin trajnim të mjaftueshëm adekuat profesional për mundësi të zhvillim praktik në procesin mësimor, kanë nevojë për ndihmë për të zbatuar arsimimin mbi ndryshimet klimatike në klasat e tyre. Deklarata është miratuar nga 113 Akademitë e Rrjetit të Akademive të Botës (InterAcademyPartnership-IAP) për shkencën ku bën pjesë aktive edhe Akademia e Shkencave e Shqipërisë, e cila e ka zhvilluar atë në kuadër të programit "Edukimi në shkencë". Bashkëkryetarët e grupit punës Lena Pierre (*Académie des Sciences, France*) dhe Chanin Marie-Lise (*Académie des Sciences, France*) prezantuan rezolutën e Grupit të Punës:

1. Mesazhet kryesore

- Arsimi, sidomos edukimi shkencor, duhet të luajë një rol thelbësor në përgatitjen e tashme dhe në të ardhshmen për të kuptuar ndryshimet klimatike dhe për të qenë të përgatitur më së miri për t'iu përshtatur dhe për të zbutur ndikimet e saj.

- Edukimi mbi ndryshimet klimatike duhet të marrë në konsideratë nevojën për tu ofruar mësuesve, si në vendet e zhvilluara, ashtu dhe në vendet në zhvillim, mundësitë e të mësuarit profesional me fakte të përditësuar, procese trajnimi të reja dhe inovative, burime të reja për klasën dhe mjete të reja për fuqizimin e studentëve të tyre si 'agjentë të ndryshimit'.

- Edukimi shkencor i bazuar në hulumtim (Inquiry-based science education, IBSE), zhvilluar gjatë dy dekadave të fundit, ka treguar një mënyrë të efektshme për të mësuar shkencën në nivel fillor dhe të mesëm dhe gjithashtu për të frymëzuar arsimin e lartë në të gjithë botën. Ai siguron një bazë të fortë për të zhvilluar urgjentisht një program të veçantë ndërdisiplinor për ndryshimet klimatike.

- Ndryshimet klimatike dhe ngjarjet e lidhura me to do të ndikojnë në mënyrë joproportionale te 3 miliardë më të varfrit e popullsisë globale, shkollimi i të cilëve është i pamjaftueshëm. E drejta mbi klimën (*climate justice*) bën thirrje për mbështetjen e shkollave dhe mësuesve të tyre me nisma specifike.

- Bashkëpunimi ndërkombëtar, nëpërmjet përfshirjes së komunitetit shkencor, do të rrisë në masë të madhe mobilizimin e sistemeve arsimore. Duke qenë se Paneli Ndërqeveritar për Ndryshimet Klimatike (Intergovernmental Panel on Climate Change, IPCC) po prodhon raporte periodike vlerësimi, të shoqëruara me përmbledhje për hartuesit e politikave, komuniteti shkencor duhet të përdorë materiale nga raportet e IPCC-së, për të prodhuar burime dhe mjete për mësuesit.

2. Edukimi shkencor në pararojë

Njerëzimi përballet me një krizë serioze klimatike, e cila do të ndikojë në të gjithë botën gjatë shekullit XX dhe më tutje. Ballafaqimi me këtë krizë do të varet shumë nga të rinjtë që janë sot në shkolla e mund të bëhen “agjentë të ndryshimit”. Korniza ligjore ndërkombëtare për të trajtuar ndryshimet klimatike, si Konventa Kuadër e Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike (UNFCCC, 1992) dhe Marrëveshja e Parisit (OKB, 2015), e pranojnë këtë pikë duke deklaruar se “Zhvillimi dhe zbatimi i programeve të arsimit dhe trajnimit... në veçanti për vendet në zhvillim” (UNFCCC, neni 6.b.ii) dhe “Palët duhet të marrin masa... për të rritur edukimin për ndryshimin e klimës” (Marrëveshja e Parisit, Neni 12).

Kuptimi i klimës së Tokës, ndikimi i emetimeve të gazrave serrë në sistem, si dhe perceptimi i strategjive për zbutjen ('lufta kundër shkaqeve') dhe adaptimi ('përballimi me efektet'), nga nivelet globale në ato lokale, kërkon njohuri shkencore dhe mendim kritik. Shkenca klimatike bashkon çështje specifike të cilat aktualisht nuk janë të njohura gjerësisht nga kurrikulat shkencore në shkolla dhe universitete.

Praktikuesit e disiplinave tradicionale, siç janë shkencat e tokës, fizika, kimia, shkencat e jetës, matematika, shkenca shoqërore dhe ekonomia etj., duhet të bashkëpunojnë në mënyrë ndërdisiplinore për t'i trajtuar këto çështje në të gjithë programin mësimor, madje edhe në nivelin fillor. Përveç kësaj, ekziston nevoja për të kuptuar se si këto ndërveprime komplekse midis sistemeve natyrore dhe shoqërore (p.sh. menaxhimi i riskut) lidhin veprimet lokale me pasojat globale - duke kërkuar kështu edhe përfshirjen e shkencave sociale, si edhe të shkencave shëndetësore dhe të ekonomisë. Një arsimim i tillë duhet të njohë gjithashtu edhe rolin e solidaritetit, altruizmit dhe vlerave etike, të cilat nuk rrjedhin nga njohuritë shkencore. Nevojitet një përpjekje e rëndësishme për ti përfshirë të gjitha këto aspekte.

Gjatë dy dekadave të fundit, komuniteti shkencor, dhe sidomos akademiti e shkencës, janë përfshirë thellë në propozimin e ndryshimeve në arsimin bazë shkencor në shkollat fillore, të mesme dhe të larta dhe kanë nxitur projekte pilot në një numër vendesh si në zhvillimin dhe në botën e zhvilluar. Një konsensus i qartë është ndërtuar rreth një mënyre për të mësuar shkencat natyrore: një edukim shkencor me bazë kërkimi (IBSE), i cili i fut studentët në shkencë në një mënyrë aktive. Dhjetëra milionë studentë të rinj kanë përfituar nga IBSE dhe vazhdojnë ta bëjnë këtë. Këto përpjekje ofrojnë një bazë të shkëlqyeshme për adresimin e çështjeve të ndryshimeve klimatike në shkolla, të cilat janë kaq thellësisht të lidhura me zhvillimin e qëndrueshëm.

3. Arsimimi një problem përparësor

Është e ditur tashmë (raporti i 5-të i Vlerësimit të IPCC) se efektet e ndryshimeve klimatike do të ndikojnë në mënyrë disproporcionale tek njerëzit e varfër, të cilët janë 3 miliardë dhe jetojnë më së shumti në botën në zhvillim. Fëmijët (të moshës nën 15 vjeç) përfaqësojnë një të katërtën e popullsisë globale dhe një miliardë kanë shkollim të dobët, sidomos në shkencë dhe zhvillimin e qëndrueshëm. Në nivelin aktual, vetëm 14 për qind do të kenë arsim të mesëm në vitin 2030 ('Arsimi për njerëzit dhe planetin', UNESCO, 2016). Për më tepër, krahasuar me djemtë, arsimi për vajzat është shumë më i pakët. Aktualisht, edhe në vendet e zhvilluara, njohuritë lidhur me ndryshimet klimatike nuk mësohen në mënyrë efektive: një analizë e kurrikulave aktuale në 78 shtete tregon se vetëm 58 për qind përdorin termin *ekologji* dhe 47 për qind përmendin *arsimin mjedisor* ('Arsimi për njerëzit dhe planetin' UNESCO, 2016). Përshtatja ndaj efekteve të ndryshimeve klimatike (valët e nxehtësisë dhe ngjarjet e tjera ekstreme të motit, rritja e

nivelit të detit, ndryshimi i ushqimit dhe burimeve ujore, ndotja dhe kërcënimet shëndetësore etj.) do të ndikojnë në sjelljen individuale dhe kolektive në të gjithë sektorët e shoqërisë.

Nevojitet një përpjekje e vazhdueshme që shkollat të jenë të lidhura mirë me familjet dhe komunitetet në mënyrë që të fuqizojnë të rinjtë jo vetëm në shqetësimet që rezultojnë nga ndryshimet klimatike, por edhe në përfitimet sociale dhe ekonomike të ofruara nga puna për një botë më të qëndrueshme duke shpresuar në të ardhmen. Duhet të përcaktohen fushat e ndërlydhura të ndërhyrjes siç janë menaxhimi i sigurt i ujit, burimet alternative të energjisë, njohuritë tradicionale, bujqësia e qëndrueshme, bioekonomia dhe kimia e gjelbër.

Megjithatë, ndryshimi i klimës është një problem që po rritet me shpejtësi dhe situata sot është më e keqe se kurrë më parë. Mbajtja e rritjes së temperaturës mesatare globale në më pak se 2°C mbi nivelet para-industriale dhe synim kufizimin e rritjes së temperaturës në 1.5°C do të kërkojnë që shoqëria të arrijë vlerën zero për emetimet e CO₂ deri në vitin 2100. Zgjedhja e një përzierjeje të përshtatshme të energjisë debatohet fuqishëm dhe merr parasysh faktorë të tillë si mbrojtja e biodiversitetit, por dhe kufizimet etike, sociale dhe politike të cilat fillimisht u shpërfillën në diskutimet ndërkombëtare. Është e vështirë të parashikohet se cilat do të jenë vendimet më të përshtatshme për mbas njëzet vjetësh, kur brezi i tashëm i studentëve të rinj do të jetë vendimmarrës. Prandaj, arsimit sot duhet t'i pajisë ata me aftësinë e të kuptuarit dhe vendimmarrjes, bazuar në dëshmi dhe mendime kritike, për të mos lejuar që mendimet *a priori* apo mungesa e arsyes të udhëheqin zgjedhjet e tyre në të ardhmen.

4. Mbështetje procesit të mësimdhënies, në shkollat fillore e të mesme dhe universitete

Arsimi fillor dhe i mesëm. Projektet pilote të IBSE-sënë Amerikë, Europë, Azi dhe Afrikë kanë ofruar një bazë të dhënash të madhe mbi atë që kërkohet për të arritur ndryshime të suksesshme në arsimin bazë shkencor. Përfundimi më i dukshëm është se mësuesit duhet të arsimohen, të trajnohen dhe të mbështeten në mënyrë që shkenca të mësohet në mënyrë aktive dhe pjesëmarrëse, duke përfshirë eksperimente, testimet hipoteze, të menduarit kritik dhe përdorimin e gjuhës së duhur. Një qasje e ngjashme në lidhje me ndryshimet klimatike, e cila kërkon pjesëmarrjen e kërkuesve shkencorë, mund të marrë shumë forma: mundësia e arsimimit profesional përqendruar në konceptet e shkencës klimatike; puna kolektive duke përdorur mësimin në distancë; dhe burimet pedagogjike për klasën, të përshtatura me nivelin e mësimdhënies (fillore, të mesme) dhe me ekspertizën specifike të mësuesve dhe rrethinat lokale.

Duhet të planifikohen nga njëra anë mobilizimi i përshtatshëm i mësuesve, arsimimi dhe përkrahja, dhe nga ana tjetër futja e arsimimit mbi ndryshimet klimatike në kurrikulat kombëtare të shkencës. Përveç kësaj, për përgatitjen e plotë të edukatorëve të të gjitha nivelet për të mësuar me besim rreth ndryshimeve klimatike, ndikimeve të tyre dhe strategjive të përballimit, ata duhet të trajnohen mbi mënyrën si të përballen me skeptikët e klimës dhe si të diskutojnë në klasat dhe komunitetet e tyre në mënyrë racionale çështjet e debatueshme.

Arsimi i lartë. Në institucionet e arsimimit të lartë, profesorët e shkencave natyrore si dhe atyre sociale dhe ekonomike janë të lidhur me kërkimin shkencor. Çështjet e klimës u ofrojnë atyre një mundësi të shkëlqyer për të adoptuar qasje të integruara dhe interdisiplinare në mënyrë që studentët dhe profesionistët e ardhshëm të përgatiten për

të kontribuar me aftësitë e duhura në sfidat e zbutjes dhe përshtatjes, në të gjitha fushat e jetës. Kjo përpjekje duhet të përfshijë trajnimin para dhe gjatë shërbimit të mësuesve.

Megenëse Toka është një sistem i ndërlikuar, nismat e arsimit të lartë duhet të përcaktojnë drejtpërdrejt konceptet e mëposhtme, me qëllim që ato të kuptohen siç duhet: (i) dallimet midis efekteve globale dhe atyre lokale, dhe pasojat mjedisore; (ii) parashikimet për të ardhmen dhe paqartësitë që e shoqërojnë; (iii) optimizimi i skenarëve, në varësi të zgjedhjeve të shoqërive për të ardhmen e tyre; (iv) larmia ekstreme e shkallëve në hapësirë dhe kohë; (v) reagimet pozitive dhe negative; (vi) shkaqet multi-faktoriale dhe proceset e rastit; (vii) jo-linearizimet dhe tranzicioni fazor.

5. Roli i shkencëtarëve dhe i inxhinierëve në arsim

Bërja e njohurive të reja u jep shkencëtarëve që kryejnë hulumtimin dhe atyre që e përdorin atë, një rol thelbësor në frymëzimin dhe përshtatjen e vazhdueshme të përmbajtjes së arsimit, në shkolla dhe në universitete. Risia e çështjeve klimatike, sfidat ndërdisiplinore për t'i adresuar ato, së bashku me dyshimet që shpesh mbartin konkluzionet shkencore, i japin bashkësisë shkencore një rol të veçantë në kontributin për transformimin e arsimit. Mësimdhënësit e shkollave, të cilët në shumë rajone nuk marrin trajnim të mjaftueshëm dhe zhvillim profesional të përshtatshëm kanë nevojë për ndihmë për të zbatuar arsimimin mbi ndryshimet klimatike në klasat e tyre.

Shkencëtarët dhe inxhinierët e përfshirë në të gjitha aspektet e ndryshimeve klimatike kanë një rol vendimtar në përparimin dhe zbatimin e edukimit mbi ndryshimet klimatike pasi ata kanë njohuritë që duhet të përfshihen në kurrikula dhe të përcillen tek mësuesit. Shkencëtarët njohës dhe specialistët e arsimit kanë gjithashtu një rol të rëndësishëm në përparimin e edukimit për ndryshimet klimatike, duke sjellë në tavolinë kuptimin e tyre mbi procesin e të mësuarit në të gjitha moshat, pedagogjinë efektive dhe hartimin e materialeve mësimore të fuqishme dhe efektive. Këto grupe duhet të mbështesin krijimin e burimeve të mësimdhënies dhe mundësive të zhvillimit profesional të kërkuar për mësuesit në të gjitha nivelet.

Më tej, shkencëtarët dhe inxhinierët duhet të ngrenë zërin për domosdoshmërinë e një arsimiti të tillë, si në nivel global ashtu edhe brenda vendeve dhe komuniteteve të tyre, si avokatë thelbësorë të rëndësisë së edukimit mbi ndryshimet klimatike, rolin kritik të mësuesve dhe burimet e nevojshme. Për shembull, nismat e reja shumëgjuhëshe mund të përfshijnë një shërbim global që ofron burime dhe mjete për mësuesit; shërbimet lokale mund të krijojnë ndërveprime të drejtpërdrejta me ndihmën e internetit midis shkencëtarëve dhe mësuesve.

6. Përfundime dhe rekomandime

Edukimi i brezave të tashëm dhe të ardhshëm rreth ndryshimeve klimatike dhe mësimi i tyre për të vepruar me një mendje kritike dhe një zemër shpresëdhënëse, është thelbësore për të ardhmen e njerëzimit. Arsimiti në shkencë duhet të përballojë sfidën, veçanërisht nëpërmjet përdorimit të një pedagogjie ndërdisiplinore e të bazuar në hulumtim, dhe komuniteti shkencor global të luajë një rol thelbësor në zbatimin dhe përmirësimin e tij.

Akademitë e shkencave, duke punuar përmes IAP-it, i bëjnë thirrje politikëbërësve, autoriteteve të arsimit dhe shkencëtarëve të tjerë që:

1. Të pranojnë që edukimi mbi ndryshimet klimatike, për zbutjen si dhe për adaptimin, duhet të kthehet në përbërës parësor të edukimit shkencor në të gjitha nivelet arsimore;

2. Të zhvillojnë sa herë të jetë e mundur përdorimin e pedagogjisë së bazuar në hulumtim;
3. Të mbështetet përgatitja e mësuesve dhe profesorëve - faktorë bazë në edukimin e brezave të tashëm dhe të ardhshëm - përmes një sërë nismash, siç janë ndryshimet e kurrikulave që përfshijnë interdisiplinaritetin; sesionet e trajnimit profesional, vënien në dispozicion të burimeve të ndryshme dhe specifike, mësimin në distancë etj.;
4. Të organizojnë mbështetjen e nevojshme dhe sigurimin i burimeve financiare për këto nisma, të cilat kërkojnë krijimtari dhe inovacion nga komuniteti shkencor;
5. Të fuqizojnë studentët për të vepruar me krijimtari dhe shpresë në shkollat, familjet dhe komunitetet e tyre, për të trajtuar çështjet sociale dhe ekonomike që lidhen me qëndrueshmërinë dhe për të kuptuar se si edukimi shkencor do t'i ndihmojë ata të marrin vendime bazuar në dëshmi dhe në mendimin kritik;
6. Të kenë në fokus të veçantë komunitetet e kërcënuara - veçanërisht në botën në zhvillim - të ekspozuara ndaj përmbytjeve, thatësirës, uraganeve dhe ngjarjeve të tjera ekstreme të motit;
7. Të shqyrtojnë veprimet që duhet të kryhen paralelisht me raportet periodike të IPCC-së, me qëllim që të ofrohen "Burime dhe Mjete për Mësuesit" në nivel global, në bashkëpunim me aktorët vendorë, për të bërë përshtatjet e nevojshme që lidhen me larminë e situatave lokale.

II. *Grupi i Punës "Shëndeti urban"*

Qytetet tani janë habitati dominues njerëzor dhe për të ardhmen e afërt shumica e rritjes së popullsisë do të jetë në zonat urbane. Gjatë 20-30 viteve të ardhshme, OKB vlerëson se 2-3 miliardë më shumë njerëz do të duhet të strehohen në qytete - më shumë se 1 milion çdo javë. Në të ardhmen, mbrojtja dhe promovimi i shëndetit gjithnjë e më shumë varet nga vendimet e marra brenda dhe në lidhje me sistemet urbane. Ndërsa urbanizimi ka kontribuar në rënien e përgjithshme të varfërisë, sfidat e zhvillimit vënë në rrezik shëndetin dhe mirëqenien e njerëzve në qytete. Prandaj, nevojitet një kuptim më i mirë i lidhjeve, dinamikave dhe kompleksitetit të mjediseve urbane. Një program ndërdisiplinor i udhëhequr nga ICSU në partneritet me PLA dhe Universitetin e Kombeve të Bashkuara për "Shëndetin dhe mirëqenien në mjedisin ndryshueshëm urban: qasja e analizës së sistemeve" është sfidë e cila ka nisur një përpjekje dhjetëvjeçare me vizionin për të gjeneruar njohuri relevante për politikën që do të përmirësojnë gjendjen shëndetësore, do të zvogëlojnë pabarazitë shëndetësore dhe do të rrisin mirëqenien e popullatave që jetojnë në mjedise urbane që po përjetojnë ndryshime të vazhdueshme.

IAPartnership (për shëndetësinë) organizoi një pyetësor të shkurtër për të zhvilluar aktivitetet e tij programatike në fushën e shëndetit urban, nëpërmjet të cilit me anëtarët e akademive anëtare të ndërtohej rrjeti i ekspertëve në shëndetin urban, për të sjellë në vëmendjen e politikëbërësve për çështjet e shëndetit urban, si dhe të vendosë pozitën e IAP në agjendën globale të kërkimit shkencor dhe të politikave që ajo duhet të zhvillojë.

Nga një analizë e kohëve të fundit të bashkëkryetarëve të IAP (për akademitë anëtare të Shëndetësisë ku aderon edhe ASHSH) tregon se akademitë kanë treguar mbështetje edhe për aktivitetet e *Shëndetit Urban*, të cilat janë të listuara në IAP për Veprimin Prioritar Strategjik të Shëndetësisë, si përgatitja e Deklaratave të

konferencave shkencore - këshillave të bazuara në dëshmi për politikbërjen e qeverinë; fuqizimin e partneritetit me organizata të tjera brenda dhe përtej komunitetit ndër-akademik etj.

Ne, si IAP për Shëndetësinë ka theksuar gjithashtu rëndësinë që akademitë të punojnë së bashku për të promovuar iniciativat e Shëndetit Urban. Në këtë drejtim, ne vlerësojmë gjithashtu rolin që ish-anëtar i Këshilit të Europës, Jo Boufford ka luajtur në përfaqësimin e IAPPartnership në këtë program.

Duke shkuar më tej për këtë çështje, IAP synon të përfshijë më shumë akademitë e anëtarëve në Iniciativën e Shëndetit Urban, sidomos duke identifikuar personat kryesorë nga rajonet e ndryshme të cilët mund të shërbejnë si pikat fokale për akademitë e tyre kombëtare dhe gjithashtu të përfaqësojnë IAP në programet relevante kombëtare, rajonale dhe / ose takime ndërkombëtare. Ne gjithashtu do të donim të vlerësonim se ASHSH ka qenë aktive në fushën e shëndetit në përgjithësi ku që nga viti 2010 ajo ka zhvilluar 5 konferenca shkencore ndërkombëtare ndër rekomandimet e të cilave janë trajtuar edhe probleme të Shëndetit Urban dhe që është ndërmarrë të studiohet me fokus të përqendruar për çështjet përparësore të saj.

Të bërët e qyteteve botërisht të shëndetshëm arrihet nëpërmjet një harmonizimi të: (i) zhvillimit të një mjedisi natyral të gjelbërt; (ii) edukimit; (iii) planifikimit urban; (iv) ndërtimeve urbane në harmoni me mjedisin; (v) transportit; (vi) cilësisë në sektorin e shëndetit; (vii) qasjes në një strehim adekuat dhe të sigurt që mund të tërheqë investime ekonomike, një fuqi punëtore të ndryshme që rrit nivelet e zhvillimit social, ekonomik dhe ndjenjën e komunitetit gjithashtu; (viii) zhvillimit ekonomik eficient dhe (ix) shëndetit dhe kohezionit të komunitetit që janë të lidhura në mënyrë të pashmangshme. Bazuar në përzgjedhjet mbi aktivitetet, për vendin tone do të ngrihet një n/grup pune që do të kordinohet nga prof. asoc. Besnik Aliaj nga Universiteti POLIS, Tiranë.

III. Grupi i punës *Shëndeti në të gjitha politikat (Health in All Policies, HiAP)*

IAP për Shëndetësinë është e angazhuar për përmirësimin e shëndetit në mbarë botën. Miliona njerëz, sidomos në vendet zhvillim, nuk kanë qasje në kujdesin konvencional mjekësor. Shëndeti në të gjitha politikat (HiAP) është një qasje bashkëpunuese që integron dhe artikulon konsideratat shëndetësore në hartimin e politikave në të gjithë sektorët për të përmirësuar shëndetin e të gjitha komuniteteve dhe njerëzve. Me këtë në mendje, *IAP për Shëndetin* po lançon një projekt të kryesuar nga Akademia Kineze e Inxhinierisë për të mbledhur praktikat më të mira globale në *HiAP*, ato praktika intersektoriale dhe masat që kanë të mira efektet shëndetësore.

Tani po kërkojmë që akademitë e anëtarëve të emërojnë pjesëmarrës të interesuar për t'u ulur në Drejtues Komiteti i projektit. Pjesëmarrësit do të: (i) sigurojnë këshilla teknike dhe strategjike për IAP në lidhje me këtë thirrje; (ii) udhëzojë mbledhjen dhe shqyrtimin e rasteve që do të kërkohen nga akademitë e anëtarëve të IAP në vendet e tyre; (iii) të përfshihen në përcjelljen e thirrjes në vëmendje të politikave, hulumtimeve dhe rrjeteve të komuniteteve përkatëse dhe në këtë mënyrë të inkurajojë pjesëmarrjen në këtë proces; (iv) ata duhet të kenë përvojë në koordinimin e politikave shëndetësore dhe menaxhimin e shëndetit dhe sigurisht, kujtëdo që ka pasur ndonjë përvojë në *HiAP*.

Qëllimi i projektit është që më pas të propozojë sugjerime strategjike, parime themelore udhëzuese dhe iniciativat për promovimin e *HiAP* sipas përvojave dhe mësimave nga rastet e studimit të marra dhe nga hulumtimet e bazuara në prova.

Komiteti Drejtues në mënyrë ideale do të përbëhet nga 15-20 persona të nominuar nga akademitë anëtare, të cilët do të punojnë kryesisht në mënyrë virtuale e në një konferencë përfundimtare për të paraqitur rezultatin e kësaj nisme. Nga vendi ynë është përzgjedhur **prof. dr. Alban Ylli** nga Instituti i Shëndetit Publik, Tiranë.

IV. Grupi i punës Këshillat shkencore për politikëbërjen globale në transformimin e botës sonë

Partneriteti InterAcademy - rrjeti global i akademive shkencore, mjekësore dhe inxhinierike ka dy vjet që ka nisur një projekt trevjeçar në bashkëpunim me Institutin për Studime të Avancuara (IAS) dhe me mbështetjen e Carnegie Corporation të Nju Jorkut. Projekti do të shqyrtojë se si të forcohet kontributi shkencor për Kombet e Bashkuara, qeveritë dhe palët e tjera që synojnë arritjen e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm 2030 (Sustainable Development Goals, SDG) të OKB, zyrtarisht i njohur si “Transformimi i botës sonë”. SDG-përmbledh 17 objektiva të ndara në 169 synime frymëzuese për një zhvillim të qëndrueshëm njerëzor, që mbulon çështje të tilla si përfundimi i varfërisë dhe urisë, siguri i jetës së shëndoshë dhe edukimi cilësor, luftimi i ndryshimeve klimatike dhe mbrojtja e mjedisit global. Në takimin inaugurues në Nju Jork (18 gusht 2016), komiteti i projektit me 11 shkencëtarë me përvojë në bashkëpunimin shumëpalësh në politikën e shkencës dhe kërkimit, diskutoi peisazhin aktual për këshilla shkencore globale dhe hulumtoi mënyrat për forcimin e ndërfaqes së politikës shkencore. Disa ekspertë të ftuar ofruan njohuri për sfidat kryesore me të cilat përballen shkencëtarët dhe këshilltarët e shkencës në sistemet globale. Gjatë rrjedhës së projektit, komiteti do të shqyrtojë pikat e forta, dobësitë dhe mundësitë për këshilla shkencore; ku akademitë kombëtare të shkencës dhe rrjetet ndër-akademike mund të luajnë rolin e tyre; dhe çfarë duhet të ndryshojë për një zbatim më të mirë rajonal dhe kombëtar të bazuar në prova të kornizave globale të politikave të OKB-së. “Agjenda e 2030 e OKB-së është një kornizë e mirë-artikulluar, e miratuar globalisht. Ajo planifikohet të jetë me ndikim të lartë, aksione të larta dhe do ofrojë një mundësi për të shqyrtuar peizazhin gjithnjë e më të ndërlikuar të këshillave shkencore globale”, tha profesor Robbert Dijkgraaf, ex. President i IAP dhe Drejtor, si dhe Leon Levy, profesor në IAS, i cili tha: *Unë parashikoj që ky projekt do të ofrojë njohuri të dobishme për akademitë dhe komunitetet më të gjera shkencore dhe politikëbërëse.* Profesor Li Jinghai, bashkëkryesues i komitetit të projektit të IAP dhe nënkryetar i Akademisë Kineze të Shkencave, përsëriti rëndësinë e ofrimit të këshillave me cilësi të lartë për politikëbërësit: *IAP dhe rrjete të tjera ndërkombëtare të shkencave - përfshirë ICSU (Këshilli Ndërkombëtar për Shkencën) - mund të ndihmojë që shkenca të luajë rolin e saj në arritjen e Qëllimeve të Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDGs). Ato mund të ndihmojnë në formulimin e politikave dhe praktikave më të mira për zhvillimin e këshillave të politikave si një bazë për përmirësimin e praktikave në të gjithë botën.* Ndërsa dr. Eva Alisic, bashkëkryesuese e Komitetit të Projektit të IAP dhe bashkëkryesuese e Akademisë Botërore së të Rinjve shtoi se “Ky projekt mund të ndihmojë në nxitjen e dialogut dhe bashkëpunimit midis ofruesve të këshillave globale shkencore”, duke përfshirë të gjitha disiplinat dhe të gjitha gjeneratat.

Komisioni kordinues për *Përmirësimin e imputeve shkencore në politikën globale: Strategjitë për zhvillimin e qëllimeve të zhvillimit të qëndrueshëm* përbëhet nga: dr. Eva Alisic (bashkëdrejtuese), prof. Li Jinghai (bashkëdrejtues), prof. Emeritus Michael Barber, prof. Rajae El Aouad, prof. Peter Fritz, prof. Sandy Harrison, prof. Norichika

Kanie, prof. Keto Elitabu Mshigeni, prof. Hubert Kairuki, prof. Muhammad Saidam, prof. Francisco José Sánchez-Sesma dhe prof. Robert Scholes.

C- Workshop-i “Perceptimi i rrezikut dhe pranueshmërisë së ekspozimit të njeriut ndaj pesticideve”.

SAPEA (Këshilli Shkencor për Politikën nga Akademitë Europiane) dhe Instituti për Studimet e Qëndrueshme dhe të Avancuara (IASS) i kryesuar nga prof. dr. Ortwin Renn, si pjesë të mekanizmit të këshillimit shkencor të Komisionit Europian, mbledhi (më 20 Dhjetor 2017, Berlin - Gjermani) ekspertë shkencorë nga akademitë e shkencave në një workshop me tematikë **“Perceptimi i rrezikut dhe pranueshmërisë së ekspozimit të njeriut ndaj pesticideve”**. Në këtë veprimtari nga propozimet e bëra nga ASHSH, organizatorët përzgjedhën prof. dr. Shpend Shahini dhe prof. dr. Magdalena Cara, ekspertë të fushës nga Universiteti Bujqësor i Tiranës, me të cilin ASHSH bashkëpunon ngushtë në fushat e bujqësisë. Qëllimi i workshopit ishte i lidhur me perceptimin e rrezikut dhe pranueshmërinë e ekspozimit të njeriut ndaj pesticideve:

- a. arritjen e një kuptimi më të mirë të mekanizmave bazë që shkaktojnë shqetësim publik për ekspozimin e njeriut ndaj pesticideve;
- b. sigurimin dhe diskutimin e provave empirike rreth perceptimit të rrezikut dhe implikimit të tij për sjellje individuale dhe politike;
- c. përcaktimin e strategjive të menaxhimit të riskut dhe komunikimit që adresojnë shqetësimet e publikut dhe shkaqet e tyre psikologjike dhe sociale e të tjera që lidhen me këto çështje.

Rezultatet e workshopit do të informojnë me këshilla shkencore Komisionin Europian dhe do të bëhen të njohura dhe lokalisht edhe në vendin tonë, në institucionet të cilët trajtonë këto probleme.

Në workshop u shtrua për diskutim pyetja se sa mund të bëhet më efektiv, efikas dhe transparent sistemi i dyfishtë i BE-së për miratimin dhe autorizimin e Produkteve të Mbrojtjes së Bimëve, dhe nëse po, si mund të arrihet kjo. Ekspertët nga e gjithë Europa synuan t'i përgjigjen kësaj problematike, duke kombinuar njohuritë e tyre për shkencat mjekësore, natyrore, sociale dhe teknikën në një mënyrë unike nëpërmjet përvojave të tyre, të cilat nëpërmjet referuesve kryesore u bënë objekt diskutimi, synuan në:

- (i) perceptimin e rrezikut dhe pranueshmëria e ekspozimit ndaj njeriut pesticideve (prof. Ortwin Renn);
- (ii) rregulloret e pesticideve në BE dhe boshllëqet e komunikimit në tanishme system (DG JRC);
- (iii) vlerësimi i rrezikut toksikologjik dhe vlerësimi dhe rreziku i pasigurisë në perceptim (Susanne Bennekou Andy Hart)
- (iv) rrisku dhe rreziqet: ndikimi i perceptimit dhe komunikimit (Ragnar Löfstedt);
- (v) perceptimi dhe komunikimi e perceptimi dhe paragjykimet (Katherine McComas)
- (vi) komunikimi me rrezikun: si të komunikojnë pasiguritë dhe kompleksitet (Helmut Jungermann).

Në workshop, përfaqësuesja e grupit pjesëmarrës nga Shqipëria prof. Magdalena Cara, në diskutimet e saj bëri një prezantim të gjendjes në Shqipëri dhe disa synime në lidhje me tematikat e zhvilluara në këtë takim.

Nga trajtimi i çështjeve të trajtuara në workshop mund të veçojmë disa problematika që duhen pasur parasysh në vendin tonë si:

- Shqipëria duhet të përafrojë kuadrin ligjor për pesticidet me paketën ligjore të BE-së për pesticidet dhe Produktet për Mbrojtjen e Bimëve;
- të krijohen strategji dhe programe për aplikime me projekte për:
 - ✓ njohjen dhe perceptimin e riskut të pesticideve në shëndetin e njeriut, kafshëve dhe mjedisin,
 - ✓ të futet në procedurë vlerësimi i rrezikut toksikologjik dhe vlerësimi i rrezikut të pasigurisë në perceptim,
 - ✓ në mënyrë të vazhdueshme të realizohet komunikimi për informimin mbi rrezikun;
- të organizohen takime me grupet e interesit dhe shoqërinë civile për ndërgjegjësimë në lidhje me riskun nga pesticidet.

Attach 1:**Rezolutë mbi rolin e shkencës dhe teknologjisë në reduktimin e rrezikut nga fatkeqësitë,¹ përgatitur nga akademitë anëtare të IAP-it për shkencën****1. Kuadri**

Pasojat negative të rreziqeve natyrore, si: tërmetet, cunamet, shpërthimet vullkanike, rrëshqitjet e tokës, ortekët, stuhitë e erës, shirat e rrëmbyeshëm, përmbytjet, valët e nxehta dhe të ftohta, thatësitë e zgjatura dhe, si pasojë, mungesa e ujit, janë rritur vitet e fundit dhe kanë pasur si rezultat katastrofa të mëdha anembanë globit. Ndikimi i këtyre ngjarjeve mund të përkeqësohet nga aktivitetet njerëzore, duke përfshirë zhvillimet e pakontrolluara urbane dhe rurale, infrastrukturat dhe ndërtesat e modifikuara keq, apo nga faktorë të tjerë social-ekonomikë dhe njerëzorë, si rritja e shpejtë e popullsisë, rritja e dendësisë së popullsisë në zonat ku rreziku priret të ndikojë dhe ndryshimet drastike në praktikën e përdorimit të tokës. Kështu, shumë qytete dhe popullata janë më të ekspozuara dhe më të prekshme se më parë. Kjo është veçanërisht e rëndësishme për vendet në zhvillim që nuk kanë aftësitë e duhura ripërtëritëse për t'u përballur me fatkeqësitë, veçanërisht kur i nënshtrohen ngjarjeve me probabilitet të ulët por ndikim të madh.

Në disa raste, ndikimi mund të jetë shumë i gjerë dhe përtej të kuptuarit tonë imediat. Për shembull, në vitin 2011, tërmeti Tōhoku, i ndjekur nga një cunam dhe nga një fatkeqësi në një impiant të energjisë bërthamore në Japoninë Lindore, rezultoi me zhvendosjen e më shumë se dyqind mijë njerëzve, me ndërprerje të veprimtarive social-ekonomike në të gjithë vendin. Në kontekstin e një ekonomie globale, efektet e një katastrofe mund të kenë ndikime të rëndësishme në rajonet e ndodhura larg nga vendi i ngjarjes aktuale dhe shumë kohë pas saj. Disa grupe të rrezikuara mund të preken edhe më shumë.

Në vitin 2015, bashkësia ndërkombëtare ra dakord për tri marrëveshje të mëdha: Korniza Sendai "Për reduktimin e rrezikut nga fatkeqësitë 2015-2030"², Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm dhe Marrëveshja e Parisit mbi Ndryshimet Klimatike. Zyra e Kombeve të Bashkuara për Reduktimin e Rrezikut nga Fatkeqësitë (UNISDR) mbajti në janar 2016 në Gjenevë të Zvicrës, Konferencën për Shkencën dhe Teknologjinë në Zbatimin e Kornizës Sendai "Për reduktimin e rrezikut nga fatkeqësitë 2015-2030". Roli i shkencës, teknologjisë dhe kërkimit në dhënien e dëshmive dhe njohurive mbi rreziqet e fatkeqësive dhe si të reduktohen rreziqet, janë theksuar në të gjitha kornizat dhe agjendat kryesore ndërkombëtare dhe rajonale. Shembujt e përpjekjeve të fundit nga IAP-i për të përballuar këto probleme përfshijnë një panel mbi "Këshillat e shkencës në kohën e emergjencave" të organizuar gjatë konferencës së IAP-it në Hermanus të

¹ Kjo deklaratë është një shkrirje, me shtesa dhe rishikime, e Deklaratës së Tokios, Agjendës së Veprimit të Tokios, i propozimit me titull "Nxitja e studimit ndërkombëtar për reduktimin e rrezikut të fatkeqësive dhe aftësisë ripërtëritëse dhe reduktimi i rreziqeve nga fatkeqësitë", dhe i deklaratës së titulluar "Përforcimi i aftësisë ripërtëritëse ndaj katastrofave është thelbësor për zhvillimin e qëndrueshëm". Deklarata e Tokios u miratua në janar të vitit 2015 dhe Agjenda e Veprimit të Tokios u miratua në të njëjtën kohë në Konferencën e Tokios mbi studimin ndërkombëtar për reduktimin e rrezikut dhe aftësinë ripërtëritëse ndaj fatkeqësive. "Nxitja e studimit ndërkombëtar për reduktimin e rrezikut të fatkeqësive dhe aftësisë ripërtëritëse dhe reduktimi i rreziqeve nga fatkeqësitë" u përgatit nga Këshilli Shkencor i Japonisë në shkurt të vitit 2016 dhe "Përforcimi i aftësisë ripërtëritëse ndaj katastrofave është thelbësor për zhvillimin e qëndrueshëm" u botua në prill 2016 si pjesë e Deklaratës së Akademisë të G-Shkencës 2016.

² <http://www.unisdr.org/partners/academia-research/conference/2016/>

Afrikës së Jugut, në fillim të vitit 2016³. Gjithashtu, konferenca e organizuar nga *Accademia Nazionale dei Lincei* - IAP në tetor 2016, "Firenze 1966-2016 - Aftësia ripërtëritëse e qyteteve të artit ndaj katastrofave natyrore: roli i akademive", dëshmoi se ka ende shqetësime të konsiderueshme lidhur me çështjet në këtë fushë⁴.

Shkenca, teknologjia dhe kërkimi në çështjet e lidhura me reduktimin e rrezikut nga fatkeqësitë kanë përparuar dukshëm në të gjitha frontet dhe në të gjithë sektorët. Shkencëtarët dhe hulumtuesit kanë prezantuar një kuadër më të gjerë të rreziqeve, dobësive, rreziqeve të fatkeqësive dhe lidhjeve të tyre me proceset e zhvillimit. Sidoqoftë, ekzistojnë sfida dhe mangësi të vazhdueshme në përkthimin e këtij informacioni shkencor në politikë, në mënyrë që politikatat e reduktimit të rrezikut nga fatkeqësitë të bazohen në shkencë dhe në prova. Duke pasur parasysh ndikimin e fatkeqësive në shoqërinë tonë, është thelbësor shqyrtimi i mundësisë së integritit të shkencave fizike e shoqërore me teknologjinë, për të zvogëluar rreziqet e fatkeqësive dhe ndikimet e tyre.

2. Drejtimet kyçe

Është e nevojshme të zhvillohen strategji për zvogëlimin e rreziqeve të fatkeqësive para ndodhjes së ngjarjeve, të menaxhohen emergjencat tek ndodhin, të sigurohet rikuperimi i mëpasshëm efektiv dhe të rritet aftësia ripërtëritëse. Prandaj, është thelbësore që të ketë veprime të përbashkëta ndërkombëtare për të adresuar:

- zbatimin e njohurive ekzistuese shkencore dhe inxhinierike në praktikën e përgjithshme;
- si duhet ta nxisë shoqëria reduktimin e rrezikut nga fatkeqësitë dhe aftësinë ripërtëritëse;
- si mund t'i mbështesin përpjekje të tilla shoqërore shkenca dhe teknologjia, duke përfshirë praktikatat e mira të bazuara në njohuritë lokale dhe
- metodologjitë për krijimin e kërkesës për siguri dhe integritimin e sigurisë me përfitimet ekonomike.

Për të mbështetur rritjen e aftësisë së shoqërisë për t'u ripërtërirë pas fatkeqësive, është i domosdoshëm veprimi ndërkombëtar i bashkërenduar dhe i koordinuar, për të siguruar të gjithë aktorët, përfshirë politikëbërësit, zbatuesit, ndërmarrjet private dhe grupet e komunitetit, të kuptojnë rreziqet e fatkeqësive dhe të jenë në gjendje të njohin dhe të përdorin njohuritë shkencore dhe teknologjike më të reja që mund të zbatohen. Zvogëlimi i rreziqeve nga fatkeqësitë dhe ndërtimi i një shoqërie të aftë për t'u ripërtërirë është përgjegjësia e përbashkët e të gjithë aktorëve dhe sjell përfitime për të gjithë. Rrjedhimisht, secili vend duhet të zhvillojë një platformë të përbashkët për të gjitha palët e interesuara për të diskutuar këto çështje, duke marrë parasysh nevojën për t'u dhënë palëve të ndryshme të interesit mundësinë e përfshirjes në diskutime me shkencëtarët, në gjuhët lokale. Këto diskutime do të fuqizojnë qytetarët për menaxhimin e rrezikut të fatkeqësive nga komuniteti, duke adresuar sfidat lokale në lidhje me çështjet gjinore, grupet e rrezikuara dhe çështje të tjera. Për shembull, Këshilli i Europës ka njohur dobësinë specifike të personave me aftësi të kufizuara dhe mbrojtjen e tyre ligjore. Shkenca dhe teknologjia mund të ofrojnë zgjidhje inovatore për të rritur aftësinë e tyre ripërtëritëse.

³ <http://www.interacademies.net/News/29857.aspx>

⁴ <http://www.interacademies.net/2952/30966.aspx>

Është thelbësore që qeveritë, subjektet private, agjencitë ndërkombëtare dhe akademitë shkencore të investojnë fonde të nevojshme për rritjen e kapaciteteve të komunitetit shkencor për mbledhjen e të dhënave të kërkuara dhe për zhvillimin e metodologjive për të krijuar qasje të reja mbi integrimin e nevojave të lidhura sociale dhe proceseve fizike, me qëllim që të zvogëlojnë rreziqet e lidhura me shkaqet natyrore. Këto qëllime kërkojnë një qasje ndërdisiplinore që përfshin studiues nga shkencat natyrore, inxhinieria, shkencat mjekësore, shkencat shoqërore dhe shkencat humane, me kontribut të vazhdueshëm nga të gjitha palët e interesuara.

3. Rekomandime

1) Të promovohet dhe të forcohet zhvillimi i një platforme të përbashkët në nivel kombëtar, nëpërmjet së cilës të gjithë aktorët dhe shkencëtarët të kenë dialog të vazhdueshëm në gjuhët lokale dhe të ndihmohen përpjekjet e qeverive dhe qytetarëve në zvogëlimin e rrezikut të fatkeqësive dhe në aftësinë ripërtëritëse, duke krijuar marrëdhënie më të forta përtejdisiplinore dhe ndërdisiplinore.

- Të ngrihet një sistem monitorimi i katastrofave, që të jetë gjithëpërfshirës, me cilësi të lartë dhe të qëndrueshme, me mbështetjen e vëzhgimit të tokës nga hapësira, kur është e përshtatshme, ku të përfshihet një gamë sa më e gjerë burimesh.
- Të kryhen vlerësime të integruara të ndikimeve socio-ekonomike që kanë rreziqet nga fatkeqësitë dhe masat e mundshme për reduktimin e rrezikut të fatkeqësive dhe për aftësinë ripërtëritëse.
- Të përdoren teknologjitë e të dhënave masive (*big data*) dhe të forcohen kapacitetet për përdorimin e tyre në procesin e monitorimit dhe raportimit.
- Të përmirësohet njohja e proceseve dhe historisë së tokës në nivele të ndryshme palësh interesi dhe të përhapen njohuri të qëndrueshme për tokën, atmosferën, oqeanin e për veprimet njerëzore dhe bashkëveprimin e tyre te një audiencë më e gjerë.
- Të përmirësohet edukimi mbi katastrofat duke ofruar arsimim sistematik, si dhe të zhvillohen praktikat e mira dhe qasjet efektive për komunikim dhe edukim të të gjithë aktorëve (palëve të interesit). Trajnimi duhet të përfshijë diskutime rreth grupeve të rrezikuara, duke përfshirë gratë, dhe nevojat e tyre specifike.
- Të hartohen udhëzime për forcimin e platformave kombëtare dhe lokale lidhur me reduktimin e rrezikut nga fatkeqësitë dhe mekanizmat e koordinimit të tyre, nëpërmjet kontributeve nga shkenca dhe nga teknologjia, duke marrë parasysh sistemet tradicionale të njohurive.

2) Lidhur me reduktimin e rrezikut nga fatkeqësitë, një rol i rëndësishëm t'i përcaktohet shkencës që studion katastrofat, inxhinierisë së reduktimit të fatkeqësive, shkencave mjedisore dhe shkencave shoqërore; sidomos sociologjisë, gjeografisë dhe ekonomisë, shkencave shëndetësore, shkencave të tokës, vëzhgimit të tokës dhe fushave të tjera të rëndësishme. Në bashkëpunim, këto fusha duhet të krijojnë një kuadër që siguron përpjekje ndërdisiplinore për rritjen e aftësisë ripërtëritëse të komuniteteve lokale ndaj fatkeqësive.

- Të forcohen lidhjet midis shkencës që studion katastrofat dhe shkencës së mjedisit për të përmirësuar menaxhimin e rrezikut dhe për të negociuar hendekun midis urgjencës kohore dhe asaj politike për reduktimin e rreziqeve nga fatkeqësitë dhe kërcënimet mjedisore në mënyrë gjithëpërfshirëse.
- Të zhvillohen metoda dhe materiale më të mira inxhinierike për përmirësimin e

sigurisë së strukturave, duke përfshirë dhe megastrukturat. Gjithashtu, të ripërpunohen dhe të forcohen sa më shpejt të jetë e mundur strukturat ekzistuese të rrezikuara.

- Të zhvillohet një sistem i menaxhimit shëndetësor për të siguruar shëndetin dhe kushtet mendore të qytetarëve gjatë gjithë procesit të paskatastrofës, që nga përpjekjet e shpëtimit emergjent deri te rehabilitimi dhe rindërtimi.
- Të sigurohet informacioni që lehtëson investimet në rast fatkeqësish, të nevojshme për ndërtimin e një shoqërie të aftë për t'u ripërtërirë, dhe të informohen qytetarët për rreziqet e fatkeqësive, bazuar në paralajmërimin në kohë dhe në lokalizimin e rreziqeve.
- Të zhvillohen sisteme portabël paralajmërimi dhe reagimi, të përdorshme nga komuniteti, të zbatueshme për raste të tilla, si: rrëshqitjet e tokës, përmytjet etj., të cilat janë të shpeshta në shumë lokalitete.
- Të zhvillohen procedurat standarde të operimit për këshillimin shkencor, inputet dhe komunikimet në kohën e situatave emergjente në rast fatkeqësish.
- Të kuptohen shkaqet dhe nxitësit kryesorë të fatkeqësive përmes studimeve të detajuara të ngjarjeve, mësimave të nxjerra, sukseseve dhe dështimeve, për të nxitur menaxhimin e qëndrueshëm dhe reduktimin e rrezikut nëpërmjet kërkimeve të bazuara në dëshmi dhe prova.

3) Të nxiten kërkimet shkencore dhe teknologjike në nivel lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar për krijimin e platformave kombëtare gjithëpërfshirëse, efektive dhe të qëndrueshme në funksion të përpjekjeve për reduktimin e rrezikut të fatkeqësive dhe për aftësitë ripërtëritëse nëpërmjet bashkëpunimit ndërdisiplinor.

- Të themelohet dhe të zbatohet një sistem institucional në të gjitha nivelet, që siguron vendimmarrje mbi menaxhimin e katastrofave, bazuar në njohuri shkencore, të tilla si vlerësimi i detyrueshëm i ndikimit të rrezikut, duke përfshirë rolin e shkencës dhe teknologjisë në monitorimin, matjen, parashikimin, modelimin dhe zbutjen e rreziqeve të katastrofave para çdo lejeje zhvillimi.
- Të kryhet rregullisht sintetizimi i konsoliduar dhe i integruar i studimeve të katastrofave në shkallë globale.
- Të krijohen funksione të konsultimit ndërkombëtar, përmes të cilit komuniteti i shkencës dhe teknologjisë të ofrojë këshilla profesionale për mbështetjen e veprimtarive në shkallë lokale të zvogëlimit të rrezikut, duke marrë parasysh karakteristikat e ndryshme lokale.
- Të nxitet përdorimi efektiv i të dhënave të reja shkencore të fatkeqësive që vijnë nga projektet kërkimore, veçanërisht në vendet në zhvillim.
- Të ndahen e të shkëmbehen mes vendeve përvojat mbi zbatimin e zbulimit të të dhënave masive të hapura, të të dhënave gjeohapësinore të ndërveprimit dhe infrastrukturës, lidhur me vlerësimin e rrezikut të fatkeqësisë dhe elasticitetit.
- Të koordinohen më mirë rrjetet ekzistuese dhe institucionet kërkimore-shkencore në të gjitha nivelet dhe në të gjitha rajonet për të çuar përpara zvogëlimin e rrezikut nga katastrofat.
- Të zhvillohen metoda metrike të përshtatshme, në mënyrë që vendet të mund të dokumentojnë dhe të monitorojnë progresin dhe përmirësimet e tyre.

4) Për zbatimin efektiv të njohurive ekzistuese në procesin e zhvillimit dhe në jetën e përditshme të njerëzve, ne duhet të krijojmë shkencë të orientuar nga kërkesa për

sigurinë, veçanërisht në vendet në zhvillim ku siguria nuk është domosdoshmërisht një prioritet i madh për qeverinë apo për publikun. Krijimi i kërkesës mund të bëhet përmes:

- Përmirësimin e sistemit të komunikimit mbi rrezikun, duke e kthyer në një të mirë publike kërkesën e njerëzve për strehim të sigurt, qytete të sigurta, infrastrukturë të sigurt, energji të besueshme, menaxhim të mirë të ujit dhe ajër të pastër.
- Përkthimin e kërkesës për siguri në një përfitim ekonomik dhe integrimi i sigurisë me stimujt për rritje të përfitimeve ekonomike.
- Zbatimin e kodeve të ndërtimit, standardeve të sigurisë dhe rregulloreve të përdorimit të tokës, dhe marrjes së masave të vogla dhe të përballeshme për të garantuar siguri, siç është zhvillimi i standardeve për vlerësimin dhe renditjen e ndërtesave për cilësinë dhe sigurinë.

II. RAPORTIMI I PARAQITUR NË ANALIZËN VJETORE TË SSHSHA

1. Një vështrim i përgjithshëm

Viti 2017 qe një vit anormal për Akademinë e Shkencave (ASH) dhe për Seksionin e Shkencave Shoqërore dhe Albanologjike (SSHSHA). Probleme të shumta, të bartura vit pas viti, u shfaqën në formën e pamundësisë për të vazhduar si më parë. Këto probleme e kanë burimin tek dështimi i disa nismave të qeverisjes për një reformë ligjore në ASH nga njëra anë dhe tek mungesa e vështrimeve perspektive në vetë institucionin tonë.

Sa u takon dështimeve të nismave reformuese përmendim këto:

1. Dokumenti i propozuar nga *komisioni Milo*, i ngritur me urdhër të Kryeministrit, u vlerësua si i pamjaftueshëm për një reformë institucionale.
2. Pas kësaj reforma në ASH u bë pjesë e ligjit për arsimin e lartë. Në dy rinde këshillimi me institucionet që duhej të ishin pjesë e fushës së veprimit të tij, duke përfshirë ASH, ky ligj premtonte qysh në titull se do të zgjidhte problemet e reformës *në arsim dhe në shkencë*. Në mënyrë të papritur dhe të pashpjeguar, në variantin e tretë mbeti si pjesë e veprimit këtij ligji vetëm kërkimi shkencor në universitete. Kjo bëri të detyrueshme hartimin e një ligji më vete për shkencën, duke shkaktuar një vonesë të re.
3. Për zgjidhjen e problemeve të krizës juridike-institucionale, në kuadër të nismave shtetërore për një reformë të thellë institucionale e administrative në gjithë rrjetin e institucioneve shkencore jashtë fushës së veprimit të ligjit për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në universitete, u ngrit një tjetër komision, i cili u mblodh për herë të fundit në prill të vitit të kaluar, pa arritur të propozojë një zgjidhje me karakter ligjor.
4. Vetë Kryesia e ASH, duke e kuptuar reformën vetëm në formën e pyetjes nëse ajo do të kishte edhe më tej institucione në vartësi apo jo, qendroi në pritje dhe nuk ndërmoi hapat që kërkonte urgjenca e situatës. Qendrimet kritike ndaj saj u shtuan jo vetëm nga Qeveria, por edhe nga vetë bashkësia e studiuesve shqiptarë, brenda e jashtë vendit.
5. Në shtator të vitit të kaluar, pas dështimit të zgjedhjeve të reja për kryesinë e ASH, krizave të mëparshme iu shtua edhe *kriza e përfaqësimit*.

Disa përpjekje për hapje, përgjegjësi dhe transparencë në kuadër të legjislacionit ekzistues, duke amenduar disa pjesë të Statutit, nuk mundën ta ndryshojnë gjendjen. U krijua një bindje e përgjithshme se ASH nuk është në gjendje të ndryshojë vetveten, ose nuk dëshiron të preket nga ndryshimet. Marrëdhëniet mes ASH dhe administratës shtetërore shkuan deri në atë shkallë sa të lindte nevoja për krijimin e një *komiteti mirëbesimi*, që do të mundësonte rivendosjen e dialogut mes palëve. (shih: http://akad.gov.al/ash/pdf/VENDIM%20NR_1_DT_18%20JANAR%202018%20ASAMBLEJA.pdf)

6. Për më shumë se një gjysmë viti Qeveria dhe ASH dialoguan vetëm në mënyrë deklarative përmes shtypit. Me përjashtim të ndonjë zëri të veçuar, ASH arriti në pikën që *t'i kishte të gjithë kundër*. Kjo prirje u intensifikua edhe nga fakti se diskutimet në *komisionin Shtino*, ku ASH përfaqësohej nga kryetari i saj akad. Korkuti, mbetën të

mbyllura dhe nuk iu ofruan as seksioneve dhe as Asamblesë për marrje mendimi. (shih: http://akad.gov.al/ash/pdf/urdher_nr.297_dt.1.6.2016.pdf)

I vetmi dokument për të cilin i është kërkuar mendim SSHSHA është një skemë me tri variante të mundshme të rregullimit administrativ të rrjetit të institucioneve kërkimore-shkencore jashtë universiteteve.

7. Për shumë shkaqe, duke përfshirë ndarjen nga jeta të figurave më të rëndësishme të albanologjisë, që e varfëroi jashtë mase SSHSHA; por mbi të gjitha për shkak të përtëritjes së ngadaltë të anëtarësisë së Asamblesë, ASH iu shfaq opinioneve si një institucion i mbyllur dhe i plakur. Përpjekja për të bërë ndryshime në Statut, me qëllim që ASH të hapej ndaj bashkësisë shkencore dhe të rivendoste lidhjet me disa breza dijetarësh të mbetur pa përfaqësim brenda saj (përpjekje në të cilën kontribuuan kryesisht anëtarë të SSHSHA) gjeti kundërshti dhe gjendja nuk ndryshoi.
8. Në gjithë këtë situatë tejet të rënduar, për shkak të krizave të mbivendosura, sidomos të mjegullimit të së ardhmes, anëtarë të SSHSHA kanë kontribuar me propozime konkrete për ndryshim paraqitur brenda në seksion dhe në Asamble e më pas edhe në shtyp. Këtu veçojmë angazhimin e veçantë të akad. A. Fugës në përcaktimin e problematikave të funksionimit të Akademisë së Shkencave, propozimet konkrete për reformën në Akademi, ç'ka ndikoi që të kalohej nga diagnostikimi i gjendjes drejt përpjekjeve për të reaguuar. Një pjesë e madhe e propozimeve të tij dhe të kolegëve të tjerë janë bërë tashmë pjesë e dokumenteve që po përgatiten për një zgjidhje rrënjësore të reformës, ku përfshihen: ligji i ri për ASH, Statuti dhe rregullat procedurale për pranime të hapura dhe konkurruese në Asamble dhe për zgjedhjen e drejtuesve të saj. Në këtë projekt, si dhe në Statut, gjejmë shprehje një shumicë propozimesh të akad. A. Fugës, që kanë të bëjnë me hapjen e ASH ndaj botës shkencore, me decentralizimin e përgjegjësisë, me transparencën e konkurrimit, me auditimin e buxhetit, me përtëritjen dhe ndryshimin e strukturës së Asamblesë, me rivendosjen e lidhjeve me të rinjtë, me mendësinë e drejtimit dhe sidomos me aftësimin për të punuar me të tjerët, duke hequr dorë prej qëllimeve të porealizueshme, që e kanë paraqitur ASH si institucionin kryesor të kërkimit shkencor.
9. Në përpjekje për vetëreformim Asambleja krijoi një *komision ad hoc*, që duhej të përgatiste e t'i propozonte Qeverisë një dokument reforme të pranueshëm. Me të drejtë u vendos që në këtë komision të mos përfshihej asnjë nga akademikët me detyra drejtuese, që nga SSHSHA është respektuar (por jo dhe seksioni tjetër, SSHNT). Në *komisionin ad hoc* gjithashtu pjesa më e madhe e kontribuesve janë nga SSHSHA. (shih: <http://akad.gov.al/ash/pdf/VENDIMI%20I%20ASAMBLESE%20PER%20KOMISIONIN.pdf>)
10. Detyra e komisionit të mirëbesimit u përfundua me arritjen e një marrëveshjeje që projekt-ligji për ASH të hartohej prej një grupi pune me përbërje mikste, nga MAS dhe ASH. Në krye të këtij komisioni, MAS caktoi akad. Skënder Gjinushin, ndërsa anëtarët e tij janë të gjithë nga SSHSHA. Pas diskutimeve me anëtarët e Asamblesë, me bashkësinë e studiuesve në universitete dhe të qendrave kërkimore si dhe të *Akademisë së të Rinjve*, tashmë një projekt-ligj është hartuar. Në projekt-ligj, thuhet se është ripërkufizuar statusi dhe janë ripërcaktuar funksionet e ASH, por kërkojmë që, në formën që është arritur ky Projekt-ligj duhet të bëhet i njohur për seksionet dhe anëtarët e Asamblesë.

Në rethanat kur Statuti ishte kthye në një mur që ndante ASH nga bota shkencore, u ndërmorën disa hapa, gjithashtu të propozuar nga anëtarët e SSHSHA. të cilat shërbyen si sinjale për një vullnet hapjeje dhe afrimi me brezat e rinj. Përmendim ndër to:

1. Krijimin e *Akademisë së të Rinjve*, me statusin e një forumi, në përputhje me dokumentin rekomandues të Asamblesë së Përgjithshme të ALLEA-s (Vienë, maj 2016). *Akademia e të Rinjve* u anëtarësua shumë shpejt në *Young World Academy* dhe sot është anëtare e saj. Gjatë vitit 2017 mund të konsiderohet si e vetmja nismë e përshëndetur nga autoritetet qeverisëse. (shih: <https://globalyoungacademy.net/national-young-academies/>)
2. Themelimin e çmimeve të mëdha shkencore (shih: <http://akad.gov.al/ash/2016-10-06-11-54-37/cmime-2017>), që, përveç afrimit të studiuesve të suksesshëm nga jashtë ASH, konsolidoi *traditën e ligjëratave akademike*, një format shumë i suksesshëm komunikimi, që, sikurse dihet, do të jetë gjithashtu forma më e rëndësishme e veprimit shkencor për Vitin e Gjergj Kastriotit - Skënderbeut, përcaktuar si *lectio magistralis*.
3. Miratimin formal të *kodit europian të deontologjisë shkencore*, në një përpjekje për të forcuar rolin institucional për mbrojtjen e kërimit shkencor nga plagjiatura, sido që ky kod ishte i detyrueshëm për ne nga fakti se ASH është anëtare e ALLEA-s dhe rrjedhimisht dhe zbatuese vullnetare e akteve të miratuara prej saj. (shih: <http://akad.gov.al/ash/kodi-europian>)

Pozitive është se ky kod po plotësohet e po përshtatet për kushtet e vendit tonë, me qëllim që të mos jetë vetëm një *rregullator etik*, por dhe *standard i detyrueshëm ligjor*. Në këtë proces janë angazhuar kryesisht anëtarë të SSHSHA. Ndër të tjera, është propozuar edhe *krijimi i një kolegji kombëtar të etikës*, me të drejtë vendimmarrjeje të apeluashme në një gjykatë penaltetesh. E theksojmë këtë sepse me të drejtë nga anëtarët e SSHSHA është kërkuar me këmbëngulje të identifikohet përgjegjësia institucionale dhe funksionale e ASH për mbrojtjen e shkencës nga plagjiatura. Me këtë akt do të jetë e nevojshme që me ligj të parashikohet edhe kjo detyrë e saj.

4. Një hap pozitiv është këshillimi i projektit me Kryesinë e Akademisë *Leopoldina*, që është ngarkuar me detyrat për shkencën në dokumentin e *Procesit të Berlinit*; si dhe marrja e opionencave me shkrim prej saj dhe prej ekspertëve të ALLEA-s. (shih: http://akad.gov.al/ash/pdf/Letter_ALLEA_ASA_Draft_Law_20180307%20dt.%207%20mars%20pas%20takimit%20në%20Berlin.pdf)

Akademia Çeke e Shkencave, pas vizitës së kryetares së saj akad. Zažimalova në Tiranë, përcolli shqetësimet tona në akademitë e rajonit. Mund të konsiderohet se me këtë hap projekti është eurokodifikuar. Afati i paracaktuar do të zbatohet. Paralelisht është punuar për Statutin dhe rregulloren e procedurave të pranimeve të reja dhe të zgjedhjes në detyra drejtuese.

2. Detyra të tjera që ka përballuar SSHSHA:

1. Anëtarë të seksionit kanë kontribuar për plotësimin e paketës juridike të *vetting*-ut, me cilësinë e ekspertëve të ftuar.
2. SSHSHA lloboi me sukses dhe mbrojti propozimin për pranimin e ASHAK-ut në Unionin Ndërkombëtar të Akademive (Tokio 2017).
3. Në bashkëpunim me sektorin e marrëdhënieve me jashtë, SSHSHA ka synuar të mbajë e fuqizojë lidhjet bashkëpunuese me seksionet përkatëse të institucioneve akademike të rajonit (Kosovë, Maqedoni, Bullgari, Mali i Zi, Poloni etj.).

4. SSHSHA ringriti komisionin shtetëror të *Atlas Linguistic of Europe (ALE)*, që kishte pushuar së funksionuari prej katër vjetësh.
5. SSHSHA ka mbajtur peshë për hapjen ndaj institucioneve akademike e universitare jashtë vendit, sidomos me qendrat e albanologjisë, duke u bërë iniciator për rivendosje kontaktesh e bashkëpunim.
6. SSHSHA, me nismën e vet, organizoi një varg ligjëratash akademike me specialistë në fusha të ndryshme të albanologjisë jashtë institucionit.
7. Nga ky seksion u përgatit dhe u propozua VKM për shpalljen e Vitit të Gjergj Kastriotit – Skënderbeut.

3. Kontribute në projekte kombëtare e ndërkombëtare për nisma dhe përmirësime ligjore, drafte, konsulencë e ekspertizë.

1. Akad. Aurela Anastasi. Eksperte e nivelit të lartë të projektit për *Reformën në Drejtësi* pranë Kuvendit të Republikës së Shqipërisë. Referimi në 12 konferenca rajonale për njohjen e publikut me ndryshimet Kushtetuese, 5 nga të cilat në universitet e Vlorës, Shkodrës dhe Durrësit; informacioni mund të gjendet në: <http://reformanedrejttesi.al/aktivitetet>.
2. Akad. Kosta Barjaba. *Policy Paper and Action Plan on the engagement of the Albanian Communities Abroad in development initiatives of Albania*, projekt (studim) përgatitur për Organizatën Ndërkombëtare të Migracionit, IOM, dhe Qeverinë e Shqipërisë.
3. Projekti legjislativ për reformën në shkencë. Për këtë projekt u ngrit një komision ndër-institucional, pranë MAS. ASHSH u përfaqësua në këtë komision nga kryetari i saj akad. Muzafer Korkuti. SSHSHA paraqiti pikëpamjet e veta në formën e një përkujtese pas diskutimit të rezultatit përfundimtar të shprehur në tri zgjidhjet e mundshme
4. Akad. asoc. Shaban Sinani. Hartues i projektit të VKM për *përdorimin e gjuhës shqipe në funksione zyrtare*.
5. Akad. asoc. Shaban Sinani. Kontribut për hartimin e projektit të VKM për shpalljen e vitit 2017 “Viti i Gjergj Kastriotit-Skënderbeut”.

4. Konferenca

Viti 2017 ka qenë viti i organizimit të disa konferencave, kombëtare e ndërkombëtare, si dhe i disa veprimtarive solemne kushtuar ngjarjeve dhe personaliteteve të shquar të shkencave albanologjike, si:

1. Konferenca shkencore ndërkombëtare ***Qytetërimi i Voskopojës dhe shekulli i iluminizmit në Ballkan*** në 250-vjetorin e lulëzimit të këtij qyteti, (1767-2017), e cila u mbajt më 13-14 nëntor 2017 (Tiranë - Voskopojë), me studiues të arshur nga Kosova, Greqia, Maqedonia, Mali i Zi, Bullgaria, Rumania, Italia etj. Konferenca pati për qëllim të ndriçojë fenomenin e Voskopojës në dritën e koncepteve bashkëkohore të eurokulturës dhe të *receptimit empatik të tjetrit*, e u orientua në disa tema kuadër. Konferenca i zhvilloi punimet në dy ditë, në Tiranë më 13 nëntor dhe në Voskopojë më 14 nëntor. Gjatë ditës së dytë prof. Aurel Plasari mbajti një ligjëratë rreth koleksionit me dokumente dhe burime historike për Voskopojën, i pasqyruar edhe me një dokumentar.

2. Konferenca ndërkombëtare, në bashkëpunim me ASHAK-un: ***Studimet albanistike në vendet ku flitet gjermanisht*** (Prishtinë, 26-27 10.2017).

3. Konferencë shkencore ndërkombëtare **Risi arkeologjike nga trevat shqiptare** (30-31 janar 2017), organizuar nga Akademia e Shkencave dhe Instituti i Arkeologjisë. U prezantun zbulimet më të fundit arkeologjike të mbarë trevave ku jetojnë shqiptarët, që nga shekulli i 6-të para Krishtit në trevat e Ilirisë e më gjerë. Në këtë konferencë u paraqiten kumtesa nga 62 autorë vendas dhe të huaj: nga Gjermania, Italia, Franca etj., si dhe nga rajoni i Ballkanit: Mali i Zi, Maqedonia, Kosova etj.

4. Forum i hapur: prezantim i botimit **Antropologji e Kanunit**, i studiuesit Nebi Bardhoshi, nominuar për çmimin *Kërkuesi i ri më i suksesshëm*, në edicionin I të konkursit shkencor të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë.

5. Prezantim i librit **Arbërit e Jonit** i prof. Pëllumb Xhufit, fitues i çmimit *Çabej*, në edicionin I të konkursit shkencor të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, organizuar në sallën “Aleks Buda”, të Akademisë së Shkencave (30 maj 2017).

6. Pas nominimit të veprës **Thimi Mitko: Fjalëtore gërqisht-shqip dhe ndihmesa të tjera leksikografike**, për çmimin *Çabej*, në edicionin I të konkursit shkencor të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, prof. Dhori Qirjazi vjen para studiuesve, akademikve, profesorëve e studentëve të shkencave filologjike, me ligjëratën e hapur *Mitkologji dhe ballkanologji: “Fjalëtoret”, arkivi i Ali Pashës dhe “tekstet shqiptare” të H. Pedersenit*. Prezantimi u mbështet në burime e fakte të reja (2 qershor 2017).

7. Ligjëratë e hapur **Katërngjillëshi i dekoruar i Korçës** (Kodiku i Korçës), me autorë Andi Rëmbecin dhe Sokol Çungën, fitues të çmimit *Kërkuesi i ri më i suksesshëm*, në edicionin I të konkursit shkencor të ASH (5 qershor 2017).

8. Ligjëratë e hapur: **Një 80-vjetor i akademizmit albanologjik në Shqipëri**, nga prof. Aurel Plasari, në sallën “Aleks Buda” të ASH, në prani të një grupi profesorësh e studiuesish, kryesisht të fushave albanologjike (19 nëntor 2017).

9. Konferencë shkencore ndërkombëtare **Mapping Balkan routes: literary, cultural and linguistic landscapes, International Conference on Balkan Studies**, organizuar nga Universiteti i Vlorës, Universiteti i Beogradit dhe ASH.

10. Konferencë jubilarë **Androkli Kostallari figurë e shquar e albanologjisë shqiptare**, me rastin e 95-vjetorit të lindjes, organizuar prej Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe Shoqatës së Gjuhësisë Shqiptare (7 nëntor 2017).

11. Konferenca shkencore jubilarë **Rexhep Ismajli në 70-vjetorin e lindjes**, organizuar nga Akademia e Shkencave e Shqipërisë në bashkëpunim me Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, e mbajtur më 8 qershor 2017 në sallën “Aleks Buda”.

12. Takim shkencor jubilar **20-vjet revista kulturore shkencore “Perla”**, bashkëpunim i Akademisë së Shkencave me Ambasadën e Republikës Islamike të Iranit dhe Fondacionin kulturor “Saadi Shirazi” (10 nëntor 2017).

13. Konferencë shkencore **Mitrush Kuteli, në 110-vjetorin e lindjes**, organizuar nga Akademia e Shkencave dhe Universiteti i Korçës.

14. Konferenca shkencore **Studiuesi Rexhep Qosja dhe vepra e tij**, organizuar nga Universiteti i Gjirokastrës, ASA dhe ASH, mblodhi në Gjirokastër një numër të madh akademikësh, studiues e kritikë, të cilët mbajtën referata e kumtesa të ndryshme në lidhje me veprimtarinë e gjatë të akademikut R. Qosja (30 tetor 2017).

15. Konferencë shkencore **Personaliteti shkencor i akademik Jorgo Bulos**, organizuar nga Universiteti i Gjirokastrës dhe ASH.

16. Konferencë jubilarë **Prenkë Jakova në 100-vjetorin e lindjes** organizuar nga ASH në bashkëpunim me Universitetin e Arteve (9 qershor 2017). Kumtesat e mbajtura nga

pspecialistë të fushës nxorën në pah origjinalitetin e veprave të tij si një kompozitor me origjinalitet thellësisht shqiptar dhe vlera të çmueshme në muzikën shqiptare.

17. Promovimi i botimeve *Tefta Tashko Koço dhe bashkëkohësit e saj në imazhe* dhe *Libërth me dorëshkrime këngësh (1936-1945)* në kuadrin e 70-vjetorit të ndarjes nga jeta të sopranos Tefta Tashko Koço, u organizuan nga ASH në bashkëpunim Këshillin e Muzikës Shqiptare, më 2 nëntor 2017.

18. Janë bërë disa paraqitje të botimeve shkencore nga fusha e historisë, arkeologjisë, ekonomisë etj., të anëtarëve të ASHSH dhe të bashkëpunëtorëve të saj, në mjediset e ASH, të ASHAK, në panairë të librit etj.

5. BOTIMET

Gjatë vitit 2017 këshilli i botimeve miratoi mbështetjen me buxhet të ASH të 21 titujve, nga të cilët 14 nga fushat që mbulon SSSHSHA.

1. Androkli Kostallari, *Vepra III - Fjalëformimi dhe leksikografia* (540 f.), dhe *Vepra IV - Çështje të filologjisë shqiptare* (576 f). Vëllimi përmban 13 studime e shkrime nga dy fushat kryesore fjalëformimi dhe leksikografia. Ndërsa në veprën IV “Çështje të filologjisë shqiptare”, ku janë përmbledhur 27 punime studimore që rrokin të trajtojnë çështje e problematika me interes në fushën e filologjisë shqiptare, të gjuhës e të letërsisë, të onomastikës e posaçërisht të kulturës së gjuhës të prof. Androkli Kostallarit.

2. Shaban Demiraj - *Histori e gjuhës së shkruar shqipe* (f. 130), Në libër hasim qasjen historiko-krahasuese përmes së cilës prof. Shaban Demiraj studioi dukuri të dukshme dhe të padukshme të gjuhës shqipe me synimin për të nxjerrë në dritë, në rrafshin sinkronik dhe diakronik, veçantitë funksionale fonomorfologjike dhe kompleksin strukturor të saj.

3. Dhimitër S. Shuteriqi - *Fjalor i Naim Frashërit* (f. 450). Vepra është jo vetëm burim të dhënash për leksikun e frazeologjinë e Naimit, por edhe burim të dhënash shkencore, mundësi referimesh për studime të mëtejshme gjuhësore, përmes krahasimesh me autorë bashkëkohorë, si Kristoforishi, Samiu, Vreto, Pasho Vasa etj. ose me studimet e disa albanologëve të huaj, si Xylander, Hahn, Dozon, nga autorë bejtexhinj e nga më të vjetrit veprat e Buzukut, Matrëngës, të Budit, të Bogdanit etj.

4. Apollon Baçe - *Arkitektura civile ilire* (f. 650) vjen në një kohë kur mungojnë studimet analitike dhe sintetike për këtë problem në shkencën e albanologjisë. Në këtë monografi i është kushtuar një analizë e thellë çështjeve të arkitekturës, historisë antike, kulturës materiale dhe toponimisë antike të trevave ilire. Punimi mbart dhe një material ilustrativ, pa të cilin analiza e shembujve do të mbetet abstrakte.

5. Gjovalin Shkurtaj - *F. A. Santori - Satira* (f. 270). Vepra e zbuluar disa vite më parë (1979), e transliteruar dhe pajisur me shënime të shumta nga prof. Shkurtaj e poeti dhe studiuesi arbëresh K. Kandreva, vjen i plotësuar dhe i pasuruar me shënime, sjell prurje me vlerë filologjike e dialektologjike prej të folmeve arbëreshe dhe të dialekteve të shqipes.

6. Luan Omari - *Çështje juridike shoqërore* (f. 690) përmban studime, trajtesa, propozime për çështje kushtetutshmërie dhe ligjshmërie në një vështrim më të gjerë në Shqipërinë e pas viteve 1990, pa përjashtuar qasjet prapavajtëse për zhvillime të mëhershme në këto fusha.

7. Kristaq Prifti - *Gjenocidi dhe komplotet antishqiptare të serbomëdhenjve* (f. 400). Ky botim u bën të njohur studiuesve dhe publikut të gjerë, se situata në viset që iu shkëputën Shqipërisë më 1913, aspiratat e shqiptarëve të atjeshëm dhe perspektivat mbeten gjithnjë probleme aktuale.

8. Shaban Sinani - *Hieronimi: në botën arbëreshe* (f. 444). Duke përdorur në mënyrë jokonvencionale teknikat metodologjike të shkollave të ndryshme, libri shfaqet në formën e tij shumëkëndëshe si një refleksion organik i një periudhe të gjatë historike (shek XVIII-shek. XX). Studimi përmban analiza të drejtuara metodologjikisht drejt ekdotikës dhe kritikës letrare, dhe drejt antropologjisë kulturore dhe kulturologjisë.

9. Bashkim Kuçuku - *Kadare në kritikën botërore* (vëll. I-II, f. 2000). Ky libër është i pari i këtij lloji, që, në origjinalin e 12 gjuhëve sjell pjesën më të madhe të shkrimeve dhe studimeve të kritikës botërore për veprën e Ismail Kadaresë, të shkruara nga studiues të fushave të ndryshme letrare, kulturore, antropologjike, profesorë, akademikë, shkrimtarë, të botuara në shtypin e përditshëm dhe periodik, në revista të specializuara në frëngjisht, gjermanisht, anglisht, spanjisht, italisht, portugalisht, suedisht, holandisht, danisht, norvegjisht, finlandisht etj. Libri paraprihet nga një studim hyrës 15-20 faqe, i cili do të jetë shqip dhe frëngjisht, për të qenë në harmoni me lëndën e përgjithshme, dhe për të hyrë në biblioteka të huaja akademike dhe universitare, që është edhe një nga qëllimet kryesore të këtij botimi.

10. Thoma Murzaku - *Koha kur u caktuan kufijtë e Shqipërisë (1912-1914)* (776 f.). Ky studim shkencor trajton një moment shumë të rëndësishëm të historisë shtetërore e kombëtare të shqiptarëve. Autori ka shfrytëzuar rreth 11 arkiva shqiptare dhe të huaja dhe rreth 30 volume me dokumente historike, një literaturë të gjerë historiografike. duke realizuar një studim autentik, me analiza dhe argumente të reja shkencore.

11. Vasil S. Tole - *"EP" për orkestër simfonike* (partitura, f. 70) Vepra është kompozimi origjinal për orkestër simfonike i prof. V. S. Toles. Në këtë vepër ndjehet *ndërlidhja profesionale e autorit me traditën muzikore të Shqipërisë, e posaçërisht* riinterpretimi që ai i bën në rrugë bashkëkohore këtyre vlerave të trashëgimisë muzikore shpirtërore.

12. Albana Velianj - *Rite dhe simbole në dasmën tradicionale shqiptare* (f. 250). përmban prurje të spikatura për ritualin e dasmës tradicionale shqiptare, duke i çuar studimet në një stad të ri.

6. Çështje të diskutuara gjatë analizës së SSHSHA

1. Diskutimi themelor mbetet roli që duhet t'i jepet Akademisë si një institucion i pavarur me specialistë nga shumë fusha të albanologjisë, për të qenë një agjent i jashtëm i shtetit, i shoqërisë, i Qeverisë etj. Prej saj duhet të priten rekomandime për nivelin e studimeve, për problematikat e tyre, për përafrimin e standardeve tona në unifikim me standardet e BE-së dhe të vendeve të përparuara.

2. Akademia duhet të bëjë pasqyrimin e gjendjes me raporte publike, jo me raporte burokratike. Seksioni ka bërë propozime, të cilat nuk janë marrë fare në konsideratë nga komisioni që ishte ngritur nga qeveria.

3. Sugjerohet që, si seksion, duhet t'i propozojmë Kryesisë së Akademisë që në ditët e ardhshme të ngremë një grup pune, i cili të hartojë një projekt lidhur me rritjen e nivelit shkencor në shkencat sociale dhe albanologjike. Ky raport mund të kërkojë një vit, apo dy vjet studime, sa të jetë e nevojshme. Të angazhojmë dhe specialistë të tjerë siç do ta mendojmë e miratojmë këtu në Seksion dhe ta marrim vetë iniciativën. Duke mos qenë institucion kërkimor Akademia duhet të marrë përsipër studimin e problematikave të zhvillimit të shkencave shoqërore dhe albanologjike.

4. Të parashikojmë një studim, i cili të rrokë fushat që përfshin seksioni. Një grup i zgjedhure duhet të evidentojë problemet, për të dalë me propozimet konkrete. Një projekt i tillë, në të gjitha fushat albanologjike, do krijojë mundësinë t'i drejtohem me qëndrim të qartë instancave të larta, prej të cilave varet Akademia.

5. U shpreh qëndrim kritik nga drejtuesja e seksionit se përveç forumeve që ka organizuar akad. K. Barjaba (me mbështetjen e seksionit) nuk janë bërë propozime për konferenca, tryeza diskutimi mbi problematika të fushave që përfaqëson secili. Kjo mbetet një detyrim shkencor për periudhën në vazhdim.

6. U shpreh një mendim se Seksioni ynë është shumë i gjerë në fusha. Ndoshta do ishte më frytdhënëse ndarja në dy departamente: gjuhë-letërsia më vete, studimet historike, sociale, ekonomike më vete (siç janë në ASHAK).

7. Një nga problemet themelore për të cilat duhet të angazhohet është ndërmarrja e një studimi mbi gjendjen e gjuhës shqipe sot. Kjo kërkon bashkëpunim me Institutin e Gjuhësisë, me Universitetet.

8. Në studimin që duhet të bëjmë, me Akademinë e reformuar, të dalim me propozimin që qendra e gravitetit të zhvendoset nga Asambleja në seksion, i cili ka mundësi të marrë përsipër me përgjegjësi më shumë kompetenca e më shumë kontribute edhe duke ndërtuar edhe instrumentet. P.sh., duhet të biem dakord që çdo seksion të ketë komisionet e veta të fushave disiplinore, ndërdisiplinore, të cilat janë më të ngushta se fushat që mbulon seksioni dhe për komisionet të vendosim bashkërisht. Në përbërje të komisioneve të ftohen jo vetëm anëtarë të Akademisë, por edhe përfaqësues nga komuniteti shkencor i vendit, nga universitetet, nga qendrat e kërkimit, nga sektori privat, pra nga të gjithë aktorët që janë në tregun e prodhimit shkencor. Kjo do të ndihmojë që jo vetëm qendra e gravitetit të vendoset në seksion, por dhe vetë anëtarët e Akademisë do të jenë bërthama e një strukture më të gjerë. Edhe seksioni merr më shumë rol e kontribut edhe çdo akademik merr më shumë përgjegjësi dhe vetë Akademia ndërlidhet më mirë me pjesën tjetër të komunitetit shkencor.

9. U shpreh mendimi se ka mungesë informacioni, censurë për përhapjen e tij, me dashje apo pa dashje. Akad. A. Fuga deklaroi se nëse komisioni i Akademisë nuk funksionin, do të japë dorëheqjen. Komisionet punojnë në mënyrë opake, të mbyllura pa marrë opinionin e Asamblesë, që po fle. Sipas tij Sekretari i përgjithshëm duhet të mbledhë menjëherë Asamblenë dhe të pajisë me mandate dhe jo me kontribute personale përfaqësuesit atje. Të thërresë kryetarin dhe anëtarët e komisionit *ad hoc* e t'i pyesë pse nuk po punojnë, në mos t'i ndërrojmë. Këtë mendim e mbështeti dhe akad. B. Meta, sipas të cilit ky komision i Asamblesë mund të dalë me variantin e vet të projekt-reformës.

10. Duhet të ketë kritere të rrepta për miratimin e veprave për botim. Gjithashtu edhe për organizimin e konferencave të ndryshme nga Akademia e Shkencave.

11. *Fjalori i drejtshkrimit*, për të cilin sot ka shumë nevojë, është botuar vetëm dy herë; në një rast kemi botim me konflikt interesi. Gjithashtu tenderin e botimit të veprave të Akademisë të mos e fitojë disa vjet rresht një shtëpi botuese. Pati mendim personal edhe që që të mos ketë këshill botimi dhe titujt të diskutohen në seksion.

12. Nga akad. A. Fuga u kërkua njohja e situatës financiare në analizat vjetore: sa është buxheti, sa shkon për rroga, sa për botime, sa për projekte, dhe si është përdorur ky buxhet.

13. Revista e seksionit duhet të dalë në web. Pati ndonjë propozim që seksioni të diskutojë edhe tematikën e revistës. Synimi është të njihet se çfarë dobie sociale sjellin botimet tona.

14. U shprehën tre shqetësime të tjera të rëndësishme:

a. Gati dy vjet Këshilli ndërgjuhësor i ngritur mes dy Akademive me urdhërtë ASHSH dhe ASHAK nuk ka asnjë aktivitet. Po shkohet drejt një shuarje graduale pa nxjerrë në dritë një produkt, që të paktën, deri në këtë moment që ka vepruar, çfarë ka arritur? U shpreh mendimi nga ish kryetari i Akademisë që Këshilli Ndërakademik i Gjuhës shqipe ka arritur në përfundime teknike të çështjeve të gjuhës, por tani duhet ngritur një komision që të dalë me vendime dhe t'i drejtohem qeverisë që ta njohë këtë komision dhe vendimet e dala prej tij.

b. Seksioni është me minus 6 anëtarë, duke patur një disproporcion me Seksionin tjetër. Duhet vepruar për ta zgjidhur këtë problem.

- c. Nëse Asambleja nuk do të jetë e gatshme të shpallë zgjedhje deri në tetor të këtij viti do të hyjmë në krizën e vetëshuarjes, sepse i vetmi autoritet i cili ka mundësi të përfaqësojë Akademinë zyrtarisht është Sekretari i Përgjithshëm, mandati i të cilit mbaron në shkurtin e ardhshëm. Sipas një kalendari, duke e paraqitur situatën optimiste që të harxhohet koha e fushatës së zgjedhjeve, të bëhet zgjedhja e e kandidatëve të merituar për në Akademi etj. etj. na kanë mbetur vetëm tetë muaj, në të kundërt shkojmë në vetëshuarje.

KREU II

VEPRIMTARIA VETJAKE E ANËTARËVE TË ASAMBLESË SË ASH

A. Veprimtaria individuale e anëtarëve të SSHNT (Shtojcë I)

(shih: <http://akad.gov.al/ash/seksionet-ash/sshnt/anetar-sshnt>)

Pjesëmarrje në projekte shkencore jashtë ASHSH

Arben Merkoçi

1. Sensing toxicants in Marine waters makes Sense using biosensors (SMS) Reference: 613844 Funded by: European Commission Program: FP7-OCEAN 2013.1 Official web site of the project: <http://www.project-sms.eu/> Period: 01/12/2013 - 31/08/2017 Partners: Fundación Privada Institut Català de Nanotecnologia (ICN); Universita degli Studi di Roma Tor Vergata (U2), Agenzia Nazionale...
2. "Nanobioconjugated paper/plastic platforms for improved diagnostics applications (NAP2DIAGNOSTICS)", (Period: 2015-2017) project funded by MINECO (Spanish Government)
3. "Development of a Nanodiagnostic platform for monitoring of Cancer cell secreted proteins (NACANCELL) Period: 1 Nov 2016 to 31 Oct 2019, project funded by MINECO (Spanish Government)
4. "Development and application of Novel, Integrated Tools for monitoring and managing Catchments (INTCATCH <http://intcatch.eu/>)", Period: 1 Jun 2016 to 31 Jan, 2020 (Funded by: European Commission Program: H2020.

Arjan Durrësi

1. *INFEWS/T2: iFEWCoordNet - a secure decision support system for coordination of adaptation planning among FEW actors in the Pacific Northwest*, Mbeshtetur nga NSF-USDA
2. *Large-Scale Distributed Scientific Experiments on Shared Substrate*, Mbeshtetur nga National Science Foundation (NSF), Computer and Network Systems.
3. *An Application Delivery Platform for Mobile Apps on Global Clouds*, Mbeshtetur nga National Science Foundation (NSF), Computer and Network Systems.
4. *Secure Data Architecture: Collaborative Research: Assured Mission Delivery Network Framework for Secure Scientific Collaboration*, Mbeshtetur nga National Science Foundation (NSF), Computer and Network Systems.

Neki Frashëri

1. *VI-SEEM i Horizon2020 për krijimin e platformës virtuale rajonale për përpunimin paralel të të dhënave me aplikime nga meteorologjia biologjia dhe trashëgimia kulturore. Akad. N. Frashëri është drejtues i grupit të punës të Universitetit Politeknik të Tiranës. Është studiuar skalabiliteti i softuerit OpenFOAM për simulimin e erës mbi terren malor të vendit. Projekti i Universitetit Politeknik të Tiranës.*
2. *COST IC1305 NESUS për zhvillimin e sistemeve kompjuterike paralele, me pjesëmarrje në përgatitjen e një artikulli dhe prezantime të punimit mbi inversionin e anomalive të gravitetit në sistemet paralele. Projekti i Universitetit Politeknik të Tiranës.*

Jorgaq Kaçani

1. *Invalor 101. A network for joint valorization of material flows in tourist areas” Cooperation Programme “Interreg V -B Balkan-Mediterranean 2014-2020 Projekti synon përpunimin e mbetjeve në zonat turistike ku për palën shqiptare imlementimi do të bëhet në zonën turistike të Vlorës. Partnerë janë : Universiteti i Patrës, Greqi; bashkia e Markopulos, Greqi; Frederick Research Center, Qipro; bashkia e Paralimnosit, Qipro; Universiteti Politeknik i Tiranës, Shqipëri dhe bashkia e Vlorës, Shqipëri.*
2. *Dixhitalizimi dhe eksperiencia 3D në promovimin e trashëgimisë kulturore dhe zhvillimit Turistik. Interreg IPA CBC Italy - Albania - Montenegro Programme. Akronimi i Projektit: 3D-IMP-ACT. Qëllimi i projektit konsiston në:*
 - Menaxhim & Studim marketing për operatorët turistik;
 - Analiza SWOT dhe PEST për operatorët turistik;
 - Skanimin 3d të disa objekteve të trashëgimisë kulturore;
 - Konvertimin e tyre në imazhe 3D për projeksione video dhe realitete virtuale;
 - Printimin 3d të disa objekteve të përzgjedhura;
 - Promovim i turizmit në zona të cilat janë të pa njohura;
 - Krijimi i imazheve atraktive (3D) për zona turistike;
 - Krijimi i artikujve shkencorë lidhur me teknikat 3D etj.

Fakulteti i Inxhnierisë Mekanike, si partner në këtë projekt, me eksperiencën e stafit të vet në fushat e dixhitalizimit dhe printimit 3D ofron ekspertizën e tijë në përmbushjen objektive të mësipërme. Laboratori i skanimit dhe printimit 3D, pjese e departamentit të prodhimit dhe menaxhimit, synon të forcohet akoma më shumë me pajisjet dhe teknikat e fundit në këtë fushë. Artikujt shkencorë tashmë pjesë e konferencave ndërkombëtare ofrojnë garancinë për përmbushjen me sukses të objektive të tilla si: skanimi 3D, printimi 3D, ndërtim imazheve dhe renderizime, promovim menaxherial të aspekteve turistike, analiza SWOT dhe PEST për operatorët turistik etj.

I. Pjesëmarrje në konferenca shkencore

1. A. A. Bushati, **S. Bushati**, “Tracing the Global Child: Global politics shaping local childhoods”, International Conference “Globalism vs Nationalism”, Podgorica (2-3 November 2017),

2. A. Hasana, **J. Kacani**, L. Falch, "B2 method of Hydrostatic Testing applied in Gas Pipeline; Cause Study: Testing Block Valve Station ABV25 -TAP Project", 1st International Conference "Engineering and Entrepreneurship" Tirana, Albania, 17-18 November ICCE 2017, Proceedings Book.ISBN 978-9928-146-47-2.

3. **A. Kondili**, "Treatment of atrial fibrillation in patients with WPW syndrome" Prishtinë Maj 2017

4. A. Mazrreku, I. Beqiraj, **I. Malollari**, "Rikuperimi i bioenergjisë me ane të procesit të transesterifikimit të vajrave të mbetura të gatimit për prodhimin e biodiezelit", konferenca e shkencave të natyrës dhe teknologjisë, Book of Abstracts, p. 202, Tiranë 17-18 nëntor 2017

5. A. Mazrreku, I. Beqiraj, **I. Malollari**, "Bioenergy Recovery Through Transesterification of Waste Cooking Oil Producing Biodiesel", 19th International Symposium on Environmental Pollution and its Impact on Life in the Mediterranean Region, October 4-6, 2017, Rome - Italy, Book of abstracts p.95,, info@mesaep.org - <http://www.mesaep.org>

6. A. Mazrreku, I. Beqiraj, **I. Malollari**, "Experimental testing setup of some waste oil seeds treatment for biodiesel obtaining", International Workshop "Information Technology, Sustainable Development, Scientific Network & Nature Protection" Edessa 8 -11 October 2017

7. **A. Merkoçi**, "Diagnostics with paper-based sensors using nanomaterials as signalling tools", Keynote talk, NanoBioSensor Conference, Dresden, Germany, Sept. 4-5, 2017

8. **A. Merkoçi**, "Graphene-based platforms for biosensing applications", Invited Talk, Graphene Connect workshop - Biomedical Technologies, 16 November 2017, Dusseldorf, Germany.

9. **A. Merkoçi**, "Health and environment diagnostics using paper-based nanobiosensors", Keynote Talk, NanoBioMed Conference, 22-24 Nov. 2017, Barcelona, Spain

10. **A. Merkoçi**, "Nanobiosensors based on printing onto paper or plastic platforms", Keynote talk at General Assembly of ESMA 2017 (www.esma.com), Lisbon (Portugal), 24 March 2017.

11. **A. Merkoçi**, "Nanobiosensors for diagnostics", Invited lecture, Universidad de Alicante, Departamento de Quimica Fisica, Instituto Universitario de Materiales, Alicante, Spain, February 21st, 2017

12. **A. Merkoçi**, "Nanobiosensors for diagnostics", Invited talk at BioSystems S.A., 29.11.2017, (www.biosystems.es), Barcelona, Spain

13. **A. Merkoçi**, "Nanomaterials-based sensors for diagnostics" Invited talk at Instituto de Química Orgánica General, CSIC, Madrid, Spain, May 31st, 2017, Madrid, Spain.

14. **A. Merkoçi**, "Paper-based Nanobiosensors: Diagnostics Going Simple", Keynote Talk, Lab-on-Chip & Microfluidics World Congress 2017, Coronado Islan, California, USA, October 2-4, 2017

15. **A. Merkoçi**, "Promoting the establishment of Centres of Excellence in Albania and the impacts on promoting Albanian young scientists", Invited panel discussion, Workshop: Capacity Building and Knowledge Transfer in Albania, February 16-17, 2017, Tirana, Albania

16. **A. Merkoçi**, Diagnostics using nanobiosensors, Invited talk in Beijing Institute of Technology, Beijing, China, March 15th, 2017

17. **A. Merkoçi**, Diagnostics using nanobiosensors, Invited talk in School of Biological Sciences & SynthSys, University of Edinburgh, Edinburgh, UK, February 23d, 2017

18. **A. Merkoçi**, Invited Lecture, "Nanobiosensors for diagnostics: from plastic to simple paper-based platforms", Invited lecture, Department of Information Engineering, Università degli Studi di Padova, Italy, January 19th, 2017.

19. A. Neziri, **I. Malollari**, V. Lajçi (Makolli) Increasing the pollution control in natural waters by automation the sampling technology and laboratory analyses in combination with spot water sampling”, 16th IFAC Symposium on Automation in Mining, Mineral and Metal Processing August 25-28, 2013. San Diego, California, USA, 10.3182/20130825-4-US-2038.00031

20. **A. Merkoçi**, “Nanobiosensors for diagnostics”, Invited talk at European Foundation for the Study of Chronic Liver Failure - EF Clif, Barcelona, Spain

21. B. Çuko, V. Sota & **E Kongjika**. 2017. *In vitro* methodologies that avoid polyphenolic oxidation in different explants of apple (*Malus domestica* L.). 1st Nationwide Scientific Conference of Young Albanian Academy “Methodology and Scientific Research: Tradition and Innovation, December 4, 2017. Tirana, Albania, Book of Abstracts, pg. 28 - 30.

22. B. Gashi, F. Babani & **E. Kongjika** 2017. Photosynthetic activity during dehydration and rehydration cycle of the resurrection plants of genus *Ramonda* in Kosovo. 37th Meeting “Eastern Alpine and Dinaric Society for Vegetation Ecology”, Prizren 13-16 July 2017.

23. **B. Resuli**. “Serum alanine aminotransferase (ALT) activity in overweight and obese subjects”. International Conference on Diabetes, 2017, North Carolina, USA (Poster).

24. B. Cuko, V. Sota & **E. Kongjika** 2017. Stabilizimi i metodikave të izolimit të meristemës së dy kultivarëve të mollës (*Malus domestica* L.) për qëllime shëndetësi dhe ruajtjes së stabilitetit gjenetik gjatë mikroshumimit. Konferencë e shkencave të natyrës dhe teknologjisë, KSNTTEK 2017, 17-18 nëntor 2017, Tiranë. Libri i abstrakteve, f. 73 -74.

25. B. Cuko, V. Sota & **E. Kongjika** 2017. “Stabilisation of *in vitro* rhizogenesis of two apple (*Malus domestica* L.) cultivars during micropropagation”. Second International Conference on “Biotechnology in Agriculture”, Abstract Book ISBN 9789928146441, 18 - 19 April 2017, Tirana, Albania, p. 74.

26. E. Dhuka - Prespa, **J. Kacani**, Y. Shehu, I. Vozga, “A Quantitative Investigation of Multiphase Diffusion in the Fe - Zn Binary System”, Qershor, 2017, ICE2017, “International Conference of Ecosystems”, Punimi P.S.P.143

27. E. Dhuka-Prespa, **J. Kaçani**, Y. Shehu Shtator, 2017, “Structural investigation of the AZ61 Magnesium alloy, in dependence of various heat treatment processes, Shtator, 2017, “Nineteenth Annual Conference “YUCOMAT 2017”, TEM analyze”,

28. **E. Kongjika**, A. Zajmi, A. Myrta, L. Susuri & F. Krasniqi 2017. Prodhimi dhe certifikimi i fidanëve të pemëve frutore, hardhisë, ullirit dhe agrumeve në Shqipëri dhe Kosovë. Konferenca vjetore e shkencës “Java e Shkencës” 2017. Libri i abstrakteve. ISBN 978-9951-16-111-4, 16 - 19 maj 2017, Prishtinë, Kosovë, f. 224-225.

29. **E. Kongjika**, V. Sota, C. Damiano 2017. Costituzione di collezioni *in vitro* di alcune importanti specie arboree ‘minori’ da frutto. VitroSoi 2017, III Convegno Nazionale sulla Micropropagazione, 29 - 31 Maggio 2017, Pescia Italia. Book of Abstracts, CREA & SOI, pg. 81.

30. E. Piperi, L.M. Galantucci, **J. Kacani**, I. Bodi, T. Spahiu “3D scanning technique for digitalization of mechanical parts” 1st International Conference “Engineering and Entrepreneurship” Tirana, Albania, 17-18 November ICCE 2017, Proceedings Book. ISBN 978-9928-146-47-2.

31. E. Piperi, L.M. Galantucci, **J. Kacani**, I. Bodi, T. Spahiu “Cultural heritage digitalization. Case study: Albania artefacts approach for digitalization and 3D printing” Cities in Transition, “1st International forum on architecture and urbanism “IFAU December 14-16, Tirana, Albania

32. E. Prespa, **J. Kaçani**, Y. Shehu, “Inxhinieria dhe kompleksiteti ekonomik ne Shqiperi”, Shtator, 2017, konferencë shkencore ndërkombëtare”, Fakulteti i Inxhinierisë, Universiteti Metropolitan Tirana, Punimi P.S.C.5.

33. E. Rista, A. Pilaca, I. Akshija, A. Durau, A. Rama, S. Bino, M. Kota, E. Muço, E. Kolovani, E. Tomini, **N. Thereska**, A. Harxhi. "Hemorrhagic fever with renal syndrome in Albaia. A 5 year study" Kongresi European i sëmundjeve të veshkave për vendet e Ballkanit, Sarajevë, Tetor 2017

34. F. Cela, **P. Petro**, Konferencë e shkencave të natyrës dhe teknologjise, Universiteti i Tiranës, Nëntor 2017.

35. F. Cela, **P. Petro**, "On Green's relations in rings and their multiplicative semigroup", "1st International Conference of Natural Sciences and Mathematics", Universiteti i Tetovës, shtator.

36. F. Hoxha, R. Kongoli, **I. Malollari**, R. Buzo, J. Llupa, "Analytical methods for the examination of some albanian olive oils authenticity", International Workshop "Information Technology, Sustainable Development, Scientific Network & Nature Protection" Varosi, Edessa 8-11 October

37. F. Hoxha, R. Kongoli, **I. Malollari**, X. Cani, R. Buzo "On the Food Authenticity, Identification Of Foreign Imitants And Contaminants, And Their Impact To Food Quality And Safety", International Conference Sustainable Development And Environmental Engineering, Alba Iulia, Rumania, 24-27 May, 2017, Book of Abstract, p.186.

38. F. Mandija, J. Bushati, **F. Vila**, "The Climatology of the Aerosol load over Shkodra lake; Assessment of the Main Sources and Inter - Annual Trends Based on Remote Sensing Technologies and Model outputs", Mediterranean Natural Sciences and Engineering Congress (MENSEC), Podgorica, Montenegro, october 19-22, 2017.

39. F. Tartari, **N. Thereska**, F. Dogan, L. Gjoshaj, A. Hoda etj. "Some details for diagnostic prostate cancer in american hospital for 4 years" Konferenca 3të ndërkombëtare e Mjekësisë multidisciplinore, Tiranë, 16 - 18 Nëntor 2018

40. **F. Vila**, **I. Malollari**, Dh. Premti, I. Spahiu, "Vlerësimi i disa karakteristikave standarte të atmosferës për qëllime referimi duke përdorur dhomën klimaterike", Java e Shkencës, Ministria e Arsimit e Shkencës dhe e Teknologjisë, Departamenti i Shkencës dhe Teknologjisë, 16 - 19 Maj, Prishtinë, 2017.

41. H. Manaj, **I. Malollari**, A. Dhroso, "Study of the possibility for bio gas production from some organic waste using a mini batch anaerobic bioreactor", 19th International Symposium on Environmental Pollution and its Impact on Life in the Mediterranean Region, October 4-6, 2017, p.95, Rome - Italy, Book of abstracts, info@mesaep.org - <http://www.mesaep.org>

42. I. Bodi, L.M. Galantucci, **J. Kacani**, E. Piperi, F. Lavecchia "Extruder head thermal analysis for an open-source 3D printer" 1st International Conference "Engineering and Entrepreneurship" Tirana, Albania, 17-18 November ICCE 2017, Procerdings Book.

43. A. Gjyzari, I. Gjyzari, D. Ylli, **N. Thereska** "Urinary tract infection in adults living in the community", Konferenca III Ndërkombëtare e Mjekësisë Multidisiplinore, Tiranë, nëntor 2018.

44. **I. Malollari**, "Simulation Testing of Some Organic Materials As Alternative Fuels For Performance Improving Of An Albanian Cement Plant", 19th International Symposium on Environmental Pollution and its Impact on Life in the Mediterranean Region, October 4-6, 2017, p.105, Rome - Italy, Book of abstracts, info@mesaep.org - <http://www.mesaep.org>, Energy, environment and sustainability Afternoon session - October 5th Oral presentations.

45. **I. Malollari**, Dh. Premti, L. Pinguli, H. Manaj, Xh. Cani "Mbi metodologjinë e projektimit të proceseve kimike që mbështetet në analizën konceptuale; On the chemical proces design methodology driven by the conceptual analysis", Konferenca e Shkencave Të Natyrës Dhe Teknologjisë, Book of Abstracts, p.196 Tiranë 17-18 Nëntor 2017,

46. **I. Malollari**, X. Cani, R. Buzo, B. Baruti, J. Llupa (Albania) Shiitaki Mushroom's Waste Treatment for Proper and Efficient Biogas Profit, International Conference Sustainable Development And Environmental Engineering, Alba Iulia, Rumania, 24-27 2017, Book of Abstract, p.248

47. I. Vozga, **J. Kacani** "Zirconia membranes by the sol-gel method" 1st International Conference "Engineering and Entrepreneurship" Tirana, Albania, 17-18 November ICCE 2017, Proceedings Book. ISBN 978-9928-146-47-2.

48. K. Taraj, **I. Malollari**, F. Ylli, R. Maliqati, A. Andoni, E. Plaku "A study on Albanian Pinus Halepensis Mill. essential oils obtained by different methods. Characterization by FTIR spectroscopy and UV-Vis spectrophotometry" International Workshop "Information Technology, Sustainable Development, Scientific Network & Nature Protection" Edessa 8-11 October 2017

49. L. Hoxha, R. Kongoli, **I. Malollari**, "Dehydration of figs as an alternative of sun-drying , technique and effect on some quality parameters", International Workshop "Information Technology, Sustainable Development, Scientific Network & Nature Protection" Varosi, Edessa 8-11 October 2017

50. L. Pinguli, **I. Malollari**, T. Vaso, "Energy recovery and conservation an important tool in minimizing environment and operational costs in Albanian Breweries", 19th International Symposium on Environmental Pollution and its Impact on Life in the Mediterranean Region, October 4-6, 2017, p.96, Rome, Italy, Book of abstracts, info@mesaep.org, <http://www.mesaep.org>

51. L. Pinguli; **I. Malollari**, H. Manaj; A. Dhroso; Dh. Premti, Xh. Cani "Krahasimi i hidrolizës acide dhe enzimatike të materialeve celulozike; A comparative study of acidic and enzymatic hydrolyses of cellulosic materials", Konferenca e Shkencave të Natyrës dhe Teknologjisë, Book of Abstracts, p.202, Tiranë 17-18 Nëntor 2017, p.200,

52. M. Koci, **J. Kacani** "Yaht Production, Tradicional of Composite Materials, Advantages and Disadvantages", 12 International Conference on Social Science Amsterdam, 19-20 May 2017, Proceedings Volume II, ISBN 9788890916144,

53. **N. Frasheri**, D. Minarolli. Project VI-SEEM - a Regional Virtual Research Environment. International Conference ISTI 2017: fostering As-A-Service Economy, 23 - 24 June 2017, Tirana

54. **N. Frasheri**, E. Atanassov. "Interprocess Communication Issues with OpenFOAM for Wind Simulation". BalkanCom 2017 - First International Balkan Conference on Communications and Networking, Tirana, Albania, May 30 - June 2, 2017

55. **N. Frasheri**, E. Atanassov. "Scalability Issues for Wind Simulation Using OpenFOAM." VRE Workshop "Two Years Avitohol: Advanced HPC applications", 29-31 October, Panagyurishte, Bulgaria.

56. **N. Frasheri**, E. Atanassov. "Scalability Issues for Wind Simulation using OpenFOAM". IEEE EUROCON 2017 - 17th IEEE International Conference on Smart Technologies, 6 - 8 July 2017 Ohrid, Republic of Macedonia.

57. **N. Frasheri, G. Beqiraj, S. Bushati**. "Multitemporal Interferometry and Big Data - Case of Albania". Conference on Big Data from Space (BiDS'17), Toulouse 28-30 November 2017, ISBN 978-92-79-73527-1 ISSN 1831-9424 doi:10.2760/383579. [Academy of Sciences]

58. **N. Frasheri, G. Beqiraj, S. Bushati**. "SAR Data Processing for Evaluation of Environmental Changes in Albania". ESA EO Open Science 2017, 25-28 September 2017, ESA-ESRIN, Frascati. [Academy of Sciences]

59. **N. Frasheri, G. Beqiraj, S. Bushati**. "SAR Interferometry for Identification of

Environmental Phenomena - Case of Albania" ESA FRINGE 2017 Workshop, Aalto University of Helsinki (Finland), 05 - 09 June 2017. [Academy of Sciences]

60. N. Pasko, A. Strakosha, V. Çadri, E. Stefo, S. Mumajesi, **N. Thereska**, F. Nasto, M. Barbullushi "Prevalence and control of dylipidemia among diabetic patients with overt diabetic nephropathy" Kongresi European i sëmundjeve të veshkave për vendet e Ballkanit, Sarajevë, Tetor 2017

61. N. Pasko, A. Strakosha, F. Nasto, **N. Thereska**, A. Dedej, V. Çadri, E. Stefo, S. Mumajesi, M. Barbullushi "Diabetics' patient's survival in hemodialy treatment " Konferenca 3të ndërkombëtare e Mjekësisë multidisciplinore, Tiranë, 16 - 18 Nëntor 2018

62. O. Beqiri, **P. Petro**, "On inverse Γ -rings", "1st International Conference in Computing, Information Technology and Business Applications", Universiteti "Aleksander Moisiu", Durres, Maj, Proceedings Book, ISBN: 978-9928-4387-5-1, p. 26-36.

63. P. Dhima, **F. Vila**, "Përcaktimi i rezistencës elektrike specifike volumore të polietilenit me anë të metodës së rënies së potencialit të sipërfaqes", Konferenca e Shkencave të Natyrës dhe Teknologjisë, (KSNTEK 2017), Tiranë, 17-18 Nëntor 2017.

64. R. Buzo, **I. Malollari**, J. Llupa, G. Dimco, A. Gjata (Albania) "Organizing of Waste Management In The Wine Albanian Industry", International Conference Sustainable Development And Environmental Engineering, Alba Iulia, Rumania, 24-27 May, 2017, Book of Abstract, p.227

65. S. Mumajesi, M. Imeraj, V. Çadri, N. Pasko, A. Strakosha, E. Rëmbeci, A. Bulla, **N. Thereska**, M. Barbullushi. "Inflammation and cardiorenal anemia syndrome". Kongresi European i sëmundjeve të veshkave për Vendet e ballkanit, Sarajevë, Tetor 2017

66. T. Kamburi; L. Xhagolli; **I. Malollari**, L. Lici "Impact of Malt quality parameters on beer filtration optimization process" Seventh International Conference "Modern Trends in Science"; 14-18/06/2017, Blagoevgrad, BULGARIA. Book of Abstracts.

67. T. Prifti (Vaso), L. Pinguli, **I. Malollari**, "Kinetic modeling of Immobilized Yeast Batch Fermentation", International Journal of Engineering Research & Science (IJOER) ISSN: [2395-6992] [Vol-3, Issue-6, June- 2017]

68. T. Vaso; L. Xhagolli; **I. Malollari** "Kinetic parameters study of heterogeneous fermentation systems with immobilized yeast" First Black Sea Association of Food Science and Technology Congress. 22-24 September 2016, Ohrid Macedonia. Book of Abstracts.

69. T. Vaso; L. Xhagolli; **I. Malollari**: "Biocatalytic Diameter Influence of Beads immobilized in kinetic fermentation with immobilized yeast." International Conference of Applied Sciences, Engineering and Mathematics; 05-07 May 2017; Struga-Ohrid, Macedonia. Book of Abstracts Proceedings Book: International Conference of Applied Sciences, Engineering and Mathematics; 05-07 May 2017; Struga-Ohrid, Macedonia.

70. V. Sota & **E. Kongjika** 2017. "Optimisation of micropropagation and *in vitro* conservation methods of fruit trees species economically important" 1st Nationwide Scientific Conference of Young Albanian Academy "Methodology and Scientific Research: Tradition and Innovation, December 4, 2017. Tirana, Albania, Book of Abstracts, pg. 72 - 73.

71. V. Sota, B. Çuko, **E. Kongjika** 2017. Effect of salinity stress on *in vitro* propagation of different wheat cultivars (*Triticum aestivum* L.). Second International Conference on "Biotechnology in Agriculture", Abstract Book ISBN 9789928146441, 18 - 19 April 2017, Tirana, Albania, pg. 27.

72. V. Sota, **E. Kongjika**, C. Damiano 2017. Collezioni *in vitro* di alcune specie autoctone del genere *Prunus* in Albania. VitroSoi 2017, III Convegno Nazionale sulla Micropropagazione, 29-31 Maggio 2017, Pescia Italia. Book of Abstracts, CREA & SOI.

73. V. Sota, S. Themeli, Zh. Zekaj & **E. Kongjika** 2017. Aplikimi i citokininave ekzogjene shkakton ndryshime në parametrat e gojëzave dhe trikomave gjendrore në bimët e rozmarinës të rigjeneruara *in vitro*. Konferencë e shkencave të natyrës dhe teknologjisë, KSNTTEK 2017, 17-18 nëntor 2017, Tiranë. Libri i abstrakteve, f. 28-29.

74. Xh. Cani, **I. Malollari**, H. Manaj, Dh. Premti, D. Koromani, “Aplikimi i skemave të ndryshme të simulimit për procesin e përpunimit të naftës bruto Application of different simulation schemes for crude oil refining process”, Konferenca e Shkencave të Natyrës dhe Teknologjisë, Book of Abstracts, p.202, Tiranë 17-18 Nëntor 2017, p.202,

75. Xh. Cani, **I. Malollari**, I. Beqiraj, S. Makolli, “Data Treatment from Crude Oil Distillation using Aspen Hysys Simulation”, International Workshop “Information Technology, Sustainable Development, Scientific Network & Nature Protection”, Edessa 8-11 October 2017

III. BOTIME

Monografi

1. Balliu, A., N.K. Marsić, and **N. Gruda** 2017. Seedling production. Chapter 6 of Part II, pp. 189-206. In: “Good Agricultural Practices for greenhouse vegetable production in the South East European countries - Principles for sustainable intensification of smallholder farms.” FAO Plant Production and Protection Paper 230. Eds. W. Baudoin, A. Nersisyan, A. Shamilov, A. Hodder, D. Gutierrez, S. de Pascale, S. Nicola, N. Gruda, L. Urban, and J. Tanny. ISBN 978-92-5-109622-2, 449 pp.

2. Baudoin, W., A. Nersisyan, A. Shamilov, A. Hodder, D. Gutierrez, S. de Pascale, S. Nicola, **N. Gruda**, L. Urban, and J. Tanny. 2017. Good Agricultural Practices for greenhouse vegetable production in the South East European countries - Principles for sustainable intensification of smallholder farms. FAO Plant Production and Protection Paper 230. ISBN 978-92-5-109622-2. FAO 2017, 449 pp.

3. **Gruda, N.** and A. Shundi 2017. Horticultura: vështrim enciklopedik, ISBN: 978-9928-237-08-8. Adel Co. 1, 846 pp.

4. **Gruda, N.**, and G. Popsimonova 2017. Current situation and future trends of protected cultivation in South East Europe. Chapter 2 of Part I. pp. 17-26. In: “Good Agricultural Practices for greenhouse vegetable production in the South East European countries - Principles for sustainable intensification of smallholder farms.” FAO Plant Production and Protection Paper 230. Eds. W. Baudoin, A. Nersisyan, A. Shamilov, A. Hodder, D. Gutierrez, S. de Pascale, S. Nicola, N. Gruda, L. Urban, and J. Tanny. ISBN 978-92-5-109622-2, 449 pp.

5. **Gruda, N.**, G. Sallaku, and A. Balliu 2017. Cucumber. Chapter 7 of Part III, 287-300. In: “Good Agricultural Practices for greenhouse vegetable production in the South East European countries - Principles for sustainable intensification of smallholder farms.” FAO Plant Production and Protection Paper 230. Eds. W. Baudoin, A. Nersisyan, A. Shamilov, A. Hodder, D. Gutierrez, S. de Pascale, S. Nicola, N. Gruda, L. Urban, and J. Tanny. ISBN 978-92-5-109622-2, 449 pp.

6. **Kaçani. J.** Proceedings of 1st International Conference “Engineering and Entrepreneurship”, ICEE2017, November 17-18, 2017, Tirane, Albania.

7. **Kongjika E.**, Susuri L., Zajmi A. & Myrta A. 2016. "Prodhimi dhe certifikimi i fidanëve të pemëve frutore, hardhisë, ullirit dhe agrumeve në Shqipëri dhe Kosovë", Akademia e Shkencave të Shqipërisë. 350 fq. Përrurimi i librit në Prishtinë (qershor 2017) dhe në Tiranë (nëntor 2017).

8. Pano N., **Frashëri A.**, **Bushati S.**, **Kongjika E.**, Abdyli B., Hasko H., Taska E., Muça G. 2017. "Hapësira bregdetare Divjakë - Karavasta në Adriatik", Akademia e Shkencave

9. **Pinguli E.** Studime tekniko-shkencore mbi mundësinë dhe problemet e shfrytëzimit të lumenjve Drini i Zi dhe Vjosa, f. 94.

10. Popsimonova, G., B. Benko, L. Karic, and **Gruda N.** 2017. Production systems: integrated and organic production, and soilless culture. Chapter 7 of Part II, 207-226. In: "Good Agricultural Practices for greenhouse vegetable production in the South East European countries - Principles for sustainable intensification of smallholder farms." FAO Plant Production and Protection Paper 230. Eds. W. Baudoin, A. Nersisyan, A. Shamilov, A. Hodder, D. Gutierrez, S. de Pascale, S. Nicola, N. Gruda, L. Urban, and J. Tanny. ISBN 978-92-5-109622-2, 449 pp.

11. Rodríguez-Delfín, A., **Gruda N.**, Eigenbrod C., Orsini F., Gianquinto G. 2017. Soil Based and Simplified Hydroponics Rooftop Gardens. *In: Rooftop Urban Agriculture*, Eds. Orsini, F., M. Dubbeling, H. de Zeeuw, G. Gianquinto, Springer International Publishing, Berlin/Heidelberg, eBook ISBN 978-3-319-57720-3, DOI 10.1007/978-3-319-57720-3, Hardcover ISBN 978-3-319-57719-7, Series ISSN 2197-1730, Pages 61-81.

Artikuj shkencorë

1. Adriaenssens T, Joner M, Godschalk TC, Malik N, Alfonso F, Xhepa E, De Cock D, Komukai K, Tada T, Cuesta J, Sirbu V, Feldman LJ, Neumann FJ, Goodall AH, Heestermans T, Buysschaert I, Hlinomaz O, Belmans A, Desmet W, Ten Berg JM, Gershlick AH, Massberg S, **Kastrati A**, Guagliumi G, Byrne RA, Prevention of Late Stent Thrombosis by an Interdisciplinary Global European Effort I. Optical Coherence Tomography Findings in Patients With Coronary Stent Thrombosis: A Report of the PRESTIGE Consortium (Prevention of Late Stent Thrombosis by an Interdisciplinary Global European Effort). *Circulation*. 2017; 136:1007-1021

2. Alfantoukh L., Ruan Y., **Durresi A.**, "Trust-Based Multi-Stakeholder Decision Making in Water Allocation System," In Advances on Broad-Band Wireless Computing, Communication and Applications. BWCCA 2017. Lecture Notes on Data Engineering and Communications Technologies, vol 12. Springer, Cham

3. Álvarez-Diduk R., Orozco J., **Merkoçi A.**, "Paper strip-embedded graphene quantum dots: a screening device with a smartphone readout", Scientific Reports, 7, 976, DOI:10.1038/s41598-017-01134-3

4. Balliu, A., N.K. Maršić and **Gruda N.** 2017: Seedling production. VII Southeastern Europe Symposium on Vegetables and Potatoes in Maribor, Slovenia 20-23 June 2017. ISHS, Book of Abstracts, 53.

5. Beqiri, O., **Petro, P.** "Generalized division Γ -rings", JNTS, 2017 (2), XXII, (44), fq. 17-28.

6. Bisbis, M., **Gruda N.**, M. Blanke 2017: Adapting to Climate Change with Innovative Greenhouse Technologies. International Symposium on New Technologies for Environment Control, Energy-Saving and Crop Production in Greenhouse and Plant Factory - GreenSys 20-24 August, Beijing, China, Book of Abstracts, 207.

7. Bradaric C, Eser K, Preuss S, Dommasch M, Wustrow I, Langwieser N, Haller B, Ott I,

Fusaro M, Heemann U, Laugwitz KL, **Kastrati A**, Ibrahim T. Drug-eluting stents versus bare metal stents for the prevention of restenosis in patients with renovascular disease. *EuroIntervention*. 2017;13:e248-e255

8. **Bushati S. & Kongjika E. 2017.** An excellence center of nanotechnology and biosensors - a necessity of scientific development and applications of new technologies in Albania. *JNTS (Journal of Natural and Technical Sciences)*. Special Edition, No. 43. XXII, 5 - 11.

9. Buzo R, **Malollari I**, Lici L, Kongoli R, Characterisation Of Polyphenolic Changes During Wine Micro-Oxygenation and Mathematical Modelling Of Oxygen Distribution, *Journal Of Environmental Protection And Ecology* 18, No 1, 125-134 (2017), (Impact Factor)

10. Byrne RA, Stone GW, Ormiston J, **Kastrati A**. Coronary balloon angioplasty, stents, and scaffolds. *Lancet*. 2017;390:781-792

11. Cani Xh., Bakillari V., **Malollari I**, Qyra M, Simulimi i Dy Varianteve Të Fraksionimit Atmosferik Të Naftave Bruto Të Vendit Tonë, *Buletini i Shkencave te Natyres*, nr. 23, 2017.

12. Cassese S, Husser O, **Kastrati A**. Adverse events with bioresorbable vascular scaffolds in routine percutaneous coronary interventions: “coup de theatre” or unfinished play? *J Thorac Dis*. 2017;9:2303-2307

13. Cassese S, **Kastrati A**, Fusaro M. Bioresorbable vascular scaffolds for complex coronary anatomies: “Icarus’ flight” for interventional cardiologists? *Cardiovasc Diagn Ther*. 2017;7:S98-S101

14. Cassese S, Ndrepepa G, Byrne RA, Kufner S, Xhepa E, de Waha A, Rheude T, Colleran R, Giacoppo D, Harada Y, Laugwitz KL, Schunkert H, Fusaro M, **Kastrati A**. Outcomes of patients treated with durable polymer platinum-chromium everolimus-eluting stents: a meta-analysis of randomised trials. *EuroIntervention*. 2017;13:986-993

15. Cassese S, Ndrepepa G, Kufner S, Byrne RA, Giacoppo D, Ott I, Laugwitz KL, Schunkert H, **Kastrati A**, Fusaro M. Drug-coated balloon angioplasty for in-stent restenosis of femoropopliteal arteries: a meta-analysis. *EuroIntervention*. 2017;13:483-489

16. Cassese S, Xhepa E, **Kastrati A**. Biodegradable-polymer drug-eluting stents: back to the future? *Heart*. 2017;103:91-92

17. Chałupniak A. and **Merkoçi A.**, “Towards Integrated Detection and Graphene-based Removal of Contaminants in Lab-on-a-chip Platform”, *Nano Research*, 2017, doi:10.1007/s12274016-1420-3

18. Cheevewattanagul N., Morales-Narváez E., Hassan Abdel-Rahim H. A., Bergua J. F., Surareungchai W., Somasundrum M., and **Merkoçi A.** “Straightforward Immunosensing Platform Based on Graphene Oxide-Decorated Nanopaper: A Highly Sensitive and Fast Biosensing Approach”, *Adv. Funct. Mater*. 2017, 1702741

19. Colleran R, Harada Y, Kufner S, Giacoppo D, Joner M, Cassese S, Ibrahim T, Laugwitz KL, **Kastrati A**, Byrne RA. Changes in high-sensitivity troponin after drug-coated balloon angioplasty for drug-eluting stent restenosis. *EuroIntervention*. 2017;13:962-969

20. Colleran R, Joner M, Kufner S, Altevogt F, Neumann FJ, Abdel-Wahab M, Bohner J, Valina C, Richardt G, Zrenner B, Cassese S, Ibrahim T, Laugwitz KL, Schunkert H, **Kastrati A**, Byrne RA, Intracoronary S, *Angiographic Results: Optimizing treatment of Drug Eluting Stent In-Stent R*, investigators. Comparative efficacy of two paclitaxel-coated balloons with different excipient coatings in patients with coronary in-stent restenosis: A pooled analysis of the Intracoronary Stenting and Angiographic Results: Optimizing Treatment of Drug Eluting Stent In-Stent Restenosis 3 and 4 (ISAR-DESIRE 3 and ISAR-DESIRE 4) trials. *Int J Cardiol*. 2018;252:57-62

21. Colleran R, **Kastrati A**. Don't think twice: BMS is never nice. *EuroIntervention*.

2017;12:1566-1567

22. Colleran R, Kufner S, Harada Y, Giacoppo D, Cassese S, Repp J, Wiebe J, Lohaus R, Lahmann A, Schneider S, Ibrahim T, Laugwitz KL, **Kastrati A**, Byrne RA, Intracoronary S, Angiographic Results: Test Efficacy of S, ProbucoL-Eluting Versus Zotarolimus-Eluting Stents I. Five-year follow-up of polymer-free sirolimus- and probuLcoL-eluting stents versus new generation zotarolimus-eluting stents in patients presenting with st-elevation myocardial infarction. *Catheter Cardiovasc Interv.* 2017;89:367-374

23. Çuko B., Sota V. & **Kongjika E.** 2017. Stabilizimi i metodikave të izolimit të meristemës së dy kultivarëve të mollës (*Malus domestica* L.) për qëllime shëndetësimi dhe ruajtjes së stabilitetit gjenetik gjatë mikroshumimit. *Buletini i Shkencave Natyrore* (në botim).

24. Çuko B., Sota V., **Kongjika E.**, 2017. Stabilisation of *in vitro* rhizogenesis of two apple (*Malus domestica* L.) cultivars during micropropagation. *Albanian j. Agric. Sci.* Open access, Special Edition. Pg. 257 - 262.

25. D'Ascenzo F, Iannaccone M, Saint-Hilary G, Bertaina M, Schulz-Schupke S, Wahn Lee C, Chieffo A, Helft G, Gili S, Barbero U, Biondi Zoccai G, Moretti C, Ugo F, D'Amico M, Garbo R, Stone G, Rettegno S, Omede P, Conrotto F, Templin C, Colombo A, Park SJ, **Kastrati A**, Hildick-Smith D, Gasparini M, Gaita F. Impact of design of coronary stents and length of dual antiplatelet therapies on ischaemic and bleeding events: a network meta-analysis of 64 randomized controlled trials and 102 735 patients. *Eur Heart J.* 2017; 38:3160-3172

26. Dhima P., **Vila F.**, "Determination of Volume Conductivity of Polyethylene Using Positive Corona, when the Current through the sample Depend Lineary on Grid Potential", *Journal of Materials Science and Chemical Engeneering*, (MSCE), Vol. 5, No. 12, 40-51, 2017

27. Dhima P., **Vila F.**, "Përcaktimi i rezistencës elektrike specifike volumore të polietilenit me anë të metodës së rënies së potencialit të sipërfaqes", *Buletini i Shkencave Natyrore*, BSHN, (UT), ISSN 2305-882X, nr. 24, f. 93-104, 2017.

28. Dhuka-Prespa E., **Kaçani J.**, Shehu Y. "Management and urban waste recycling in Albania practice" *International Journal of Ecosystem and Ecology Sciences (IJEES)*, , (ISSN: 2224-4980), Volume 7/3, 2017, (<http://ijeess.net/>), Fq.465-472;

29. Dhuka-Prespa E., **Kaçani J.**, Shehu Y., Vozga I. "Teknologjia e riciklimit të mbetjeve urbane në praktikën Shqiptare", *Buletini i Shkencave Teknike*, UPT,

30. Faggioni M, Baber U, Afshar AE, Giustino G, Sartori S, Sorrentino S, Steg PG, Stefanini GG, Windecker S, Leon MB, Stone GW, Wijns W, Serruys PW, Valgimigli M, Camenzind E, Weisz G, Smits PC, Kandzari DE, Galatius S, Von Birgelen C, Jeger RV, Mikhail GW, Itchhaporia D, Mehta L, Ortega R, Kim HS, **Kastrati A**, Chieffo A, Dangas GD, Morice MC, Mehran R. Effects of Body Mass Index on Clinical Outcomes in Female Patients Undergoing Percutaneous Coronary Intervention With Drug-Eluting Stents: Results From a Patient-Level Pooled Analysis of Randomized Controlled Trials. *JACC Cardiovasc Interv.* 2018; 11:68-76

31. **Frasheri N**, Atanassov E. Scalability Issues for Wind Simulation Using OpenFOAM. Submitted in Cybernetics and Information Technologies, Bulgarian Academy of Sciences, 2017.

32. Giacoppo D, Colleran R, Cassese S, Frangieh AH, Wiebe J, Joner M, Schunkert H, **Kastrati A**, Byrne RA. Percutaneous Coronary Intervention vs Coronary Artery Bypass Grafting in Patients with Left Main Coronary Artery Stenosis: A Systematic Review and Meta-analysis. *JAMA Cardiol.* 2017; 2:1079-1088

33. Giustino G, Harari R, Baber U, Sartori S, Stone GW, Leon MB, Windecker S, Serruys PW, **Kastrati A**, Von Birgelen C, Kimura T, Stefanini GG, Dangas GD, Wijns W, Steg PG, Morice MC, Camenzind E, Weisz G, Smits PC, Sorrentino S, Sharma M, Farhan S, Faggioni M, Kandzari D, Galatius S, Jeger RV, Valgimigli M, Itchhaporia D, Mehta L, Kim HS, Chieffo A, Mehran R. Long-

term Safety and Efficacy of New-Generation Drug-Eluting Stents in Women With Acute Myocardial Infarction: From the Women in Innovation and Drug-Eluting Stents (WIN-DES) Collaboration. *JAMA Cardiol.* 2017; 2:855-862

34. Godschalk TC, Byrne RA, Adriaenssens T, Malik N, Feldman LJ, Guagliumi G, Alfonso F, Neumann FJ, Trenk D, Joner M, Schulz C, Steg PG, Goodall AH, Wojdyla R, Dudek D, Wykrzykowska JJ, Hlinomaz O, Zaman AG, Curzen N, Dens J, Sinnaeve P, Desmet W, Gershlick AH, **Kastrati A**, Massberg S, Ten Berg JM, Investigators P. Observational Study of Platelet Reactivity in Patients Presenting With ST-Segment Elevation Myocardial Infarction Due to Coronary Stent Thrombosis Undergoing Primary Percutaneous Coronary Intervention: Results From the European PREvention of Stent Thrombosis by an Interdisciplinary Global European Effort Registry. *JACC Cardiovasc Interv.* 2017; 10:2548-2556

35. Golmohammadi H, Morales-Narváez E, Naghdi T., and **Merkoçi A.**, “Nanocellulose in (bio)sensing”, *Chem.Mater.* 2017, 29, 5426–5446

36. **Gruda, N.** 2017: Protected vegetables in South-East Europe. VII Southeastern Europe Symposium on Vegetables and Potatoes in Maribor, Slovenia 20-23 June 2017. ISHS, Book of Abstracts, 15.

37. **Gruda, N.** 2017: Zhvillimet në hortikulture – Arritjet dhe Risitë. Kumtues i ftuar. Simposiumi “Gjendja dhe ardhmëria e hortikulturës”. Akademia e Shkencave e Shqipërisë. 2 Qershor 2017, Tiranë.

38. Harada Y, Colleran R, Piniack S, Giacoppo D, Michel J, Kufner S, Cassese S, Joner M, Ibrahim T, Laugwitz KL, **Kastrati A**, Byrne RA. Angiographic and clinical outcomes of patients treated with drug-coated balloon angioplasty for in-stent restenosis after coronary bifurcation stenting with a two-stent technique. *EuroIntervention.* 2017; 12:2132-2139

39. Harada Y, Michel J, Lohaus R, Mayer K, Emmer R, Lahmann AL, Colleran R, Giacoppo D, Wolk A, Ten Berg JM, Neumann FJ, Han Y, Adriaenssens T, Tolg R, Seyfarth M, Maeng M, Zrenner B, Jacobshagen C, Wohrle J, Kufner S, Morath T, Ibrahim T, Bernlochner I, Fischer M, Schunkert H, Laugwitz KL, Mehilli J, Byrne RA, **Kastrati A**, Schulz-Schupke S. Validation of the DAPT score in patients randomized to 6 or 12 months clopidogrel after predominantly second-generation drug-eluting stents. *Thromb Haemost.* 2017; 117:1989-1999

40. Head SJ, da Costa BR, Beumer B, Stefanini GG, Alfonso F, Clemmensen PM, Collet JP, Cremer J, Falk V, Filippatos G, Hamm C, Kappetein AP, **Kastrati A**, Knuuti J, Kolh P, Landmesser U, Laufer G, Neumann FJ, Richter DJ, Schauerte P, Taggart DP, Torracca L, Valgimigli M, Wijns W, Witkowski A, Windecker S, Juni P, Sousa-Uva M. Adverse events while awaiting myocardial revascularization: a systematic review and meta-analysis. *Eur J Cardiothorac Surg.* 2017; 52:206-217

41. Husser O, Kim WK, Pellegrini C, Holzamer A, Walther T, Mayr PN, Joner M, Kasel AM, Trenkwalder T, Michel J, Rheude T, **Kastrati A**, Schunkert H, Burgdorf C, Hilker M, Mollmann H, Hengstenberg C. Multicenter Comparison of Novel Self-Expanding Versus Balloon-Expandable Transcatheter Heart Valves. *JACC Cardiovasc Interv.* 2017; 10:2078-2087

42. Husser O, Nunez J, Burgdorf C, Holzamer A, Templin C, Kessler T, Bodi V, Sanchis J, Pellegrini C, Luchner A, Maier LS, Schmid C, Luscher TF, Schunkert H, **Kastrati A**, Hilker M, Hengstenberg C. Improvement in Risk Stratification in Transcatheter Aortic Valve Implantation Using a Combination of the Tumor Marker CA125 and the Logistic EuroSCORE. *Rev Esp Cardiol (Engl Ed).* 2017; 70:186-193

43. Iijima R, Ndrepepa G, Kujath V, Harada Y, Kufner S, Schunkert H, Nakamura M, **Kastrati A**. A pan-coronary artery angiographic study of the association between diabetes mellitus and progression or regression of coronary atherosclerosis. *Heart Vessels.* 2017; 32:376-384

44. Jobs A, Mehta SR, Montalescot G, Vicaut E, Van't Hof AWJ, Badings EA, Neumann FJ,

Kastrati A, Sciahbasi A, Reuter PG, Lapostolle F, Milosevic A, Stankovic G, Milasinovic D, Vonthein R, Desch S, Thiele H. Optimal timing of an invasive strategy in patients with non-ST-elevation acute coronary syndrome: a meta-analysis of randomised trials. *Lancet*. 2017; 390:737-746

45. Kadriu S., **Malollari I.**, Pula-Beqiri L., Aliu M., Sadiku M., Baruti B., Kelmendi M., Presence Of Heavy Metals In Water And Sediment Of Rivers Trepca And Sitnica, *Journal Of Environmental Protection And Ecology* 18, No 1, 10-21 (2017) (Impact Factor)

46. Karaj S., **Gruda N.**, Ibraliu A., Mueller J. 2017. Medicinal and Spice Plants in Albania. *Journal of Medicinal & Spice Plants* 22 (2), 66-68.

47. Karaj Sh., **Gruda N.** Ibraliu A., Müller J. 2017: Das Potential der Arznei- und Gewürzpflanzen in Albanien, Fakten und Daten. 27. Bernburger Winterseminar für Arznei- und Gewürzpflanzen, 21-22. Februar, Bernburg.

48. Karaj, S, **Gruda N.**, Buscher M., Müller J. 2017: Production of *Valeriana officinalis* roots in different soil structure in East Albania. VII Southeastern Europe Symposium on Vegetables and Potatoes in Maribor, Slovenia 20-23 June 2017. ISHS, Book of Abstracts, 62.

49. Karakus M., **Durresi A.** "Quality of Service (QoS) in Software Defined Networking (SDN): A Survey," *Journal of Network and Computer Applications*, Volume 80, 15 February 2017, Pages 200-218

50. Karakus M., **Durresi A.**, "A Survey: Control Plane Scalability Issues and Approaches in Software-Defined Networking, (SDN)," *Computer Networks*, Volume 112, 15 January 2017, Pages 279-293

51. Karakus M., **Durresi A.**, "Service Cost in Software Defined Networking (SDN)," in *Proceedings of the 31-st IEEE International Conference on Advanced Information Networking and Applications (AINA-2017)*

52. Kessler T, Wobst J, Wolf B, Eckhold J, Vilne B, Hollstein R, von Ameln S, Dang TA, Sager HB, Moritz Rumpf P, Aherrahrou R, **Kastrati A**, Bjorkegren JLM, Erdmann J, Lusus AJ, Civelek M, Kaiser FJ, Schunkert H. Functional Characterization of the GUCY1A3 Coronary Artery Disease Risk Locus. *Circulation*. 2017; 136:476-489

53. Khater M., de la Escosura-Muñiz A., **Merkoçi A.** "Biosensors for plant pathogen detection", *Biosensors and Bioelectronics*, 93, 2017, 72-86.

54. Kim YG, Suh JW, Sibbing D, **Kastrati A**, Ko YG, Jang Y, Cho YS, Youn TJ, Chae IH, Choi DJ, Kim HS. A laboratory association between hemoglobin and VerifyNow P2Y12 reaction unit: A systematic review and meta-analysis. *Am Heart J*. 2017; 188:53-64

55. **Kongjika E.**, Sota V. 2017. New opportunities of plant biotechnology in Albania using nanomaterials. *JNTS (Journal of Natural and Technical Sciences)*. Special Edition, No. 43. XXII, 23-37, http://akad.gov.al/ash/pdf/periodike/07_jnts_1_2017.

56. **Kongjika E.**, Sota V., Damiano C. 2017. Costituzione di collezioni in vitro di alcune importanti specie arboree "minori" da frutto, *Acta Italus Hortus* (in press).

57. Kufner S, Joner M, Schneider S, Tolg R, Zrenner B, Repp J, Starkmann A, Xhepa E, Ibrahim T, Cassese S, Fusaro M, Ott I, Hengstenberg C, Schunkert H, Abdel-Wahab M, Laugwitz KL, **Kastrati A**, Byrne RA, Investigators I-D. Neointimal Modification With Scoring Balloon and Efficacy of Drug-Coated Balloon Therapy in Patients With Restenosis in Drug-Eluting Coronary Stents: A Randomized Controlled Trial. *JACC Cardiovasc Interv*. 2017; 10:1332-1340

58. Kurbanoglu S., Ozkan S. A., **Merkoçi A.**, "Nanomaterials-based enzyme electrochemical biosensors operating through inhibition for biosensing applications", *Biosensors and Bioelectronics*, 89, 2017, 886-898

59. Kurbanoglu S., Rivas L., Ozkan S. A., **Merkoçi A.**, “Electrochemically reduced graphene and iridium oxide nanoparticles for inhibition-based angiotensin-converting enzyme inhibitor detection”, *Biosensors and Bioelectronics* 88 (2017)122-129

60. Lesevic H, Karl M, Braun D, Barthel P, Orban M, Pache J, Hadamitzky M, Mehilli J, Stecher L, Massberg S, Ott I, Schunkert H, **Kastrati A**, Sonne C, Hausleiter J. Long-Term Outcomes After MitraClip Implantation According to the Presence or Absence of EVEREST Inclusion Criteria. *Am J Cardiol.* 2017; 119:1255-1261

61. Liu J., Morales-Narváez E., Orozco J., Vicent T., Zhong G., **Merkoçi A.** Bioluminescent Nanopaper for the Fast Screening of Toxic Substances, *Nano Research*, 2017, In print.

62. Mandija F., Bushati J., **Vila F.**, “The Climatology of the Aerosol load over Shkodra lake; Assessment of the Main Sources and Inter - Annual Trends Based on Remote Sensing Technologies and Model outputs”, Abstract Book, (MENSEC), p.69, October 19 - 22, 2017, Podgorica, Montenegro.

63. Montón H., Medina-Sánchez M., Antoni Soler J., Chałupniak A., Nogués C., **Merkoçi A.**, Rapid on-chip apoptosis assay on human carcinoma cells based on annexinV/quantum dot probes, *Biosensors and Bioelectronics* 94 (2017) 408-414

64. Morales-Narváez E., Baptista-Pires L., Zamora-Gálvez A. and **Merkoçi A.** “Graphene-based biosensors: Going simple”, *Advanced Materials*, 2017, 29, 1604905

65. Morales-Narváez E., Florio Sgobbi L., Spinola Machado S. A., **Merkoçi A.**, “Graphene-encapsulated materials: synthesis, applications and trends”, *Progress in Materials Science*, *Progress in Materials Science* 86 (2017) 1-24

66. Muller AM, Langwieser N, Bradaric C, Haller B, Fusaro M, Ott I, von Beckerath N, **Kastrati A**, Laugwitz KL, Ibrahim T. Endovascular Treatment for Steno-Occlusive Iliac Artery Disease: Safety and Long-Term Outcome. *Angiology.* 2017;3319717720052

67. Ndrepepa G, Colleran R, **Kastrati A.** Gamma-glutamyl transferase and the risk of atherosclerosis and coronary heart disease. *Clin Chim Acta.* 2018; 476:130-138

68. Ndrepepa G, Colleran R, **Kastrati A.** Reperfusion injury in ST-segment elevation myocardial infarction: the final frontier. *Coron Artery Dis.* 2017; 28:253-262

69. Ndrepepa G, Colleran R, **Kastrati A.** Reply: Baseline or Post-Procedural High-Sensitivity Troponin? Probably Both. *J Am Coll Cardiol.* 2017; 69:1994-1995

70. Ndrepepa G, Holdenrieder S, Cassese S, Fusaro M, Xhepa E, Laugwitz KL, Schunkert H, **Kastrati A.** A comparison of gamma-glutamyl transferase and alkaline phosphatase as prognostic markers in patients with coronary heart disease. *Nutr Metab Cardiovasc Dis.* 2018; 28:64-70

71. Ndrepepa G, Holdenrieder S, Xhepa E, Cassese S, Fusaro M, Laugwitz KL, Schunkert H, **Kastrati A.** Prognostic value of alkaline phosphatase in patients with acute coronary syndromes. *Clin Biochem.* 2017; 50:828-834

72. Ndrepepa G, **Kastrati A.** Response to the letter to the editor: Mortality risk of elevated alkaline phosphatase in patients with coronary artery disease and percutaneous coronary intervention. *Clin Biochem.* 2017; 50:1328-1329

73. Ndrepepa G, Xhepa E, Braun S, Cassese S, Fusaro M, Schunkert H, **Kastrati A.** Alkaline phosphatase and prognosis in patients with coronary artery disease. *Eur J Clin Invest.* 2017; 47:378-387

74. Ndrepepa G, Xhepa E, Colleran R, Braun S, Cassese S, Fusaro M, Laugwitz KL, **Kastrati A.** Gamma-glutamyl transferase and atrial fibrillation in patients with coronary artery disease. *Clin Chim Acta.* 2017; 465:17-21

75. Nelson CP, Goel A, Butterworth AS, Kanoni S, Webb TR, Marouli E, Zeng L, Ntalla I, Lai FY, Hopewell JC, Giannakopoulou O, Jiang T, Hamby SE, Di Angelantonio E, Assimes TL, Bottinger EP, Chambers JC, Clarke R, Palmer CNA, Cubbon RM, Ellinor P, Ermel R, Evangelou E, Franks PW, Grace C, Gu D, Hingorani AD, Howson JMM, Ingelsson E, **Kastrati A**, Kessler T, Kyriakou T, Lehtimaki T, Lu X, Lu Y, Marz W, McPherson R, Metspalu A, Pujades-Rodriguez M, Ruusalepp A, Schadt EE, Schmidt AF, Sweeting MJ, Zalloua PA, AlGhalayini K, Keavney BD, Kooner JS, Loos RJF, Patel RS, Rutter MK, Tomaszewski M, Tzoulaki I, Zeggini E, Erdmann J, Dedoussis G, Bjorkegren JLM, Consortium E-C, CardioGramplusC4D, group UKBCCCw, Schunkert H, Farrall M, Danesh J, Samani NJ, Watkins H, Deloukas P. Association analyses based on false discovery rate implicate new loci for coronary artery disease. *Nat Genet.* 2017; 49:1385-1391

76. Orban M, Orban M, Lesevic H, Braun D, Deseive S, Sonne C, Hutterer L, Grebmer C, Khandoga A, Pache J, Mehilli J, Schunkert H, **Kastrati A**, Hagl C, Bauer A, Massberg S, Boekstegers P, Nabauer M, Ott I, Hausleiter J. Predictors for long-term survival after transcatheter edge-to-edge mitral valve repair. *J Interv Cardiol.* 2017; 30:226-233

77. Ott I, Cassese S, Groha P, Steppich B, Hadamitzky M, Ibrahim T, Kufner S, Dewitz K, Hiendlmayer R, Laugwitz KL, Schunkert H, **Kastrati A**, Fusaro M. Randomized Comparison of Paclitaxel-Eluting Balloon and Stenting Versus Plain Balloon Plus Stenting Versus Directional Atherectomy for Femoral Artery Disease (ISAR-STATH). *Circulation.* 2017; 135:2218-2226

78. Ott I, Shivaraju A, Schaffer NR, Frangieh AH, Michel J, Husser O, Hengstenberg C, Mayr P, Colleran R, Pellegrini C, Cassese S, Fusaro M, Schunkert H, **Kastrati A**, Kasel AM. Parallel suture technique with ProGlide: a novel method for management of vascular access during transcatheter aortic valve implantation (TAVI). *EuroIntervention.* 2017; 13:928-934

79. Owens H., **Durresi A.**, "Multi-Domain Video over Software-Defined Networking (MDVSDN)," in Proceedings of the 31-st IEEE International Conference on Advanced Information Networking and Applications (AINA-2017)

80. Palmerini T, Bacchi Reggiani L, Della Riva D, Romanello M, Feres F, Abizaid A, Gilard M, Morice MC, Valgimigli M, Hong MK, Kim BK, Jang Y, Kim HS, Park KW, Colombo A, Chieffo A, Ahn JM, Park SJ, Schupke S, **Kastrati A**, Montalescot G, Steg PG, Diallo A, Vicaut E, Helft G, Biondi-Zoccai G, Xu B, Han Y, Genereux P, Bhatt DL, Stone GW. Bleeding-Related Deaths in Relation to the Duration of Dual-Antiplatelet Therapy After Coronary Stenting. *J Am Coll Cardiol.* 2017; 69:2011-2022

81. Paruchuri V., **Durresi A.**, "LEAS: A Load-Aware Energy-Efficient Adaptive Scheduling for Heterogeneous Wireless Sensor Networks," In Advances in Network-Based Information Systems. NBIS 2017. Lecture Notes on Data Engineering and Communications Technologies, vol 7. Springer, Cham

82. Paruchuri V., **Durresi A.**, "Optimal Transmission Range in Sleeping Wireless Networks," In Advances in Network-Based Information Systems. NBIS 2017. Lecture Notes on Data Engineering and Communications Technologies, vol 7. Springer, Cham

83. Pinguli L., **Malollari I.**, Lici L. Optimization of Cleaning Process in breweries an important tool in efficient use of water and minimization discharges. *European Journal of Engineering and Technology*, Volume 5, No 4, 2017.

84. Pino F., Mayorga-Martinez C.C., **Merkoçi A.**, "High-performance sensor based on copper oxide nanoparticles for dual detection of phenolic compounds and a pesticide", *Electrochemistry Communications* 71 (2016) 33-37

85. Popsimonova, G., B. Benko, L. Karic and **Gruda N.** 2017: Production systems in SEE greenhouses. VII Southeastern Europe Symposium on Vegetables and Potatoes in Maribor, Slovenia 20-23 June 2017. ISHS, Book of Abstracts, 55.

86. Prespa E., **Kacani J.**, Shehu Y. "Quantitative analysis of phase precipitation of the magnesium alloy in dependence of various heat treatment processes" European Academic Research (EAR), (ISSN: 2286 - 4822), Volume V, Issue 3/ Qeshor 2017, www.euacademic.org

87. Quesada D., **Merkoçi A.**, "Mobile phone-based biosensing: an emerging "diagnostic and communication" technology", Biosensors and Bioelectronics, Volume 92, 15 June 2017, Pages 549-562

88. **Resuli B.** Acute-on-chronic liver failure in patients with liver cirrhosis. World Journal of Research and Review, 2017, vol.4, Issue 6, 25-28.

89. Rheude T, Pellegrini C, Michel J, Trenkwalder T, Mayr NP, Kessler T, Kasel AM, Schunkert H, **Kastrati A**, Hengstenberg C, Husser O. Prognostic impact of anemia and iron-deficiency anemia in a contemporary cohort of patients undergoing transcatheter aortic valve implantation. *Int J Cardiol.* 2017; 244:93-99

90. Rista E, Pilaca A., Harja E.,... Bino S., Çadri V., Kota M., **Thereska N.**, Harxhi A. Hemorrhagic fever with renal syndrome in Albania. Focus on predictors of acute kidney injury in HFRS: Journal o Clinical Virology, 2017 Elsevier B.V

91. Rista E., Dyrmishi B., Hoxha E., Harja E., Kolovani E., Çadri V., **Thereska N.** A case with acute kidney injury, thrombocytopenia and hyperbilirubinemia due to leptospirosis, JSSW: 2312-7678, 2017

92. Ruan Y, **Durresi A.** "Measurement Theory Based Trust Management Framework for Online Social Communities," ACM Transactions on Internet Technology, Volume 17 Issue 2, May 2017, Article No. 16

93. Ruan Y, **Durresi A.** "A Trust Management Framework for Cloud Computing Platforms," in Proceedings of The 31-st IEEE International Conference on Advanced Information Networking and Applications (AINA-2017)

94. Siepi M., Morales-Narváez E., Domingo N., Monti D. M., Notomista E., **Merkoçi A.** Production of biofunctionalized MoS₂ flakes with rationally modified lysozyme: a biocompatible 2D hybrid material, 2D Mater. 4 (2017) 035007

95. Sota V., Çuko B., **Kongjika E.** 2017. Effect of salinity stress on *in vitro* propagation of different wheat cultivars (*Triticum aestivum* L.). *Albanian j. Agric. Sci.* Open access, p. 59 - 65.

96. Sota V., **Kongjika E.**, Damiano C. 2017. Collezioni in vitro di alcune specie autoctone del genere Prunus in Albania, *Acta Italus Hortus* (in press).

97. Sota V., Themeli S., Zekaj Zh. & **Kongjika E.** 2017. Aplikimi i citokininave ekzogjene shkakton ndryshime në parametrat e gojëzave dhe trikomave gjendrore në bimët e rozmarinës të rigjeneruara *in vitro*. Numër Special. *Buletini i Shkencave Natyrore* (në botim).

98. Stefanini GG, Byrne RA, Windecker S, **Kastrati A.** State of the art: coronary artery stents - past, present and future. *EuroIntervention.* 2017; 13:706-716

99. Steppich B, Groha P, Ibrahim T, Schunkert H, Laugwitz KL, Hadamitzky M, **Kastrati A**, Ott I, Regeneration of Vital Myocardium in STSEMIBESI. Effect of Erythropoietin in patients with acute myocardial infarction: five-year results of the REVIVAL-3 trial. *BMC Cardiovasc Disord.* 2017; 17:38

100. SHEME E., Lucanin D., **Frasheri N.**, Holmbacka S., L. Sébastien. "Feasibility of Using Renewable Energy to Supply Data Centers in 60 Degrees North Latitude". Elsevier Journal "Sustainable Computing, Informatics and Systems", 31 October 2017.

101. Taraj K., **Malollari I.**, Andoni A., Ciko L., Lazo P., Ylli F., Osmeni A., Como A. Eco-Extraction Of Albanian Chamomile Essential Oils By Liquid Co₂ At Different Temperatures And Characterisation By FTIR, Spectroscopy, Journal Of Environmental Protection And Ecology 18, No 1, 117-124 (2017), (Impact Factor)

102. Vaso T., Xhagolli L., **Malollari I.** A comparative study of kinetic immobilized yeast parameter in batch fermentation process. *European Journal Of Advanced Research In Biological And Life Sciences*. Vol 5, No 3, 2017. ISSN 2056-5984.

103. Vaso T., Xhagolli L., **Malollari I.** A comparative study of kinetic immobilized yeast parameter in batch fermentation process. *European Journal Of Advanced Research In Biological And Life Sciences*. Vol 5, No 3, 2017. ISSN 2056-5984.

104. Vaso T., Xhagolli L., **Malollari I.** Kinetic modeling of immobilized Yeast Batch Fermentation. *International Journal of Engineering Research & Sciences*. ISSN 2395-6992. Vol 3; Issue 6. PP: 49-55. June 2017/IJOER-JUN-2017-7. DOI: 10.25125

105. **Vila F., Frashëri N.,** Mandija F., “Vlerësimi satelitor dhe lokal i aerosoleve në zonën e Shkodrës, “Java e Shkencës”, f. 495-507, Prishtinë, 2017. ISBN 978-9951-16-112-1

106. **Vila F., Malollari I.,** Premti Dh., Spahiu I., “Vlerësimi i disa karakteristikave standarte të atmosferës për qëllime referimi duke përdorur dhomën klimatike”, Libri i abstrakteve, Java e Shkencës 2007, 253-254, Prishtinë, 2017. ISBN 978-9951-16-111-4

107. Webb TR, Erdmann J, Stirrups KE, Stitzel NO, Masca NG, Jansen H, Kanoni S, Nelson CP, Ferrario PG, König IR, Eicher JD, Johnson AD, Hamby SE, Betsholtz C, Ruusalepp A, Franzen O, Schadt EE, Björkegren JL, Weeke PE, Auer PL, Schick UM, Lu Y, Zhang H, Dube MP, Goel A, Farrall M, Peloso GM, Won HH, Do R, van Iperen E, Kruppa J, Mahajan A, Scott RA, Willenborg C, Braund PS, van Capelleveen JC, Doney AS, Donnelly LA, Asselta R, Merlini PA, Duga S, Marziliano N, Denny JC, Shaffer C, El-Mokhtari NE, Franke A, Heilmann S, Hengstenberg C, Hoffmann P, Holmen OL, Hveem K, Jansson JH, Jöckel KH, Kessler T, Kriebel J, Laugwitz KL, Marouli E, Martinelli N, McCarthy MI, Van Zuydam NR, Meisinger C, Esko T, Mihailov E, Escher SA, Alver M, Moebus S, Morris AD, Virtamo J, Nikpay M, Olivieri O, Probst S, AlQarawi A, Robertson NR, Akinkunle KO, Reilly DF, Vogt TF, Yin W, Asselbergs FW, Kooperberg C, Jackson RD, Stahl E, Müller-Nurasyid M, Strauch K, Varga TV, Waldenberger M, Wellcome Trust Case Control C, Zeng L, Chowdhury R, Salomaa V, Ford I, Jukema JW, Amouyel P, Kontto J, Investigators M, Nordestgaard BG, Ferrières J, Saleheen D, Sattar N, Surendran P, Wagner A, Young R, Howson JM, Butterworth AS, Danesh J, Ardisino D, Bottinger EP, Erbel R, Franks PW, Girelli D, Hall AS, Hovingh GK, **Kastrati A,** Lieb W, Meitinger T, Kraus WE, Shah SH, McPherson R, Orho-Melander M, Melander O, Metspalu A, Palmer CN, Peters A, Rader DJ, Reilly MP, Loos RJ, Reiner AP, Roden DM, Tardif JC, Thompson JR, Wareham NJ, Watkins H, Willer CJ, Samani NJ, Schunkert H, Deloukas P, Kathiresan S, Myocardial Infarction G, Investigators CAEC. Systematic Evaluation of Pleiotropy Identifies 6 Further Loci Associated with Coronary Artery Disease. *J Am Coll Cardiol*. 2017;69:823-836

108. Wiebe J, Dorr O, Ilstad H, Husser O, Liebetrau C, Boeder N, Bauer T, Mollmann H, **Kastrati A,** Hamm CW, Nef HM. Everolimus- Versus Novolimus-Eluting Bioresorbable Scaffolds for the Treatment of Coronary Artery Disease: A Matched Comparison. *JACC Cardiovasc Interv*. 2017; 10:477-485

109. Wiebe J, Hoppmann P, Colleran R, Kufner S, Valeskini M, Cassese S, Schneider S, Joner M, Schunkert H, Laugwitz KL, **Kastrati A,** Byrne RA. Long-Term Clinical Outcomes of Patients Treated with Everolimus-Eluting Bioresorbable Stents in Routine Practice: 2-Year Results of the ISAR-ABSORB Registry. *JACC Cardiovasc Interv*. 2017; 10:1222-1229

110. Xhepa E, Tada T, Kufner S, Ndrepepa G, Byrne RA, Kreutzer J, Ibrahim T, Tiroch K, Valgimigli M, Tolg R, Cassese S, Fusaro M, Schunkert H, Laugwitz KL, Mehilli J, **Kastrati A.** Long-term prognostic value of risk scores after drug-eluting stent implantation for unprotected left main coronary artery: A pooled analysis of the ISAR-LEFT-MAIN and ISAR-LEFT-MAIN 2 randomized clinical trials. *Catheter Cardiovasc Interv*. 2017; 89:1-10

111. Zamora-Gálvez A., Mayorga-Matinez C. C., Parolo C., Pons J., **Merkoçi A.**, “Magnetic nanoparticle-molecular imprinted polymer: A new impedimetric sensor for tributyltin detection”, *Electrochemistry Communications*, 82, 2017, 6-11

112. Zhang P., Durresi M., **Durresi A.**, “Enhanced Internet Mobility and Privacy Using Public Cloud,” *Mobile Information Systems*, Volume 2017 (2017), Article ID 4725858, 11 pages

IV. AKTIVITETE TE TJERA

Anesti Kondili

Kursi i edukimit për faktorët e rrezikut kardiovaskular dhe sëmundjen ishemike të zemrës, Viti i II. “Infarkti akut i miokardit, diagnoza e komplikacionet”. Për mjekët e përgjithshëm, të familjes, dhe specialistët e shërbimit ambulator në Shqipëri organizuar nga kompania Berlin Chemie

- me mjekët e Tiranës Hotel Sheraton 8 prill.2017
- me mjekët e Durrësit,Kavajë,Krujë Durrës 20 maj 2017
- me mjekët e Elbasanit Elbasan 23 shtator 2017
- me mjekët e Shkodrës Universiteti “Luigj Gurakuqi” Shkodër 07 tetor 2017
- me mjekët e Beratit Kompleksi Blerimi Lushnjë 1 korrik 2017
- me mjekët e Sarandës Hotel Butrinti Sarandë 28 tetor 2017
- me mjekët e Korçës Hotel Palace Korçë 18 nëntor 2017
- me mjekët e Lezhës , Dibrës Lezhë 2 dhjetor 2017

Zv. Rektor për aktivitetin Shkencor

Pjesëmarrje në organizimin e konferencave shkencore të Universitetit në fushat e stomatologjisë, farmacisë, infermierisë, psikologjisë, shkencave juridike , ekonomike dhe të ndërtim-arkitekturës

Kryeredaktor i revistës “OPTIME”

Arben.Merkoçi

Chairman of International Symposium on Sensor Science (I3S) 2017, Dates: 27 - 29 September 2017, Barcelona, Spain

Arjan Durresi

1. Co-Chair of BalkanCom 2017, First International Balkan Conference on Communications and Networking, Tirana, Albania, May 30-June 2, 2017

2. Co-Chair of The Tenth International Workshop on Bio and Intelligent Computing (BICom-2017), Tamkang Universit, Taipei, Taiwan, March 27 - 29, 2017. In conjunction with the 31-st International Conference on Advanced Information Networking and Applications (AINA-2017)

3. Co-Chair of the 13-th International Workshop on Heterogeneous Wireless Networks (HWISE-2017), Tamkang Universit, Taipei, Taiwan, March 27 - 29, 2017. In conjunction with the 31-st International Conference on Advanced Information Networking and Applications (AINA-2017)

4. Co-Chair of the 8th International Workshop on Trustworthy Computing and Security (TwCSec-2017), August 24-26, 2017, Ryerson University, Canada. In Conjunction with NBiS 2017 International Conference.

5. Co-Chair of the 11-th International Workshop on Advances in Information Security (WAIS-2016), July 10-12, 2017, Citta della Politecnica, Torino, Italy. In Conjunction with the 11-th International Conference on Innovative Mobile and Internet Services in Ubiquitous Computing (IMIS-2017)

6. Associate Editor of the *International Journal of Virtual Technology and Multimedia (IJVTM)*, Published by Inderscience Publishers, ISSN (Print): 1741-1874, March 2010 - present.

7. Editorial Board Member of the *Journal of Wireless Sensor Network*, Published by Scientific Research Publishing , ISSN Print: 1945-3078, ISSN Online: 1945-3086, 2011-Present.

8. Editorial Board Member of the *Journal of Network and Computer Applications* Published by Elsevier, ISSN: 1084-8045, April 2008 - present.

9. Area Editor of *ICST Transactions on Networks and Communications*, ISSN: 2032-9423 2009 - Present.

10. Editorial Board Member of the *Journal of Ubiquitous Computing and Intelligence -JUCI*, Published by American Scientific Publishers, 2005-present.

Efigjeni Kongjika

1. Anëtare e komitetit organizativ të konferencës shkencore ndërkombëtare “Kanceri i qafës së mitrës: parandalimi, diagnostikimi dhe trajtimi i tij”, ASH, Tirana, 4 shkurt 2017.

2. Organizatore e simpoziumit shkencor “Hortikultura Shqiptare: Gjendja dhe ardhmëria në këndvështrimin e studimit enciklopedik më të fundit të Akademisë së Shkencave”, Akademia e Shkencave, Tirana, 2 qershor 2017.

3. Organizatore e takimit shkencor për përrurimin e botimit “Pemëtaria dhe vreshtaria në Shqipëri dhe në Kosovë” (Kultivarët e vendit dhe prodhimi i fidanëve të pemëve frutore, hardhisë, ullirit dhe agrumeve), në kuadër të Panairit të Librit, organizuar në Prishtinë më 6 - 12 qershor 2017.

4. Organizatore e forumit shkencor “Kultivarët e vendit të pemëve frutore, hardhisë, ullirit dhe agrumeve në Shqipëri dhe në Kosovë dhe ndërtimi i sistemit shkencor të certifikimit për prodhimin e fidanëve” (në këndvështrimin e botimit të ri shkencor *Pemëtaria dhe vreshtaria në Shqipëri dhe në Kosovë*, në kuadër të Protokollit të Bashkëpunimit Shkencor dhe Artistik midis ASHSh dhe ASHAK), Tiranë, 22 nëntor 2017.

Floran Vila

Anëtar i Jurisë së çmimeve shkencore kombëtare vjetore të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë për vitin 2016

Jorgaq Kaçani

1. Kryetar i komitetit organizator te 1st International Conference “Engineering and Entrepreneurship” te mbajtur ne Universitetin Politeknik te Tiranës, Albania, 17-18 November

2. Anëtar i komitetit organizator të "1st International Forum on Architecture and Urbanism" të mbajtur në Universitetin Politeknik të Tiranës, Albania, 14-16 December

3. Kryetar i jurise për mbrojtjen e disertacionit me temë: "Menaxhimi i trafikut në nyjet multimodale të portit të Durrsit" përgatitur nga Ms. Eli Vyshka

4. Kryetar i jurise për mbrojtjen e disertacionit me temë: "Studimi i potencialit të fibrave natyrore vendase për tekstilet teknike" përgatitur nga Msc. Ilda Kola

5. Kryetar i jurise për mbrojtjen e disertacionit me temë "Sistemet inteligjente të transportit (SIT) në rajonin Tirane-Durrës" përgatitur nga Msc. Drakuli Lumi

6. Kryetar i Jurise për mbrojtjen e disertacionit me temë "Ndikimi i parametrave gjeometrike të sipërfaqes së kontaktit të çiftit Rrote-Shine dhe gjeometrise së vijes hekurudhore në konsumin e tyre. Rasti në studim: Vija hekurudhore Durrës-Elbasan-Lin."

Nazim Gruda

1. Drejtues i Grupit të Punës për Europën Juglindore (Chair of Workgroup for Vegetables and Potatoes), Shoqata Ndërkombëtare e Shkencave të Hortikulturës, qershor 2017 - vazhdim. Është hera e parë që në drejtimin e një grupi pune nga Shoqata Ndërkombëtare e Shkencave të Hortikulturës zgjidhet një shkencëtar nga Shqipëria.

2. Kryerja e detyrave në emër të Zyrës Federale të Bujqësisë dhe Ushqimit të Gjermanisë. Ato përfshijnë vlerësimin, miratimin dhe shoqërimin e disa projekteve kërkimore shkencore, nga aplikimet e universiteteve dhe shkollave të larta, institucioneve kërkimore shkencore, organizatave shtetërore e NGO-s, e ndërrmarjeve të prodhimit e shërbimit; si edhe raportimin e risive në fushën e kërkimit shkencor dhe zhvillimit eksperimental në fushën e bujqësisë dhe ushqimit, Gjermani.

3. Bashkëdrejtues i thirrjes për projekte kërkimore në fushën e ndikimit të ndryshimit të klimës ndaj rritjes së bimëve COP21, Gjermani.

4. Bashkërendues i projektit të standardeve të cilësisë së frutave dhe perimeve: Ministria e Bujqësisë, Shqipëri dhe Zyra Federale e Bujqësisë dhe e Ushqimit, Gjermani.

5. Bashkërendues i Grupit rajonor të punës "Prodhimet e serrave në Europën Jug-Lindore", FAO.

6. *Aktivite recensuese për Zyrën Federale të Ushqimit dhe Bujqësisë, Gjermani*

7. *Aktivitere recensuese për revista shkencore:*

- Acta Horticulturae

- Applied Soil Ecology

- Journal of the Science of Food and Agriculture

8. Biological Agriculture & Horticulture - An International Journal for Sustainable Production Systems

9. *Member of Editorial Boards*

- Co-Editor and coordinator of GAP for Vegetable Production in South Eastern European Countries, FAO

- Member of Editorial Board of "Horticulturae", an Open Access Journal from MDPI

- Member of Editorial Board of "Acta Scientiarum Polonorum: Hortorum Cultus"

- Regional Editor of "The Open Horticulture Journal"

- Member of Editorial Advisory Panel and Country Coordinating Editor of "Journal of Applied Horticulture"

- Member of Editorial Board of “Journal of Natural & Technical Sciences”
- Member of Editorial Board of Journal “Albanian Journal of Agriculture “

10. Artikuj dhe intervista në media

Entries mbi inovacionet e te rejat shkencore te projekteve te Zyres Federale te Bujqesisie dhe Ushqimit te Gjermanise.

Nestor Thereska

Anëtar i bordit shkencor për Kongresin Europian i sëmundjeve të veshkave për vendet e Ballkanit, Sarajevë, Tetor 2017

Petra Petro

Organizim i tre seminareve

- “Elementet inverse në unaza”.
- “ Γ -grupet e përgjithësuara, Γ -unazat inverse, Γ -unazat plotësisht inverse dhe Γ -unazat me pjesëtim të përgjithësuara”.
- “Unazat primitive, unazat gjysmë të thjeshta dhe radikali i Jacobson-it”.

IV. BASHKËPUNIM ME INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË

A. Mësimdhënia (leksione)

Arben Merkoçi,

Coordinator of the module “Nanodiagnostics” at “master of the Nanotechnology” at UAB and lectures (6 h) on nanobiosensors.

Arjan Durrësi

Advanced Mobility and Cloud Computing, graduate course, Indiana University Purdue University, USA, Pranvere 2017

Security Engineering, graduate course, Indiana University Purdue University, USA, Vjeshte 2017

Data Communications and Computer Networks, Indiana University Purdue University, USA, Vjeshte 2017.

Floran Vila

Cikli I Universitar, lënda: *Fizika Moderne*.

(Master) Cikli II Universitar, lëndët: *Bazat e Optikës, Probleme të Fizikës Moderne*.

(Shkolla e doktoraturës) Cikli III Universitar, lëndët: *Fizika e Atmosferës, Plotësime të Fizikës*.

Jorgaq Kaçani

Leksione në Fakultetin e Inxhinierise Mekanike, dega mekanike në bachelor leksione në lëndën “Teknologjia mekanike”, në master shkencor dhe professional në lëndën “Shkenca e saldimit”

Udhëheqje e disa tema diplomash në bachelor, master shkencor dhe ate professional.

Nazim Gruda

Bashkëligjërues në modulën “Horticultural Production Systems” (rreth 70 MSc-studentë), Rheinische Friedrich-Wilhelms-Universität Bonn, Germany.

Bashkëligjërues në modulin „Grundnahrungsmittel” (rreth 300 BSc-studentë), Rheinische Friedrich-Wilhelms-Universität Bonn, Gjermani.

Bashkëligjërues në modulin „Anbau und Physiologie der Sonderkulturen” (rreth 70 BSc-studentë), Rheinische Friedrich-Wilhelms-Universität Bonn, Gjermani.

Neki Frashëri

“Programimi në mjedise të shpërndara” (Bsc) dhe “Kriptografia” (Msc) në degën inxhinieri informatike në Fakultetin e Teknologjisë së Informacionit në Universitetin Politeknik Tiranë.

“Sistemet e shfrytëzimit” me degën e informatikës (Bsc) në Fakultetin Ekonomik, Universiteti i Tiranës (i jashtëm)

“Sistemet e shfrytëzimit” me degën e informatikës (Bsc) në Universitetin Mesdhetar (i jashtëm)

Udhëheqje diplomash Bsc, MP dhe Msc.

B. Kualifikimi shkencor (udhëheqje për doktorata dhe mastera)

Arben Merkoçi

1. Bentolhoda Heli Bacterial cellulose supported sensor for bacteria and gas detection development Polytechnique Montréal, Monthreal, Canada (Co-director prof. Abdellah Ajji) (04.11.2017)

2. Alejandro Zamora Nanobiosensors for diagnostics applications Autonomous University of Barcelona, Bellaterra (Barcelona), Spain (Co-directors: Carmen C. Mayorga Martinez and Edén Morales Narváez) (11.11.2017)

3. Andrzej Chalupniak Development of novel electrochemical and optical lab-on-a-chip platforms for contaminants and biomarkers sensing Autonomous University of Barcelona, Bellaterra (Barcelona) (27.11.2017)

4. Jie Liu Toxicity Bioassay and Bioremediation of Diuron Pollution Using Microorganism-decorated Nano Biocomposites Department of Pesticides, South China Agricultural University, Guangzhou, China (Co-director: dr. prof. Guohua Zhong) (03.12.2017)

Arjan Durrësi

1. Pinga Zhang, Yefeng Ruan, Lina Alfantoukh, Harold Owens, Murat Karakus Indiana University Purdue University USA:

2. Shpetim Latifi, South East European University, Tetove, Maqedoni

3. Esmeralda Make, Universiteti Politeknik i Tiranës

4. Kumud Bhat (master) Indiana University Purdue University

Floran Vila

“Studim mbi elektrizimin e polimerëve” (Doktorant Pranvera Dhima)

“Studim mbi karakteristikat elektrostatische dhe optike te aerosoleve atmosferike” (Doktorant Edmond Lukaj)

“Evolucioni i pikëpamjeve dualiste mbi dritën dhe lëndën” (Master Paola Gora)

Jorgaq Kaçani

“Perdorimi i materialeve kompozite ne mjetet detare tip Jaht” me disertante Ing Mirela Koci, ; dorezuar per mbrojtje.

“Vlerësimi i integritetit të strukturave të tubacioneve të gazit- Rast studimi Gazsjellesi TAP-Shqiperi”, me disertant Msc. Alfred Hasanaj.

Nazim Gruda

Cand. BSc. S. Landvogt. Undergraduate Mentor/bachelor's Thesis. Thesis title: “Biostimulants in Horticulture - A current Overview”, graduated October 2017. Rheinische Friedrich-Wilhelms-Universität Bonn.

Cand. BSc. D. Lassek. Undergraduate Mentor/Bachelor's Thesis Chairperson. Thesis title: “Der Einfluss von Effektiven Mikroorganismen auf eintriebige Sonnenblumen der Sorte ‘Sunray’ in Abhängigkeit der Anwendungsmethode”, graduated October 2017. Rheinische Friedrich-Wilhelms-Universität Bonn.

Neki Frashëri

Kujtim Hyseni (nga trojet - Presheva), Mbi sistemet e shpërndara të rregullimit (përgatitet për mbrojtje)

Igli Hakrama, Probleme të inteligjences artificiale në sistemet ekonomike

Nestor Thereska

Mimoza Bërbatovci-Ukimeraj “Aplikimi i eritropoetinës alfa dhe beta, përparësitë e tyre në përqëndrimin e HgB të të sëmurit me pamjaftueshmëri kronike të veshkave.”

Suela Mumajesi “Çregullimet renale gjatë sëmundjeve të zemrës”

Etleva Rista “Çregullimet renale gjatë leptospirozave”

Petra Petro

Orgest Beqiri: “ Γ -gjysmëgrupet inversive dhe Γ -unazat inversive” (mbrojtja Janar 2018).

Florion Cela: Relacionet e Green-it në unaza dhe lidhja e tyre me relacionet e Green-it në gjysmëgrupet e shumëzimit të unazave përkatëse”. (në proces)

V. DETYRA TË PARASHIKUARA PËR VITIN 2018

Arben Merkoçi

Vazhdim i i punës në projektet e EU, si dhe kërkim projektesh të tjera (H2020 etj.)

Udhëheqja e 2 doktoraturave (PhD)

Arjan Durrësi

Vazhdim i punës në projektet ekzistuese si dhe në projekte të reja.

Publikime në konferenca dhe revista shkencore.

Vazhdim në udhëheqjen shkencore të studentëve ekzistues.

Floran Vila

A. Elektrizimi i polimerëve

1 Përcaktimi i efektit të rrezatimit elektronik dhe i efektit të shkarkesës kurorë në përcjellshmërinë elektrike të polimerëve.

2 Krijimi i një metodike të re për përcaktimin e përcjellshmërisë elektrike të polimerëve, me anën e triodës kurorë (rasti i varësisë kuadratike të rrymës nga potenciali i grilës).

3 Përcaktimi i përcjellshmërisë elektrike specifike të polimerëve, me metodën e rënies së potencialit të sipërfaqes, pas ngarkimit me anën e triodës kurorë.

4 Krahasimi dhe interpretimi i rezultateve të marra me metoda të ndryshme.

B. Fizika Atmosferës

1 Përcaktimi i karakteristikave kryesore optike dhe mikro-fizike të aerosoleve në rajonin e Shqipërisë.

2 Përpunimi i të dhënave të modeleve bashkëkohore për karakteristikat kryesore optike të aerosoleve.

3 Përpunimi i të dhënave satelitore (MODIS-NASA) për vetitë e aerosoleve.

4 Identifikimi i ngjarjeve me ngarkesë të lartë aerosolësh, si dhe përcaktimi i origjinës së tyre.

5 Përcaktimi i cikleve vjetore dhe trendeve ndër-vjetore, të këtyre karakteristikave të aerosoleve.

6 Nxjerja e konkluzioneve përkatëse mbi mbi analizën e të dhënave.

C. Udhëheqja e doktoratave dhe diplomave të masterit shkencor

D. Leksione, sipas parashikimit, në Fakultetin e Shkencave të Natyrës të Universitetit të Tiranës.

Nestor Thereska

Përgatitja e një projekti mbi kancerin e prostatit në Shqipëri. Studim disavjeçar

Petra Petro

Udhëheqja e disertantit Florion Cela.

Shkrimi dhe botimi i 2 artikujve shkencorë

Organizim i tre seminare shkencore në teorinë e unazave, dhe në teorinë e gjysmëgrupeve e përgjithësimeve të tyre.

B. Veprimtaria individuale e anëtarëve të SSHSHA

(shih: <http://akad.gov.al/ash/seksionet-ash/sshsha/anetar-sshsha>)

Projekte ndërkombëtare në kuadër të programeve të BE (FP6 dhe FP7 etj.) dhe të organizatave të tjera.

1. **Akad. Artan Fuga.** Drejtues shkencor i projektit studimor: *Modelet ekonomike të industrisë së medias në Shqipëri*. Projekt shkencor në grupin e kërkimit shkencor të Departamentit të Gazetarisë dhe Komunikimit të UT, me financimin e Autoritetit të Mediave Audiovizive, si edhe me partneritet dhe koordinim shkencor me IPAG - France, Ladyss, CNRS - France, Revue Européenne Des Médias.

2. **Akad. Anastas Angjeli.** Është bashkëfitues dhe zbatues i dy projekteve: “*Erasmus plus*” 2016-2017; “*Erasmus plus*”, Social rights in my hands, në “Universitetin Mesdhetar të Shqipërisë”.

3. **Akad. Aurela Anastasi.** Eksperte e nivelit të lartë të projektit për *Reformën në Drejtësi* pranë Kuvendit të Republikës së Shqipërisë. Rezultatet e punës si bashkautore: *Analizë e Sistemit të Drejtësisë në Shqipëri*, botuar në: <http://reformenadretjesi.al/dokumenti-analitik>; *Strategjia e Reformës në Sistemin e Drejtësisë*, botuar në: <http://reformenadretjesi.al/strategjia-e-reformes-ne-sistemin-e-drejtësisë-0>; *Projekti i Amendamenteve Kushtetuese për Reformën në Drejtësi*; botuar në disa variante: <http://reformenadretjesi.al/publikime>; Referimi në 12 konferenca rajonale për njohjen e publikut me ndryshimet kushtetuese, 5 nga të cilat në universitet e Vlorës, Shkodrës dhe Durrësit; informacioni mund të gjendet në: <http://reformenadretjesi.al/aktivitetet>

4. **Akad. Beqir Meta.** Redaktimi përfundimtar shkencor dhe përgatitja për botim i vëllimit I, *Historia e shqiptarëve gjatë shek. XX*, 650 f.; Përmirësimi i mëtejshëm i pjesëve të shkruara prej prof. B. Metës, për këtë vëllim, 110 f.

5. **Akad. Marenglen Verli.** Projekte shkencore kombëtare: “*Historia e shqiptarëve gjatë shek. XX*”, vëll. I (rreth 650 faqe). Monografi kolektive. Plotësimi me aparatën e duhur shkencor i pjesëve të hartuara prej tij (rreth 150 faqe), redaktimi i pjesëve të autorëve nga Kosova (rreth 200 faqe) dhe plotësimi i vëllimit me ilustrime; b) Plotësimi me rreth 250 faqe shtesë, pajisja me ilustrime dhe botimi i vëllimit “*101 profile biografike*”. Nga Kosova për Kosovën (rreth 1200 faqe).

6. **Akad. Marenglen Verli.** Projekte shkencore ndërkombëtare: a) Fillim i punës hulumtuese për projektin - *Historia e Kosovës* (projekt i Institutit të Historisë së Republikës së Kosovës); b) U iniciua hartimi i projektit për organizimin e konferencës ndërkombëtare kushtuar vitit jubilar të Gjergj Kastriotit - Skënderbeut (me rastin e 550-vjetorit të vdekjes), që do të realizohet nga Akademia e Studimeve Albanologjike në bashkëpunim me Akademinë e Shkencave dhe Universitetin e Tiranës; c) Drejton punën për përgatitjen e kolanës me rreth 20 botime të Akademisë së Studimeve Albanologjike (monografi, përmbledhje studimesh dhe dokumente) kushtuar Vitit Jubilar të Skënderbeut).

7. **Akad. asoc. Shaban Sinani.** *Vlerësues i jashtëm i agjencisë ndërkombëtare ANVUR* (për vlerësimin e librit të këshillueshëm në sistemin universitar).

8. Akad. asoc. Shaban Sinani. Referent i jashtëm për projektin e Akademisë së Shkencave të Bullgarisë *About the Corpora of Premodern Mural Painting*, miratuar si projekt i UAI.

9. Akad. asoc. Shaban Sinani. Në komitetin shkencor organizator të *konferencës për Voskopojën*, organizuar nga Akademia e Shkencave.

10. Akad. asoc. Shaban Sinani. Në komitetin shkencor organizator për konferencën *për lidhjet shqiptaro-sllave*, organizuar nga Univeriteti i Vlorës, Univeriteti i Beogradit dhe Akademia e Shkencave.

11. Akad. asoc. Shaban Sinani. Në komitetin shkencor organizator të konferencës kushtuar *Mitrush Kutelit*, organizuar nga Univeriteti i Korçës dhe Akademia e Shkencave.

12. Akad. asoc. Shaban Sinani. Në komitetin shkencor organizator të konferencës ndërkombëtare *kushtuar Naim Frashërit*, organizuar nga Univeriteti i Teheranit e Akademia e Shkencave.

III. Pjesëmarrje në konferenca, seminare shkencore

Anëtarët e SSHSHA, kanë qenë aktivë me pjesëmarrjen e tyre në konferenca shkencore brenda e jashtë vendit. Midis tyre mund të përmendim:

Jashtë vendit:

1. Akad. Albert Doja. "The current *Kulturpolitik* of knowledge in between and betwixt colonial, national-communist and post-colonial post-communist contexts", Paper presented at the *Making of the Humanities Conference VI*, Somerville College, University of Oxford, 28-30 September 2017;

2. Akad. Albert Doja. "The Morphodynamics of Social Reality: Mapping Identity Transformations, Cultural Encounters, Core Values and other Challenges to European Integration", Project Proposal presented at the Visiting Scholars Seminar, Center for European Studies, Harvard University, Cambridge (MA), 20 September 2017. (Video at <https://youtu.be/xvzTvHzVGkk>);

3. Akad. Albert Doja. "Anthropological Perspectives on the Society and Governance of International Relations", Paper presented at the *International Union of Anthropological and Ethnological Sciences (IUAES) and Canadian Anthropology Society (CASCA) Conference*, University of Ottawa (Canada), 2-7 May 2017;

4. Akad. Albert Doja. "The politics of identity from pre-modern times in modern constructivist perspectives", Paper presented at the *27th ASEN Conference on Anthony D. Smith and the Future of Nationalism: Ethnicity, Religion and Culture*, London School of Economics, 27-28 March 2017;

5. Akad. Albert Doja. "From Ideological Construction to War and Thereafter: A Socio-Anthropological Account of the Balkan Wars" [with Enika Abazi], Paper presented at the *Peace and Conflict Studies from the Margins to the Center: Rethinking Europe in an Unequal World*, Joint Conference of European Peace Research Association (EuPRA) and German Association for Peace and Conflict Studies (AFK), Schwerte/Dortmund (Germany), 16-18 March 2017;

6. Akad. Albert Doja. "Pride and Prejudice: The Global Politics of Hooliganism and Nationalism in a Local Football Game between Serbia and Albania" [with Enika Abazi], Paper presented at the *Football as an Instrument of Nation-Building*, Federation Internationale de Football Association and Schwabenakademie Irsee Conference, FIFA Headquarters, Zürich (Switzerland), 17-19 February 2017;

7. Akad. Aurela Anastasi. *From CEDAW to Istanbul Convention: Where do we stand?*", referim në konferencën "Ending Violence against women in the Western Balkan countries and

Turkey: Impementing norms, changing minds”, 10 Korrik 2017, organizuar nga EU/UNwomen, Estonian Permanent Representation to the EU, Bruksel, Belgjikë;

8. Akad. Aurela Anastasi. *The reform of justice in Albania and the extension of the access of the individual in the Constitutional Court*, bashkautore, kumtesë e paraqitur në konferencën shkencore: “La riforma Costituzionale (strutturale) del sistema della giustizia nella Republica d’Albania”, Facolta di Giurisprudenza, “Sapienza”, Universita di Roma. Proceedings book, ISBN: 9788868128609;

9. Akad. Anastas Angjeli. “*Global Parliamentary Conference*” - organizuar nga “The Parliamentary Network on the World Bank & IMF”, Washington DC, 17-18 Prill 2017;

10. Akad. Beqir Meta. *Albanian’s Political Identity During the First World War*. Paper presented at the AIESEE, Belgrade Conference, 7-8 November 2017);

11. Akad. asoc. Gjovalin Shkurtaç. *Hulli të mbara dhe kontribute të akad. Idriz Ajetit në fushën e dialektologjisë dhe të onomastikës shqiptare*, 23 janar 2017, ASHAK, Prishtinë;

12. Akad. asoc. Gjovalin Shkurtaç. *Nderimi dhe vlerësimi për “Rrapin Shekullor” nuk shterojnë kurrë*” (Edhe një herë për ndihmesat e akademik Idriz Ajetit në fushën e dialektologjisë dhe të onomastikës), në konferencën e zhvilluar nga Instituti Albanologjik i Prishtinës, 27 qershor 2017;

13. Akad. Kosta Barjaba. *Links between education and youth employment in Albania*, prezantuar në konferencën ndërkombëtare “Belt and Road Education Dialogue”, Pekin, 26-28 nëntor 2017;

14. Akad. Marenglen Verli. Prezantimi i kumtesës *Ngjarjet e vitit 1981 në kontekstin e situatës me RFS Jugosllave pas Titos*, në konferencën shkencore ndërkombëtare me temë: *Demonstratat e vitit 1981*, Prishtinë, 17 mars 2017;

15. Akad. Marenglen Verli. Prezantimi me temë: *Bashkëpunimi midis Institutit të Historisë, Tiranë dhe Institutit të Historisë, Prishtinë në vitet 1981-2007*, në konferencën shkencore ndërkombëtare me temë: *50-vjetori i Institutit të Historisë - Prishtinë*, organizuar nga Instituti i Historisë “Ali Hadri”, Prishtinë, më 15 maj 2017;

16. Akad. Marenglen Verli. Prezantimi me temë: *Shote Galica përtej miteve dhe tabuve*, në konferencën shkencore ndërkombëtare me temë: *Shote Galica dhe Lëvizja Çlirimtare*, organizuar nga Instituti i Historisë “Ali Hadri”, Prishtinë, Vushtri, Kosovë 30 qershor 2017;

17. Akad. Marenglen Verli. Prezantimi me temë: *Informacione në arkivat europiane për Kongresin e Manastirit*, në konferencën shkencore ndërkombëtare me temë: *Kongresi i Manastirit*, organizuar nga Instituti i Trashëgimisë Kulturore të Shqiptarëve në Maqedoni, Manastir 22 nëntor 2017;

18. Akad. Marenglen Verli. Prezantimi me temë: *Ferhat Draga sipas dokumentacionit shqiptar dhe serb*, në konferencën shkencore ndërkombëtare me temë: *Organizata “Xhemijeti” dhe rezistenca e saj kundër kolonizimit*, organizuar nga Instituti i Trashëgimisë Kulturore të Shqiptarëve në Maqedoni. Shkup, 17 dhjetor 2017;

19. Akad. asoc. Shaban Sinani. *Kërkimet shkencore si antropogjuhësi në studimet e Idriz Ajetit*, kumtesë në konferencën ndërkombëtare në 100-vjetorin e gjuhëtarit Idriz Ajeti, Prishtinë. (për botim).

20. Akad. Vasil S. Tole. Pjesëmarrje në *50-vjetorin e krijimit të Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Maqedonisë*, Shkup, 9 tetor 2017.

Brenda vendit:

1. Akad. Albert Doja. Kumtesa: *Demokracia dhe kultura e qytetarisë: sfidat lokale dhe globale të qeverisjes në Shqipëri*, *Open Lecture*, University of Shkodra (Albania), 12 May 2017. Video at <https://youtu.be/i2Esl9xjYlo>;

2. Akad. Anastas Angjeli. Konferenca ndërkombëtare: *Migrimi, diaspora dhe Zhvillimi në Shqipëri dhe në Ballkanin Perëndimor*, organizuar nga Universiteti Mesdhetar në bashkëpunim me Qendrën për Studime Ekonomike dhe Sociale, 27 Tetor 2017, Tiranë;

3. Akad. Anastas Angjeli. Forumi: *Roli strategjik i Izraelit në Mesdheun Lindor*, 27 Mars 2017, Tiranë;

4. Akad. Aurela Anastasi. *Vlerësimi i riskut dhe menaxhimi i pasigurive gjatë reformimit të sistemeve ligjore*, botuar në Proceedings book "Analiza e Riskut". Konferenca IV shkencore vjetore e KLSH-së., Tiranë, 20-22 qershor, 2016, ISBN: 978-9928-159-49-6;

5. Akad. Aurela Anastasi. "Opinion on the draft laws on anti-corruptions courts in Ukraine", Komisioni i Venecias (bashkautore), Venezia, 6-7 Tetor 2017. e vlefshme në: [http://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD\(2017\)020-e](http://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD(2017)020-e);

6. Akad. Aurela Anastasi. "An overview of Parliamentary immunity in Albania", mbajtur në konferencën e organizuar nga Asambleja parlamentare e Këshillit të Europës *Promoting transparency and accountability measures for members of parliament*, Rome, 26-27 Tetor 2017; <http://website-pace.net/documents/10643/3183395/CorruptionSeminarAlbania-Rome1020176-EN.pdf/dc85bf66-3d64-48ac-b670-6b80672523cf>;

7. Akad. Beqir Meta. *Bektashizmi shqiptar i ndriçuar prej ndjenjave kombëtare e progresive*. Kumtesë e mbajtur në konferencën shkencore të organizuar nga Komuniteti Bektashian i Shqipërisë, Tiranë, 20 mars 2017;

8. Akad. Beqir Meta. *Kontributi i personaliteteve dibrane në shtetndërtimin kombëtar shqiptar në vitet 1920-1930*. Kumtesë e mbajtur në konferencën shkencore të organizuar nga Akademia e Shkencave të Shqipërisë dhe shoqata "Bashkësia Dibrane", Tiranë, 7 qershor 2017;

9. Akad. Beqir Meta. *Preludi i Kongresit të Manastirit*. Kumtesë e mbajtur në konferencën shkencore organizuar nga Ministria e Kulturës e Republikës së Maqedonisë dhe shoqata "22 Nëntori", Manastir, 19 nëntor 2017;

10. Akad. Beqir Meta. *Nga kriza drejt shpresës - Identiteti politik i shqiptarëve në dekadën e parë të pavarësisë*. Kumtesë e mbajtur në konferencën shkencore të organizuar nga Instituti i Historisë - ASA, Tiranë, 27 nëntor 2017;

11. Akad. asoc. Gjovalin Shkurtaç. Ka mbajtur kumtesën "*Shqyptarija*" në vjershat dhe në veprimtarinë shoqërore, gjuhësore dhe politike të Ndre Mjedës, në konferencën shkencore të organizuar Qendra Kulturore "Ndre Mjeda", në Mjedë, nëntor 2017;

12. Akad. asoc. Gjovalin Shkurtaç. Ka mbajtur kumtesën me titull *Pikat e anketimeve për sintaksën dialektore në të folmet e Malësisë së Madhe*, në Tryezën shkencore të organizuar nga Akademia Albanologjike e Shqipërisë, më 13 dhjetor 2017;

13. Akad. asoc. Gjovalin Shkurtaç. Ka mbajtur kumtesën *Hulumtimet e reja shkencore dhe tradita e shkrimit akademik* (Njohja e thelluar e bibliografisë si bazë e akribisë së të shkruarit), në konferencën e organizuar nga biblioteka e Akademisë së Shkencave, 22 shtator 2017;

14. Akad. asoc. Gjovalin Shkurtaç. Ka mbajtur kumtesën me titull: *Revista shkencore-kulturore "Perla" dhe studimet albanologjike*. Kumtesë me rastin e 22-vjetorit të daljes së numrit të parë Revistës shkencore "Perla", në numrin e 75-të saj;

15. Akad. Marenglen Verli. Prezantim me temë: *Marrëdhëniet e shqiptarëve të Kosovës me shtetin amë (1912-1939)*, në konferencën shkencore *Rrugëtimi i shtetit të pavarur shqiptar nga krijimi drejt integritetit europian*, organizuar nga Instituti i Historisë më 27 nëntor 2017;

16. Akad. Marenglen Verli. Prezantimi me temë: Disa të dhëna për Gjergj Pekmezin në dokumentacionin konsullor të Austro-Hungarisë, mbajtur në sesionin shkencor me temë: *Gjergj Pekmezi, figurë e shquar kombëtare*, organizuar nga bashkia e Pogradecit, 6 maj 2017;

17. Akad. asoc. Shaban Sinani. "*Sorvegliare, non punire*": *Qëndrimi i komandës së ushtrisë fashiste ndaj ardhjeve masive të hebrenjve në Shqipëri*, kumtesë në konferencën

ndërkombëtare *Hebrenjtë në Shqipëri - vështrime të kryqëzuara*, miratuar për botim;

18. Akad. asoc. Shaban Sinani. *Letërsia e vjetër shqipe në shkrime e tejshkrime të Rexhep Ismajlit*, paraqitur në konferencën e organizuar nga Akademia e Shkencave, botuar;

19. Akad. asoc. Shaban Sinani. *Pesë nisma të Papa Klementit XI në dobi të vendit të origjinës*, kumtesë në konferencën për hartimin e dosjes për regjistrimin si popullsi në mbrojtje nga UNESCO, organizuar nga Akademia e Shkencave, miratuar për botim;

20. Akad. asoc. Shaban Sinani. *Mitrush Kuteli në dy studime të panjohura*, kumtesë në konferencën shkencore *Mitrush Kuteli, në 110-vjetorin e lindjes*, organizuar nga Akademia e Shkencave dhe Universiteti i Korçës, botuar;

21. Akad. asoc. Shaban Sinani. *Mitrush Kuteli dhe fati i rezervave bankare shqiptare në vitet 1943-1946*, kumtesë në konferencën e organizuar nga Banka e Shqipërisë, për botim;

22. Akad. asoc. Shaban Sinani. *Some anthropologic observations on the interaction of Albanian with the languages in contact: the case of Serbian*, referat (key-note speaker) në konferencën shkencore ndërkombëtare *Mapping Balkan routes: literary, cultural and linguistic landscapes, International Conference on Balkan Studies*, organizuar nga Universiteti i Vlorës, Universiteti i Beogradit dhe Akademia e Shkencave, për botim;

23. Akad. asoc. Shaban Sinani. *Jashtëvarësitë e Voskopojës*, në konferencën ndërkombëtare *Qytetërimi i Voskopojës dhe shekulli i iluminizmit në Ballkan*, organizuar nga Akademia e Shkencave, për botim;

24. Akad. asoc. Shaban Sinani. *Parathëniet e Rexhep Qosjes për letërsinë shqipe në gjuhën serbe*, kumtesë në konferencën shkencore organizuar nga Akademia e Shkencave dhe Universiteti i Gjirokastrës, për botim;

25. Akad. asoc. Shaban Sinani. *Miniaturat e Jorgo Bulos*, kumtesë në konferencën shkencore *Personaliteti shkencor i akademik Jorgo Bulos*, organizuar nga Universiteti i Gjirokastrës dhe Akademia e Shkencave e Shqipërisë;

26. Akad. asoc. Shaban Sinani. *Letërkëmbim dhe letërsi pasioni*, kumtesë në konferencën *Letërsia si qëllim dhe estetikë*, organizuar nga Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë, miratuar për botim;

27. Akad. asoc. Shaban Sinani. *Kujtesa dokumentare e "Gjeneralit të ushtrisë së vdekur"*, kumtesë në konferencën shkencore ndërkombëtare *Letërsia dhe kujtesa* organizuar nga Universiteti i Tiranës, për botim.

IV. Botime shkencore

a. Monografi dhe botime shkencore:

1. Akad. Artan Fuga. *Mediamorfozë dhe Metakomunikilm*, 837 faqe, monografi, botimet Papirus 2017;

2. Akad. Artan Fuga. Drejtuesi shkencor i përmbledhjes me studime konference shkencore me bashkëpunim ndërkombëtar: *Televizioni pa televizor, mbi televizionin në ekranet e vegjël*, Toena, 2017, Botim i Departamentit të Gazetarisë dhe Komunikimit, të Fakultetit Histoti-Filologji, UT, 323 fq., me bord ndërkombëtar shkencor botimi si edhe në bashkëpunim me agjenci të huaja shkencore (IPAG, France, Ladyss - CNRS - France, REM, France).

3. Akad. Aurela Anastasi. *Tekste mësimore (të miratuara në Departamenti i të Drejtës Publike, FD) 1. "Barazia Gjinore dhe mosdiskriminimi"*, bashkautore, botim i Departamentit të së Drejtës Publike, ribotim i përditësuar, Tiranë, 2017. ISBN: 978-99956-59-25-7.

4. Akad. Aurela Anastasi. *"E drejta Kushtetuese"*, ribotim i përditësuar, bashkautore, Tiranë 2017, ISBN: 978-99956-01-41-6.

5. Akad. Fatos Kongoli. Botuar në italisht libri: *Iluzione në sirtar* (Illusioni nel cassetto), botuar nga sh.b. "RUBBETTINO", (2017).

6. Akad. Fatos Kongoli. Botuar në italisht romani: *Bolero në vilën e pleqve* (Bolero nella villa dei vecchi), botuar nga sh.b "Salento books", (2017).

7. Akad. asoc. Gjovalin Shkurtaç. Ka botuar librin *Enigma e emrave*. Monografi antroponimisë shqiptare, Shtëpia Botuese "Naimi", 2017 (301 faqe).

8. Akad. asoc. Gjovalin Shkurtaç. Ka rivështruar e ribotuar për nevojat e shkollave të larta librin "Urgjenca gjuhësore", Shtëpia botuese "Naimi", Tiranë, 2017, 207 faqe.

9. Akad. Kosta Barjaba. Ideimi, përgatitja dhe botimi i *Karta e Gjelber: Shqipëria 2025: Rimodelimi i zhvillimit ekonomik në kotekstet locale*, botim i Akademisë së Shkencave.

10. Akad. Kosta Barjaba. Ideimi, përgatitja dhe botimi i tetë veprave të zgjedhura të akademikut Hamit Beqja, 2016-2017.

11. Akad. asoc. Shaban Sinani. *Hieronymi: në botën arbëreshe*, studim monografik, bot. Akademia e Shkencave.

12. Akad. asoc. Shaban Sinani. *Pyetje të tjera në albanologji*, studime, bot. Naimi.

13. Akad. Vasil S. Tole. *Sazet e Selimit dhe Hafizesë, e Ajdin Leskovikut, themeluesit e muzikës popullore qytetare të Shqipërisë së Jugut*. Booket + CD, Shtëpia botuese "Media Print", Tiranë, 2017.

14. Akad. Vasil S. Tole. *Koncert recital me muzikë dhome*, Prishtinë, 18 maj 2017.

15. Akad. Vasil S. Tole. *Kompozim për orkestër EP*, Botimi i kësaj vepre, ASH, 2017

b. Botime në revista shkencore

Gjatë vitit 2017 kemi një numër botimesh nga anëtarë të SShShA në revista shkencore kombëtare e ndërkombëtare, ndër të cilat përmendim:

Jashtë vendit:

- Akad. Albert Doja. I. Artikuj të botuar në revista ndërkombëtare me bord editorial, faktor impact, dhe të indeksuara (Web of Science Clarivate Analytics): 1. "The past in the present: Time and narrative of Balkan wars in media industry and international politics" [with Enika Abazi], *Third World Quarterly*, 2017, vol. 38 (4), pp. 1012-1042, doi:10.1080/01436597.2016.1191345. <halshs-01349135> [Routledge Journals, ISSN 0143-6597; SSCI IF 1.434];

- Akad. Albert Doja. II. Artikuj të përkthyer dhe botuar në revista ndërkombëtare me bord editorial: 1. "Religionspolitischer Alltag im Südosteuropa" [The Everyday of Religion and Politics in the Balkans], *Religion & Gesellschaft in Ost und West* (Zürich), vol. 45, 2017, no. 2, pp. 24-27. <halshs-01491434>; 2. "Lindja e Albanologjisë sipas Shkrimeve Gjermane dhe Austriake" [From the foreigner point of view: The birth of Albanologie in German and Austrian writings], *Gjurmime Albanologjike: Folklor dhe Etnologji* (Prishtina), vol. 46, 2017, pp. 9-40, <https://www.ceeol.com/search/article-detail?id=540694>. <halshs-01529441>;

- Akad. Albert Doja. Kapituj të botuar në vëllime kolektive: 1. "Come costruire l'identità nel Regione Adriatico-Ionica: Prospettive culturali, regionali ed europee tra le idee civiche e le motivazioni stato-nazionale", *Innovazione e Integrazione nelle Politiche di Sviluppo Territoriale per la Regione Adriatico-Ionica: Proposte di Riflessione da una Prospettiva Locale e Regionale*, Bologna: Adrigov, 2017, pp. 216-220. ISBN 9788896724095. <halshs-01388409>. (Video at http://youtu.be/6Bwls_l_VyU and <http://youtu.be/leZCVz59Jsw>);

- Akad. Kosta Barjaba. *Failure of "Myth of Homeland": delay of return migration to Albania*, Itinerary di Ricerca Storica, Università del Salento, Issue 2, 2017;

- Akad. Kosta Barjaba. *From Failure to Success: Return Migration in Albania* (with Barjaba, J.) Africa e Mediterraneo, Vol 86, Issue 86 (7/17), 2017;
- Akad. asoc. Shaban Sinani. *Some International Acts that Facilitated the Emigration of Jews to Albania in the Period between the Two World Wars*, botim i Komitetit Polak të AIESSEE-së.
- Akad. asoc. Shaban Sinani. *"Noi, figli di nuovo secolo" di Migjeni e "Il secolo mio" di Kadare" - uno sguardo comparativo*, në *Lingue e Letterature d'Oriente e d'Occidente*, revistë e Universitetit të Firenze-s, numër special për Shqipërinë, 2017.
- Akad. asoc. Shaban Sinani. *Etnoflore in Oral Tradition of Southeast regions of Albania, në Flora in Arts and Artefacts of the Korça Region*, international project.
- Akad. asoc. Shaban Sinani. *Migjeni i Esad Mekulit*, në revistën *Studime* të ASHAK, nr. 23 (2017).
- Akad. asoc. Shaban Sinani. *Endonime dhe ekzonime për shqiptarët dhe fqinjët*, në revistën *Studime* të ASHAK, nr. 23 (2017).

Brenda vendit:

- Akad. Aurela Anastasi. *Diskriminimi i shumëfishtë dhe roli i avokatit në adresimin e tij*, Revista "Avokatia", nr. 21, 2017;
- Akad. Beqir Meta. *Diskutimet shqiptaro-britanike për çështjen e shkollave të minoritetit grek gjatë vitit 1935*, në "Studime Historike", 1-2/2017;
- Akad. Beqir Meta. *Çështja e shkollave të minoritetit grek në vitin 1934*, në: "Studime Historike", 3-4/2017;
- Akad. asoc. Gjovalin Shkurtaç. Dhënë për botim në revistën "Studime filologjike" artikullin: Anila Omari, *Marrëdhëniet gjuhësore shqiptaro-serbe*, Qendra e Studimeve Albanologjike - Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Botimet Albanologjike, Tiranë, 2012, 420 f.

V. Aktivitete të tjera

Anëtarët e ASH kanë zhvilluar edhe aktivitete të tjera në fushën e botimeve, si redaktime veprash shkencore, studime, raporte, ekspertiza për vlerësime të projekteve, R&D country profile etj.

- Akad. Albert Doja. Mori ftesën si *profesor vizitues* për një vit në Universitetin "Harvard".
 - Akad. Aurela Anastasi. Fiton titullin "akademike", anëtare e Akademisë së Shkencave të RSh. Fusha "drejtësi", dt. 04.9.2017;
- Anëtare e redaksisë së revistës shkencore "**STUDIME JURIDIKE**", botim i Fakultetit të Drejtësisë, UT, **ISSN 2220-3990**; Anëtare e Redaksisë së Revistës shkencore "**JETA JURIDIKE**", botim i Fakultetit të Drejtësisë, UT, **ISSN:2219-4134**; Anëtare e Redaksisë së Revistës shkencore "**CONSTITUTIO**", botim i Fakultetit të Drejtësisë, Prishtinë. **ISSN: 1409-8962**; Anëtare e Redaksisë së Revistës "**KUVENDI**", botim zyrtar i Kuvendit të Shqipërisë. (Përfaqësuese e Akademisë së Shkencave të RSH, pranë kësaj Redaksie); Anëtare e Redaksisë së Revistës "**Avokatia**", Botim i Dhomës Kombëtare të Avokatisë.
- Akad. Beqir Meta. *Recensione veprash shkencore* - Muin Çami, Marenglen Verli - *Shqipëria në Konferencën e Paqes*; Thoma Murzaku - *Çështja e kufijve të Shqipërisë në vitin 1913*; Fatmira Musaj - *Republika Shqiptare 1925-1928*;

Recension tezash doktrate - Parim Kosova - Shpërngulja e shqiptarëve nga Kosova në vitet 1912-1941; Dorian Koçi - Shqipëria në fillimet e Luftës së Ftohtë (1946-1953);

Kryeredaktor i revistës *Studime Historike*; Anëtar i redaksisë së revistës *Kosova*; Ka kryer detyrën e Drejtorit të Institutit të Historisë dhe Kryetarit të Këshillit Shkencor të Institutit të Historisë;

- **Akad. Kosta Barjaba.** Studime: "Policy Paper and Action Plan on the engagement of the Albanian Communities Abroad in development initiatives of Albania", përgatitur për Organizatën Ndërkombëtare të Migracionit, IOM dhe qeverinë e Shqipërisë;

- **Akad. Marenglen Verli.** Recensione veprash shkencore: Thoma Murzaku - Çështja e kufijve të Shqipërisë në vitin 1913; Kristaq Prifti - Gjenocidi dhe komplotet antishqiptare të serbomëdhenjve; Hamit Kaba dhe Sabit Syla, " Demonstratat e Vitit 81 në arkivin kombëtar të Londrës" (dokumente); Zv. kryeredaktor i revistës *Studime historike*, Tiranë, 1-2, 3-4/2017; anëtar i redaksisë së revistës *Studia albanica*, Tiranë, 2016; Anëtar i redaksisë së revistës *Kosova*, Prishtinë, 2017; ka kryer detyrën e rektorit të ASA-së, kryetarit të Senatit Akademik dhe anëtarit të këshillit të profesorëve të Institutit të Historisë. Gjatë periudhës shtator 2017 ka kryer edhe detyrën e përgjegjës të Departamentit;

- **Akad. asoc. Shaban Sinani.** Përkujdesës botimesh (redaktim shkencor dhe parathënie): *Dritëro Agollit*, përmbledhje studimesh të albanologëve nga bota dhe të studiuesve vend, libër Festschrift, në 85-vjetorin e shkrimtarit; *Nulla dies sine linea*, aforizma të Dritëro Agollit, parathënie dhe këshillimi shkencor.

VI. Bashkëpunimi me institucionet e arsimit të lartë dhe të kërkimit shkencor

- **Akad. Anastas Angjeli** - Leksion i hapur: "Bashkimi Europian e shkuara, e tashmja, e ardhmja"; Udhëheqje shkencore: 1. Hisen Xhemali - Tema "Ndikimi i borxhit publik dhe efektet e politikave ekonomike në ekonominë e R. Maqedonisë" (Analizë emperike për rolin dhe rëndësinë e borxhit publik)", Strugë 2017; 2. Kandidate Denisa Vyshka - "Partneritetet publiko-private, format dhe faktorët kyç të suksesit. Rikonstruimi dhe modernizimi i ndriçimit publik në bashkinë e Elbasanit", Strugë 2017.

- **Akad. Aurela Anastasi.** Drejtuese shkencore për përgatitjen e doktoratave: Pranë Fakultetit të Drejtësisë UT, 6 punime të doktoraturës të përfunduara; Pranë Shkollës së Studimeve Europiane UT, 2 punime të doktoraturës të përfunduara; Bashkëpunimi shkencor me Shkollën e Magjistraturës: Trajnere në trajnimin vazhdues të gjyqtarëve dhe të prokurorëve; Bashkëpunimi shkencor me Shkollën e Avokatisë: Përgjegjëse e grupit të lëndëve të së drejtës Publike në shkollën e Avokatisë; Pedagoge e ciklit "E drejta Kushtetuese".

- **Akad. Beqir Meta.** Cikël leksionesh: *Historia e Rilindjes Shqiptare* - cikël leksionesh në Universitetin e Prishtinës; Udhëheqje tezash doktrate: Monika Stafa - *Hebrenjtë në Shqipëri*; Erjon Dervishi - *Federata Panshqiptare "Vatra", 1939-1989.*

- **Akad. asoc. Gjovalin Shkurtaç.** Ka marrë pjesë në juri për mbrojtje doktoraturash e mastearsh dhe për dhënie titullit *profesor ose prof. asoc.* (një në Fakultetin e Historisë e të Filologjisë, (2 oponente) në Institutin e Gjuhësisë e të Letërsisë të QSA (dy oponente); Edhe gjatë vitit akademik 2016-2017 ka vazhduar bashkëpunimin si pedagog i jashtëm për lëndët që është titullar dhe autor i teksteve përkatëse: "Dialektologji", "Dialektologji e diasporës", në Universitetin e Tiranës, Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë, si dhe lëndën "Kultura e gjuhës" në Universitetin e Arteve, dega e dramës dhe e skenografisë. Ka dhënë leksionet e lëndës "Shqipja e sotme" në Albanian University, si pedagog i jashtëm, gjithashtu edhe anëtar i revistës "Optime"; Ka drejtuar disa tema studimesh për gradën "Master" e "Doktor i shkencave", të regjistruara, përkat. në Fakultetin e Historisë dhe të Filologjisë, në Fakultetin e

Gjuhëve të Huaja dhe në Qendrën e Studimeve Albanologjike; Ka botuar në faqen e tij; on-line “Urgjenca gjuhësore” artikuj dhe biseda të ndryshme për gjuhën shqipe dhe kulturën shqiptare, si dhe dy artikuj në revistën prestigjioze “Fox-News”, kushtuar problemeve të gjuhë shqipe në Maqedoni etj.

- **Akad. Kosta Barjaba.** Tre udhëheqje doktoraturash në Universitetin Europian të Tiranës, të mbrojtura në vitin 2017; tre oponenca për mbrojtje doktoraturash në Universitetin Europian të Tiranës.

- **Akad. Marenglen Verli.** *Leksione* - Cikël leksionesh me studentët e Fakultetit të Shkencave Sociale (Universiteti i Tiranës) mbi Historinë bashkëkohore të popullit shqiptar; *Udhëheqje shkencore*: Parim Kosova “Shpërngulja e shqiptarëve nga Kosova në vitet 1912-1941; Armend Mehmeti “Diplomacia e Britanisë së Madhe mbi marrëdhëniet shqiptare- jugosllave “(1919-1923); Astrit Sahitaj “Shqiptarët dhe serbët (1912-1918), (në proces); Sami Gashi “Marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave “1928-1934, (në proces); *Recensione tezash doktorate*: Denisa Tare” Arbëreshët e Italisë dhe çështja kombëtare shqiptare “(1878-1912); Lorenc Xhaferaj “Roli i komunitetit ndërkombëtar në vendosjen dhe konsolidimin e demokracisë në Kosovë. Realitete dhe sfida (1991-2012); David Osaflook - Lëvizja protestante ndër shqiptarëve (1816-1908); Monika Stafa -Hebrenjtë në Shqipërisë (1933-1946); Elsa Hoxha - Çështja e marrëdhënieve ndërkombëtare të LANCL-së në Shqipëri në kuadrin e Luftës së Dytë Botërore.

- **Akad. asoc. Shaban Sinani.** *Udhëheqje tezash shkencore doktorale jashtë vendit*: 1. Ece Dillioğlu, *Çağdaş Arnavut Edebiyatında İsmail Kadare ve Romanları*, University of Thrace (Turqi): mentor i dytë; Anesti Naci, *L'immagine dell'Italia e degli italiani nell'Albania comunista*, Università degli Studi di Udine (Itali), supervisor i dytë. *Mësimdhënie brenda dhe jashtë vendit*: Kurs semestral i plotë i lëndës së *antropologjisë kulturore*, në Universitetin e Beogradit. kurs i *etnofolkloristikës së krahasuar*, master, Universiteti i Tiranës.

- **Akad. Vasil S. Tole.** Udhëheqje doktoratash: Blerina Shalari - me temën “Polifonia labe dhe muzika e kultivuar shqiptare”, 7 shtator 2017; Kushtrim Jakupi, 23 nëntor 2017.

KREU III

REFORMA NË AKADEMINË E SHKENCAVE HAP PAS HAPI⁵

12 korrik 2017

Me anë të shkresës nr. 316/1 prot., Kryesia e ASH i është drejtuar Kryeministrit të Shqipërisë z. E. Rama mbi disa sugjerime për mirëqeverisje në fushën e shkencës. Ndër të tjera në pikën 2 të kësaj letre është kërkuar vëmendja e tij dhe është theksuar se: *Akademia e Shkencave gjendet në një proces reformimi të pambyllur qysh prej vitit 2013. Ne kërkojmë që ky akt themelor juridik për funksionimin e ASH-së dhe të institucioneve kërkimore jashtë rrjetit të universiteteve të hartohet sa më shpejt, duke përfillur seriozisht zgjidhjet që ofrohen nga vetë këto institucione. Rregullimi juridik i statusit të ASH-së, si institucioni kryesor i promovimit të vlerave europiane të identitetit shqiptar, do të ndikojë frytshëmrisht për rritjen e autoritetit të shkencës kombëtare në rrafsh të brendshëm dhe në atë kombëtar. Ndërsa në pikën 3 të kësaj shkrese, thuhet se: Sipas ligjit ekzistues, ASH-ja duhet të zgjedhë Kryesinë e re më 4 shtator 2017, ligj që është në fuqi për shkak të vonesës që u krijua në procesin e reformimit. Por zgjidhja më e mirë do të ishte që fillimisht të përfundohej miratimi i ligjit të ri për shkencën dhe pastaj të bëhej zgjedhja e Kryesisë së re, gjë që do të na mundësonte arsyetimin e një shtyrjeje të përkohshme të kohës së zgjedhjeve, me qëllim që Kryesia e re ta nisë punën me një ligj të ri.*

31 tetor 2017

Asambleja e Akademisë së Shkencave mori vendimin nr. 19, datë 31 tetor 2017 *Për reformën institucionale të kërkimit shkencor dhe të ardhmen e Akademisë së Shkencave* (nr. prot. 445, 3 f.) në të cilin u vendos mbajtja e një konference dhe paraqitja e një deklarate për shtyp për informimin e opinionit publik, iu kërkuar zyrtarisht takim Kryeministrit të Shqipërisë, iu kërkuar MASR dokumentet e hartuara nga grupet e punës të ngritura për reformën e kërkimit shkencor në vend, iu kërkuar komisionit të posaçëm *ad hoc* të ngritur me vendimin nr. 18, datë 11 shtator 2017, përmbyllja brenda datës 16 nëntor 2017 e propozimit të institucionit lidhur me reformimin e sistemit institucional të kërkimit shkencor në emër të Asamblesë së Akademisë së Shkencave dhe vendin e Akademisë së Shkencave në të, si dhe ta kalonte atë për aprovim në mbledhjen e radhës së kësaj Asambleje. Në këtë vendim iu kërkuar Komisionit vjelja e të gjitha mendimeve të akademikëve dhe konsultimi me gjithë praktikën

⁵ Të gjitha dokumentet e përmendura janë të konsultueshme në dosjen përkatëse në arkiv-protokollin e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë. Shih gjithashtu: <http://akad.gov.al/ash/ecuria-e-reformes>

shkresore të prodhuar nga ky proces ndërinstitucional. Më tej u kërkua që ky dokument i miratuar nga Asambleja t'i dërgohej zyrtarisht MASR.

3 nëntor 2017

Kryesia e ASH mori vendimin nr. 20 *Për hartimin e dokumentit strategjik të reformës, propozim i Asamblesë së Akademisë së Shkencave dhe për pagesën e anëtarëve të komisionit "ad hoc", me mandat të plotë përfaqësimi, për reformën në kërkimin shkencor dhe në atë institucionale* (nr. prot. 450, 2 f.).

17 nëntor 2017

Asambleja e ASH mori vendimin nr. 21, *Për aprovimin në parim të draftreformës institucionale të kërkimit shkencor dhe rolit të Akademisë së Shkencave* (nr. prot. 467, 2 f.). Në vijim të takimit të datës 22 nëntor 2017 me Kryeministrin, Z. E. Rama me përfaqësues të Asamblesë së ASH dhe me prani të ministres së Arsimit, ku u la si detyrë ngritja e një komiteti të përbashkët të mirëbesimit për ndjekjen dhe monitorimin e procesit të ristrukturimit të ASH, më 24 nëntor 2017, Kryesia e ASH iu drejtua ministres së Arsimit, znj. Lindita Nikolla, me anë të shkresës numër prot. 474 (1 f.), *Për vijimin e reformimit të Akademisë së Shkencave*. Mes të tjerash, në këtë letër shprehet dakordësia në lidhje me nismën e MASR për ngritjen e këtij komiteti si shprehje e një vullneti të përbashkët dhe gatishmëria për të ndjekur së bashku përmbylljen e këtij procesi shumë të domosdoshëm për të ardhmen e ASH.

22 dhjetor 2017

Asambleja e ASH mori vendimin nr. 23, *Për aprovimin e kalendarit të reformës institucionale në Akademinë e Shkencave* (janar-mars 2018) (nr. prot. 529, 3 f.), në të cilin është parashikuar: ngritja e komisionit të përbashkët të mirëbesimit për ndjekjen dhe monitorimin e procesit të reformimit, midis ASH dhe MASR, hartimi i draftligjit *Për Akademinë e Shkencave të Shqipërisë*, hartimi i draftit të VKM-së *Për organikën e ASH*, hartimi i draftit të Statutit të ASH, hartimi i dokumenteve për kriteret dhe standardet e pranimeve të reja si akademik dhe akademik i asociuar, për kriteret dhe standardet e konkurrimit në pozicionet drejtuese të ASH, si dhe hartimi i draftit të kodit akademik për integritet në kërkimin shkencor në Shqipëri. Në këtë vendim gjithashtu autorizoi Këshillin Ekzekutiv që të informojë Këshillin e Ministrave dhe MASR-në për vendimmarrjen e kësaj mbledhjeje dhe njëkohësisht të kërkojë bashkëpunimin e tyre institucional në këtë proces të përbashkët për ngritjen e grupeve të punës të reformës përmes akteve urdhëruese përkatëse, për hartimin në kohën e duhur të draftligjit për Akademinë dhe aktet e tjera shoqëruese, drafte dhe dokumente që duhet t'u përcillen zyrtarisht instancave përkatëse brenda muajit mars 2018.

22 dhjetor 2017

Pas mbledhjes dhe në zbatim të vendimit nr. 23, të Asamblesë, Kryesia e ASH, iu drejtua ministres së Arsimit, znj. Lindita Nikolla, me anë të shkresës numër prot. 529 (3 f.) me anë të së cilës i përcillet vendimi i Asamblesë së Akademisë së Shkencave për aprovimin e kalendarit

të hapave të reformës, në të cilin është parashikuar ngritja e *komisionit të përbashkët të mirëbesimit* për ndjekjen dhe monitorimin e procesit të reformimit midis ASH dhe MASR. Aty kërkohet ndihmesa institucionale e MASR për ngritjen e Grupit të Punës për hartimin e draftligjit *Për Akademinë e Shkencave të Republikës së Shqipërisë*, të draftit të VKM-së *Për organikën e ASH*, të draftit të *Kodit akademik të sjelljes për integritet në kërkimin shkencor në RSH*. Po kështu është propozuar edhe që përbërja e këtyre grupeve të jetë me përfaqësues të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, me përfaqësues akademikë dhe me përfaqësues të universiteteve publike e private në Shqipëri me përvojë në hartimin dhe përgatitjen e bazës ligjore. Ndër të tjera në këtë shkresë bëhet me dije se hartimi i draftit të Statutit të ASH dhe të dokumenteve për kriteret dhe standardet e pranimeve të reja si akademik e si akademik i asociuar, si dhe i kriterëve për konkurrim në pozicionet drejtuese të ASH-së do të bëhen dhe do të miratohen nga Asambleja e ASH si shprehje e vetëreformimit të brendshëm të saj.

10 janar 2018

Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë i drejtoi Kryesisë së Akademisë së Shkencave shkresën nr. prot. 224 (këtu nr. prot. 19, 1 f.) me lëndë *Për vijimin e ristrukturimit të Akademisë së Shkencave*, me anë të së cilës komunikon se në përgjigje të shkresës nr. prot. 474 të datës 24 nëntor 2017 *Për vijimin e reformimit të ASH*, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, në *komitetin e përbashkët të mirëbesimit* do të përfaqësohet nga z. Ervin Demo dhe këshilltari i ministres, z. Redi Shtino.

11 janar 2018

Në përgjigje të shkresës nr. prot. 224 të MASR, Kryesia e ASH, i drejtohet më 11 janar 2018 Këshillit Ekzekutiv, Asamblesë dhe gjithë akademikëve (dërguar për dijeni z. Lindita Nikolla) me shkresën nr. prot. 19/1 (1 f.), me lëndë *Kërkesë për caktimin e përfaqësuesve të Akademisë së Shkencave në "Komisionin e përbashkët të mirëbesimit" për ndjekjen dhe monitorimin e procesit të reformimit*". Më 12 janar 2018, pas dorëheqjes së dy anëtarëve nga komisioni *ad hoc* për reformën, kryetari i këtij komisioni, akad. A. Baçe, i kërkon Kryesisë së ASH zëvendësimin e këtyre anëtarëve me anë të shkresës nr. prot. 26 (1 f.).

16 janar 2018

Ministria e Arsimit, Sporteve dhe Rinisë doli me urdhrin nr. 29, *Për ngritjen e Grupit të Punës për hartimin e projektligjit "Për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë" dhe të akteve nënligjore në zbatim të tij* (nr. prot. 419, 2 f.) me anë të të cilit urdhëroi ngritjen e Grupit të përbashkët të Punës mes ASH dhe MASR për hartimin e këtyre dokumenteve. Në këtë vendim u përcaktua edhe përbërja e këtij grupi, u kërkua zhvillimi i mbledhjes së parë të këtij grupi jo më vonë se 1 javë nga data e hyrjes në fuqi të urdhrit për miratimin e kalendarit të punës së grupit. Në këtë urdhër u kërkua që në mbledhjet e GP, në bashkëpunim me ASH, të ftohen të marrin pjesë përfaqësues të komisionit *ad hoc* të reformës në ASH, përfaqësues të njësisë së kërkimit shkencor në Këshillin e Ministrave, si dhe përfaqësues të shquar të botës akademike e institucionale shkencore shqiptare e më gjerë, kontributi i të cilëve vlerësohet si

i domosdoshëm për hartimin e këtyre akteve. Për zbatimin e këtij u ngarkuan Grupi i Punës dhe MASR në bashkëpunim me ASH.

18 janar 2018

Asambleja e ASH-së shprehet me vendimin nr. 1, *Për aprovimin e përfaqësuesve të Akademisë së Shkencave në "komisionin e përbashkët të mirëbesimit mes MASR dhe ASH dhe për një ndryshim në numrin dhe përbërjen e komisionit "ad hoc"* (nr. prot. 19/3, 2 f.), në të cilin vendos që akademikët V. S. Tole dhe B. Meta të jenë përfaqësuesit e ASH-së në përbërje të Komisionit të përbashkët të Mirëbesimit mes MASR-së dhe ASH-së, për ndjekjen dhe monitorimin e procesit të reformimit si dhe vendos që komisioni ad hoc të ketë 9 anëtarë me akademikët: A. Baçe, A. Fuga, A. Angjeli, A. Anastasi, F. Vila, K. Barjaba, N. Frashëri, S. Gjinushi dhe S. Bushati.

18 janar 2018

Kryesia e ASH i drejtohet ministres, znj. Lindita Nikolla me shkresën nr. prot. 19/2, me lëndë *Caktohen përfaqësuesit e Akademisë së Shkencave në "komisionin e përbashkët të mirëbesimit"*, për ndjekjen dhe monitorimin e procesit të reformimit, me anë të së cilës komunikon se në mbledhjen e datës 18 janar 2018, Asambleja e ASH, pasi shqyrton kërkesën e z. ministre (nr. prot. 224, 10.01.2018), vendosi që akademikët V. S. Tole dhe B. Meta, të jenë përfaqësuesit e ASH-së në përbërje të komisionit të përbashkët të mirëbesimit.

24 janar 2018

Kryesia e ASH i drejtohet Kryeministrit Edi Rama me shkresën nr. prot. 38, me lëndë *Mbi ecurinë e deritanishme të reformës në Akademinë e Shkencave në vijim të takimit të zhvilluar më 22.11.2017, me anë të së cilës informon mbi hapat e ndjekur për procesin e reformimit.*

24 janar 2018

Po me të njëjtën datë dhe objekt (informimin mbi ecurinë e procesit të reformës), më 24 janar 2018, Kryesia e ASH i drejtohet edhe Presidentit të Republikës së Shqipërisë z. Ilir Meta me anë të shkresës nr. prot. 39, me lëndë *Informacion mbi ecurinë e deritanishme të reformës në Akademinë e Shkencave.*

Hartimi i projekteve nga Grupi i Punës⁶

25 janar 2018

Mbledhja e parë e Grupit të Përbashkët të Punës mes ASH dhe MASR për hartimin e projektligjit *Për Akademinë e Shkencave të Republikës së Shqipërisë* si dhe të draftit të *Kodit akademik të sjelljes për integritet në kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë* (grup i ngritur me vendim të ministres së Arsimit nr. 29, datë 16 janar 2018). Sipas procesverbalit nr. prot. 32/2 (3 f.), në këtë mbledhje u miratua *Kalendari* i punës për muajin janar - mars 2018 i Grupit të Punës (shkresë nr. prot 32/1).

(<http://akad.gov.al/ash/pdf/Kalendari%20i%20mbledhjeve%20te%20grupit%20t%20punes%20te%20ligjit%20per%20ASH.pdf>)

29 janar 2018

Mbledhja e radhës e Grupit të Punës. Sipas procesverbalit nr. prot. 32-3 (3 f.) në këtë mbledhje u bë paraqitja e varianteve fillestare të dy drafteve të projektligjit për ASH-në dhe të kodit të etikës, variante që shërbyen si bazë mbi të cilën u mbledhën më tej mendimet, sugjerimet dhe vërejtjet gjatë konsultimeve të parashikuara në kalendarin e punës të Grupit.

7 shkurt 2018

Mbledhje e zgjeruar e Grupit të Punës për marrjen e mendimeve nga Këshilli Ekzekutiv dhe seksionet e ASH mbi draftligjin. Sipas procesverbalit nr. prot. 32/4, në këtë mbledhje u bë një prezantim i variantit fillestar të draftligjit dhe u morën mendimet dhe sugjerimet e të pranishmëve në lidhje me atë draft.



⁶ Grupi i Punës për hartimin e projektligjit *Për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë dhe të akteve nënligjore në zbatim të tij*, i ngritur përmes vendimit të Ministres së Arsimit nr. 29, datë 16 janar 2018, me kryetar akad. Skënder Gjinushi, anëtarët: Ervin Demo, akad. Luan Omari, akad. Apollon Baçe, akad. asoc. Shaban Sinani, akad. Beqir Meta, akad. Kosta Barjaba.

9 shkurt 2018

Në mjediset e MASR u zhvillua takimi i Grupit të Punës me ministren e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, z. Lindita Nikolla. Sipas shkresës nr. prot. 32/5 (3 f.) në këtë mbledhje GP informoi MASR-në për vijimësinë e procesit të përgatitjes së dy drafteve dhe në përmbyllje pjesëmarrësit rikonfirmuan gatishmërinë për komunikimin hap pas hapi të ecurisë së procesit të hartimit të akteve ligjore dhe nënligjore për reformën e ASH-së dhe takimin e propozuar nga zëvendësministri parashikuar javën vijuese.



14 shkurt 2018

Mbledhje e zgjeruar e grupit të punës me përfaqësuesit e instituteve dhe qendrave të kërkimit shkencor në universitete e më gjerë, për dhënie mendimesh dhe sugjerimesh në lidhje me draftligjin e Akademisë së Shkencave dhe draftkodin e etikës akademike për integritet në kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë (sipas procesverbalit nr. prot. 32/6, 4 f.).



21 shkurt 2018

Mbledhje e zgjeruar e Grupit të Punës me *Akademinë e të Rinjve*, me kërkuesit dhe shkencëtarët e rinj për dhënie mendimesh dhe sugjerimesh në lidhje me pjesë të draftligjit të Akademisë së Shkencave dhe të draftkodit të etikës akademike për integritet në kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë (procesverbal nr. prot. 32/7).





27 shkurt 2018

Në mjediset e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë u zhvillua një mbledhje e Grupit të Punës (procesverbal nr. prot. 32/8, 3 f.) në të cilën u mbajt një relacion mbi ecurinë e punës për hartimin e projektligjit dhe mbi hapat e mëtejshëm të parashikuar deri në përfundim të procesit. Anëtari i Grupit të Punës, zëvendësministri E. Demo, deklaroi se mbi variantin paraprak të draftligjit të paraqitur në këtë mbledhje, do të shprehet më tej MASR-ja, e cila do ta shikojë, analizojë dhe vlerësojë këtë projektligj dhe pasi të kristalizojë qëndrimin e saj, do të zhvillojë sërish një takim midis saj dhe Grupit të Punës për ta shprehur këtë qëndrim. Edhe Grupi i Punës deklaroi se ndërkohë do të saktësojë dhe përmirësojë variantin aktual të projektligjit me sugjerimet që janë grumbulluar në takimet e zhvilluara në javët paraardhëse dhe ato që do të merren në takimet me ALLEA-n dhe Leopoldina-n.



15 mars 2018

Pas zhvillimit të takimeve në Berlin të kryetarit të Grupit të Punës, akad. S. Gjinushi, me përfaqësuesit e ALLEA-s dhe Akademisë Gjermane të Shkencave, më 15 mars 2018 u zhvillua një mbledhje e Grupit të Punës, në të cilën u bë paraqitja e të gjitha reflektimeve mbi sugjerimet dhe mendimet e marra gjatë konsultimeve të zhvilluara në javët paraardhëse në takimet brenda dhe jashtë vendit, duke bërë ndryshimet përkatëse në drafte (procesverbal nr. prot. 32/9, 2 f.).



20 mars 2018

Mbledhje e Grupit të Punës gjatë së cilës kaluan një për një për diskutim nenet e draftit të projektligjit për ASH, u verifikua dakordësia brenda grupit nga anëtarët e tij dhe u shqyrtuan sugjerimet për ndryshime të neneve ku nuk kishte dakordësi (procesverbal nr. prot. 32/10, 3 f.).



21 mars 2018

Mbledhje e Grupit të Punës në të cilën u bë kalimi një për një i neneve të projektit të Kodit të Etikës. U verifikua dakordësia brenda grupit nga anëtarët e pranishëm dhe u shqyrtuan sugjerimet për ndryshime të neneve ku nuk kishte dakordësi (procesverbal nr. prot. 32/11, 2 f.).

27 mars 2018

Takim i GP me anëtarët e Asamblesë së Akademisë së Shkencave në të cilin u bë informimi mbi punën e kryer dhe njohja me draftligjin *Për Akademinë e Shkencave të Shqipërisë* dhe draftit të *Kodit etik në veprimtarinë akademike dhe në kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë*. Në këtë mbledhje u morën sugjerimet përfundimtare para dërgimit të projekteve në Ministrinë e Arsimit, Sporteve dhe Rinisë (procesverbal nr. prot. 32/12).

Pas shqyrtimit të sugjerimeve të fundit dhe rishikimit të fundit nga anëtarët e Grupit të Punës, draftet i dërgohen Ministrisë së Arsimit për vlerësim në datën 30 mars 2018.

Shih: <http://akad.gov.al/ash/pdf/Draftligji%20per%20ASH.pdf>

Shih: http://akad.gov.al/ash/pdf/RELACION_SHPJEGUES_I_PROJEKTLIGJIT.PDF

<http://akad.gov.al/ash/pdf/KODI%20%20ETIK%20NE%20KERKIMIN%20SHKENCOR.pdf>

f

Shih: http://akad.gov.al/ash/pdf/RELACION_SHPJEGUES_KODI.PDF



KOMUNIKIMI ME ALLEA-N DHE AKADEMINË E SHKENCAVE TË GJERMANISË “LEOPOLDINA”

28 dhjetor 2017

Kryesia e Akademisë së Shkencave i drejton presidentit të Akademisë së Shkencave “Leopoldina” të Gjermanisë, Jörg Hacker, shkresën numër prot. 529-2 (2 f.), në të cilën informohet mbi debatin mbi reformimin e ASH-së dhe ku kërkohet mbështetja dhe asistimi i tyre në procesin e hartimit të projekteve të kërkuara dhe procesit të reformimit të saj.

28 dhjetor 2017

Po me të njëjtin objekt dhe kërkesë, Kryesia e Akademisë së Shkencave i drejtohet presidentit të ALLEA-s, Günter Stock, me shkresën numër prot. 529/3 (2 f.) në datën 28 dhjetor 2017.

18 janar 2018

Presidenti i ALLEA-s, Gunter Stock i përgjigjet pozitivisht kërkesës së Kryesisë së ASH për ta mbështetur atë dhe për ta asistuar në gjithë procesin e reformimit dhe hartimit të projektligjit *Ref: Your letter dated 28 December 2017 / Reform of the Albanian Academy of Sciences* (dërguar dt. 8 janar 2018, nr. prot 30).

18 janar 2018

Përgjigje pozitive ndaj së njëjtës kërkesë vjen edhe nga presidenti i Akademisë së Shkencave Gjermane “Leopoldina”, Jörg Hacker mbi konfirmimin e kërkesës për asistim gjatë procesit të reformimit (shkresë nr. prot. 30/1).

19 janar 2018

Në përgjigje të konfirmimit të gatishmërisë për mbështetje dhe asistim gjatë procesit të reformimit, më 19 janar 2018, Kryesia e ASH i drejton shkresën nr. prot. 30/2, presidentit të ALLEA-s, Günter Stock dhe shkresën nr. prot. 30/3, datë 19 janar 2018 presidentit të Akademisë së Shkencave Gjermane “Leopoldina”.

12 shkurt 2018

Për t'i informuar mbi ecurinë e procesit të reformës, më 12 shkurt 2018, Kryesia e ASH i drejton shkresën nr. prot. 30/4 presidentit të Akademisë së Shkencave Gjermane “Leopoldina”, Jörg Hacker dhe shkresën nr. prot. 30/5 presidentit të ALLEA-s.

7 mars 2018

Pas takimeve zhvilluar në Berlin me kryetarin e Grupit të Punës, S. Gjinushi, mbi konsultimet për hartimin e projektligjit për ASH-në, presidenti i ALLEA-s, Günter Stock, i drejton Kryesisë së ASH-së shkresën nr. prot. 30/6, datë 7 mars 2018 dhe, po në të njëjtën datë, Presidenti i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Europës, prof. dr. Felick Unger, i drejton shkresën me nr. prot. 93.



Foto: Berlin, me Presidetin e ALLEA prof. Gunter Stock



Foto: Nga takimi në Akademinë Kombëtare Gjermane LEOPOLDINA, Berlin.

KREU IV

VEPRIMTARIA E ADMINISTRATËS DHE SHËRBIMEVE (SHTOJCË II)

1. BURIMET NJERËZORE

Në mbështetje të Rregullores së Brendshme të Institucionit, neni 30 dhe neni 33, Përgjegjësja e Sektorit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve zbaton dhe ndjek në vijimësi ligjet, vendimet, udhëzimet, urdhëresat, ndryshimet etj., të miratuara nga Kryesia e Akademisë së Shkencave dhe nga institucionet shtetërore, me të cilat ka bashkëpunim.

Gjatë muajit janar e në vijimësi për vitin 2017, ka vazhduar bashkëpunimi me Departamentin e Administratës Publike për zbatimin e ligjeve dhe VKM për ndjekjen e procedurës dhe plotësimin e dokumentacionit për rekrutimin e punonjësve të rinj, emërimin e tyre etj.

Gjatë vitit 2017 Sektori (përgjegjësja), në bashkëpunim me Kryesinë dhe Departamentin e Administratës Publike të Këshillit të Ministrave, ka bërë rekrutimet për vendin vakant të redaktor/it/es të botimeve, nga për zgjedhja e kandidatave për këtë vend vakant është bërë emërimi për periudhën e provës znj. Brikena Liko, si dhe në muajin dhjetor 2017 emërimi definitiv i znj. Brikena Liko.

Është bërë raportimi on-line në Sektorin e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve të Këshillit të Ministrave, për vendet vakante, lirimet, emërimet, proceset gjyqësore dhe ankimimet e nëpunësve civilë. për të dhënat e kërkuara nga DAP në mënyrë të vazhdueshme gjatë vitit 2017 deri në muajin shtator 2017 - pas këtij muaji Akademia e Shkencave është në proces reformimi dhe nuk na është kërkuar informacion.

Gjatë muajve prill-nëntor 2017 nga Shkolla e Administratës Publike, janë bërë trajnime të herëpashërme: për nëpunësit civil në periudhë prove, si dhe nëpunësit civil me status.

Për vitin 2017, Sektori (përgjegjësja), në bashkëpunim të vazhdueshëm me Institutin e Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore, ka bërë verifikimin dhe kontrollin e dokumentacionit, për punonjësit që kanë dalë në pension të plotë pleqërie (Muzafer Korkuti, Efigjeni Kongjika, Gudar Beqiraj), por edhe për ish-punonjësit e ASH të cilët kanë punuar për periudha të caktuara kohore, për të cilët lëshohet vërtetim mbi të dhënat e dokumentuara në regjistrin themeltar të punonjësve, sipas kërkesës së të interesuarit, si dhe verifikimi i dokumentacionit nga specialisti i Institutit të Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore. Gjatë vitit 2017 është punuar për kontrollin dhe plotësimin e dokumentacionit të dosjeve të punonjësve, dhe të anëtarëve të Akademisë së Shkencave, me dokumentacionin e sjelle nga vetë punonjësit, lidhur me kualifikimet, trajnimet etj., të cilat hidhen edhe në sistemin on-line HRMIS.

Sektori ndjek në mënyrë të vazhdueshme planifikimin e lejeve vjetore të punonjësve, si dhe përpilimin e shkresave, në bazë të procedurave përkatëse, në zbatim të ligjeve në fuqi.

Gjatë vitit janë kryer kontrole të herëpashershme për zbatimin e orarit zyrtar dhe disiplinën në punë. Gjatë muajit janar dhe në vijimësi për gjithë muajt e vitit, është bërë planifikimi për administrimin e sallave të Akademisë së Shkencave, për përdorimin me qira nga të tretët, si dhe nga ana e vetë Akademisë, për konferencat shkencore, simpoziumet, promovimet e botimeve të reja të akademikëve, çmimeve shkencore, aktivitetet dhe veprimtaritë e ndryshme social-kulturore, si dhe për dhënie leksionesh nga ana e anëtarëve të Asamblesë së ASH, si edhe nga lektorë të ndryshëm për fusha me interes kombëtar.

Disa problematika që kemi hasur gjatë vitit, për krijimin e kushteve optimale dhe për mbarëvajtjen e mirë të punëve në realizimin e detyrave, janë kapërcyer, duke u pajisur punonjësit me pajisje elektronike bashkëkohore. Sektori (në varësi të fondeve të planifikuara në buxhet për institucionin), ka në vijimësi shqetësimin dhe preokupimin për plotësimin e infrastrukturës me pajisjet e domosdoshme, si për zyrat ashtu edhe për Sallat e ASH (të cilat jepen në përdorim për të tretët), për të patur një mbarëvajtje sa më të mirë, duke bërë edhe propozime për plotësimin dhe përmirësimin e kësaj infrastrukture.

Në fillim të muajit janar e deri në fund të muajit mars të vitit 2017, ky Sektor (përgjegjësja e Sektorit) ka bashkëpunuar me Inspektoratin e Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, në zbatim të ligjit nr.9049, dt.10.04.2003, i ndryshuar “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, ka udhëzuar subjektet përkatëse në plotësimin e deklaratave për vitin 2016, (Kryetari, Zëvendëskryetari, Sekretari Shkencor dhe dy drejtuesit e seksioneve të ASH), deri në dorëzimin e formularëve në Inspektoratin e Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive, brenda afatit të përcaktuar në ligjin e mësipërm.

Sektori (përgjegjësja), ka dërguar shkresat përkatëse në ILDKPKI si dhe ka përgatitur vërtetimet dhe vetdeklarimet për subjektet që kanë detyrimin për deklarimin e pasurive në bazë të ligjit. Gjithashtu nga muaji shtator-dhjetor janë dërguar në ILDKPKI edhe formularët e deklaramit të pasurive pas largimit nga funksioni (dorëheqje) për subjektet që mbartin detyrim për deklarimin e pasurive: Muzafer Korkuti dhe Gudar Beqiraj.

Procedurat e mësipërme janë pasqyruar edhe me shkëmbimin e shkresave, të cilat janë regjistruar në protokollin e Institucionit, si dhe në librin e protokollit të vetë Sektorit.

Gjatë muajit janar e në vijim Sektori (përgjegjësja), ka punuar për zbatimin me përpikëri të ligjit nr.9367, dt.07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, në zbatim të akteve nënligjore të miratuara nga titullari për identifikimin dhe regjistrimin e interesave në kushtet e konflikteve rast për rast të interesave, si Autoritet Përgjegjës, në zbatim edhe të rregullores së brendshme “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, si dhe të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” si koordinator i institucionit, për garantimin e një vendimmarrjeje transparente, të paanshme, në mbështetje të realizimit të objektivave dhe detyrave kryesore të Akademisë, në interesin më të mirë të mundshëm të publikut e të besimit të tij ndaj këtij institucioni, nëpërmjet parandalimit të konfliktit, ndërmjet interesave publike dhe atyre private të një zyrtari, në ushtrimin e funksioneve vendimmarrëse në Akademi. Për gjithë veprimtarinë dhe detyrat që ka Autoriteti Përgjegjës i institucionit në fillim të muajit janar raporton në Inspektoratin e Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave për vitin paraardhës.

Përgjegjësja e sektorit të burimeve njerëzore dhe shërbimeve ka si detyrë funksionale edhe detyrën e sekretares së Kryesisë (Rregullorja e Brendshme e ASH, neni 31). Gjatë vitit 2017, në mënyrë të vazhdueshme, në bashkëpunim edhe me Sektorët e tjerë ka

kontribuar për realizimin e disa konferencave shkencore dhe veprimtarive kulturore si: dhënie dekorata, medalje, ditëlindje të anëtarëve të Asamblesë, për konkursin e dhënies së Çmimeve shkencore për botimet më të mira të vitit, ka punuar për realizimin e lidhjeve të titullarëve, me organe e institucione të tjerë, me të cilët bashkëpunon Akademia; ka koordinuar punën me sektorët për pritjet e ndryshme të Kryesisë, në takimet me delegacione, personalitete, përfaqësues institucionesh shtetërore e private, si dhe ka kryer detyrat e caktuara nga vendimet e Asamblesë për Komisionin ad-hoc të reformës në ASH, duke përgatitur materialet për zhvillimin e mbledhjeve dhe shpërndarjen e informacionit për çdo anëtar të Asamblesë së ASH.

Gjatë vitit 2017 është punuar edhe për zbardhjen e vendimeve të mbledhjeve të Asamblesë, Këshillit Ekzekutiv, Kryesisë së ASH, proceset e votimit në Asamble për Kryetar e Zëvendëskryetar të ASH, si dhe ka marrë pjesë në Komisionin ad-hoc, të krijuar me vendim Asambleje, për reformimin e Akademisë së Shkencave, në përgatitjen e materialeve dhe shkëmbimin e informacionit nga secili anëtar i Asamblesë dhe i Komisionit.

Pjesë e strukturës së Sektorit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve janë edhe:

Specialistja e IT ka zbatuar detyrat e përcaktuara për vendin e punës, duke i realizuar ato në kohë dhe kryer sipas porosive:

1. Menaxhimi i përpunimit të informacionit shkencor në Akademinë e Shkencave të Shqipërisë nëpërmjet dizenjimit, implementimit, administrimit dhe mirëmbajtjes së bazave të të dhënave, rrjetit kompjuterik, aplikacioneve web mbështetur në kërkesat funksionale të kryesisë dhe sektorëve të Akademisë.
2. Kontaktimi në mënyrë të vazhdueshme me Kryesinë, me sektorët dhe me nëpunës të tjerë të aparatit të Akademisë së Shkencave, për problemet që lindin në lidhje me përpunimin, mirëmbajtjen dhe shfrytëzimin e informacionit.
3. Menaxhimi i punës për dizenjimin, implementimin dhe mirëmbajtjen e faqes zyrtare të ASH bazuar në një bazë të dhënash e cila aksesohet në bazë të një politike të vendosur nga Akademia e Shkencave për marrjen e informacioneve në mënyrë on-line nga akademik apo universitete dhe punonjës shkencor që shfrytëzojnë këtë informacion.
4. Popullarizimi me informacion i rrjeteve sociale (Facebook, Twitter, Youtube) të aktivitetit dhe veprimtarisë shkencore të Akademikëve dhe të Akademisë së Shkencave.
5. Mirëmbajtja e arkitekturës hardware dhe software të sistemeve të informacionit të ngritura në ASH (rrjeti kompjuterik, Internet, E-mail, Administrim i bazave të të dhënave, Aplikacionet, Siguria, Administrim serveri në platforma të ndryshme etj.).
6. Vlerësimi i teknologjisë që përdoret nga ASH dhe rekomandime për përmirësime sipas nevojës.
7. Konfigurimi, përditësimi i LAN, Hubs, Switches.
8. Monitorimi i problemeve të rrjetit, dështimet e lidhjeve me HTTP, HTTPS, SMTP, FTP, SSL, ICMP, VOIP, dhe protokollat e tjera.
9. Identifikimi i nevojave për përmirësimin dhe plotësimin e mangësive në rrjet apo për rritjen e kapaciteteve të rrjetit për t'ju përgjigjur kërkesave.
10. Mbështetje teknike për aktivitetet e kryera në Sallën "Aleks Buda".
11. Popullarizimi me informacion të aktivitetit dhe veprimtarisë shkencore të Akademikëve së të rinjve në faqen zyrtare të Akademisë së Shkencave.

Gjatë vitit 2017 puna në arkiv-protokoll ka qenë korrekte, duke zbatuar ligjin në fuqi. Dokumentet e brendshme dhe ato dërguese kanë qenë të sakta dhe nuk ka patur probleme.

Janë shpërndarë sipas udhëzimeve të titullarëve. Dokumentacioni për institucionet, si brenda vendit dhe jashtë vendit është shpërndarë në bashkëpunim me postën. Sipas udhëzimeve (vendime, urdhra etj.) të Asamblesë, Kryesisë dhe Këshillit Ekzekutiv, gjatë vitit 2017 është bërë protokollimi sipas kërkesave për dosjet shkencore, që janë paraqitur nga studiues dhe kërkues të ndryshëm, për çmimet shkencore të dhëna nga ASH, për kandidaturat e paraqitura për zgjedhjet e Kryetarit dhe Zëvendëskryetarit të ASH etj.

Është dorëzuar në Arkivin Qendror të Shtetit dokumentacioni (dokumente historike kombëtare dhe dokumente të përkohshme), i përpunuar dhe inventarizuar për vitin 2006, për të ndihmuar arkivistin është marrë me honorar edhe një punonjës, i cili ka bërë klasifikimin e dokumentacioneve që dorëzohen në Arkivin Qendror të Shtetit. Është duke u punuar për vitin 2006 dhe po vazhdojnë proceset e fundit për t'i dorëzuar në AQSH, sipas rregullave në fuqi. Është punë në proces klasifikimi i dokumenteve sipas viteve.

Ky sektor ka në strukturën e tij edhe punonjës administrativ të shërbimit (1 punëtor teknik mirëmbajtës (neni 39 i rregullores së brendshme të ASH), 1 shofer (neni 40 i rregullores së brendshme të ASH) dhe 1 punonjëse shërbimi-sanitar (neni 41 rregullores së brendshme të ASH), detyrat dhe realizimi i të cilave, i kanë shërbyer si titullarëve të institucionit, ashtu edhe punonjësve të sektorëve të ndryshëm, për përmbylljen me sukses të shumë veprimtarive, kërkimore-shkencore, studimore, kulturore etj., që zhvillon Akademia e Shkencave.

Në mbledhjen e sektorit të datës 6 shkurt 2018, përveç nëpunësve të këtij sektori, morën pjesë edhe dy përgjegjëse të sektorit të financës dhe sektorit të botimeve shkencore dhe bibliotekës. Në këtë mbledhje u diskutua rreth detyrave të secilit, në zbatim të rregullores së ASH, si dhe përmirësimin e punës në vijim. Gjithashtu u miratua edhe raporti vjetor 2017 për sektorin e burimeve njerëzore dhe shërbimeve.

II. SHËRBIMI I FINANCËS

Mbështetur në statusin dhe rregulloren e brendshme të ASH sektori i financës hartoi analizën vjetore të sektorit. Nga ana e këtij sektori janë bërë përpjekje maksimale për të organizuar dhe kryer veprimtaritë e tij mbi bazën e ligjeve dhe vendimeve si dhe rregullave në fuqi duke u përgjigjur për zbatimin e përpiktë të tyre. Para miratimit të shkresave/urdrave me karakter financiar, është bërë kujdes, lidhur me ligjshmërinë, rregullshmërinë dhe respektimin e parimeve të ekonomicitetit, efijencës dhe efektivitetit.

Sektori i financës varet nga Kryesia e ASH dhe ka për detyrë të drejtojë dhe kontrollojë veprimtarinë ekonomiko-financiare të aparatit të Akademisë. Është hartuar dokumenti përfundimtar i buxhetit dhe bashkërendimin e punës gjatë procesit të përgatitjes së buxhetit si dhe llogaritjen e kostove të veprimtarive të përcaktuara nga drejtuesit e programeve duke bërë edhe identifikimin dhe krijimin e regjistrit të riskut, vlerësimin, kontrollin e risqeve që vënë në rrezik arritjen e objektivave dhe realizimin me sukses të veprimtarive.

Sektori i financës ka për detyrë:

1. Të përdorë buxhetin e Shtetit konform legjislacionit në fuqi për realizimin e detyrave në baze projektesh, për botime, në investime, për përsosjen e infrastrukturës shkencore të Akademisë së Shkencave, si dhe në shpenzime me jashtë që i shërbejnë realizimit të bashkëpunimit, transferimit të teknologjive, kualifikimit etj. në plotësimin e detyrave të Akademisë së Shkencave në përputhje me ligjin e Akademisë së Shkencave për përafrimin e

standardeve të kërkimit shkencor shqiptar me ato europiane si një faktor i rëndësishëm në prosperitetin e kombit.

2. Pas organizimit të procesit të detajimit të Buxhetit, dërgohet pranë Ministrisë së Financave, zyrtarisht dhe në formë elektronike detajimin e fondeve buxhetore për vitin në vazhdim sipas strukturës buxhetore.

3. Ndjekjen dhe zbatimin e kontratave të lidhura nga titullari.

4. Ndjekjen dhe zbatimin financiar të projekteve në bashkëpunim me seksionet dhe bën raportimet përkatëse.

5. Të kryejë në mënyrë periodike rakordimi i situacioneve të shpenzimeve dhe të të ardhurave me Degën e Thesarit Tiranë.

6. Është përgjegjëse për ngritjen e një sistemi për monitorimin e menaxhimit financiar dhe të kontrollit, monitorimin dhe vlerësimin e sistemit duke e realizuar përmes monitorimit në vijueshmëri, vetëvlerësimin dhe auditimit të brendshëm. Çdo 3 muaj behet raporti i monitorimit ku analizohet aktiviteti financiar i institucionit.

7. Ta trajtojë Riskun si një proces të identifikimit, vlerësimin, kontrollin dhe monitorimin të atyre ngjarjeve potencialisht të dëmshme për arritjen e objektivave në Institucionin tonë.

8. Në fillim të vitit me marrjen e buxhetit të miratuar hartohet dhe depozitohet regjistri i prokurimeve publike zyrtarisht dhe elektronikisht në Agjencinë e Prokurimit Publik dhe Degën e Thesarit në fillim të çdo viti buxhetor mbështetur në kërkesat tona, si dhe çdo ndryshim të tij gjatë vitit, përpara fillimit të procedurës së prokurimit. Në çdo rast, shuma totale e prokurimeve duhet të jetë e barabartë ose më e vogël se fondet e miratuara për vitin buxhetor. Çdo 4 muaj bëhet raportimi i realizimit të regjistrin të prokurimeve.

9. Ndjek zbatimin e organikës dhe strukturës organizative të miratuar. Përgatit borderotë e pagesave të punonjësve dhe mban evidencën e pagave në librat përkatës të miratuara sipas legjislacionit në fuqi.

10. Numri maksimal i punonjësve detajohet në përputhje me emërtesën e institucionit dhe numrin përkatës të saj të përcaktuar në Urdhrin e miratimit të strukturës. Fondi i pagave dhe sigurimeve shoqërore përdoret për numrin faktik mujor të punonjësve në organikë, brenda numrit limit të miratuar pa lejuar përdorimin e fondit të lirë që rezulton nga strukturat e paplotësuara.

11. Fondi i veçantë i njësive shpenzuese nuk është pjesë e fondit të pagave, pasi ky fond alokohet dhe përdoret me miratim të ministrit të Financave. Limiti maksimal i fondit të veçantë, i parashikuar për t'u përdorur, është përcaktuar sipas udhëzimit të Buxheti. Përdorimi i fondit të veçantë bëhet në përputhje me kriteret e përcaktuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 929, datë 17.11.2010 *Për krijimin dhe përdorimin e Fondit të veçantë, i ndryshuar*. Kërkesat për përdorimin e fondit të veçantë brenda limitit paraqiten rast pas rasti pranë strukturës përgjegjëse për buxhetin dhe i propozon për miratim të ministri i Financave. Kjo kërkesë duhet të përmbajë edhe informacionin lidhur me shumën e përdorur nga fondi i veçantë deri në momentin e paraqitjes së kësaj kërkesë.

12. Mban marrëdhënie të vazhdueshme me Institutin e Sigurimeve Shoqërore dhe Drejtorinë e Tatimeve për pagesat e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore. Përgatit dokumentet financiare për punonjësit që dalin në pension,

13. Ndjek zbatimin e VKM për përdorimin e fondit të veçantë.

14. Sektori i financës kujdeset për shitjen dhe shpërndarjen e botimeve të Akademisë sipas rregullave në fuqi, duke arkëtuar të ardhura, gjatë vitit 2017 janë arkëtuar 911.025 lekë nga të cilat 30 për qind ose 273.307 janë përdorur për nevoja të Institucionit ndërsa pjesa tjetër është derdhur në buxhet. Po kështu kujdeset edhe për arkëtimin dhe derdhjen në buxhet të të ardhurave nga dhënia e sallave me qera sipas çmimeve të miratuara nga ana e Ministrisë së Financave. Gjatë vitit 2017 janë derdhur në buxhet 707.000 lekë ose 373.000 lekë më shumë se viti paraardhës. nga këto të ardhura 90 për qind ose 636.300 janë përdorur për nevoja të Institucionit ndërsa pjesa tjetër është derdhur në buxhet

15. Ndjek në vijimësi procedurat ekonomiko-financiare të tenderimit të botimeve të Akademisë që në momentin e hartimit të listës së botimeve nga Këshilli i Botimeve e deri në miratimin e çmimeve të shitjes nga ana e Ministrisë së Financave. Në vitin 2017 janë botuar 21 tituj monografi dhe studime shkencore dhe 5 revista periodike dhe u tenderuan 5.000.000 leke. Midis botimeve shumë të rëndësishëm është vazhdimi i botimit të serisë së Albumeve ilustrative shkencore të Veshjeve Popullore Shqiptare.

Është patur kujdes në mbajtjen e sistemit të kontabilitetit, raportimit në funksion të realizimit të objektivave, kontabilizimin e plotë, të saktë dhe në kohë të të gjitha transaksioneve. Është bërë raportimi periodik i realizimit të objektivave, si dhe të pasqyrave financiare vjetore, në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi dhe rregullat e miratuara nga Ministri i Financave, në bazë të dokumentimit të të gjitha transaksioneve financiare dhe garantimin e gjurmës së auditimit për të gjitha proceset që ndodhin.

Pasqyrat financiare përmbledhëse janë përpiluar dhe dërguar brenda afateve të miratuara në Degën e Thesarit Tirane si dhe në Ministrinë e Financave shoqëruar me situacionin përfundimtar të shpenzimeve, relacionin shpjegues përkatës dhe analizën e të gjithë llogarive sintetike që përbejnë aktivin dhe pasivin e bilancit.

Menjëherë pas ardhjes së planit financiar të miratuar nga organet përkatëse është kryer zbërthimi i tij dhe i është paraqitur për miratim Kryesisë pas së cilës ai do të behet veprues për këtë sektor. Gjatë zbatimit të buxhetit janë bërë edhe ndryshime të pjesshme të diktuar nga gjendje të paparashikuara me synimin e shfrytëzimit racional të fondeve duke përfshirë edhe zhvendosjen e tyre nga një zë në tjetrin, gjithnjë në përputhje me rregullat në fuqi.

Gjatë kryerjes së transaksioneve financiare ditore me Degën e Thesarit, është bërë edhe mbajtja e kontabilitetit, dhe të pasqyrave financiare duke u mbështetur në Ligjin nr. 9228, Datë 29.4.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" i ndryshuar. Dokumentet justifikuese për kryerjen e veprimeve ekonomike janë plotësuar konform dispozitave ligjore në fuqi duke zbatuar parimet e përgjithshme për përgatitjen e llogarive vjetore dhe mbajtjen e kontabilitetit. Artikujt kontabël janë regjistruar në mënyrë kronologjike në ditarët e "Arka në Leke", "Arka në Valute", në ditarët e "Veprimeve me Bankën", në "Ditarët e hyrje-daljeve të magazinës". Të gjitha veprimet dhe mbylljet e llogarive regjistrohen në "Centralizator". Për çdo vit janë përpiluar Bilancet të shoqëruara me relacionet, situacionet përfundimtare të shpenzimeve dhe të ardhurave si dhe me aktet e rakordimit me Ministrinë e Financave të Buxhetit dhe Investimeve. Debitë dhe kreditë janë mbajtur në partitarët analitike të tyre megjithatë ka edhe debitorë dhe kreditorë të krijuar para vitit 2001, por që nuk mund të gjejmë zgjidhje. Debitorë të rinj nuk ka më të krijuar.

Për ruajtjen dhe mbrojtjen e aktiveve dhe të dokumentacionit të njësisë kundrejt humbjeve, vjedhjeve, keqpërdorimit dhe përdorimit të paautorizuar është treguar kujdes i vazhdueshëm. Inventarët fizike për mallrat në përdorim dhe në magazine kryhen rregullisht sipas urdhrave të brendshme të Kryesisë duke respektuar afatet e përfundimit të tyre, behet azhurnimi dhe nxjerrja e rezultatit përfundimtar. Mbase kryhet inventarizimi është hartuar relacioni përkatës për titullarin e institucionit duke bërë propozimet përkatëse për nxjerrje jashtë përdorimit.

ASH është e përfshirë institucionalisht në projekte e programe të ndryshme si:

- Projekte në kuadër të marrëveshjes së bashkëpunimit kërkimor-shkencor dhe artistik midis ASH dhe ASHAK (shpenzime për Kosovën - art 604)
- Projekte në kuadër të marrëveshjes së bashkëpunimit kërkimor-shkencor dhe artistik midis ASH dhe akademive të shkencave dhe arteve të vendeve fqinje si p.sh. projekti: *Marrëveshje mbi bashkëpunimin në vendosjen e një sistemi kombëtar bibliografik për vlerësimin e rezultateve të kërkimit shkencor në Shqipëri (Projekti COBISS)*,

• Projekte të mbështetura nga akademitë e shkencave dhe organizma europianë apo ndërkombëtarë

Për realizimin e këtyre projekteve nga ana jonë janë bërë përpjekje për miradministrimin e fondeve të vëna në dispozicion. Këto projekte janë realizuar sipas tabelës së mëposhtme:

Në mijë lekë

Nr.	Emërtimi	Buxheti vjetor 2017	Realizimi vjetor 2017	Në për qind
1	Fonde jashtë-buxhetore	1340	1300	97
	Totali i shpenzimeve	1340	1300	97

Fondet e perealizuara janë të trashëgueshme për vitin pasardhës.

Duke krahasuar treguesit e buxhetit të miratuar për vitin 2017 me ata faktikë rezulton se janë bërë përpjekje maksimale për realizimin e projekteve të planifikuara. Akademia e Shkencave menaxhon fondet buxhetore, në programin *Veprimtari akademike*.

a) Realizimi i shpenzimeve për periudhën Janar - Dhjetor 2017, krahasuar me planin vjetor të miratuar paraqitet si vijon:

Në mijë lekë

Nr.	Emërtimi	Buxheti vjetor 2017	Realizimi vjetor 2017	Në për qind
1	Paga (600)	27400	27225	99
2	Sigurime shoqërore (601)	4600	3992	87
3	Shpenzime korente (602)	42650	42650	100
4	Transferta të brendshme (604)	1500	988	66
5	Transferta me jashtë (605)	400	377	94
6	Transferime të brendshme (606)	32736	29131	89
7	Investime (231)	2000	1341	67
	Totali i shpenzimeve	110950	105704	95

Shpenzimet faktike krahasuar me fondet e buxhetit për vitin 2017:

- Artikulli 600 është realizuar 99 për qind
- Artikulli 601 është realizuar 87 për qind
- Në artikullin 602 realizimi i fondeve është 100 për qind .
- Për artikullin 604 (shpenzime për Kosovën) janë realizuar vetëm 66 për qind
- Në artikullin 605, pagesat e kuotave të anëtarësisë të organizatave ndërkombëtare në të cilat aderon Institucioni ynë, janë realizuar 94 për qind .
- Artikulli 606 është realizuar në masën 89 për qind
- Në zërin 231 realizimi i fondeve është 67 për qind

b) Shpenzimet nga te ardhurat dytesore (kap. 5) sipas limitit të miratuar u realizuan sipas pasqyrës së mëposhtme

Në mijë lekë

Nr.	Emërtimi	Fondi limit per vitin 2017	Të realizuara gjatë vitit 2017	Shpenzuar për vitin 2017	Në për qind
1	Shpenzime korrente (602)	1050	910	903	99
	Totali i shpenzimeve	1050	910	903	

Konkluzioni kryesor që nxirret nga një analizë e thjeshtë e kësaj tablele është se niveli i realizimit të shpenzimeve në total, për periudhën janar-dhjetor 2017 në krahasim me fondet e vëna në dispozicion, arriti në rreth 95 për qind.

Në zbatim të VKM 120 dt. 27.1.1997 gjatë vitit 2017 janë bërë pagesat e honorarëve për autorët e veprave shkencore, për afro 12.253.020 lekë.

Për vitin në vazhdim krahas detyrave të mësipërme do të synohet në përmirësimin e sistemit të menaxhimit financiar me qëllim që të sigurohet përdorimi me efektivitet, ekonomi dhe efikasitet të fondeve publike. Gjatë vitit 2017 janë mbështetur financiarisht veprimtaritë në fushën e shkencave shoqërore dhe albanologjike dhe të shkencave natyrore dhe teknike si për realizim i projekteve dypalëshe e shumëpalëshe dhe projekte në kuadër të protokollit të bashkëpunimit shkencor dhe artistik midis ASH dhe ASHAK: *Studimi i ndryshimeve mjedisore në një segment të zonës ndërkufitare Shqipëri-Kosovë.*

Konferenca dhe simpoziume

1. Konferenca shkencore ndërkombëtare “Kanceri i qafës së mitrës: parandalimi, diagnostikimi dhe trajtimi i tij” (4 shkurt)
2. Kongresi V Ndërkombëtar i Shoqatës Shqiptare të Obstetër-Gjinekologëve (12-14 maj)
3. Simpozium shkencor “Hortikultura shqiptare: gjendja dhe ardhmëria në këndvështrimin e studimit enciklopedik më të fundit të ASH” (2 qershor)
4. Simpozium shkencor: “Prof. Arqile Bërxfholi, një jetë në kërkimin shkencor e pedagogjik në fushat multidisiplinore të gjeografisë” (29 qershor)
5. Konferenca shkencore ndërkombëtare *Qytetërimi i Voskopojës dhe shekulli i iluminizmit në Ballkan*, (1767-2017), 13-14 nëntor 2017 (Tiranë - Voskopojë)
6. Konferenca shkencore jubilarë *Rexhep Ismajli në 70-vjetorin e lindjes*, organizuar nga ASH në bashkëpunim me ASHAK, e mbajtur më 8 qershor 2017 në sallën “Aleks Buda”
7. Konferencë jubilarë *Prenkë Jakova në 100-vjetorin e lindjes* organizuar nga ASH në bashkëpunim me Universitetin e Arteve (9 qershor 2017)
8. Konferencë jubilarë *Androkli Kostallari figurë e shquar e albanologjisë shqiptare*, me rastin e 95-vjetorit të lindjes, organizuar prej Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe Shoqatës së Gjuhësisë Shqiptare. (7 nëntor 2017)
9. Konferencë shkencore ndërkombëtare *Risi arkeologjike nga trevat shqiptare* (30-31 janar 2017).

10. Konferencë shkencore **Mitrush Kuteli, në 110-vjetorin e lindjes**, organizuar nga Akademia e Shkencave dhe Universiteti i Korçës.

11. Konferencë shkencore ndërkombëtare **Mapping Balkan routes: literary, cultural and linguistic landscapes, International Conference on Balkan Studies**, organizuar nga Universiteti i Vlorës, Universiteti i Beogradit dhe Akademia e Shkencave.

12. Konferenca shkencore **Studiuesi Rexhep Qosja dhe vepra e tij**, organizuar nga Universiteti i Gjirokastrës, ASA dhe ASH, mbledhi në Gjirokastrë një numër të madh akademikësh, studiues e kritikë, të cilët mbajtën referata e kumtesa të ndryshme në lidhje me veprimtarinë e gjatë të akademikut Qosja (30 tetor 2017)

13. Konferencë shkencore **Personaliteti shkencor i akademik Jorgo Bulos**, organizuar nga Universiteti i Gjirokastrës dhe Akademia e Shkencave e Shqipërisë.

BOTIME DHE PËRURIME

Botime monografish

1. Botimi i dy numrave të revistës shkencore “Journal of Natural and Technical Sciences” (JNTS);

2. Botimi i dy numrave të revistës “Studia Albanica”.

Forume shkencore, promovime botimesh, tryeza të rrumbullakëta me grupe ekspertësh

1. Forum shkencor “Kultivarët e vendit të pemëve frutore, hardhisë, ullirit dhe agrumeve në Shqipëri dhe në Kosovë dhe ndërtimi i sistemit shkencor të certifikimit për prodhimin e fidanëve” (në këndvështrimin e botimit të ri shkencor *Pemëtaria dhe vreshtaria në Shqipëri dhe në Kosovë*, në kuadër të Protokollit të Bashkëpunimit Shkencor dhe Artistik midis ASHSh dhe ASHAK) (22 nëntor)

2. Takimi shkencor “Një jetë me përkushtim në Gjeologji” për specialisten mineraloge prof. dr. Marije Koçi (9 shkurt)

3. Ceremoni për dhënien e medaljes “Nderi i Akademisë” prof. dr. Agim Ballvorës (10 mars)

4. Leksion i hapur “The innovative technology on the environment quality using the moss survey”. (4 korrik)

5. Promovimi i botimit “*Atlasi i Florës i Shqipërisë*” me autor *Jani Vangjeli* (6 nëntor)

6. Forum i hapur: Prezantim i botimit **Antropologji e Kanunit**, i studiuesit Nebi Bardhoshi, nominuar për çmimin *Kërkuesi i ri më i suksesshëm*, në edicionin I të konkursit shkencor të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë.

7. Prezantim i librit **Arbërit e Jonit**, i profesor Pëllumb Xhufit, fitues i çmimit *Çabej*, në edicionin I të konkursit shkencor të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, organizuar në sallën “Aleks Buda”, të Akademisë së Shkencave (30 maj 2017)

8. Pas nominimit të veprës **Thimi Mitko: Fjalëtoje gërqisht-shqip dhe ndihmesa të tjera leksikografike**, për çmimin *Çabej*, në edicionin I të konkursit shkencor të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, (2 qershor 2017)

9. Ligjëratë e hapur **Katërrungjillëshi i dekoruar i Korçës** (Kodiku i Korçës), me autorë Andi Rëmbecin dhe Sokol Çungën, fitues të çmimit *Kërkuesi i ri më i suksesshëm*, në edicionin I të konkursit shkencor të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë. (5 qershor 2017).

10. Takim shkencor jubilar **20-vjet revista kulturore shkencore "Perla"**, bashkëpunim i Akademisë së Shkencave me Ambasadën e Republikës Islamike të Iranit dhe Fondacionin kulturor "Saadi Shirazi". (10 nëntor 2017)

11. Ligjëratë e hapur: **Një 80-vjetor i akademizmit albanologjik në Shqipëri**, nga prof. dr. Aurel Plasari, në sallën "Aleks Buda" të Akademisë së Shkencave, në prani të një grupi profesorësh e studiuesish, kryesisht të fushave albanologjike. (19 nëntor 2017).

12. Promovimi i botimeve **Tefta Tashko Koço dhe bashkëkohësit e saj në imazhe dhe Libërth me dorëshkrime këngësh (1936-1945)** në kuadrin e 70-vjetorit të ndarjes nga jeta të sopranos Tefta Tashko Koço, u organizuan nga Akademia e Shkencave në bashkëpunim Këshillin e Muzikës Shqiptare, më 2 nëntor 2017.

III. BOTIMET SHKENCORE DHE BIBLIOTEKA

Biblioteka shkencore e Akademisë së Shkencave në punën e saj synon: të mbështetë fuqimisht kërkuesit shkencorë në punën e tyre përmes sigurimit të informacionit shkencor për fushat akademike; të mbështetë studiuesit e rinj për hulumtime të specializuara sipas indekseve në bazën e të dhënave të literaturës shkencore; të organizojë informacionin shkencor, të sigurojë qasje dhe të ndihmojë përdoruesit në gjetjen dhe shfrytëzimin e literaturës së bibliotekës; të ndjekë bashkëpunimin e të realizojë shkëmbimin ndërbibliotekar me synim pasurimin e informacionit përmes titujve shkencorë të huaj etj.

(shih: <http://akad.gov.al/ash/pershkrim>)

Në mbështetje të marrëveshjes **"Bashkëpunimi dhe krijimi i sistemit bibliografik kombëtar për evaluimin e rezultateve të kërkimeve shkencore në Shqipëri"** midis Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe Institutit të Shkencave të Informacionit (IZUM), Maribor, Slloveni (2012), është bërë i mundur krijimi i katalogut të përbashkët bibliografik online në Shqipëri, në të cilin janë përfshirë 29 biblioteka të Shqipërisë pasi është realizuar trajnimi i rreth 60 punonjësve të bibliotekave (biblioteka universitare, publike dhe speciale), në të cilat tashmë është implementuar sistemi COBISS (Sistemi dhe shërbimet e përbashkëta bibliografike online). Ky katalog i përbashkët me rreth 105.565 regjistrime bibliografike luan rolin e bibliotekës virtuale dhe përfaqëson një model organizativ të lidhjes së bibliotekave në sistemin online të informacionit. Biblioteka e Akademisë Akademia së Shkencave të Shqipërisë, luan rolin e liderit në këtë proces të rëndësishëm në ndihmë të krijimit të bazave të të dhënave online, shkëmbimit të informacionit brenda dhe jashtë vendit si dhe të promovimit të veprimtarive shkencore të akademikëve dhe hulumtuesve shkencorë.

(Shih:

<http://www.al.cobiss.net/scripts/cobiss?command=CONNECT&base=92001&mode=5>)

Si rezultat i punës intensive, në vitin 2017, biblioteka së Akademisë së Shkencave të Shqipërisë ofroi shërbimin më të ri të specializuar për përdoruesit: **bibliografinë e parë online për kërkuesit shkencorë**, të njërit prej personaliteteve madhore të kulturës shqiptare, akademik Kristo Frashërit, duke shënuar me këtë hap krijimin e sistemit bibliografik të kërkimit shkencor në nivel kombëtar. Ky sistem do të shërbejë në evidentimin dhe vlerësimin e rezultateve të veprimtarisë kërkimore në Shqipëri.

(shih: <http://splet02.izum.si/cobiss/bibliography?code=00728&langbib=alb&li=al>)

Biblioteka e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë organizoi konferencën shkencore “*Bibliografite shkencore - një shërbim i ri për afrimin e kërkimit shkencor më pranë përdoruesve. Bibliografia online e akad. Kristo Frashërit si model i procesit*” më 22 shtator 2017. Konferenca u shoqërua me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të bibliotekave shkencore universitare në nivel kombëtar dhe të Institutit të Shkencave të Informacionit (IZUM) Slloveni, dhe pati një impakt të menjëhershëm si një model dhe risi për të gjitha bibliotekat shqiptare, të cilat janë nxitur dhe kanë nisur punën për hartimin e bibliografive të kërkuesve të tjerë shkencorë.

Biblioteka e ASH, me këtë proces të ri të mundësuar për studiuesit e më gjerë, thekson rëndësinë e specifikës dhe efikasitetit të një biblioteke shkencore që nuk kufizohet vetëm me dhënien e informacionit dhe vënien në dispozicion të fondit të përgjithshëm të saj, por ofron një shërbim më të specializuar : procesi i krijimit të bibliografisë së kërkuesve shkencorë bën pjesë në ato procese që bën dallimin e një biblioteke shkencore nga të tjerat.

Nëpërmjet përmbushjes së fillimit të mbarë të sfidës, krijimit të së parës bibliografi online të një përfaqësuesi të shkencës shqiptare, mundësohet;

- *Integrimi i kërkimit shkencor shqiptar në sistemin bashkëkohor* ndërkombëtar të qasjes së informacionit mbi shkencëtarët.

- *Komunikimi i vlerave dhe dijes albanologjike* me trashëgiminë botërore, promovimi i elitës shkencore shqiptare si shprehje e dukshme e integritit të shkencës shqiptare në sisteme të hapura botërore të informacionit.

- *Krijimi për herë të parë i skemës online apo modelit bibliografik të kërkimit shkencor shqiptar* përmes arritjeve akademike të kërkuesve të fushave të ndryshme të dijeve albanologjike: histori, gjuhësi, letërsi, antropologji, shkencat shoqërore në përgjithësi, si dhe të shkencave natyrore: mjekësi, fizikë, matematikë, gjeologji, informatikë etj., duke dhënë një vizion të gjerë të ekzistencës dhe bashkëveprimit ndërdisiplinor shkencor.

- *Qasje e re ndaj literaturës* të ofruar sipas tipologjisë shkencore: monografi, artikuj, trajtesa, kumtime, përkthime, kritikë, vëzhgime, hulumtime etj., gjithçka që është referencë për shkencën shqiptare; *shumëfishimi i mundësive të kërkimit dhe zgjedhjeve* që ofron sistemi, përmes tipologjisë shkencore të përcaktuar sipas standardit, kronologjisë historike dhe elementeve të tjera të përshkrimit bibliografik duke krijuar hapësira të frytshme kërkimi.

Pasurimi i fondit të bibliotekës shkencore të Akademisë është kryer, si gjithmonë, nëpërmjet tri proceseve kryesore: blerjes së botimeve të reja shkencore, shkëmbimit me biblioteka e institucione shkencore në botë, dhe nëpërmjet dhuratave nga institucione e individë. Buxheti i përcaktuar për bibliotekën, prej 400.000 lekësh është shpenzuar për blerjen e botimeve më të fundit shkencore, të cilat kanë pasuruar koleksionin e bibliotekës sonë me 152 tituj të rinj; nga dhuratat hynë në fond: 81 tituj, nga shkëmbimet: 92 tituj.

Procesi i katalogimit online, i klasifikimit të njësive bibliografike dhe regjistrimit të tyre e ASH e ka çuar numrin e regjistrimeve të bibliotekës së ASH, në 8635 regjistrime) mund t'i shihni në bazën e të dhënave online (OPAC) ku përdoruesit mund të kërkojnë me elementet e kërkimit të përshkrimit bibliografik materialet që u nevojiten.

Sektori ynë si rezultat i punës në grup, gjatë vitit 2017 **përditësoi katalogun online të botimeve shkencore të ASH** për vitet 2000-2016, të specifikuar në rubrikën përkatëse të botimeve, në faqen zyrtare të Akademisë së Shkencave.

Katalogu online përmban skedën e hollësishme të secilit botim, me të dhënat përshkruese bibliografike e kopertinat, dhe është një pasqyrë e plotë e titujve shkencorë të institucionit të Akademisë që vjen si ndihmë jo vetëm për kërkuesit shkencorë, por dhe si një nevojë e

domosdoshme për referencë shkencore të studiuesve të ndryshëm, studentëve e gjithkujt të interesuar për botime të karakterit shkencor.

Përditësimi i listëve të periodikëve të huaj shkencorë, që vijnë në bibliotekën e ASH nëpërmjet procesit të shkëmbimit, u krye në një formë të re, në mënyrë shumë të specifikuar, nëpërmjet informacionit përmbledhës në lidhje me çdo periodik. Nëpërmjet këtij përditësimi të rëndësishëm mbi kërkimin shkencor në botë, vjen specifika dhe larmia e artikujve, sipas fushave të ndryshme, në ndihmë të përdoruesve të bibliotekës, kërkuesve të dijeve shkencore.

Përditësimi i përhershëm i akademikëve me hyrjet e botimeve të reja në fondin e bibliotekës, është kryer nëpërmjet buletinit informativ në kontaktin online me ta.

Në fokus të informimit të komunitetit shkencor, studiuesve, kërkuesve shkencorë, studentëve e gjithë të interesuarve për shkencën kanë qenë botimet shkencore të Akademisë së Shkencave, titujt e rinj dhe periodikët shkencorë të vendit e të huaj që hyjnë në fondin e bibliotekës, njoftime të rëndësishme për ngjarje e konferenca shkencore, të cilat janë shoqëruar me informacione të detjuara dhe janë pasqyruar gjerësisht në faqen zyrtare të ASH dhe në rrjetet sociale.

Kualifikimi shkencor i stafit të bibliotekës, si një nevojë e kushteve të reja në sfidat, ambiciet shkencore dhe perspektivat që synon biblioteka shkencore e ASH, ka qenë një përparësi e vazhdueshme. Dy punonjëse të stafit mbajnë gradën “Doktor i Shkencave” dhe së shpejti dhe redaktorja e botimeve akademike do të mbrojë gradën “Doktor”. Ndërkohë që punonjësja e sallës së leximit (me gradën Master) po kryen shkollën e bibliotekonomisë pranë BK dhe së shpejti merr licencën si kataloguese, në trajnimin në kurset e kualifikimit profesional të drejtuar nga biblioteka e Akademisë së Shkencave, çka do të çojë në përshpejtimin e ritmeve të regjistrimeve të katalogimeve të bibliotekës sonë.

Botimet shkencore të Akademisë së Shkencave i janë përmbajtur kritereve të botimit të përcaktuara në rregulloren e botimeve në të gjitha proceset teknike -përgatitja e veprave për botim, redaktimi i tyre, procese të veçanta që lidhen me shtypshkrimin (radhitje, korrektim, faqosje librash) duke mundësuar këta tituj shkencorë:

- Monografi:

1. Androkli Kostallari, Vepra III, *“Fjalëformimi dhe leksikografia”*, 540f.
2. Androkli Kostallari, Vepra IV, *“Çështje të filologjisë shqiptare”*, 630 f.
3. Shaban Demiraj, *Histori e gjuhës së shkruar shqipe*, 130 f.
4. Dhimitër S. Shuteriqi, *Fjalor i Naim Frashërit*, 450 f.
5. Gjovalin Shkurtaç, *F.A. Santori - Satira*, 270 f.
6. Luan Omari, *Çështje juridike shoqërore*, 690 f.
7. Kristaq Prifti, *Gjenocidi dhe komplotet antishqiptare të serbomëdhenjve*, 450 f.
8. Salvator Bushati, Vilson Silo, *Bazat e gjeofizikës së zbatuar në shkencat e tokës*, 690 f.
9. Salvator Bushati, Efigjeni Kongjika, Niko Pano, Alfred Frashëri, Bardhyl Abdyli, Hajri Haska, Evis Taska, Gentian Muça, *Hapësira bregdetare Divjakë-Karavasta në Adriatik*, 500 f.
10. Vasil S. Tole, *“EP” për orkestër simfonike (partitura)*, 70 f.
11. *Kristo Frashëri - bibliografi*, 250 f.
12. Thoma Murzaku, *Koha kur u caktuan kufijtë e Shqipërisë (1912-1914)*, 700 f.
13. Albana Velianj, *Rite dhe simbole në dasmën tradicionale shqiptare*, 350 f.
14. Raporti vjetor 2016 i ASH.

15. Kontributet e SSHNT.

- **Revista shkencore**

1. JNTS 1-2017 (210 f.)

2. JNTS 2-2017 (210 f.)

3. JNTS 3-2017 (180 f.)

(Shih: <http://akad.gov.al/ash/botime/botime-ash>)

Nga sektori i botimeve është kryer dhe procesi i përgatitjes së konferencave shkencore dhe veprimtarive të tjera të zhvilluara nga ASH, përrurime botimesh shkencore, organizime ekspozitash, përgatitjet grafike (hartime e dizenjime të banderolave, fletëpalosjeve, posterave, ftesave) etj, disa prej të cilave janë: ceremonia e ndarjes së çmimeve shkencore kombëtare për botimet shkencore të vitit 2016; Konferenca e Voskopojës (ftesa, postera, baner etj.); përrurime dhe prezantime të botimeve të autorëve të ndryshëm: Jani Vangjeli, Efigjeni Kongjika, Androkli Kostallari (Vepra), Abaz Dojaka etj., Kongresi ndërkombëtar i organizuar nga SSHNT në bashkëpunim me shoqatën e Obstetrik-Gjinekologjisë, maj 12-14 maj 2017 (ftesa, postera, baner, libër abstraktesh etj.); simpoziumet shkencore: “Arqile Bërzholi - një jetë në kërkimin shkencor”; “Prenkë Jakova - në 100-vjetorin e lindjes” etj.

Ky sektor ka mundësuar gjithashtu pjesëmarrjen e ASH në Panairin Kombëtar të Librit, Tiranë 2017 dhe në panairët ndërkombëtare: Prishtinë 2017, Ulqin 2017, Shkup 2017.

Në aktivitetin shkencor të stafit numërohen botime dhe pjesëmarrje në konferenca shkencore; Biblioteka e Akademisë, ishte për herë të parë pjesëmarrëse në konferencën shkencore ndërkombëtare: ANKOS 2017: *Mësimdhënia dhe bibliotekat*, Turqi, prill 2017 (përfaqësuese e BASH, A. Velianj). Në të morën pjesë përfaqësues nga më shumë se 150 shtëpi botuese dhe gati 600 bibliotekarë nga e gjithë bota. Gjithashtu A.Velianj, ishte referuese si përfaqësuese e bibliotekës shkencore të ASH në “2nd meeting of the COBISS”, Seksioni i dytë i Këshillit të COBISS. Net), Slloveni, nëntor 2017, ku morën pjesë drejtuesit e bibliotekave kombëtare të rajonit. Ndër botimet shkencore e kumtimet e stafit të sektorit tonë përmendim:

A. Velianj, *Rite dhe simbole në ceremonialin e dasmës tradicionale shqiptare*, (monografi) Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë 2017;

S. Vaqarri (bashkautore me M. Korkutin) në përgatitjen e botimit “*Studime*” të A. Dojakës, 2017.

A. Velianj; *Bibliografia online: modeli dhe ndikimi në kërkimin shkencor (kumtesë)* në konferencën shkencore, *Bibliografite shkencore - një shërbim...*, Akademia e Shkencave, Tiranë shtator 2017;

A. Velianj, *Festivalet folklorike dhe turizmi. Trashëgimia shpirtërore si vlerë turistike* (kumtesë), konferenca shkencore *Java e Albanologjisë*, Instituti Albanologjik, Prishtinë, maj 2017;

S. Vaqarri, pjesëmarrëse në seminarin e datës me temë: “Arkivi digjital në Bibliotekën Kombëtare”, nëntor 2017.

Në kontekstin e veprimtarive shkencore të stafit, është kryer menaxhimi i procesit teknik dhe administrimi i dosjeve të kërkuesve shkencorë konkurrues për çmimet shkencore kombëtare të Akademisë së Shkencave për vitin 2017, nga sektori i botimeve dhe i bibliotekës.

Përparësi për vitin 2018

- Përpilimi i bibliografive të reja online të akademikëve dhe kërkuesve shkencorë nga fusha të ndryshme të dijes. **Përpilimi i bibliografisë online të akademikut Dhimitër Shuteriqi.**

Në këtë kontekst do të kryhet përrurimi dhe paraqitja e tyre për të gjithë rrjetin e informacionit shkencor në Shqipëri dhe në Kosovë. Nxitja dhe ndihma e specializuar për ndërtimin e bibliografive të tilla shkencore *online* edhe në bibliotekat e tjera shkencore universitare dhe speciale pjesëmarrëse në këtë sistem dhe prezantimi i tyre në bazën *online* duke krijuar kështu një informacion të hapur përmes këtij sistemi.

- Katalogu i botimeve shkencore të ASH me kopertina: vitet (2000-2017);

- Përgatitja e rubrikës online në faqen zyrtare të ASH: Periodiku i huaj shkencor në Bibliotekën e ASH (duke filluar nga vitet 2016, 2017 e në vazhdim);

- Trajnimi profesional i punonjësve të rinj të bibliotekave në Shqipëri e Kosovë, përmes bashkëpunimit të bibliotekës së ASH dhe IZUM-t, për katalogimin e përbashkët në këtë sistem si edhe për automatizimin e proceseve të bibliotekës.

- Krijimi dhe plotësimi i bazës së dhënave nga Biblioteka e Akademisë së Shkencave dhe bibliotekat e përfshira në sistem. Përfshirja e bibliotekave të reja në sistemin e përbashkët bibliografik online. Nxitja dhe harmonizimi i rregullave të katalogimit me rekomandimet dhe standardet ndërkombëtare dhe redaktimi i bazës së të dhënave për rritjen cilësore të regjistrimeve bibliografike dhe katalogut të përbashkët të informacionit.

IV. BASHKËPUNIMI ME JASHTË

ALLEA vazhdon të jetë një protagonist i rëndësishëm për akademitë e shkencave, eficientën dhe angazhimin e tyre, si edhe tek sfera ku shkenca takon politikën. Diskutimet në Asamblenë e Përgjithshme të këtij viti u fokusuan në tematikën mbi qëndrueshmërinë e sistemeve: në planin e emergjencave dhe fatkeqësive apo kërcënimeve të natyrës apo kërcënimeve globale, qëndrueshmërinë e institucioneve, qëndrueshmërinë e sistemit të shkencës dhe e produktit të kërkimit, drejtimet e reja në përgjigje të sfidave globale vecanërisht programi i projekteve shkencore pas 2020⁷. Tabloja më e gjerë lidhet me synimet për një zhvillim të qëndrueshëm dhe për një Europë të bashkuar, të qëndrueshme dhe të fortë përkundër sfidave. *Në këtë kuptim, sfera e kërkimit, arritjet, bashkëpunimi i shkencëtarëve për të zgjidhur sfidat e Europës së bashkuar, ka arritur të bëhet një prioritet kryesor për Bashkimin Europian.*

Specifika e kontributit të kërkimit nevojitet jo vetëm për zgjidhje problemesh e sfidash, por edhe për qëndrueshmëri dhe rezistencë në sfera të ndryshme profesionale, si dhe për zhvillimin ekonomik e shoqëror, për një Europë të Bashkuar. Në Asamblenë e Përgjithshme u paraqitën tablo, praktika të ndryshme, raste konkrete ku shkenca zgjidh probleme të kësaj natyre dhe hap perspektiva, duke qenë një faktor i vecantë në këtë drejtim. Institucionet shkencore mundësojnë qëndrueshmërinë e sistemeve, një kapacitet që, edhe nën kushtet e kërcënimit, mosfunksionit të pjesshëm, dëmtimit, të ndërtohet një kapacitet i brendshëm që të gjenerojë qëndrueshmëri e rezistencë.

⁷ Informacion më i detajuar gjendet tek raporti përkatës i ASH mbi punimet e Asamblesë së Përgjithshme 2017

Këtu duhet parë edhe sa qëndrueshmëri krijon shkenca në vetvete, pra që shkenca të jetë një sistem me nivel të lartë qëndrueshmërie. Prezantuesit nxorën në pah disa avantazhe të sistemit shkencor edhe në kushtet e shtërngesave dhe krizave, si infrastrukturën që e disponon dhe mund të vijojë ta përdorë, burimet njerëzore që janë prioritare për sa i përket nivelit të produktivitetit, aftësinë dhe hapësirën për të kombinuar burimet etj. Një rëndësi të jashtëzakonshme merr programi i BE-së për shkencën, FP7 dhe H-2020, që ka mundësuar ndërveprimin dhe bashkëpunimin, mobilitetin, afrimin e studiusve, ekipeve, institucioneve në projekte të përbashkëta.

SAM - Scientific Advice Mechanism

Bazuar në një projekt të Horizon 2020 (SAPEA), 5 rrjete të rëndësishme europiane janë bërë protagonistë në iniciativën e Komisionit European për të ndërtuar SAM - *Scientific Advice Mechanism*, që do të jetë në rolin e këshilltarit për shkencën pranë Komisionit European. Më herët funksiononte struktura e Kryekëshilltarit për Shkencën, nën varësinë direkte të Kreut të KE (Barroso). Presidenti i ri i KE-së Juncker vendosi përfundimin e këtij modeli dhe ndërtimin në vend të tij të një mekanizmi të tërë këshillues që përfshin: **i)** përfaqësim dhe drejtim të këshillimit nga institucionet e shkencës, me angazhimin direkt të 5 rrjeteve kryesore shkencore të Europës; **ii)** institucionet e veta kërkimore (nën KE-në) dhe **iii)** një front më i gjerë, shkencëtarë të shquar në fushën e tyre, të cilët do të kontaktohen apo kontraktohen direkt nga KE. Mekanizmi është ende në ndërtim e sipër, por edhe po funksionon paralelisht duke asistuar KE-në për politikën dhe strategjitë kryesore, sidomos në modelimin e një të ardhme të re për Europën. Mekanizmi përfshin edhe akademitë anëtare, për një pozicionim paralel me politikë-bërjen në vendet e tyre dhe në raport me nivelet politike kombëtare. ALLEA kontribuon efektivisht edhe duke mbledhur praktika të avancuara dhe duke i ndarë më gjerë me akademitë anëtare, si dhe orienton drejt praktikave dhe standarteve më të unifikuara. Këtë është duke bërë aktualisht edhe në drejtim të ASH, duke e asistuar në këtë proces reforme, me informacione, ekspertizë, shkëmbime e rekomandime.

Asambleja e Përgjithshme trajtoi gjerësisht efikasitetin e këshillimit shkencor, pengesat për një komunikim produktiv mes shkencës dhe politikës, praktika pozitive, relevancën dhe impaktin e këtij kontributi në politika, institucione, në një përcjellje konkrete, nëpërmjet urave të krijuara, politikave, apo tryezave ku shkenca komunikon me politikën. Komunikim shkencë-politikë ka edhe përtej strukturave formale, në tryeza, forume, takime, por parakusht është së pari ndërgjegjësimi i politikës për vlerat e kontribuara, dhe së dyti është e nevojshme të arrihet një cilësi më e lartë e këshillimit shkencor, dhe kërkimit në këtë funksion. Praktikën pozitive të shkëmbyera vecanërisht në vendet që kanë krijuar tashmë traditë: Gjermani, Hollandë, Norvegji, Finlandë, si dhe në vendet më të reja si Hungari, Çeki, Sllovakia etj, janë një model për të vijuar më tej, si dhe për të zgjeruar këtë dimension ndër vende të tjera.

Komisioni European ka zgjedhur të përfshijë akademitë në Mekanizmin e ri të Këshillimit Shkencor (Scientific Advice Mechanism - SAM) për të marrë rekomandime bazuar në të dhëna për formulimin e politikave të veta. Është sinjal i fortë dhe i qartë se shkenca ftohet të kontribuojë në nivelin më të lartë të proceseve që formësojnë të ardhmen. Në shumë raste, ky këshillim transnacional mund të ndihmojë akademitë në rolet e tyre kombëtare që të japin këshillim për politikën, sidomos kur perspektiva kombëtare është disi e ngushtuar. Pjesëmarrja aktive e akademive në këtë përpjekje, jo vetëm forcon ekspozimin ndërkombëtar të anëtarëve, por në të njëjtën kohë hap dyert edhe për rrjete të reja mbi-kombëtare.

Kuadri i komunikimit shkencë-politikë është më produktiv kur ka këshillim dhe produkt shkencor të një cilësie të lartë, kur ka kërkim të pavarur, kur ka vëmendje që produkti shkencor duhet të ketë një impakt, dhe kur shkencëtarët marrin një feedback⁸. Këshillimi

⁸ Një proces standard brenda ALLEAs është që kur paraqitet një problem apo çështje, ka së pari një vërshim idesh (brainstorming) për temat relevante, pastaj ka një skicim të pyetjeve, sfidave dhe pistave të kërkimit, kërkohen praktikën më

shkencor duhet të strukturohet, dhe duhet të funksionojnë hapësirat dhe proceset për dialog, të egzistojë kultura dhe kuadri që palët të ulen dhe të komunikojnë, të ketë institucionalizim të komunikimit mes agjencive⁹. Vihet re edhe nevoja për një orientim më i angazhuar drejt publikut. Në disa vende shihet një rënie e besimit të publikut tek shkenca. Akademitë dhe institucionet qendrore nuk mund të injorojnë frikën dhe preokupimet e publikut, dhe duhet të synojnë një angazhim publik. Por shihet gjithashtu edhe një kërcënim ndaj shkencës, me përhapje lajmesh të sajuara, denigrim të ekspertëve e studiuesve, trajtim jo të denjë të shkencëtarëve në mediat sociale. Në këtë kontekst cilësia dhe relevanca e kërkimit bëhet edhe më e domosdoshme, duke respektuar disa standarte të pakompromentueshme, për t'i ofruar shoqërisë, institucioneve, kërkim cilësor, fakte dhe gjetje që janë produkt i proceseve¹⁰. Rekomandohet që shkenca duhet të njohë faktin që mund të luajë disa role të ndryshme, që përgjithësisht duhet të angazhohet në terma afatgjatë, që duhet të komunikojë në mënyrë të përshtatshme, që duhet të ndjekë e të vijojë aktivitetet që ndërmerr, dhe shpesh të vijojë punën edhe pas publikimit të kërkimeve.

Kodi i Etikës

Produkti më i rëndësishëm i ALLEA-s ka qenë për 2017 *Kodi i rishikuar i etikës për integritetin në kërkimin shkencor*. Botimi i mëparshëm, ku ALLEA ishte përsëri kontribuesi kryesor, është ende në themel të procedurave të projekteve të H2020, duke përcaktuar rregullat dhe standartet që Komisioni European po aplikon dhe ndjek me rigorozitet për aplikantët dhe fituesit e projekteve në këtë kuadër. Versioni i rishikuar merr në konsideratë edhe shfaqje dhe sfida të reja, duke dhënë një kuadër më të plotë, me synimin për të shërbyer si një themel edhe për akademitë dhe institucionet kombëtare, për të vendosur dhe mbajtur standarte të lartë në kërkimin shkencor.

Programi shkencor FP9

ALLEA është përfshirë edhe përpilimin e rekomandimeve për programin që do vijojë pas Horizon 2020, të Programit të 9-të Kuadër, (materiali është disponibël si broshurë dhe i aksesueshëm në faqen online të ASH). Preokupimi kryesor është së pari vijimi i prioriteteve për ekselencën, forcimi i institucioneve për këtë qëllim si dhe përpjekja, mjetet dhe një strategji konkrete për të arritur një balancim mes vendeve dhe institucioneve të ndryshme. Aktualisht janë diskutuar por edhe përdorur mekanizma dhe skema mbështetëse. Ka vende si Norvegjia, Holanda, Gjermania që disa nga këto skema i kanë aplikuar në format kombëtar, duke dhënë mbështetje vetë në funksion të ERC; ka edhe vende që kanë ngritur skema të ngjashme me ERC. Hendeku që shihet për disa nga vendet europiane apo edhe për institucione të ndryshme, mbetet një sfidë që duhet adresuar. Hendeku ndikon jo vetëm në rezultat, por edhe në impaktin tek institucionet përkatëse, tek zhvillimi i vendit në përgjithësi. Nëse dështon gjithpërfshirja në zonën europiane të kërkimit, pasojat janë të konsiderueshme për Europën e Bashkuar. U theksua domosdoshmëria e ngritjes së qendrave lokale. Ndonjëherë, në funksion të një shpërndarje më të balancuar konsiderohen kuotat e shpërndara proporcionalisht brenda një programi (kombëtar apo rajonal), por folësit u shprehën që kjo nuk siguron formulën më të mirë për zhvillim.

të mira, dhe mbi këtë bazë edhe identifikohen dhe përzgjidhen kërkues, burimet më të mira për këto përcaktime. Më pas përpilohet raporti që i dërgohet Bordit të SAPEAs, kalon mes vlerësimit të ekspertëve të jashtëm (*peer-reviewed*), dhe vetëm pas kësaj i dërgohet Grupit të Nivelit të Lartë që përcjell produktin/këshillimin shkencor tek nivelet e larta politike të BE-së

⁹ Përgjithësisht kontaktohen nivele të larta (shtetërore, politike) në nivel institucional dhe individual. Kancelarja gjermane për shembull, fton shpesh shkencëtarë të njohur të fushave të ndryshme të shkencës për këshillime apo shërbime të kërkuara nga politika.

¹⁰ Kjo ka qenë edhe fokus i disa studiuesve: gjeneza e fakteve shkencore, faktet si rezultat i procesit shkencor.

Çështje relevante prioritare në Europë

Të dhënat masive - European Open Science Cloud (EOSC)

Janë krijuar platforma të të dhënave shkencore bazuar në projekte dhe që po funksionojnë prej dekadash, si psh., CODATA, World Data System dhe së fundi: European Data Cloud (mbështetur edhe nga Komisioni Europian. Shkenca e të dhënave është bërë jashtëzakonisht e rëndësishme, dhe shumica e institucioneve kërkimore ndërkombëtar po investojnë shumë në qendra dhe programe dedikuar këtij qëllimi. Për studiuesit, kjo nënkupton një qasje më të gjerë në shërbimet që mbështesin zbulimin e tyre shkencor dhe bashkëpunimin në të gjithë kufijtë disiplinorë dhe gjeografikë. *(Për më tepër informacion, mund të shihni Aneksin në fund)*

Shkenca e hapur/ Botimet e hapura

Qasja për Shkencë të Hapur (<https://cos.io/>), promovon një shkëmbim të hapur të ideve përshpejton përparimin shkencor drejt zgjidhjes së problemeve tona më të vazhdueshme. Sfidat e sëmundjes, varfërisë, arsimit, drejtësisë shoqërore dhe mjedisit janë shumë urgjente dhe nuk duhet humbur kohë në studime që nuk kanë rigorozitet, rezultate që nuk ndahen kurrë dhe rezultate që nuk janë të riprodhueshme. Përtej aspektit teknik, kjo kërkon edhe një ndryshim të kulturës mes shkencëtarëve dhe institucioneve, për t'iu përshtatur në mënyrë efikase këtij kuadri të ri.

Në vitet e fundit promovimi dhe pranimi i Qasjes së hapur është rritur në mënyrë të vazhdueshme midis akademikëve dhe, me ardhjen e agjendës së Komisionit Europian për Shkencën e Hapur, gjithnjë e më shumë edhe me politikë-bërësit. Është një orientim që promovohet nga akademitë e shkencave dhe institucionet shkencore për të ofruar falas botimet shkencore, që të mundësohet akses i lehtë dhe pa pengesa i literaturës dhe të rejave shkencore për studiuesit, sidomos studiuesit e rinj. Mbështetja politike është e nevojshme dhe nuk po marrim atë që nevojitet. Politika duhet ta bëjë Qasjen e Hapur një prioritet dhe ta përfshijë në kuadrin e politikave të veta. Progresi ndodh kur ka politika reale dhe legjislacion - ligj konkret. Aktualisht politikanët i dëgjojnë diskutimet që vijnë nga komuniteti shkencor. *(Për më tepër informacion, mund të shihni Aneksin në fund)*

Procesi i Berlinit

Konferenca e Parisit, si takimi i 3-të i *Procesit të Berlinit*, iu kushtua investimit për shkencëtarët e rinj dhe lidhjes midis arsimit, inovacionit dhe rritjes ekonomike e punësimit. Konferenca vendosi t'i rekomandojë mbledhjes së kryetarëve të shteteve e qeverive të vendeve të procesit të Berlinit, (Trieste 2017) krijimin e Fondacionit të Kërkimeve të Ballkanit Perëndimor, me burime financimi nga Gjermania, Franca, Austria, Italia dhe vendet e tjera të BE-së dhe Europës Perëndimore. Kontributet e financimit të Fondacionit të Kërkimeve të Ballkanit Perëndimor nga vendet e BP mendohet të ulet nga 30 për qind në 20 për qind . Për aplikimet e shkencëtarëve të rinj u vendos të mos aplikohen kuota për çdo vend, por një kriter i vetëm: kredencialet e aplikanteve, pavarësisht vendit nga vijnë.

IAP

IAP ka qenë tepër aktive me iniciativa, deklarata, raporte/studime për çështje më interes të lartë global. Për shkak të natyrës, rëndësisë dhe relevancës së tyre, këto çështje janë shumë të rëndësishme për shumë nga akademitë anëtare, për të përfituar nga kontributet e shkencëtarëve më të mirë në botë. Gjatë këtij viti, kontributet e IAP kanë qenë të shumta:

- *Rezolutë mbi rolin e shkencës dhe teknologjisë në reduktimin e rrezikut nga fatkeqësitë (IAP 2017) - Përballja dhe qëndrueshmëria kundër rreziqeve natyrore, emergjencave. Kjo deklaratë është një shkrirje, me shtesa dhe rishikime, e Deklaratës së Tokios, Agjendës së Veprimit të Tokios, i propozimit me titull "Nxijtja e studimit ndërkombëtar për reduktimin e*

rrezikut të fatkeqësive dhe aftësisë ripërtëritëse dhe reduktimi i rreziqeve nga fatkeqësitë”, dhe i deklaratës së titulluar “Përforcimi i aftësisë ripërtëritëse ndaj katastrofave është thelbësor për zhvillimin e qëndrueshëm”. Deklarata e Tokios u miratua në janar të vitit 2015 dhe Agjenda e Veprimit e Tokios u miratua në të njëjtën kohë në Konferencën e Tokios mbi studimin ndërkombëtar për reduktimin e rrezikut dhe aftësinë ripërtëritëse ndaj fatkeqësive. “Nxitja e studimit ndërkombëtar për reduktimin e rrezikut të fatkeqësive dhe aftësisë ripërtëritëse dhe reduktimi e rreziqeve nga fatkeqësitë” u përgatit nga Këshilli Shkencor i Japonisë në shkurt të vitit 2016 dhe “Përforcimi i aftësisë ripërtëritëse ndaj katastrofave është thelbësor për zhvillimin e qëndrueshëm “ u botua në prill 2016 si pjesë e Deklaratës së Akademive të G-Shkencës 2016.

- *Mbi çështje të zhvillimit (SDG), Zhvillimi Urban, Smart city/Smart village,*

- *Sondazhi për Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm.* Udhëzuesi synon të inkurajojë akademitë të diskutojnë, përgatisin dhe bashkëpunojnë mes tyre dhe me aktorë të tjerë, duke përfshirë politikëbërësit. Shërben edhe si një “thirrje për veprim” për akademitë që të përfshihen, që:

1. të rritë ndërgjegjësimin për Objektivat ndër komunitetin shkencor global dhe drejtuesit e tij, në veçanti, ndër akademitë kombëtare;
2. të përmirësojë të kuptuarit e tyre se si do zbatohen Objektivat; dhe
3. të inkurajojë shkencëtarët dhe akademitë që të mbështesin Objektivat në mënyrë më efektive.

- *Grup pune mbi shëndetin urban.* Brenda kuadrit të iniciativës së IAP që synon një përpjekje globale për të zbatuar “Axe të Re Urbane të Habitatit të OKB-së” dhe Objektive të Zhvillimit të Qëndrueshëm të Mijëvjeçarit, IAP ka ndërtuar një grup pune mbi Shëndetin Urban, që nuk do jetë i fokusuar vetëm në sektorin e shëndetit. Ka një sferë veprimi shumë-disiplinare dhe përfshin të gjitha nëntemat e përcaktuara në materialin paraprak

- *Vlerësimi në lidhje me sigurinë për implikimet për kërkimin mbi genom*

- *Projekti për reduktimin dhe kontrollin e sëmundjeve nga mushkonjat* - Edukimi shkencor për këtë qëllim. Programi i Edukimit Shkencor i IAP ka punuar me Qendrën Smithsonian të Edukimit Shkencor (SSEC) për më shumë se një vit për të zhvilluar burimet e mësimdhënies në 'Zika' - një modul shkencor të shkencave komunitare globale që është duke u hartuar për të trajtuar sfidat dhe reduktimin e sëmundjeve nga mushkonjat, si Zika, dengju, chikungunya dhe malaria brenda komuniteteve lokale dhe globale.

IAP organizon çdo vit konkurimin për grante, për mbështetje projektesh që promovojnë synimet e përgjithshme dhe prioritetet kryesore të IAP. Nga ASH pati aplikime por asnjë nuk rezultoi fitues.

UAI

Në tetor 2017 u mbajt në Tokio, Japoni, Asambleja e Përgjithshme e UAI-së, ku mori pjesë edhe akad. asoc. Shaban Sinani. Ky takim pati rëndësi pasi u ASHAK u pranua anëtar i plotë me mbështetje dhe angazhim nga ASH dhe akademi të tjera partnere. Asambleja diskutoi dhe aprovoi edhe projekte të rëndësishme. Duke qenë vetëm me status vëzhguesi, sfera jonë është e kufizuar. U bisedua për avancimin e statusit dhe përfshirjen më tej në projekte. Për këtë janë marrë kontakte dhe janë diskutuar mundësi, por sfida kryesore është organizimi dhe koordinimi i aktorëve vendas. Është e nevojshme të promovohen dhe prezantohen projektet, perspektivat, projektet, mundësitë për partneritete dhe vlerat e shtuara.

AIIESEE

Këtë vit u organizua konferenca vjetore në Beograd, ku ASH e përfaqësoi (me kumtesë) Akad. Beqir Meta. Viojnë planifikimet për pjesëmarrjen në konferencën e radhës në 2018 dhe në Kongresin në 2019. Përfshirja mbetet në nivele modeste dhe ka pak jehonë në komunitetin

akademik vendas. Duhet koordinim dhe sinergji me Akademinë e Shkencave Albanologjike dhe departamentet e disa universiteteve kryesore.

Bashkëpunimi me akademi partnere

Me ASHAK

Edhe këtë vit marrëdhëniet janë organizuar kryesisht rreth aktiviteteve parashikuar në Protokollin e përbashkët 2018-2020. Këto janë pasqyruar me hollësisht në pjesët e seksioneve. E rëndësishme është që këto angazhime sjellin më afër studiuesit dhe institucionet. Ka çështje ku mund të shihet bashkëpunimi mes dy akademive: projekti për ALE, projekti për atlasin dialektor sintaksor i iniciuar nga Instituti i Gjuhësisë ku asnjë nga akademitë tona nuk janë pjesë. Kjo mund të jetë e dobishme vecanërisht në ato aspekte ku kapacitetet tona dhe të tyre nuk janë optimale.

Është diskutuar fillimisht por nuk ka pasur asnjë rezultat bashkëpunimi mes dy akademive për projekte të përbashkëta: as në kuadër bilateral (programet e IPA, programe me fonde të të dy vendeve etj.) programe rajonale apo programe europiane (si H2020). Një arsye është mungesa e institutive dhe qendrave në varësi, si dhe fakti që nuk ka pasur një angazhim për forma të ndryshme partneriteti për projekte.

Një pistë tjetër është mbështetja reciproke në një kuadër më të gjerë. Ashtu si dhe në rastin për anëtarësimin në AIESEE, ASH mbështeti kandidaturën dhe anëtarësimin e ASHAK në UAI. Edhe brenda kuadrit të Procesit të Berlinit, ASHAK dhe ASH bashkërisht kontribuan në orientimin dhe përcaktimin e disa aspekteve të ndjeshme lidhur me Fondin e Ballkanit Perëndimor për projekte shkencore.

Akademi të tjera partnere

Marrëdhëniet me akademitë austriake dhe gjermane kanë qenë përgjithësisht të mira. Në çështje të caktuara kanë demonstruar mbështetje si dhe asistencë, në kuadër të rrjeteve rajonale si dhe në kuadër bilateral, me asistencë e konsulencë për çështje të ndryshme.

Me akademitë e vendeve fqinje, konteksti ka qenë shumë pozitiv. Me Akademinë malazeze u nënshkrua edhe protokollin e bashkëpunimit mes dy akademive. Nga dy projektet në fushën e shkencave shoqërore albanologjike, ka pasur aktivitet në njërin nga projektet, ndërsa projekti tjetër është shtyrë disa herë dhe ende nuk ka marrë rrugë.

Me Akademinë maqedonase ka pasur shkëmbime dhe predispozicion të favorshëm. Nuk ka pasur ndonjë përfshirje intensive, aktivitetet bilaterale specifike apo rikthim tek tradita e javëve përkatëse shkencore për t'u organizuar njëherë në vit.

Me akademinë serbe ka pasur kontakte në aktivitete shumëpalëshe. Një takim mes përfaqësuesve u zhvillua në Asamblenë e Përgjithshme të UAI dhe u diskutuan çështje me interes.

Një intensifikim pozitiv ishte edhe në drejtim të Akademisë Rumune, me pjesëmarrjen në konferencën për Voskopojën, dhe rikthimin tonë brenda projektit ALE dhe rikompozimit me këtë rast të komitetit tonë kombëtar në këtë projekt.

Kontakte ka pasur edhe me Akademinë kineze dhe me institucione kineze. Në Nëntor 2017 u krye edhe një takim mes akad. K. Barjaba dhe zëvendës/drejtorit për Europën në Drejtorinë e Bashkëpunimit Ndërkombëtar të Akademisë së Shkencave Natyrore në Akademinë Kineze të Shkencave Shoqërore. Shkëmbime më të shumta kemi pasur me BFSU, një nga universitetet kryesore në Pekin, ku funksionon edhe katedra e albanologjisë: ligjërata, shkëmbime, mbështetje për studime doktorale, pjesëmarrje në konferenca shkencore etj. Në vitet e fundit, Kina ka paraqitur një projekt ambicioz për një korridor gjeo-strategjik: *Belt and Road*

Initiative, që në Europë konkretizohet me Iniciativën e 16 (vendeve) + 1, dhe përfshin investime jo vetëm në ekonomi, por edhe në shkencë, kulturë dhe marrëdhëniet mes popujve. Vëmendja është e konsiderueshme dhe krijon interes edhe për institucionet kërkimore.

Marrëdhëniet me publikun

Zhvillimet gjatë këtij viti janë nxjerrë në pah nevojën për një orientim, formal ose gjysëm formal, ndoshta në formën e një dokumenti kuadër, që të jetë bazë si në plan institucional - kryesisht për strukturat drejtuese, për akademikët, dhe më tej për zyrën e MJP dhe administratën që do të veprojnë edhe në bazë të udhëzimeve dhe detyrave që i caktohen rregullisht nga nivelet drejtuese. Këtu është mundësia për të përfituar nga eksperiencia e akademive partnere, nga praktikat më të mira, parime bazë që duhen pasur parasysh.

Akademia sigurisht nuk ka synim primar shkëlqimin dhe vëmendjen mediatike si organizatat që janë direkt në komunikim me publikun, partitë apo institucione të caktuara shtetërore. Edhe tematika tipike akademike jo gjithmonë është në krye të vëmendjes mediatike. Megjithatë, është një komponent i rëndësishëm për disa arsye:

- Akademia synon popullaritetin e shkencës, një imazh pozitiv dhe një inkurajim të mësuarit të shkencës (*science education/science literacy*)

- Në kuadrin e angazhimit në zhvillimin e gjithanshëm të vendit, shkenca synon të ketë një zë, jo vetëm në drejtim të politikës, për të influencuar politikë-bërjen, por edhe në drejtim të influencimit të publikut, popullarizimit të çështjeve dhe sfidave që artikulon shkenca.

Vëmendja e medias ka qenë relative. Ka pasur aktivitete dhe promovime që kanë ngjallur interes, dhe për disa aktivitete, media është treguar indiferente, ose për shkak të mungesës së interesit, ose për shkak të ngjarjeve më me interes në sferën politike, publike, sociale etj., që kanë konkurruar tematikën akademike.

Për disa aktivitete si psh., konferenca për Voskopojën, apo ngjarje si ato që lidhen me Procesin e Berlinit, mund të gjejnë hapësirë jo thjesht brenda emisionit informativ (lajmeve) por në emisione specifike kulturore apo emisione të pasdites, dhe më tej, personalitete që bëhen të pranueshëm për median dhe publikun, mund të jenë edhe pjesëmarrës në edicionet më të rëndësishme si debatet në kanalet kryesore kryesisht gjatë mbrëmjes. Fillimisht kjo mund të jetë për çështjet më interesante shkencore (këtë vit për shembull organizohet konferenca për figurën e Skenderbeut) dhe më tej mund të synohet më shumë. Këtu është e nevojshme që të dalin në pah personalitete që priten nga media dhe publiku, dhe për çështje që është treguar interes, gjë që mund të planifikohet paraprakisht në planin e masave që bën seksioni përkatës për çdo aktivitet (si nënseksion) në bashkëpunim me specialistin e MJP.

Një tjetër dizavantazh janë hallkat që mund të zbusin hendekun mes akademisë dhe medias/publikut. Ka pasur konferenca si psh., për letrat shqipe, për De Radën, për Kadarenë, por vijimi i kontributeve nuk funksionon, dmth, që këto contribute të barten, të përcillen tek universitetet, tek shkollat, dhe kështu mund të arrijnë edhe një public më të gjerë. Natyrisht që kjo bëhet tejet e vështirë, kur universitetet së pari nuk kanë demonstruar që kontributet akademike i përcjellin tek sfera e tyre kurrikulare, projektet apo punime të tjera brenda programit të studimeve. Universiteti është hallka e parë që do të vlerësonte dhe promovonte jehonën e punës dhe aktiviteteve akademike. Në këtë mënyrë do të ishte edhe pjesa e parë e audiencës së rritur në aktivitetet e ASH.


Mungesa e vëmendjes universitare është më e dukshme vecanërisht lidhur me aktivitetet dhe hapësirat që ofrojnë AIESEE dhe UAI, gjë që ka nevojë të jetë object i një veprimi të organizuar: promovim vlerash, prezantim çështjesh, projektesh, veprash apo eventesh, ndërtim partneritetesh brenda këtyre rrjeteve, intertesat konkrete që mund të kemi etj.

Akademitë e shkencave organizojnë edhe kontakte më të afërta me median, ofrojnë edhe trajnime për të orientuar dhe njohur gazetarët me çështjet e shkencës, për t'i kuptuar më mirë ato, rëndësinë dhe implikimet e tyre. Mendoj se kjo iniciativë kërkon një kontekst dhe predispozicion paraprak, një nivel të caktuar tek media dhe publiku më i gjerë.

Një drejtim me shumë interes janë çështjet globale të shkencës. Nga shumë akademi theksohet fakti që sfidat dhe çështjet globale janë vecanërisht të rëndësishme në drejtim të politikës, publikut dhe medias. Kjo ndikon edhe në rolin e, dhe imazhin për akademitë e shkencave. Ka pasur deklaratë me shumë rëndësi: Deklarata të ALLEAs, Deklarata të IAP, Deklarata nga samiti në kuadër të Procesit të Berlinit etj., të cilat mund të përcillen në mënyrë të organizuar dhe planifikuar tek media dhe publiku më i gjerë, gjë që ndikon më pas edhe në impaktin që do ketë ky ndërgjegjësim publik tek politikë-bërja. Për këtë qëllim shërbejnë: deklaratë për shtyp, organizim forumesh për këto çështje specifike, intervista me fokus të caktuar nga akademikë të fushës, organizim forumesh eksperte (që mund të dalin më pas me deklaratë), organizim ligjërimesh në akademi ose institucione universitare, kërkimore etj.

BOTIMET 2017

Monografi




Androkli Kostallari, Vepra III,
“Fjalëformimi dhe leksikografia”, 540f.

ISBN 978-9928-237-16-3


Androkli Kostallari, Vepra IV, “Çështje të
filologjisë shqiptare”, 630 f.

ISBN 978-9928-237-15-6

Numri i kopjeve: 300



Vëllimi përmban 13 studime e shkrime nga dy fushat kryesore fjalëformimi dhe leksikografia. Ndërsa në veprën IV “Çështje të filologjisë shqiptare”, ku janë përmbledhur 27 punime studimore që rrokin të trajtojnë çështje e problematika me interes në fushën e filologjisë shqiptare, të gjuhës e të letërsisë, të onomastikës e posaçërisht të kulturës së gjuhës të prof. Androkli Kostallarit.



Shaban Demiraj, *Histori e gjuhës së shkruar shqipe*, 130 f.

Monografia i kushtohet një teme deri sot unike në historinë e albanologjisë dhe të filologjisë shqipe, e cila ka të bëjë me zhvillimet që ka përjetuar gjuha shqipe dhe kultura e shkrimit shqip gjatë shekujve XVI-XIX në hapësirën kompakte shqipfolëse dhe në diasporë.

ISBN 978-9928-237-22-4

Numri i kopjeve: 400

Dhimitër S. Shuteriqi, *Fjalor i Naim Frashërit*, 450 f.

ISBN 978-9928-237-17-0

Vepra është jo vetëm burim të dhënash për leksikon e frazeologjinë e Naimit, por edhe burim të dhënash shkencore, mundësi referimesh për studime të mëtejshme gjuhësore, përmes krahasimesh me autorë bashkëkohorë, si Kristoforishi, Samiu, Vreto, Pasho Vasa etj. ose me studimet e disa albanologëve të huaj, si Xylander, Hahn, Dozon, nga autorë bejtexhinj e nga më të vjetrit veprat e Buzukut, Matrëngës, të Budit, të Bogdanit etj.

Numri i kopjeve: 300





Gjovalin Shkurtaj, *F.A. Santori - Satira*, 270 f.

Vepra e zbuluar disa vite më parë (1979), e transliteruar dhe pajisur me shënime të shumta nga prof. Shkurtaj e poeti dhe studiuesi arbëresh K. Kandreva, vjen i plotësuar dhe i pasuruar me shënime, sjell prurje me vlerë filologjike e dialektologjike prej të folmeve arbëreshe dhe të dialekteve të shqipes.

ISBN 978-9928-237-17-6

Numri i kopjeve: 300

Luan Omari, *Çështje juridike shoqërore*, 690 f.

Vepra përmban studime, trajtesa, propozime për çështje kushtetutshmërie dhe ligjshmërie në një vështrim më të gjerë në Shqipërinë e pas viteve 1990, pa përrjashtuar qasjet prapavajtëse për zhvillime të mëhershme në këto fusha.

ISBN 978-9928-237-18-7

Numri i kopjeve: 400



Kristaq Prifti, *Gjenocidi dhe komplotet antishqiptare të serbomëdhenjve*, 450 f.

Ky botim u bën të njohur studiuesve dhe publikut të gjerë, se situata në viset që iu shkëputën Shqipërisë më 1913, aspiratat e shqiptarëve të atjeshëm dhe perspektivat mbeten gjithnjë probleme aktuale.

ISBN 978-9928-237-21-3

Numri i kopjeve: 300

Salvator Bushati, Vilson Sillo, *Bazat e gjeofizikës së zbatuar në shkencat e tokës*, 690 f.

Sjellja e një botimi të tillë, me të dhëna shumëvjeçare dhe të përditësuar për nga njohja e monitorimit të terrenit, si dhe me analiza shumëdisiplinore të realizuara nga specialistët e shumtë të angazhuar për këtë botim do t'i shërbejë komunitetit të specializuar shkencor, studentëve pasuniversitarë dhe universitarë, si dhe shoqatave ambientaliste, komuniteteve prodhuese e menaxhuese të këtyre pasurive natyrore të paçmuara.

ISBN 978-9928-237-10-0

Numri i kopjeve: 300





Salvator Bushati, Efigjeni Kongjika, Niko Pano, Alfred Frashëri, Bardhyl Abdyli, Hajri Haska, Evis Taska, Gentian Muça, *Hapësira bregdetare Divjakë-Karavasta në Adriatik*, 500 f.

Botimi është fryt i një pune disavjeçare bazuar në të dhënat më të fundit të konsultuara me literaturë të gjerë bashkëkohore të fushave përkatëse të gjeofizikës. në punimet dhe artikujt shkencorë të vetë autorëve të këtij libri, si dhe të specialistëve shqiptarë e ndërkombëtarë, në përvojën e gjatë të tyre në kryerjen, drejtimin, përpunimin shifror në kompjuter dhe në interpretimin e integruar të punimeve të metodave gjeofizike.


ISBN 978-9928-237-02-6

Numri i kopjeve: 400

Vasil S. Tole, *"EP" për orkestër simfonike* (partitura), 70 f.

Vepra është kompozimi original për orkestër simfonike i prof. V. S. Toles. Në këtë vepër ndjehet *ndërlidhja profesionale e autorit me traditën muzikore të Shqipërisë, e posaçërisht riinterpretimi që ai i bën në rrugë bashkëkohore këtyre vlerave të trashëgimisë muzikore shpirtërore.*

Numri i kopjeve: 200



Kristo Frashëri - *bibliografi*, 250 f.

Numri i kopjeve: 300


Bashkim Kuçuku - *Kadare në kritikën botërore* (vëll. I-II, f. 2000).

Ky libër është i pari i këtij lloji, që, në origjinalin e 12 gjuhëve sjell pjesën më të madhe të shkrimeve dhe studimeve të kritikës botërore për veprën e Ismail Kadaresë, të shkruara nga studiues të fushave të ndryshme letrare, kulturore, antropologjike, profesorë, akademikë, shkrimtarë, të botuara në shtypin e përditshëm dhe periodik, në revista të specializuara në frëngjisht, gjermanisht, anglisht, spanjisht, italisht, portugalisht, suedisht,



holandisht, danisht, norvegjisht, finlandisht etj. Libri paraprihet nga një studim hyrës 15-20 faqe, i cili do të jetë shqip dhe frëngjisht, për të qenë në harmoni me lëndën e përgjithshme, dhe për të hyrë në biblioteka të huaja akademike dhe universitare, që është edhe një nga qëllimet kryesore të këtij botimi.

Numri i kopjeve: 200



Thoma Murzaku

Koha kur u caktuan kufijtë e Shqipërisë (1912-1914), 770 f.

Ky studim shkencor trajton një moment shumë të rëndësishëm të historisë shtetërore e kombëtare të shqiptarëve.

ISBN 978-9928-237-14-9


Numri i kopjeve: 400

Apollon Baçe - *Arkitektura civile ilire* (f. 650)

Kjo vepër vjen në një kohë kur mungojnë studimet analitike dhe sintetike për këtë problem në shkencën e albanologjisë. Në këtë monografi i është kushtuar një analizë e thellë çështjeve të arkitekturës, historisë antike, kulturës materiale dhe toponimisë antike të trevave ilire. Punimi mbart dhe një material ilustrativ, pa të cilin analiza e shembujve do të mbetet abstrakte.

ISBN 978-9928-237-21-7

Numri i kopjeve: 400




Shaban Sinani - *Hieronimi: në botën arbëreshe* (f. 444).

Duke përdorur në mënyrë jokonvencionale teknikat metodologjike të shkollave të ndryshme, libri shfaqet në formën e tij shumëkëndëshe si një refleksion organik i një periudhe të gjatë historike (shek XVIII-shek. XX). Studimi përmban analiza të drejtuara metodologjikisht drejt ekdotikës dhe kritikës letrare, dhe drejt antropologjisë kulturore dhe kulturologjisë.

ISBN 978-9928-237-19-4

Numri i kopjeve: 400




Perikli Qiriaz - *Trashëgimi natyrore e Shqipërisë - vlerat, rreziqet dhe menaxhimi*

Kjo monografi do të shërbejë si një pikë referimi për studiuesit e natyrës së vendit tonë dhe trashëgimisë natyrore. U vlerësua puna e autorit, si një bazë shumë e mirë shkencore për sensibilizimin e opinionit për njohjen, mbrojtjen dhe menaxhimin turistik të trashëgimisë sonë natyrore.

ISBN 978-9928-237-20-0

Numri i kopjeve: 400



Albana Velianj, *Rite dhe simbole në dasmën tradicionale shqiptare*, 350 f.

Punimi përmban prurje të spikatura për ritualin e dasmës tradicionale shqiptare, duke i çuar studimet në një stad të ri.

Numri i kopjeve: 300

Veshje popullore shqiptare në Kosovë, 166 f.

Kjo vepër është vëllimi i 5-të i korpusit “Veshje Popullore Shqiptare” në kuadrin e botimeve “Trashëgimia e Popullit Shqiptar” të Institutit të Antropologjisë Kulturore dhe Studimit të Artit, Departamenti i Etnologjisë, Tiranë

ISBN 978-99956-10-78-4

Numri i kopjeve: 500



DISA PËRPARËSI THEMELORE PËR VITIN 2018

1. Përmbyllja e procesit të reformimit ligjor institucional;
2. Hartimi dhe miratimi i akteve nënligjore dhe i atyre të brendshme;
3. Organizimi i zgjedhjeve të reja për Kryesinë e Akademisë së Shkencave, ringritja e organizmave të saj, dalja nga kriza e përfaqësimit;
4. Riorganizimi i veprimtarisë së seksioneve dhe shërbimeve;
5. Përgatitja dhe organizimi i konkursit për pranimet e reja në Asamble;
6. Reforma e brendshme në pajtim me kuadrin e ri ligjor, stabilizimi i vendit të Akademisë së Shkencave në kuadër të gjithë rrjetit të kërkimit akademik-universitar në vend;
7. Kryerja e të gjitha përgjegjësive për Vitin e Gjergj Kastriotit - Skënderbeut si ngjarja më e rëndësishme shkencore e vitit (me kontribute në konferencën ndërkombëtare, në ligjëratat magjistrale, me organizimin e konkursit për librin më të mirë nga autorë shqiptarë dhe të huaj kushtuar figurës së Skënderbeut, me botimin e tetë vëllimeve me dokumente të mbledhura dhe përgatitura nga akad. Kristo Frashëri, si dhe me botimin e një libri kushtim për këtë figurë, me studime të albanologëve më të njohur, enkas për këtë vit homazhi);
8. Zbatimi i pesë nismave shkencore që përmban protokollin e bashkëpunimit me ASHAK-un;
9. Integrimi i mëtejshëm institucional në rrjetëzimet ndërakademike botërore;
10. Zbatimi i prioriteteve të propozuara nga SSHTN etj.

Drejtime përparësore në kërkime dhe teknologji për vitin 2018 (SSHNT)

Në përputhje me prioritetet e vendit, bazuar në Strategjinë Kombëtare për Kërkimin e Inovacionin 2017-2020 dhe strategjitë e zhvillimit, për vitin 2018 Seksioni parashikon të zhvillojë disa veprimtari kryesore.

SSHNT, si një nga dy seksionet ku zhvillohen veprimtaritë për kërkim e zhvillim të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë (ASHSH) në përmbushje të misionit të saj, gjatë vitit 2018 do të synojë realizimin e veprimtarive në disa drejtime kryesore, në:

- këshillimin dhe ekspertizën e nevojshme për institucionet politikëbërëse dhe vendimmarrëse në fushat e kërkim-zhvillimit;
- paraqitjen e arritjeve dhe problematikave të kërkim zhvillimit, në fushat përparësore të zhvillimit të përgjithshëm të vendit nëpërmjet organizimit të kongreseve, konferencave e workshopeve/debateve shkencore në shkallë kombëtare e ndërkombëtare;

- bashkëpunimin me institucionet qeveritare në identifikimin e problematikave për angazhimin e ASHSH-së në realizimin e objektivave të Qeverisë, në grupe qeveritare, nderministrare, borde, këshille, grupe ad hoc, etj;
- bashkëpunimin me institucionet kërkimore dhe mësimore brenda dhe jashtë vendit, për kryerjen e studimeve në fusha të ndryshme të shkencës e teknologjisë, për hartimin e programeve kombëtare e dypalëshe, ekspertizave dhe monitorimeve të ndryshme në shkallë vendi etj.;
- bashkëpunimin me biznesin dhe prodhuesit në të gjithë nivelet, në lidhje me zbatimet e produkteve të kërkimeve shkencore e inovative në veprimtaritë ekonomike;
- transferimin e teknologjive inovative nga rrjeti i akademive të shkencave të botës (InterAcademy Partnership), ai vendeve të Europës (All European Academies) si dhe nga institucionet kërkimore shkencore, me të cilat Akademia bashkëpunon brenda e jashtë vendit, në ato të veprimtarive prodhuese;
- botimin e organeve periodike dhe veprave të tjera me nivel të lartë shkencor;
- zbulimin, mbështetjen, nxitjen dhe promovimin e talenteve të reja të kërkuesve shqiptarë në shkencë brenda e jashtë vendit, për të realizuar nivele të larta kërkimi në Shqipëri, si dhe për të krijuar e mbështetur strukturat e saj të përfaqësimit në komunitetin shkencor e veprimtaritë prodhuese etj.

Në realizim të këtyre prioriteteve do të zhvillohen veprimtari të ndryshme, si: workshop-e, forume shkencore, projekte etj. Gjithashtu, akademikët e SSHNT-së do të vazhdojnë kontributin e tyre duke drejtuar dhe marrë pjesë në projekte ndërkombëtare në fusha të ndryshme të kompetencës, si të teknologjisë së informacionit, energjisë në përgjithësi e asaj të rinovueshme në veçanti, transportit, edukimit, rasteve emergjente dhe problematikave që lidhen me to etj. Konkretisht sipas fushave zhvillimore synohet të kryhen veprimtaritë si më poshtë:

Në fushën e bujqësisë:

- Konferencë shkencore “Teknologjitë inovative në bujqësi me impakt pozitiv, të shpejtë dhe afat gjatë”;
- Forumi “Gjendja dhe drejtimit e ardhmërisë së kërkimeve dhe teknologjive gjenetike për zhvillime inovative në Shqipëri në mbështetje edhe të Programit të Qeverisë”;
- Seminar shkencor “Bioteknologjia moderne bimore dhe efektet në ekonomi” me Dr Agim Ballvora, Gjermani, SSHNT (ASHSH) në bashkëpunim me UT dhe UBT;
- Takime shkencore me shkencëtarë, pasuniversitarë, grupe të palëve të interesit, komunitetit të biznesit e prodhuesve si dhe shoqërisë civile për problematika të kohës (SSHNT në bashkëpunim me institucione shkencore e mësimore, biznes e shoqata etj.)
- Ngritje e kapaciteteve të diseminimit të produktit të kërkimit shkencor me një open access të revistës JNST në Google scholar.
- Veprimtari shkencore me tematika në mbështetje të Programit të Qeverisë 2017-2020

Në fushën e energjisë:

- Forum shkencor mbi metodologjitë inovative për simulimin e Klimës në mbështetje të realizimit të zhvillimeve të pritshme në fushën e energjive të rinovueshme, diellore, të erës, gjeotermale etj.;
- Forum shkencor mbi gjendjen dhe perspektivën e zhvillimit që duhet të ketë industria hidrokarbure e minerare në Shqipëri;

Në fushën e pasurive ujore:

- Forum shkencor mbi të ardhmen e planeve të menaxhimit të baseneve ujore në këndvështrimin e Strategjisë kombëtare të menaxhimit të integruar të burimeve ujore të re të Shqipërisë dhe problematikave që lidhen me to;
- Studime në drejtim të promovimit të energjisë së rinovueshme dhe efijencës së energjisë, në shfrytëzimin e pasurive ujore lumore, duke garantuar dhe mbrojtjen e mjedisit;
- Studime në investigimin e gjendjes, monitorimit dhe rrugët optimale për rihabilitimin dhe parandalimin e rrisqeve në basenet ujore të veprave hidro-energjitike dhe ujitje-kullimit;

Në fushën e ushqimit dhe sigurisë ushqimore:

- Kërkimi shkencor në problematikën e sigurisë ushqimore të prodhimeve nga tregu vendas dhe importi;
- Forume shkencore sensibilizuese me të rinj për të ushqyerit e shëndetshëm “slow food” në parandalimin e sëmundshmërive dhe në përmirësimin e cilësisë së jetës;

Në fushën e infrastruktura dhe shëndetit:

- Veprimtari shkencore në mbështetje të rritjes së kapaciteteve shkencore të infrastrukturës rrugore nën këndvështrimin e reformës së sistemit shkencor në Shqipëri;
- Forum shkencor për zhvillimin portual dhe problematikën që lidhen me hapësirat *on shore* dhe *off shore* (erozioni bregdetar, sedimentologjia, eutrofikimi i ujërave, modelimet e dinamikës hidraulike të ujërave bregdetare, studimet gjeologjiko-inxhinjerie dhe tregues të tjerë);

Në fushën e kujdesit social:

- Konferencë shkencore nderkombëtare për moshën e tretë dhe sëmundshmërinë;

Në fushën e arsimit e shkencës:

- Forume shkencore për kontributin aktiv të ASH në reformën e sistemit të kërkimit shkencor: në Strategjinë Kombëtare për Kërkimin, Teknologjinë e Inovacionin, strukturës së sistemit të kërkimit shkencor dhe legjislacionit;
- Rritja e kapaciteteve të ASH në fuqizimin e rolit të saj në kërkim - zhvillimin e vendit;

Në fushën e emergjencave civile dhe rrisqet natyrore:

- Studim mbi nevojat e shkencës dhe teknologjisë për reduktimin e riskut fatkeqesive natyrore. (grup pune i Inter Academy Partnership për shkencën).

Në fushën e politikave të jashtme, integrimi europian dhe kërkuesit shqiptarë në diasporë:

- **Kërkuesit e rinj shqiptarë në botë, faktor kyç në krijimin e resurseve shkencore** për zhvillimin e qendrueshëm në Shqipëri dhe më gjerë;
- Inpute: konsulencë dhe ekspertizë në diplomacinë shqiptare (*science for the diplomacy*) dhe vs.

Disa detyra për vitin 2018 (SSHSHA)

Projekti i punës shkencore të SSHSHA për vitin 2018 do të përcaktohet nga Ligji i ri për Akademinë e Shkencave, Statuti i Akademisë, ndryshime që mund të ketë në strukturë etj. Prandaj kjo pjesë mbetet për t'u rikonceptuar dhe diskutuar në mbledhje të posaçme, mbasi të jetë miratuar reforma në Akademinë e Shkencave. Gjithsesi, krahas atyre zërave të realizuar në vitin 2017, aspekte të pandryshueshme mbeten edhe:

1. SSHSHA do të vazhdojë të aktivizohet për paraqitjen dhe mbrojtjen e akteve ligjore e nënligjore për reformën në ASH.

2. SSHSHA do ta shohë si një detyrë urgjente tejkalimin e shpërpjesëtimeve që janë krijuar midis shkencave humane dhe atyre teknike në përbërjen e Asamblesë duke kërkuar hapje fushash për pranime të reja.

3. Të gjithë prioritetet e protokollit të bashkëpunimit me ASHAK-un për këtë vit janë përgjegjësi e SSHSHA (pesë konferenca).

4. SSHSHA është seksioni që do duhej të mbante peshën e drejtimit shkencor të konferencës kombëtare kushtuar Gjergj Kastriotit - Skënderbeut, që do mbahet këtë vit. Përgatitjet filluan para disa muajsh. U dërguan ftesat, u realizuan komunikimet me studiues të huaj dhe shqiptarë. Por me kërkesë të Ministrisë u krijua një komision i posaçëm, i cili merr gjithë kompetencat për organizimin e konferencës ndërkombëtare.